

UDHËTIMI I HEROIT



Hjun Suk Folei

UDHËTIMI I HEROIT

Hjun Suk Folei



Udhëtimi i Heroit

Hjun Suk Folei (Hyun Sook Foley)

Originally published in English under the title:

The Hero's Journey

© 2021 The Voice of the Martyrs Ltd.

All Rights Reserved

Copyright © 2021 Eric Foley, Hyun Sook Foley

Disa detaje (emrat personale, emrat e vendeve dhe datat) janë ndryshuar për arsye sigurie.

Botuesi | Eric Foley, Hyun Sook Foley Shtypja | Zëri i Martirëve Kore

Email: info@vomkorea.com

Website | <https://vomkorea.com>

ISBN 979-11-88129-33-1 (03230)

Përktheu nga anglishtja: Edlira Roberts

Redaktoi: Enkeleda Hebibasi

Citimet e Shkrimit të Shenjtë në shqip janë përkthim i vargjeve të zgjedhura nga autorja e librit sipas versionit të Biblës së përdorur nga ajo në anglisht: New International Version, NIV, New King James Version, NKJV ose King James Version, KJV.

Udhëtimi i Heroit

Le t'ju ndihmojnë të arratisurit koreanoveriorë që ta transformoni historinë e jetës suaj nga një viktimë në një fitimtar.

Përmbajtja

HYRJE	5
KAPITULLI 1. Dr. Folei: Udhëtimi i sigurt	24
KAPITULLI 2. Znj. Hong: Udhëtimi i heroit për tek e vërteta	51
KAPITULLI 3. Profesori Ço: Mendësia e Heroit	69
KAPITULLI 4. Znj. Ahn Heroina e çalë	88
KAPITULLI 5. Z. Kim: Udhëtimi ngurrues	98
KAPITULLI 6. Znj. Jang: Udhëtimi është një punë tejet e vështirë . . .	128
KAPITULLI 7. Znj. Jun: Udhëtimi me patate mbi shpinën e saj	144
KAPITULLI 8. Z. Li: Ecja me zvarritje e heroit	162
KAPITULLI 9. Znj. Seo: Lufta për çdo hap	176
KAPITULLI 10. Z. Park: Udhëtimi në hapat e mamasë së tij	189
KAPITULLI 11. Znj. Hur: Udhëtimi drejt martirizimit	209
PËRFUNDIMI: Udhëtimi juaj	224
PASTHËNIE: Ecja së bashku përgjatë udhëtimit tuaj si hero	233
BIBLIOGRAFIA	241
PËR AUTOREN	245
ÇFARË ËSHTË “ZËRI I MARTIRËVE”?	246

Hyrje

Ky libër është menduar që të jetë një libër shprese për ju. Shpresa ime është që ky do të rezultojë të jetë një libër tek i cili ju mund të ktheheni, kurdoherë që ndiheni sikur e keni humbur rrugën dhe sikur jeta nuk ka shumë kuptim. Lutja ime është që ai të mund t'ju ndihmojë të tregoni, dhe në këtë mënyrë ta përjetoni vetë, historinë e jetës suaj, ndryshe nga sa keni bërë më përpara. Unë do t'ju tregoj singlerisht historinë time për t'ju demonstruar sesi bëhet.

Por mësuesit e vërtetë të këtij libri janë dhjetë të mbijetuarit e mrekullueshëm prej qoshes më të errët e më të pashpresë në botë: Koresë së Veriut. Teksa i lexoni historitë e tyre, ju do të arrini të kapni një mesazh inkurajues dhe fisnik, i cili është mjaftueshëm i fuqishëm, sa t'i përshkojë si një tunel malet e pafundme të dëshpërimit në jetën tuaj. Por nuk është aq i fuqishëm sa t'ju tronditë, nëse betejat e së sotmes janë më se të mjaftueshme.

Mesazhi është ky: Mos u shqetësoni. Historia e jetës suaj do të dalë e mirë. Gjithçka që duhet të bëni është ta lejoni Perëndinë ta tregojë atë për ju.

Pjesa më inkurajuese e mesazhit është se, ndryshe nga ajo që mund t'ju kenë mësuar, ose ndoshta nga ajo që thjesht e keni supozuar, ju nuk keni pse të jetoni në fillim një jetë të suksesshme dhe *pastaj* ta tregoni historinë tuaj, sapo ajo të jetë lustruar e të bëhet e përsosur. Ju nuk ka pse të nisni të bëni befas zgjedhje madhështore dhe të prodhoni rezultate mahnitëse në çdo fushë që prekni, përpara sesa historia juaj t'ia vlejë për t'u dëgjuar e për t'u treguar. Në vend të kësaj, kur mësoni ta tregoni historinë tuaj ashtu siç bën Perëndia, ju do të zbuloni se me të vërtetë

tashmë jeni në mes të diçkaje vërtet të mrekullueshme, pikërisht në mes të vështirësive tuaja. Ju jeni tashmë në udhëtimin e një heroit / heroine.

Dhe pjesa fisnike e mesazhit është se nuk ka problem, nëse nuk jeni tipi heroik, sepse gjërat heroike vijnë prej Perëndisë. Ne jemi ata që i pranojnë gjërat e Tij heroike, nuk është e anasjella.

E di se mesazhi i këtij libri është i besueshëm dhe i vërtetë, por jo, ngaqë kam marrë ndonjë fjalë speciale prej Zotit për ju ose, ngaqë jam një optimiste e pashpresë. Përkundrazi, e di këtë gjë për tri arsye shumë faktike.

Së pari, një lexim nga afër i Biblës zbulon se Perëndia nuk i jep kurrë askujt një histori viktime, ose një jetë të dënuar për të dështuar. “Jo,” thotë apostulli Pal, “në të gjitha këto gjëra, ne jemi më shumë se fitimtarë, përmes atij që na deshi.”¹ Ai që na deshi ne është Perëndia. Qeniet njerëzore janë krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, dhe Perëndia nuk është viktimitë. Historitë e viktimave vijnë prej Satanit, i cili, sipas Gjonit 10:10, “vjen vetëm për të vjedhur e për të vrarë, dhe për të shkatërruar.”² Dhe asgjë nuk mundet t’jua vjedhë, t’jua vrasë dhe t’jua shkatërrojë jetën tuaj ashtu siç mund ta bëjë historia e një viktime. Perëndia, nga ana tjetër, vetëm tregon histori shpenguese, ose nga ato që mund t’i quajmë histori heronjsh. Dhe ai rezervon statusin e heroit për ata individë që thjesht besojnë në atë të vërtetë dhe në mirësinë e Tij, dhe në këtë mënyrë e lejojnë Atë ta rrëfejë siç duhet jetën e tyre. A nuk do të preferonit që historinë e jetës suaj ta tregonte Perëndia e jo Satani? Siç do të shihni në këto faqe, kjo është gjithçka që kërkon të qenit një hero / heroinë.

Së dyti, pothuajse dy dekada punë me të arratisurit nga Koreja e Veriut dhe me të krishterët, më kanë bërë ta kuptoj se ndryshimi mes atyre që janë të lumtur dhe atyre që janë të

¹ Romakëve 8:37, NIV.

² Gjoni 10:10, NIV.

traumatizuar nuk qëndron në përvojat e tyre të pashoqe, por më tepër ka të bëjë me kornizën treguese që përdorin ata për t'i kuptuar e për t'i rrëfyer historitë e tyre. Ky libër është produkti i trajnimit të koreanoveriorëve të traumatizuar për t'i treguar historitë e jetës së tyre duke përdorur një kornizë ndryshe nga ajo që ata kishin mësuar në Korenë e Veriut ose të Jugut. Ajo kornizë e ndryshme është “udhëtimi i heroit” të Jozef Kampbellit (Joseph Campbell) siç është analizuar tek *Heroi me Njëmijë Fytyra*. Kampbelli besoi se kjo prapaskenë me dymbëdhjetë faza mund të shihej pas historive të heronjve në secilën kulturë të botës.³ Është për t'u habitur se me vetëm pak fare drejtim të jashtëm (thjesht atë lloj që mund ta marrësh prej leximit dhe punimit të ushtrimeve në këtë libër), për këta koreanoveriorë u bë i mundshëm ndryshimi i jetës, ngaqë ata e ndryshuan mënyrën sesi i treguan historitë e tyre, si menduan për to dhe si i jetuan ato. Në pak a shumë të njëjtën mënyrë, ju mund të mësoni ta ndryshoni mënyrën sesi e tregoni historinë *tuaj*, dhe mënyrën sesi mendoni për të. Dhe më e mira nga të gjitha, ju mund ta ndryshoni mënyrën sesi e jetoni atë, që tani e tutje.

Arsyeja e tretë, që unë e di, se mesazhi në këtë libër është i besueshëm dhe i vërtetë, është sepse *vetë jeta ime* është transformuar rrënjësisht duke e ndryshuar kornizën time treguese. Ndoshta ashtu si edhe ju, përgjatë viteve unë kam përjetuar një numër episodesh psikologjike, shpirtërore dhe fizike, që ishin thuajse shkatërruese, përfshirë këtu pothuajse humbjen e shëndetit, divorcin, abuzimin fizik, dhe vuajtjen prej tradhtisë së dhimbshme nga miqtë e afërt. Teksa secili episod i dhimbshëm i shtohet historisë së jetës sime, tundohesha gjithnjë e më tepër për ta treguar atë si një histori të trishtuar, të thyer dhe zhgënjyese.

³ Joseph Campbell, *The Hero with a Thousand Faces (The Collected Works of Joseph Campbell)*, [Heroi me njëmijë fytyra]3d ed. (Novato, CA: New World Library, 2008), 1.

Por ajo që mësova në procesin e kërkimit të formave të tregimit, ishte se shtegu për tek ndryshimi pozitiv i jetës nuk filloi me mua që në njëfarë mënyre po nisja t'i kisha gjërat siç duhej në jetën time, por përkundrazi, me mua që së pari po e vija siç duhej vetë kornizën treguese. Në fakt, derisa ta kuptoni siç duhet kornizën tuaj treguese, shumë pak gjëra të tjera do të shkojnë mirë në jetën tuaj. Korniza e gabuar treguese do t'ju drejtojë që të bëni zgjedhje jo të kënaqshme, ashtu siç bëra unë. Kisha nevojë të mësoja ta tregoja, ta dëgjoja dhe ta jetoja historinë time për lavdinë e Perëndisë, jo për timen. Kjo do të thoshte që duhej ta përqafoja formën e Tij për tregimin, e cila është gjithnjë e hirshme, shpenguese, dhe e përqendruar te Krishti, e jo tek format e tregimit të kulturave përreth meje (ato amerikane dhe koreane), që ishin ose të përqendruara tek vetja, të bazuara mbi turpin, ose të orientuara kah suksesit.⁴

Për ta përmbledhur, mësimi sesi ta dëgjoni dhe ta tregoni historinë tuaj në mënyrën sesi e bën atë Perëndia, është çelësi për të ardhur në një paqe më të madhe me veten, me të tjerët, dhe me Perëndinë, ndonëse ju mund të ndodheni në mes të rrethanave pothuajse të pamundura. Në fund të fundit janë pikërisht këto sfida që e bëjnë historinë tuaj kaq të mirë dhe të rëndësishme.

Megjithatë, më duhet të theksoj se ky libër nuk është një thirrje për të menduarin pozitivisht. Fakti që Perëndia nuk i jep asnjërit një histori viktime, nuk do të thotë se Perëndia na jep drejtpërdrejt histori pozitive, ose se Perëndia, në ndonjë mënyrë, na shpëton prej dhimbjes, nëse thjesht do të kishim qëndrim pozitiv për jetën. Edhe një vështrim i shpejtë tek Bibla zbulon se udhëtimi i heroit jo vetëm që kalon përmes periudhave kohore të rrënimit më të errët, por ai madje mundet që, nga ana e jashtme, të përfundojë atje, pa e arritur ndonjë fund të lumtur të dukshëm. Shqyrtojeni

⁴ Dan P. McAdams, *The Redemptive Self: Stories Americans Live By* (New York, NY: Oxford University Press, 2006).

përmbledhjen e mëposhtme të historive të heronjve të Biblës tek Hebrenjve 11:36-39:

Disa u përballën me tallje dhe kamxhikë, madje edhe me pranga e burgim. Ata u vranë me gurë; u sharruan më dysh; u vranë me shpatë. Ata u endën të veshur me lëkurë delesh e dhish, varfanjakë, të përndjekur dhe të keqtrajtuar — bota nuk ishte e denjë për ta. Ata u endën nëpër shkretëtira dhe në male, jetuan nëpër shpella dhe në guva nëntokë.

Që të gjithë këta u lavdëruan për besimin e tyre, e megjithatë asnjë prej tyre nuk e mori atë që iu ishte premtuar.⁵

Sipas Biblës, ajo gjë që i bën këto histori “histori heronjsh”, nuk është fakti që njerëzit e këtyre historive praktikuan fuqinë e të menduarit pozitivisht, por është Perëndia. Me fjalë të tjera, vargu 39 është i paplotë pa vargun 40. Të marrë së bashku, që të dy vargjet lexohen kështu:

Që të gjithë këta u lavdëruan për besimin e tyre, e megjithatë asnjë prej tyre nuk e mori atë që iu ishte premtuar, ngaqë Perëndia kishte planifikuar diçka më të mirë për ne, që ata të mund të përsoseshin vetëm së bashku me ne.⁶

I përndershmi Mark Holsinger, drejtori ekzekutiv afatgjatë i Misionit të Los Anxhelosit, e kishte zakon të dëgjonte me durim teksa burrat e pastrehë vinin rrëfeshin tek ai, me rrëke lotësh, sesi ata i kishin braktisur familjet e tyre, punët dhe respektin për veten dhe ia kishin shitur shpirtrat alkoolit. Kur i përfundonin historitë e tyre të thyerjes dhe dëshpërimit, I Përndershmi Holsinger shtonte butësisht: “Por Perëndia.” Në mënyrë të pashmangshme burrat përgjigjeshin: “Por Perëndia çfarë?” Atëherë

⁵ Hebrenjve 11:36–39, NIV.

⁶ Hebrenjve 11:39–40, NIV.

I Përndershmi Holsinger do të thoshte, i ndriçuar: “Tani ju po bëni pyetjen e duhur!”⁷

Përgjigjja entuziaste e të Përndershmit Holsinger shpie tek një e vërtetë e dytë lidhur me atë se çfarë *nuk* është ky libër. Ky libër nuk është një udhëzues për të mësuar sesi ta redaktoni historinë tuaj me qëllim prodhimin e një identiteti të lustruar, të qëndrueshëm dhe të përfunduar, tek i cili të kapeni për pjesën tjetër të jetës suaj. Një “identitet dëshmie” i tillë mund të na bëjë ne dhe të tjerët që të ndihemi mirë, por ai nuk është në përputhje me mënyrën sesi na shpengon dhe na dishepullon Perëndia.

Për atë kohë sa të jemi gjallë, Perëndia do të vazhdojë t’u shtojë ngjarje historive tona. Secili episod i ri ka shumë të ngjarë që t’i kthejë tregimet tona përmbys, shpesh në mënyra të paparashikuara. E shihni se ajo shprehja: “Por Perëndia” nuk është diçka që e themi vetëm për ta ngushëlluar veten, kur gjithçka shkon keq; është gjithashtu një kujtesë për të qenë të përlurur dhe të varur krejtësisht nga Perëndia, kur gjithçka shkon saktësisht siç do të donim ne të shkonte. Çdo ditë e jetës sjell kthesa dhe ndryshime e rishikime në tregimet e jetës sonë, dhe në disa ditë, tregimet tona ekzistuese bëhen pluhur e hi dhe harrohen. Në ato ditë, gjithçka që ne mendonim se e dinim për veten tonë, jetën dhe për Perëndinë kthehet në pluhur. Lajmi i mirë është se kjo, në fakt, është një pikë e zakonshme referuese përgjatë udhëtimit të heroit. Ashtu siç tha dikur menaxheri legjendar i bejsbollit, Sparki Anderson (Sparky Anderson): “Çdo njëzet e katër orë bota kthehet përmbys mbi dikë, që dikur ishte ulur sipër saj.”⁸ Mirësevini në udhëtimin e heroit.

⁷ Erik Folei, i intervistuar prej autorit, Monument, CO, USA, 14 Shtator 2013.

⁸ “Sparky Anderson Quotations,” Memorable Quotations, 10 mars 2014, lexuar te kjo faqe interneti: <http://www.memorablequotations.com/anderson3.htm>.

E vërteta është se, po të mos jemi të kujdesshëm, historitë e jetës sonë mund të na bëhen lehtësisht idhuj. Pasi e kemi vendosur se cilat janë historitë tona, nuk duam që t'i lejojmë të rriten, të zhvillohen, ose të ndryshojnë, madje edhe kur rrethanat tona të jashtme i ekspozojnë shtirjet e atyre tregimeve ekzistuese ndaj nesh (dhe ndaj kujtdo përreth nesh gjithashtu!). Në atë çast, historitë e jetëve tona nuk bëhen më historitë e Perëndisë, të cilat tregohen për ne dhe na tregohen edhe neve, por përkundrazi bëhen përpjekja jonë për t'i penguar historitë e Perëndisë që të zënë rrënjë më të thella në jetët tona.

Perëndia i urren pengesat. Ne mund t'i vlerësojmë kontrollin dhe stabilitetin, dhe mund të bëjmë gjithçka që ta shmangim dhimbjen, turpin apo paretë me çdo kusht, kurse Perëndia vlerëson rritjen e shëmbëlltyrës së Birit të Tij, Jezusit, në ne.

Ashtu siç do ta shihni përgjatë këtij libri, ajo është një pjesë, që e bën kornizën e udhëtimit të heroit kaq të fuqishme: sa herë që i ktheheni asaj për ta treguar historinë tuaj, ajo ndryshon! Ndonjëherë do të betoheni se jeni tek faza dhjetë ose dymbëdhjetë, por herën tjetër që ktheheni për ta hartuar kursin tuaj, do ta kuptoni se në fakt jeni në fazën katër, ose ndoshta jeni akoma në fazën e parë. (Pas pak do të ketë më tepër informacion lidhur me çfarë janë këto “fazat”.)

Dhe kjo është vlera e përdorimit të udhëtimit të heroit për ta treguar historinë tuaj: më tepër nga gjithçka, udhëtimi i heroit është një mënyrë për t'ju nxjerrë nga ajo që ndonjëherë quhet “tiranja e urgjencës”. Kjo është prirja e natyrshme e çastit të tanishëm për të ushtruar ndikim të madh mbi të gjithë historinë për jetën tuaj, ndonjëherë në mënyra që ju nanurisin për tek një ndjesi e panevojshme (dhe ndonjëherë pa besim, e për pasojë ndjesi mëkatore) dëshpërimi. Korniza e tregimit të udhëtimit të heroit është një kujtesë e vazhdueshme por e butë, se thuajse gjithmonë ka përmbysje pas atyre që duken si fund i lumtur, dhe pothuajse ka gjithmonë funde të lumtur pas atyre që duken si përmbysje.

Historitë e jetës thuajse asnjëherë nuk janë aq në ekstazë ose aq dëshpëruese sa ç'na duken neve, kur jemi të ngecur tek e tanishmja dhe përpiqemi të shohim përtej saj.

Është si ajo historia e vjetër kineze për bujkun dhe djalin e tij.

Një ditë një bujk po kujdesej për kuajt e tij, kur i biri e la hapur derën dhe një kalë i vjetër iku me të katra. “Oh!” - psherëtiu i biri. “Kjo është një gjë e keqe!”

“Si e di këtë?” - ishte përgjigjja e vetme e bujkut.

Ditën tjetër bujku dhe i biri nisën një ekspeditë për ta gjetur kalin e tyre të humbur, dhe zbuluan se kali ishte bashkuar me një tufë hamshorësh të egër. Bujku dhe i biri ia dolën mbanë t'i sillnin të gjithë kuajt brenda në vathën e rrethuar me gardh dhe tani ata kishin shumë më tepër kuaj sesa më parë. “Oh!” - tha tërë gëzim djali. “Kjo është një gjë e mirë!”

“Si e di ti?” - e pyeti i ati, pa treguar as gëzim, as dëshpërim.

Ditën tjetër djali po përpiqej të hynte fshehtas atje ku ishte njëri nga hamshorët e egër dhe hamshori e shkelmoi dhe e hodhi lart në ajër. Djali u përplas në tokë, dhe theu shumë kocka. “Oh!” - tha djali duke marrë frymë me zor. “Kjo është një gjë e keqe!”

“Si e di ti?” - e pyeti i ati, duke u ulur në gjunjë pranë tij.

Ditën tjetër në fshatin e tyre erdhi ushtria, duke i regjistruar të gjithë djemtë e rinj të cilët ishin në gjendje, për të shkuar të luftonin në një vend të huaj, prej të cilit pritej se vetëm pak do të ktheheshin në shtëpi. Por djalin nuk e regjistruan, për shkak të kockave të tij të thyera. “Oh!” - psherëtiu i liruar djali. “Kjo është një gjë e mirë!”

“Si e di ti këtë?” - e pyeti i ati.⁹

Si të krishterë, ne dimë diçka për karakterin e Atit tonë qiellor, të cilën bujku nuk e dinte: Perëndia na do dhe ai vazhdimisht dëshiron gjëra të mira për ne. Ashtu siç shkroi apostulli Pal:

⁹ “The Chinese Farmer,” (Bujku kinez) Inspire21, 10 mars 2014, lexuar te kjo faqe interneti: <http://www.inspire21.com/stories/lifestories/TheChineseFarmer>.

“Dhe ne e dimë se në të gjitha gjërat, Perëndia vepron për të mirën e atyre që e duan atë, që janë thirrur sipas qëllimit të tij.”¹⁰ Udhëtimi i heroit na kujton se jo që të gjitha ngjarjet e jetës sonë janë të mira, por në historinë që Ati ynë qiellor dëshiron të na tregojë neve për veten tonë, është se edhe në rrethanat më të këqija, Perëndia vepron për të mirën tonë. Ndryshe nga ajo bota e pasigurt e bujkut, secili prej nesh mund të ketë besim se është në udhëtimin e heroit. Dhe ne mund të jemi të sigurt, se vepra heroike e Perëndisë në Krishtin, e shpreh dhe do ta shprehë veten përmes historive tona, që edhe ne të bëhemi heronj gjithashtu. Ose trashëgimtarë (dhe bashkë-trashëgimtarë), siç e thotë apostulli Pal: “Tani, nëse ne jemi fëmijë, atëherë jemi edhe trashëgimtarë—trashëgimtarë të Perëndisë dhe bashkëtrashëgimtarë me Krishtin, nëse me të vërtetë marrim pjesë në vuajtjet e tij, me qëllim që edhe ne të mundemi gjithashtu të marrim pjesë në lavdinë e tij.”¹¹

Ajo lidhje e pandashme mes pjesëmarrjes në vuajtjet e Tij dhe pjesëmarrjes në lavdinë e Tij është një e vërtetë themelore për udhëtimin e heroit: bujku mund të mendojë se jeta është një seri qarkore e ngjarjeve të pakuptueshme, por Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezus Krisht nuk i jep askujt një histori që përbëhet nga ngjarje të tilla. Në vend të kësaj, Ai i merr vuajtjet tona si të Vetat dhe na fton t’i marrim vuajtjet e Tij si tonat, e gjitha kjo me qëllimin e shfaqjes së lavdisë së Tij në jetët tona dhe përmes tyre!

Si dikush i lindur në një familje të krishterë, unë i dija këto të vërteta; në fakt, ndoshta isha tepër e njohur me to. Ideja se Perëndia në një mënyrë apo tjetër arriti të përdorte gjithçka që më ndodhi në jetë për të mirë, - madje edhe gjërat që ndodhën si rezultat i dështimeve, të metave dhe mëkateve të mia, - ekzistonte në mendjen time, por jo në mënyrën si e jetoja jetën. Në vend që të thosha: “Por Perëndia,” unë e gjeta veten duke menduar *Por unë*, dhe si rezultat, historia që jetova ishte e imja dhe jo e Zotit.

¹⁰ Romakëve 8:28, NIV.

¹¹ Romakëve 8:17, NIV.

Nuk kisha siguri ose pritshmëri, madje as ndonjë ide se Perëndia mund të bënte një heroinë prej meje. Unë as që e mendoja se Ai do të më shndërronte mua në ndonjë lloj të krishtere, po qe se nuk do ta rregulloja veten time së pari.

Pastaj njëzet vjet më parë, nisa të takohesha me disa vëllezër e motra me të cilët jam afruar shumë, dhe mezi pres t'jua prezantoj juve. Po flas për koreanoveriorët, sidomos për ata që janë arratisur prej atje dhe tani jetojnë në Korenë e Jugut, dhe që po vijnë në njohjen e Krishtit. Teksa i lexoni historitë e tyre, shpresoj se do ta shihni që udhëtimi i heroit është jo vetëm i mundshëm, por është norma që Perëndia synon për secilën qenie njerëzore. Këta dezertorë e adoptuan historinë e Krishtit si të tyren, duke hequr dorë prej historive të vetme që kishin dëgjuar ndonjëherë për veten e tyre.

Ndoshta pak informacion për sfondin lidhur me Korenë e Veriut do të ishte ndihmues.

Popullsia e llogaritur e Koresë së Veriut është pothuajse njëzet e pesë milion njerëz,¹² por në shumë mënyra, Koreja e Veriut mund të përshkruhet si vendi i një historie: historisë së Kim Il Sung-ut.¹³

Teksa të gjithë koreanoveriorët rriten, atyre iu duhet t'i mësojnë përmendësh më tepër se njëqind histori lidhur me jetën e Kim Il Sung-ut. Kjo përfshin datat e sakta, emrat e vendeve, detajet, gjithçka.¹⁴ Në shkollë ata duhet të mbajnë fjalime për jetën e tij. Kurdoherë që bëjnë diçka gabim, si për shembull, nëse nuk studiojnë mirë, ata detyrohen prej mbikëqyrësve të tyre, të bëjnë autokritikë. Atyre iu duhet ta kujtojnë veten publikisht

¹² Central Intelligence Agency, *The World Factbook: Korea, North*, 2021, lexuar më 15 tetor 2021, <https://www.cia.gov/the-world-factbook/countries/korea-north/>.

¹³ Hyung-chan Kim and Dong-kyu Kim, *Human Remolding in North Korea: A Social History of Education* (Lanham, MD: University Press of North America, 2005).

¹⁴ Kim Hee Rin (pseudonym), intervistuar prej autorit, Seoul, Korea, 10 shtator 2013.

se Kim Il Sung-u gjithmonë mësonte mirë dhe se ata duhej të përgatiteshin për t'u bërë revolucionarë për të. Kim Il Sung-u është tema e pothuajse çdo historie të Koresë së Veriut, dhe natyrisht kjo do të thotë se Kim Il Sung-u është hero i pothuajse çdo historie koreanoveriore.¹⁵

Por kur koreanoveriorët ikin prej vendit të tyre, ata hyjnë në një botë, ku ka miliona e miliona histori. Prandaj, kur ata futen në Korenë e Jugut (ku tashmë janë stabilizuar për të jetuar tridhjetë e katër mijë dezertorë koreanoveriorë),¹⁶ ballafaqohen me realitetin se historia e Kim Il Sung-ut nuk është më e dobishme. Për ju e për mua, tregimi i historive tona është diçka me të cilën jemi mësuar pak a shumë ta bëjmë mjaft natyrshëm, që nga fëmijëria, kurse për koreanoveriorët, mësimi për t'i treguar historitë e tyre si ndonjë gjë tjetër, përveç se prova e besnikërisë ndaj Kim Il Sung-ut është mjaft sfiduese.¹⁷ Ata kapen shpejt pas historive që tregojnë të tjerët për ta, dhe ato histori zakonisht nuk janë fare pozitive. Natyrisht që dezertorët konsiderohen tradhtarë prej Koresë së Veriut,¹⁸ por ama edhe në Korenë e Jugut ka një paragjykim të madh kundrejt tyre.¹⁹ Shpesh ata shihen si dembelë, budallenj, të pandershëm dhe si persona të cilëve nuk mund t'iu zësh besë.²⁰ Në mënyrë tipike, ata nuk i kanë aftësitë për të mbijetuar në një ekonomi

¹⁵ Bae Hee Hyo (pseudonym), intervistuar prej autorit, Seoul, Korea, 7 prill 2012.

¹⁶ Ministry of Unification, *Policy on North Korean defectors*. Policy on North Korean Defectors< Data & Statistics< South-North Relations< 통일부_영문. Tërhequr më 30 shtator, 2021, from https://www.unikorea.go.kr/eng_unikorea/relations/statistics/defectors/.

¹⁷ Lee Sung Gi (pseudonym), intervistuar prej autorit, Seoul, Korea, 5 nëntor 2013.

¹⁸ Barbara Demick, *Nothing to Envy: Ordinary Lives in North Korea* (New York, NY: Spiegel & Grau, 2009), 234.

¹⁹ Jacques L. Fuqua, Jr. *Korean Unification: Inevitable Challenges* (Dulles, VA: Potomac Books, 2011), 80.

²⁰ Po aty., 79.

tregu moderne.²¹ Për ata edhe të folurit e gjuhës është i vështirë, ngaqë Koreja e Veriut dhe ajo e Jugut kanë zhvilluar dialekte shumë të ndryshme gjatë viteve të ndarjes së tyre dhe për shkak të zgjedhjeve të drejtuesve të tyre.²²

Në fund, shumë dezertorë koreanoveriorë i përvetësojnë këto tregime negative për veten e tyre, dhe rezultatet janë pothuajse fjalë për fjalë fatale: Dezertorët koreanoveriorë kanë përqindjen më të lartë të vdekjes për shkak të vetëvrasjes nga çdo grup tjetër në botë: më shumë se 16 përqind.²³ Kjo është një statistikë që të kthjellon mendjen, e cila tregon thjesht se sa vdekjeprurëse është të adoptosh një kornizë treguese të kujtdo, përveçse të Perëndisë, për të treguar historinë e jetës tënde.

Kjo është arsyeja se pse u përfshiva në dëgjimin e historive të jetës së dezertorëve koreanoveriorë dhe në trajnimin e tyre për t'i ritreguar historitë e tyre duke përdorur kornizën e udhëtimit të heroit. Vërtet që ishte një çështje për jetë a vdekje! Pothuajse çdo dezertor me të cilin jam ulur për të folur, më ka treguar historinë e tij ose të saj si një histori viktime, si një histori e pavlerë, me dhimbje të padurueshme ose si të dyja këto bashkë. Jeta e këtyre personave është e mbushur me kujtime të urisë, kampeve të përqendrimit, sundimit të ashpër diktatorial dhe adhurimit pikërisht të këtyre sunduesve që ua imponuan këto gjëra atyre.

Prandaj, pasi i dëgjoj ata t'i tregojnë historitë e tyre në këtë mënyrë, unë i sfidoj dhe i trajnoj në dy mënyra.

²¹ Mok Yong Jae, "80% of Defectors Struggle to Hold Down Positions," Daily NK, 14 shkurt 2011, lexuar më 11 mars 2014, <http://www.dailynk.com/english/read.php?cataId=nk00100&num=7357>.

²² Ho-Min Sohn, *The Korean Language* (New York, NY: Cambridge University Press, 1999).

²³ Special Reporting Team, "DPR Korea: Defector Among Us—What Does She Look Like," Reliefweb, 19 tetor 2010, lexuar më mars 11, 2014, <http://reliefweb.int/report/democratic-peoples-republic-korea/dpr-korea-defector-among-uswhat-does-she-look>.

Së pasi, u tregoj kornizën e udhëtimit të heroit. U shpjegoj se Jozef Kampbell ishte një studiues i mitologjisë, i cili zbuloi se historia më e vërtetë që mund të tregohet për njerëzit e çdo kulture ishte historia e heroit dhe se histori të tilla ndjekin një model të thjeshtë që i tejkalon kulturat dhe që i mundëson të gjithë për t'i rimenduar historitë e jetës së tyre sipas saj.²⁴

Së dyti, u tregoj atyre për Perëndinë, i cili synon që ne të triumfojmë mbi armiqtë tanë me anë të gjakut të Birit të Tij, Jezus dhe me anë të fjalës së dëshmisë sonë.²⁵ Me fjalë të tjera, vetë mbijetesa jonë varet nga historitë që ne tregojmë për veten tonë. Unë i këshilloj vëllezërit dhe motrat e mia koreanoveriorë t'i tregojnë historitë e tyre, ngaqë po nuk vepruan kështu, ata do të mbeten përjetë duke jetuar përbrenda historisë së Kim Il Sung-ut, edhe pse mund të jenë larguar fizikisht nga Koreja e Veriut.²⁶

Pasi i trajnova mjaft herë dezertorët koreanoveriorë në këto të vërteta, nisa ta kuptoj se e njëjta gjë është e vërtetë edhe për ne të tjerët. Dhe teksa i vështroja të mundoheshin për t'i treguar historitë e reja të udhëtimit të heroit të përqendruara te Perëndia, e kuptova se tregimi i shëndetshëm i historive nuk është diçka që secili prej nesh di sesi ta bëjë në mënyrë reflektive. Ne duhet të mësojmë sesi t'i tregojmë historitë tona në atë mënyrë që i tregojnë ato Perëndia. Nëse nuk praktikojmë bërjen e kësaj, në mënyrë të pashmangshme do të tregojmë histori për veten që shpien në një fund jo të lumtur, qoftë përmes mashtrimit me krenari të vetes sonë, ose siç ndodh më zakonisht, duke përforcuar identitetin tonë si viktimë.²⁷

²⁴ Christopher Vogler, *The Writer's Journey: Mythic Structures for Writers*, 3d ed. (Studio City, CA: Michael Wiese Productions, 2007), xiii.

²⁵ Zbulesa 12:11, NIV.

²⁶ Helen-Louise Hunter, *Kim Il-song's North Korea* (Westport, CT: Praeger, 1999).

²⁷ James W. Pennebaker, "Telling Stories: The Health Benefits of Narrative," *Literature and Medicine* 19:1 (2000): 3-18.

Historia e një viktime është kur e tregon një histori që të përcakton ty dhe të tjerët nën dritën e dhimbjes dhe vuajtjes që ke përjetuar.²⁸ Kur je lënduar në jetë, ose kur i ke lënduar ti të tjerët, është shumë e natyrshme të dëshirosh ta tregosh një histori viktime, për shkak se ti do që gjithkush ta dijë se sa shumë ke vuajtur. Por ajo gjë që kam kuptuar prej kohës që kam kaluar me dezertorët koreanoveriorë, është se, po ta tregosh historinë e jetës tënde si një histori viktime, ajo nuk është në të vërtetë historia jote. Njerëzit e tjerë (ata që të kanë lënduar) bëhen personazhet kryesorë, dhe në fakt është një histori për ta, jo për ty.

Ka një histori tjetër për veten tënde, që mund të mësoh ta tregosh: historia e heroit. Ti mund të mos e mendosh veten si një hero/heroinë. Askush nuk e kupton këtë më mirë sesa dezertorët koreanoveriorë. Në Korenë e Veriut mund të ketë vetëm një hero: Kim Il Sung-u. Por ashtu siç mësuam dezertorët që prezantohen në këtë libër, gjithsecili që përballlet me vështirësi në jetën e vet dhe i mposht ato me anë të gjakut të Qengjit dhe me fjalën e dëshmisë së tyre, është një hero/heroinë.

Perëndia e projektoi botën në mënyrë të tillë që, teksa secili prej nesh përballlet me vështirësi të mëdha, Ai na jep forcën dhe mjetet për t'i mposhtur ato.²⁹ Dhe ndonëse historia e çdokujt është e pashoqe, ajo ka karakteristika të përbashkëta dhe ndjek një linjë befasisht të ngjashme me të tjerat, ngaqë Perëndia po e rrit secilin prej nesh për t'u bërë si shëmbëlltyra e Birit të Tij.³⁰ Nuk ka rëndësi, nëse dikush vjen nga Koreja e Veriut apo Koreja e Jugut, ose nga Amerika e Veriut apo Amerika e Jugut; gjithsecili ka një “udhëtim hero” për ta ndërmarrë, përfshirë edhe ju. Ashtu si unë dhe të dhjetë dezertorët nga Koreja e Veriut në këtë libër, juve do t'ju bëhet thirrje të dilni nga bota juaj e zakonshme, të

²⁸ Martha Minow, “Surviving victim talk,” *UCLA L. Rev.* 40 (1992): 1411.

²⁹ Gjoni 16:33, NIV.

³⁰ 2 Korintasve 3:18, NIV.

përballeni me vështirësi, të takoni aleatë, mentorë, dhe armiq, të futeni në vende të rrezikshme, të merrni shpërblime, dhe më në fund të thirrreni për ta ndarë atë që mësuar me të tjerët në botën e zakonshme, në të cilën u rritët.

Natyrisht, ju nuk mund ta shihni veten si hero sot teksa po e mbani në dorë këtë libër. Pikërisht tani, pjesët e dhimbshme në historinë tuaj mund të jenë të vetmet që ju mbani mend. Por më lejoni t’ju tregoj për një burrë me emrin Viktor Frankl, një jude i cili i mbijetoi jetës në një kamp përqendrimi nazist gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai vazhdoi për t’u bërë njëri nga autorët dhe mjekët psikiatër më të famshëm në botë, dhe shpesh i pëlqente ta citonte filozofin Niçe duke thënë: “Ai që e ka një *përse* për të jetuar, mund të durojë pothuajse cilëndo *si*.”³¹ Ajo gjë që donte të thoshte Viktor Frankli ishte se, pavarësisht se sa dhimbje na duhet të durojmë, ne mund të mbijetojmë, po të arrijmë ta kuptojmë arsyen se përse jemi të gjallë.

Dhe ky është sekreti i mrekullueshëm për “udhëtimin e heroit”: rezulton se ata, që përjetojnë dhimbjen, vuajtjen e pengesat më të mëdha dhe tragjeditë që shkatërrojnë jetën, janë po ata që vazhdojnë të bëjnë gjërat më të mëdha dhe të kenë jetën më të mirë; domethënë nëse mësojnë të shohin, të kuptojnë dhe ta tregojnë historinë e tyre për “udhëtimin e heroit” në atë mënyrë që e tregon Perëndia atë.

Në faqet që pasojnë, ju do t’i shihni në vetë historinë time, dhe në historitë e dhjetë dezertorëve të mrekullueshëm nga Koreja e Veriut, të dymbëdhjetë fazat e “udhëtimit të heroit” nëpër të cilat kalon gjithsecili përgjatë jetës së tij ose të saj. Jetët tona do ta ilustrojnë secilën fazë për ju, dhe kur ta keni mbaruar këtë libër, ju do ta kuptoni se si funksionon. (Dhe duke folur për ilustrimin, sigurohuni që t’i kushtoni vëmendje të posaçme ilustrimit që bëhet prej heroit në secilin kapitull. Do t’jua shpjegoj arsyen më vonë

³¹ Viktor E. Frankl, *Man’s Search for Meaning*, 1984 ed. (New York, NY: Washington Square Press, 1985), 97.

në libër.) Pastaj do t'ju drejtoj përmes shkrimit të vetë historisë suaj të “udhëtimit të heroit.”

Dhe mos u shqetësoni. Nuk do të jetë e vështirë që ta bëni këtë. Ju nuk do të duhet të shkruani një libër! Në fakt, është e rëndësishme ta tregoni shkurtimisht historinë tuaj. Në këtë mënyrë, mund ta mbani mend për veten tuaj dhe t'ua tregoni lehtësisht të tjerëve, dhe rishikimet do të jenë të thjeshta. Kujtohu se, Perëndia do të vazhdojë ta rishikojë atë, për sa kohë që ju merrni frymë këtu në planetin Tokë.

Por, përpara se të shkruani ndonjë gjë, dhe madje përpara sesa t'i lexoni historitë tona, më lejoni t'ju shoqëroj përmes linjës së “udhëtimit të heroit” nga Jozef Kambell. Më poshtë vijojnë të dymbëdhjetë fazat për të cilat mund të mendoni dhe të luteni:

1. **Bota e zakonshme.** Kjo thjesht është bota në të cilën ju u rritët, si ishte jeta “normale” përpara sesa të futeshin në fazën e dytë të udhëtimit tuaj. Kjo është bota e “shtëpisë.”
2. **Thirrja për aventura.** Diku, disi, prej dikujt ose prej diçkaje, ose prej disa serish ngjarjesh, ju e ndjeni thirrjen për të dalë jashtë botës suaj të zakonshme për diku tjetër, tek diçka e re, ose për ndonjë mundësi të re ose ndonjë mënyrë jetese të re.
3. **Refuzimi i thirrjes.** Fillimisht ne mund të refuzojmë ta lemë botën tonë të zakonshme, ose, po të largohemi, vendosim se ishte një gabim që bëmë, dhe kthehemi mbrapsht, ose tundohehi për t'u kthyer.
4. **Takimi i mentorit / mentores.** Dikush vjen në shtegun tonë për të na udhëzuar lidhur me si të ecim përpara në udhëtimin tonë.
5. **Kalimi i pragut të parë.** Ky është çasti, kur më së fundi ne marrim hapin e parë, ku e dimë se nuk mund të ketë

- më kthim prapa. E kemi lënë prapa krahëve botën e zakonshme dhe na ka mbërthyer aventura jonë.
6. **Sprovat, aleatët dhe armiqtë.** Përgjatë rrugës ne do të përballemi me sprova, të cilat do të na sfidojnë, me aleatë, që do të na ndihmojnë, dhe me armiq, që do të përpiqen të na ndalojnë.
 7. **Afrimi për te shpella më e brendshme në thellësi.** Kjo është pika në udhëtimin e heroit, kur e ndjejmë se drejtpërdrejt përpara nesh po na kanoset sprova jonë më e madhe. Na pret një betejë serioze. Duket sikur nuk do të mbijetojmë.
 8. **Sprova e rëndë.** Kjo është beteja, që ne e zhvillojmë brenda mendjes sonë. Shpella më e brendshme në thellësi është beteja e jashtme, kurse sprova e rëndë është beteja e brendshme. Ne mund ta vëmë veten në dyshim. Ne mund të dyshojmë gjithçka që besojmë. Mund ta humbim besimin. Mund ta humbim shpresën. Pikërisht për këto gjëra është sprova e rëndë.
 9. **Shpërblimi.** Kur i përfundojmë betejat e brendshme dhe të jashtme të dy hapave të mëparshëm, ne marrim një shpërblim. Kjo nuk është gjithnjë diçka materiale, ose financiare, si për shembull një trofe, një çmim, apo ca para. Shumicën e kohës, ai vjen në formën e njohurive të reja për veten, për botën ose për qëllimin e thirrjes sonë.
 10. **Rruga për kthimin.** Duke udhëtuar larg botës së zakonshme, ne tani kthehemi sërish në atë drejtim, duke kërkuar ta risjellim shpërblimin që kemi marrë. Kjo fazë mund të mos ju ketë ndodhur ende juve, por është e rëndësishme të dihet se ajo ndodhet përpara në udhëtimin tuaj, dhe ju mund të nisni të mendoni sesi do të jetë ajo fazë, kur të arrini atje.
 11. **Ringjallja.** Këtu ne përballemi me një sfidë tjetër. Zakonisht është një sfidë krejt e papritur, dhe që

rezulton të jetë sfida më e rëndë nga të gjitha. Mund të jetë një sfidë kaq e madhe, sa pothuajse na vret. Ndonjëherë koreanoveriorët që mbërrijnë në Korenë e Jugut mendojnë se sfidat dhe vuajtja e tyre morën fund! Pastaj, kur nisin që të jetojnë në përditshmëri në Korenë e Jugut, ata befasohen kur përballen me ndonjë lloj sfide më të madhe nga ato që kanë hasur përpara, dhe për ta kjo është diçka krejt e papritur. Për fat të keq, kjo është arsyeja se pse disa koreanoveriorë bëjnë vetëvrasje në Korenë e Jugut. Prandaj, është e rëndësishme ta presim këtë sfidë dhe gjithashtu të kujtohem se kjo fazë është quajtur ringjallja, ngaqë më në fund, duke përdorur shpërblimet që keni marrë përgjatë udhëtimit tuaj, ju mund të mbijetoni. Do të jetë pothuajse njësoj si të jeni ringjallur prej së vdekuri.

12. **Rikthimi me eliksirin.** Elikhiri është një mjekim shërues. Në jetën reale eliksiri zakonisht nuk është një mjekim në kuptimin fjalë për fjalë. Përkundrazi, është diçka që e keni mësuar gjatë udhëtimit tuaj, të cilën mund ta merrni mbrapsht në botën e zakonshme për t'u sjellë shërim të tjerëve. Më vonë, do të ndaj me ju “eliksirin” që mora unë dhe sesi po kërkoj ta përdor atë për t'ju sjellë shërim edhe juve përmes këtij libri.³²

Pra, këto janë dymbëdhjetë fazat e udhëtimit të heroit. Pasi t'i keni lexuar, ju mund të mendoni: *Po i kam kaluar që të gjitha këto dymbëdhjetë faza.* Mrekulli! Do t'ju ndihmoj t'i shkruani ato, që ta ndani lehtësisht historinë tuaj me të tjerët dhe ta rikujtoni atë për t'ju forcuar kurdoherë që të përballeni me kohë të vështira në

³² Linda George, *Fill-in-the-Blank Plotting: A Guide to Outlining a Novel Using the Hero's Journey & Three-Act Structure* (Milwaukee, WI: Crickhollow Books, 2009).

të ardhmen. Thjesht kujtohuni se nesër Zoti mund të prezantojë një zhvillim të ri në historinë tuaj, që e kthen përmbys gjithçka.

Ose, teksa po i ndaja me ju këto fazat, mund të keni menduar: *Kam kaluar nëpër disa prej këtyre fazave, por jo nëpër të gjitha ato.* Edhe kjo është gjë e mrekullueshme! Ju e keni nisur udhëtimin. Historia është në zhvillim e sipër. Duke e kuptuar historinë tuaj të “udhëtimit të heroit” dhe duke i ditur fazat që janë përpara, ju mund të përgatiteni mirë për të ardhmen. Ju mund t’i parashikoni sfidat që do të hasni dhe do të keni shpresë e mirëbesim, duke e ditur se çdo hap që ndërmerrni do t’ju sjellë më afër ndaj përfundimit me sukses të “udhëtimit tuaj të heroit”, që është i pashoq.

Ose, ju mund të keni menduar: *Nuk jam i/e sigurt nëse jam një hero/heroinë, ose madje edhe nëse jam në një udhëtim.* Ky mund të jetë për ju vendi më i mirë nga të gjithë, ku mund të ndodheni për tani. Thjesht jini të hapur ndaj mundësisë se mund t’ju presin disa zbulime e surpriza të mrekullueshme, teksa i shqyrtoni historitë e njëmbëdhjetë njerëzve të zakonshëm si ju, që e panë veten si gjithçka, por jo si heronj.

Le të fillojmë me mua.

Kapitulli 1.

Dr. Folei: Udhëtimi i sigurt

*Frika e njeriut përbën një lak, por ai
që i beson Zotit, është i sigurt*

- Fjalët e Urta 29:25

1. Bota e zakonshme

Unë u lindi në Seul, në Korenë e Jugut, më 21 nëntor 1961, si bija më e vogël e shtatë vajzave. Prindërit e mi i kishin tashmë gjashtë vajza, si rezultat i dëshirës tejet të madhe për të pasur një djalë. Kështu që, shtatë vajza, duke më përfshirë edhe mua, do të thoshte “shtatë dështime” për ta. Mamaja ime tha se donte ta provonte që të më fuste sërish në bark, si një përpjekje për të më bërë të dilja djalë. Ajo madje më vuri të rrija pranë dritares në pjesën më të ftohtë të dhomës, si një shenjë se mund të flijohesha lehtë. Motra ime më e madhe e kujton atmosferën në shtëpi, kur lindi unë, si të ishte një funeral.

E kuptoj situatën ku ndodhej mamaja ime. Për të ishte vërtet jetë a vdekje: dështimi në misionin e sigurimit të një trashëgimtari mashkull do të thoshte se ajo përjashtohej prej martesës dhe familjes. Ajo u lut me të madhe për edhe një mundësi tjetër shtatzënie, dhe ra dakord se po të mos lindte djalë, ajo do ta gjente vetë një grua të dytë për babain tim. Për fat të mirë, ajo lindi djalë dy vjet pas meje.

Prindërit e mi u takuan në një kishë në Seul. Babai im ishte nga Ansung-kun, Kyungki-Do, në Korenë e Jugut, kurse mamaja

ime ishte nga Kaesong, një qytet që u bë pjesë e Koresë së Veriut pas luftës Koreane. Babai im ishte shumë i kujdesshëm, i zgjuar dhe me karakter të mirë. Mamaja ime ishte gruaja shtëpiake më e mirë që kishte nxjerrë ndonjëherë qyteti i saj. Koreanët gjithnjë thonë se banorët e Kaesong janë kursimtarë shumë të mirë.

Për shpenzimet e jetesës së të gjithëve ne fëmijëve dhe të dy të rriturve, babai im i jepte mamasë sime aq pak lekë “sa i vogël është bishti i miut,” - siç do të thoshin koreanët. Por prej kësaj shume, ajo prapëseprapë ia dilte mbanë të kursente mjaftueshëm lekë, sa t’i bënte dhuratë babait tim një fond, të cilin ai mundi ta përdorë për të filluar biznesin e vet. Suksemi i tij do të kishte qenë i pamundur pa mbështetjen financiare të mamasë sime.

Për shkak se babai im ishte një biznesmen i madh, që pati sukses duke punuar vetëm fare, dhe duke e nisur nga asgjëja, unë u rrita në një familje të pasur dhe u mbështeta financiarisht deri sa mbarova studimet universitare. Pavarësisht se ku shkuam për të jetuar, ne banonim në shtëpinë më të madhe të fshatit dhe punësonim shoferë e shërbëtores. Unë pata një nivel pasurie që vetëm pak të tjerë e kishin.

Kur isha pesë vjeç, përjetova shërimin e Perëndisë prej një sëmundjeje të rrallë. Mamaja më shpuri nëpër shumë mjekë, por asnjëri prej tyre nuk mundi të më shëronte dot. Kështu që, ajo shkoi në çdo takim ringjalljeje kishash, kudo ku gjente, duke më marrë mbi shpinë dhe duke kërkuar lutje prej pastorëve të atjeshëm. Në njërin nga ato takime, Perëndia më shëroi. Gjithmonë jam ndier sikur po jetoj një jetë shtesë. Gjatë asaj kohe, ajo iu lut me gjithë zemër Zotit për mua, ndonëse nuk isha djalë.

Gjithsesi, duke u rritur, gjithmonë kisha ndjesinë se dashuria e saj për vëllain tim ishte shumë më e madhe sesa dashuria e saj për mua. Kur motrat e mia, gjithashtu, bënë dallim kundër meje në favor të vëllait tim, kjo gjë më zemëronte akoma më tepër. Shkrova në kapakun e pasmë të fletores: “Pse linda unë në këtë botë, pse linda në këtë vend, pse linda në këtë familje?”

Vëllai im merrte gjithçka që donte. Me kërkesën e tij, prindërit e mi siguronin gjithçka për të, nga shtëpia e re për familjen tonë e deri tek ushqimet e tij të preferuara, te shkolla private e deri te vajtja jashtë shtetit për të studiuar. Prindërit e mi, jo vetëm që i dhanë atij gjithçka që u kërkonte, por edhe ata vetë kërkonin gjithçka të mirë e të dobishme për të.

Për mua, bota dukej e padrejtë. Kur kisha konflikte me ndonjërin prej motrave të mia, prindërit gjithnjë më fajësonin mua; më thoshin se duhej t'i trajtoja motrat e mia me respekt, ngaqë isha më e vogla. Por kur kisha konflikt me vëllain, që ishte më i vogël se unë, ma hidhnin fajin sërish mua. Ai, në mendjet e tyre, ishte tepër i çmuar, ndaj nuk duhej ta shqetësoja.

Disa prej motrave të mia nuk arritën dot të shkonin në kolegje të mira, gjë që do të thoshte se prindërit e mi kishin shumë pak gjëra për t'u mburrur. Duke dashur t'i bëja të lumtur prindërit, mësoja shumë, por nuk ia dola dot mbanë dhe përfundova për të studiuar në Universitetin për Femra të Dongduk-ut, i cili nuk kishte ndonjë reputacion të mirë. Në fakt, qëllimi i tim eti për t'i dërguar vajzat në kolegje ishte që të na jepte secilës prej nesh mundësinë për të pasur martesë të mira; nuk ishte që ne të kishim karriera të mira. Në ato ditë, shumica e studenteve femra të kolegjeve, duke më përfshirë edhe mua, as nuk e njihnim fjalën *karrierë*. Unë nuk ia kisha dalë dot mbanë të shkoja në një kolegje të mirë, por prapëseprapë doja që të isha një bijë e mirë, duke u martuar me një burrë të respektueshëm dhe duke u bërë një grua shtëpiake ideale.

Edhe pse isha një e krishterë e brezit të katërt, vetëm kur erdhi koha e kolegjit e ndjeva Perëndinë në zemër. Në atë kohë, e përkushtova veten për t'u bërë misionare në të ardhmen. Kjo nënkuptonte që duhej të martohesha me një pastor. Në ato ditë, bashkëshortet e pastorëve koreanë, që të gjitha ishin sipas të njëjtit model: të hesitura. Unë isha shumë aktive dhe bija shumë në sy, pavarësisht se çfarë vishja. Nga ana tjetër, bashkëshortet e

pastorëve, që të gjitha visheshin sipas të njëjtit stil të mërzitshëm rrobash. Unë isha aq shumë ndryshe nga ato, saqë mendova se Perëndia duhej të kishte bërë gabim duke më dhënë një thirrje e një zemër të tillë.

Unë isha e guximshme, e ndershme dhe shpesh sfiduese. Prandaj, kur u organizua një konkurs për këngët pop, për ata që ishin në vitin e parë në kolegji, unë mora pjesë me shoqen time dhe këndova e kërcëva. E dija se po i tejkaloja kufijtë, ngaqë në atë kohë, edhe pse këngëtarët e huaj kërcenin, ndërkohë që ishin duke kënduar, këngëtarët koreanë këndonin pa lëvizur aspak nga vendi. Bashkë me shoqen time gjetëm një videokasetë të një grupi vajzash japonez me emrin “Pink Lady (Zonjusha Rozë)” dhe imitua lëvizjet e tyre. Ne patëm shumë sukses dhe morëm një çmim. Më vonë, producenti i programit televiziv *11 Young Star* (11 Yjet e Rinj) të MBC më mori në telefon dhe na ftoi që të performonim, kështu që shkua. U bëmë të famshme. Fill pasi u transmetua performanca jonë, KBS (rrjeti tjetër televiziv, konkurrent i MBC-së) na mori në telefon dhe na kërkoi që të performonim edhe atje. Kështu që ne performuam lart e poshtë, për një vit, në programin *11 Yjet e Rinj* të MBC-së dhe në *Youth Parade* (Parada e të Rinjve) të KBS-së, dy programe konkurente amatore me fokus të rinjtë e kolegjeve.

Megjithatë, im atë ndërhyri, duke m'i ndaluar performancat, ngaqë mendoi se kjo gjë do ta ndikonte negativisht të ardhmen e martesës sime. Ai më paralajmëroi, se do të më përjashtonte prej familjes, nëse do të vazhdoja atë rrugë. Në kohët e vjetra, koreanët i trajtonin njerëzit e famshëm, stjuardesat dhe artistet sikur ato të ishin të një niveli shumë të ulët, “si prostituta”, do të thoshte im atë. Ai e njihte botën e burrave dhe ndjeu se performanca ime do të ishte fyerje për familjen. Duke iu bindur tim eti, unë hoqa dorë.

Gjatë katër viteve në kolegji, kurseva mjaftueshëm para, sa të shkoja në një udhëtim vetëm me çantë shpine në Evropë. Dëshiroja të përjetoja një botë të re. Në kohën e sotme këtë gjë e bëjnë shumë koreanë të rinj, kurse në vitet 1980-të, ishte gjë e rrallë. Im atë ma

anuloi edhe këtë dëshirë, duke më ndaluar që të shkoja, dhe duke më thënë se thjesht duhej të sillesha mirë, deri sa të martohesha.

Pas tre vitesh në kolegji, doja të transferohesha në një kolegji amerikan, që ndodhej në një bazë ushtarake amerikane. Kisha ndjesinë se po humbja kohë në kolegjin ku isha, nuk kisha interes për lëndët kryesore dhe nuk studioja fare. Më dukej sikur po hidhja tutje lekët dhe kohën. Por im atë e kundërshtoi transferimin tim. Arsyeja e tij ishte se më kishte mbetur edhe vetëm një vit nga diplomimi dhe diploma ime do të ishte një burim i mjaftueshëm për ta paraqitur për mblesërinë. Sërish, iu binda atij. Mendoja se po sillesha si një bijë e mirë.

Duke qenë falënderuese ndaj prindërve të mi, që punuan fort për të më rritur, ndieja se qëllimi im në jetë ishte të sillesha mirë ndaj tyre. Dhe faji që mbartja, ngaqë nuk shkova në një kolegji të mirë, më bëri që t'i bindesha tim eti, në çdo gjë që do të më kërkonte. Për mua, të qenit një bijë e mirë, nënkuptonte se duhej t'i tregoja tim eti, në të ardhmen, se kisha një martesë të fortë dhe po kaloja një jetë të mirë.

2. Thirrja për aventura

Kur erdhi koha e diplomimit nga kolegji, qëllimi i shumicës së diplomuarave femra ishte të kishin një martesë të mirë. Në fillim të viteve 1980-të, në Kore nuk ishte koncepti i një “gruaje karriere”. Diploma e kolegjit ishte thjesht një certifikatë e detyrueshme për t'ua paraqitur prindërve të bashkëshortit potencial. Martesa me një burrë të pasur nënkuptonte sukses.

Im atë, me kaq shumë bija, deshi që unë të martohesha herët, që ai të lirohej prej kësaj përgjegjësie. Martesa e hershme ishte për t'ia bërë qejfin tim eti.

Prindërit e mi i kishin vizituar Shtetet e Bashkuara shumë herë në vitet 1970-të, gjë që i bëri ata të mendonin për t'i dërguar bijat

e tyre atje, që të martoheshin me burra koreanë të sapo emigruar. Ata e panë sesi bashkëshortet në Shtetet e Bashkuara gëzonin të drejta pothuajse të barabarta me ato të burrave të tyre, gjë që ishte krejt e ndryshme prej Koresë së Jugut, e cila nuk iu ofronte shumë të drejta grave. Për shembull, kur një çift blinin një shtëpi në Shtetet e Bashkuara, në tapinë e shtëpisë shënoheshin njëlloj emrat e bashkëshortit dhe të bashkëshortes.

Unë gjithnjë kisha dashur t'ia tregoja virgjërinë time bashkëshortit tim, kur të martohesha me të, për ta provuar pastërtinë time dhe se kisha pritur për të pa u lidhur me asnjë burrë tjetër. Shoqet e mia të kolegjit ranë në dashuri dhe krijuan plot kujtime të mira me burrat, kurse unë nuk iu futa asaj rruge, për t'u siguruar se do ta ruaja virgjërinë. Unë isha tërheqëse, por kisha njohuri vetëm për kishën dhe për Perëndinë.

Duke i parë motrat e mia, krijova plot ide se çfarë të bëja e çfarë të mos bëja. Një nga motrat e mia u shkaktoi plot shqetësime dhe dhimbje koke prindërve të mi, për shkak të problemeve me të dashurin e saj. Motra tjetër ishte aq lakmitare, saqë ajo dhe bashkëshorti i saj u kërkuan ndihmë financiare prindërve të mi, madje edhe pas martesës. Dhe një motër tjetër e imja, madje u kërkoi prindërve të mi t'u blinin dhurata familjes së burrit të saj, kur ata vizituan Shtetet e Bashkuara. Mendova se fakti që prindërit na lindën e na rritën, mjaftonte për të qenë falënderuese, prandaj mora vendimin që të mos sillesha si motrat e mia.

Më në fund, vendosa se do të martohesha me një burrë që do të ma prezantonin prindërit. Pata ndjesinë se kjo do të kishte më pak gjasa t'i lëndonte ata, sesa po t'u sillja në shtëpi një burrë që ata nuk do ta pëlqenin. Nisa të lutesha për këtë. Por kur kthej kokën prapa tani, mendoj se bëra një gabim të madh dhe të pamatur: Unë duhej t'i kisha drejtuar lutje Perëndisë, lidhur me cilin burrë do të donte *Ai* që të martohesha, e jo t'i deklarova Perëndisë se çfarë do të bëja në zgjedhjen e partnerit tim për martesë.

Fill pas diplomimit nga kolegji, mblesi më prezantoi (praktika e zakonshme për klasën e lartë të shoqërisë koreane) me një burrë korean që kishte emigruar në Shtetet e Bashkuara. Prindërit e tij erdhën për të më takuar mua dhe prindërit e mi. Dëgjova se familja e tij kishte një kompleks me tridhjetë apartamente në Nju Jork dhe ishin shumë mirë financiarisht. Im atë e kishte me nxitim punën e martesës sime ndaj mendova se nuk do të kishte problem, ngaqë ai e mbështeste këtë martesë. Ai mendoi se unë do të jetoja në pasuri në Shtetet e Bashkuara dhe nuk do të më mungonte asnjë gjë.

Shumë shpejt pas këtij prezantimi, ne u martuam, pa pasur thuajse asnjë njohje personale me njëri-tjetrin. E bëmë ceremoninë shumë shpejt pasi ai erdhi për vizitë në Kore. Por, duke u përgatitur për të shkuar të jetoja në Shtetet e Bashkuara, njëherë shkova për vizitë te shtëpia e vëllait të tim shoqi dhe atje dëshmoja se ai e abuzonte gruan e vet në sy të fëmijëve të tij. Kur u ktheva në shtëpi, i thashë tim ati për atë që pashë. Kur isha gati për t'u larguar nga Koreja, im atë më dha treqind dollarë dhe më tha se ato ishin për të blerë biletën e aeroplanit për të vizituar Los Anxhelosin, ku jetonin disa nga motrat e mia, në rast se do vinte rasti.

Brenda në aeroplan, pata një ëndërr të re. Unë nuk munda dot të isha bijë e mirë duke shkuar në një kolegji të mirë, por mund të isha tani një bijë e mirë, duke pasur atë martesë të mirë, që ma kishte dëshiruar im atë.

3. Refuzimi i thirrjes

Martesa e lumtur që e dëshiruan prindërit e mi prej meje, nuk ndodhi. (E them “prej meje” qëllimisht, ngaqë në Kore, lumturia martesore është një dhuratë për familjen, jo për individin që martohet.) Kur mbërrita në Nju Jork në 1985, zbulova se ata kishin gënjyer lidhur me zotërimin e një kompleksi me tridhjetë

apartamente. Përkundrazi, babai i bashkëshortit tim ishte një komisioner sigurimesh, që u shiste polica siguracionesh imigrantëve koreanë që sapo kishin mbërritur në Nju Jork, njerëz naivë si puna ime. Ai shkonte vërdallë dhe i ndihmonte njerëzit për të zgjidhur hallet që kishin, që të ndërtonte marrëdhënie me ta dhe t'u shiste polica siguracioni. Im shoq nuk kishte punë me kohë të plotë, por fitonte pak para duke ruajtur dyqanin e dikujt, me kohë të pjesshme.

Im atë u përpoq ta ndihmonte martesën tonë duke më dhënë si dhuratë martese dhjetëmijë dollarë, para në dorë, përpara se të largoheshim nga Koreja. Kjo sasi parash ishte përveç tonelatave me pajisje kuzhine dhe dhurata të tjera që i kishte blerë në udhëtimet e tij ndërkombëtare për t'i bekuar të bijat në martesë. Dhe mbi këto gjëra, ai u kishte dhënë familjes së burrit tim të ardhshëm stoli të shtrenjta, të tilla si diamante dhe rubinë, që të gjitha prodhime markash, si një dhuratë martese ndaj familjes. Edhe unë mora stoli prej familjes së burrit. Gjithçka që mora për dasmën, ua dhashë familjes së burrit.

Pak ditë pasi mbërrita në Shtetet e Bashkuara, im shoq më tha që t'i kërkoja para tim ati, që ai të mund të fillonte biznesin e vet. Refuzova me forcë për ta bërë një gjë të tillë. Mendova se ishte radha ime për të bërë diçka për prindërit e mi, e jo t'u kërkoja atyre që të bënin akoma gjëra për mua.

Sapo ia refuzova kërkesën, ai doli përjashta për të takuar një grua tjetër. Kur erdhi në shtëpi, më rrahu dhe pastaj bëri seks me mua. I ati i tij dukej si njeri i mirë, kështu që i shkrova një letër për situatën time qesharake. Por nuk pati dobi. Unë ndodhesha në një vend, ku nuk njihja askënd. Isha në një vend, gjuhën e të cilit nuk e dija. Pas një rrahjeje të veçantë, u arratisa duke thyer dritaren. Me gjak në duar, vrapova teposhtë rrugës duke kërkuar ndihmë. Po ç'mund të thuash, nëse nuk njeh njeri dhe nuk e flet gjuhën për ta shpjeguar situatën tënde? Shkova tek një ndërtesë kishe dhe u fsheha në katin e dytë, deri sa një anëtar i kishës erdhi

e më nxori përjashta me shkelma. Pak ditë më vonë, dridhesha nga frika, teksa isha fshehur në një dhomë të kyçur në shtëpinë tonë për disa ditë.

Të gjitha këto ndodhën brenda tre javëve të mbërritjes sime. Pastaj erdhën për të më vizituar prindërit e mi. Mendova t'u tregoja gjithçka që po ndodhte, por im shoq më kërcënoi se do të më vriste po ta bëja këtë. Nga njëra anë, mendova se duhej t'u tregoja atyre të vërtetën. Por nga ana tjetër, ndjeva keqardhje për ta, kur i pashë të dilnin nga aeroporti. Ata dukeshin aq të plakur, saqë unë qava. Në atë çast, vendosa se do ta shfrytëzoja deri në maksimum situatën. Nëse martesë ime nuk do të funksiononte, unë do doja të vdisja këtu. Natën përpara sesa të largoheshin ata, ia ktheva tim ati ato treqind dollarët që m'i kishte dhënë për raste urgjente. I thashë se, nëse ndodhte ndonjë gjë me martesën time, do të ishte për fajin tim, kështu që unë do të bëja më të mirën që të isha e duruar dhe të ndërtoja një martesë të mirë.

Por jo shumë kohë pasi u larguan prindërit e mi, im shoq arriti në përfundimin se nuk mundej dot të nxirrte asnjë gjë më tepër nga martesë jonë. Ai më shpuri në aeroport dhe më bleu vetëm një biletë vajtjeje për në Los Anxhelos. Fjalët e tij të fundit për mua ishin se, po të kthehesha në Nju Jork, ai do të më vriste. Pastaj ai u zhduk. Martesë ime ëndërr përfundoi në një hendek dëshpërimi dhe mungese shprese brenda një muaji të vetëm. Gjatë atyre pak javëve të shkurtra, i përjetova të gjithë skenarët e mundshëm të tmerrshëm që mund të përjetoja një bashkëshorte.

Prindërit e mi po rrinin në shtëpinë e motrës sime në Los Anxhelos, kur morën lajmin shokues të dështimit të martesës së vajzës së tyre të vogël. Për t'i ndërlikuar gjërat, zbulova se isha shtatzënë, dhe prandaj zgjodha të abortoja. Nuk kisha mundësi ta hidhja në gjyq tim shoq, ngaqë martesë jonë ende nuk kishte qenë e regjistruar ligjërisht. Im atë u shqetësua aq shumë, saqë ai madje mendoi të punësonte një vrasës me pagesë. Kur im shoq më mori në telefon, im atë i tha: "Dua të ta pi gjakun duke ta prerë qafën."

Kështu që, unë u bëra barrë për prindërit e mi. Ëndrra ime për të qenë një vajzë e mirë u bë copë-copë prej martesës sime të dështuar. Ndjeva hidhërim kundër Perëndisë. Edhe pse gratë e tjera takoheshin me burra dhe bënë shumë kujtime me ta, unë kisha dëshiruar me zjarr vetëm burrin tim të ardhshëm dhe e kisha përkushtuar kohën time ndaj Perëndisë. Por kur ktheva kokën prapa, ndihesha sikur i kisha humbur tërë ato ditë. Ngrita gishtin duke e drejtuar nga qielli dhe e mallkova Perëndinë duke e sharë. Mendova të vrisja veten. Njëri nga kunetërit e mi më tha se jeta ime ishte pa shpresë gjithsesi. Një anëtar tjetër i familjes më rrahu, duke thënë se do të ishte më mirë që të vdisja, për shkak të turp-it që u kisha sjellë prindërve të mi.

Brenda pak muajsh u shndërrova nga vajza më e vogël, e bukur, në një grua që e rrihnin. Vendosa se kishte ardhur koha që ta mbroja veten, e të mos prisja që këtë ta bënte Perëndia. Nuk mund t'i zija më besë Perëndisë.

Më në fund, takova dhe u martova me një burrë muskuloz, për të cilin mendova se do të më mbronte. Ai nuk ishte i krishterë, por nuk e çava kokën për këtë gjë. Ngaqë më ishte ulur vetë-vlerësimi, në atë kohë isha falënderuese për këdo, që do të donte të martohej me mua.

Pas martesës, përfundova shkollën e modës në Los Anxhelos dhe u bëra një dizenjatore mode e suksesshme. Fitoja shumë herë më tepër para nga sa fitonin burrat e suksesshëm në Shtetet e Bashkuara. Më vonë, madje hapa edhe studion time të dizajnit, e cila gjithashtu ishte e suksesshme.

Të gjitha paratë që fitoja ia jepja tim shoqi. Ai u dembelos dhe nuk bënte asnjë përpjekje për të kontribuar. Në vend të kësaj, ai shkonte për zhytje nën det, ose për të pirë me miqtë e tij, që të lironte stresin. Kur u martova këtë herë, nuk kisha fare iluzione se do të ishte një martesë ëndrrash. Por me kalimin e viteve, e gjeta veten në një lloj tjetër makthi, në të cilin po humbja dalëngadalë shëndetin, duke punuar pa pushim, që të siguroja para për një

burrë që dukej gjithnjë e më pak i motivuar për të kontribuar shumë ai vetë në martesën tonë.

Më kujtohet diçka që më tha babai, kur vendosa të shkoja në shkollën e modës. Ai më kishte paralajmëruar se, po të mësoja mirë një mjeshtëri, im shoq do të varej nga unë, dhe do të kishte shumë pak motivim për të qenë i suksesshëm. Prapëseprapë, pavarësisht nga të metat e tij, ne bëmë dy fëmijë bashkë, të cilët unë i doja shumë. Sa herë që gjërat dukeshin pa kuptim, prapëseprapë unë përpiqesha për të provuar më shumë, për hir të tyre. Unë kujdesesha për atë, për prindërit e tij e për fëmijët tanë, por atëherë nuk dija shumë sesi të kujdesesha për veten. Kisha filluar të merrja mësimë vallëzimi korean duke u përpjekur ta rindizja njërin nga interesat e fëmijërisë sime, por ishte e vështirë për ta bërë edhe këtë gjë në mes të një karriere gjithëpërfshirëse.

Puna e tepërt, me kalimin e kohës, ndikoi negativisht në shëndetin tim. Një mjek më urdhëroi që ta ndërprisja fare punën. Por nuk kishte asnjë mënyrë sesi ta ndaloja punën, kur gjithkush përreth meje varej nga unë që të sillja para në shtëpi.

Vendosa të përqendrohesha më tepër në mësimin e vallëzimit, ngaqë ky ishte lirimi im i vetëm. Mund ta shprehja trishtimin tim, kur vallëzoja. Mora një vit sabatik për në Kore, që të largohesha nga puna. Atje takova një “Thesar të Gjallë Kombëtar,” një njeri të caktuar nga qeveria si mishërim i njërit prej vallëzimeve të lashta tradicionale të Koresë.³³ Ishte një mundësi e mirë për të mësuar të vallëzoja nga një person i tillë, por nuk munda t’i harroja paralajmërimet e tim ati kundër artistëve, që ai m’i kishte ngulitur që kur isha fëmijë. Gjeta një mënyrë për t’i kënaqur edhe interesin tim, edhe zërin e tij në kokë, duke u regjistruar në një shkollë pasuniversitare për ta studiuar vallëzimin nga ana akademike, ndërkohë që mësoja për ta performuar artistikisht atë.

³³ Jongsung Yang, *Cultural Protection Policy in Korea: Intangible Cultural Properties and Living National Treasures* (Seoul, Korea: Jimoodang International, 2003).

Në Shtetet e Bashkuara, im shoq nuk mundi dot ta vazhdonte biznesin e modës vetë, prandaj planifikoi falimentimin. Ndërkohë, ai i përdori në limitin maksimal të gjitha kartat tona të kreditit dhe bleu gjithçka që deshi. Përfundimisht, kjo gjë solli fundin e martesës sonë. Kur u ktheva në Shtetet e Bashkuara, për shkak se ai i kishte prishur të gjitha paratë tona, unë përfundova duke jetuar në një apartament me qera bashkë me dy fëmijët e mi. E gjitha kjo po më ndodhte, pasi kisha punuar si qen për të ndërtuar një jetë të rehatshme. Të gjitha përpjekjet e mia kishin shkuar kot së koti.

Në atë kohë, u kujtova për Perëndinë, të cilin e kisha harruar krejtësisht, por e kisha dashur me shumë pasion në vitet e studimit në kolegji. Fillova të shkoja përditë në shërbesat e takimit të lutjes herët në mëngjes në një kishë koreane pranë apartamentit tim.

E dija se në disa shtete, kishte kufi për moshën se kur mund të lireshin vetëm fëmijët pa mbikëqyrjen e të rriturve, dhe se prindërit mund të mbaheshin përgjegjës. Dy fëmijët e mi ishin gjithçka që kisha, por vendosa të mbështetesha vetëm në Perëndinë. Çdo mëngjes, përpara se të largohesha për të shkuar në takimin e lutjes së mëngjesit, lutesha duke ua prekur këmbët me duar, përpara se t'i lija në gjumë. Teksa ngisja makinën në autostradë, bërtita: “Zot! Zot! Zot!” për ato pesëmbëdhjetë minuta që m'u deshën për të shkuar atje. Pasi mbaroi takimi i lutjes së mëngjesit, u luta sërish duke rënë në gjunjë në pjesën e errët të shenjtërores së kishës dhe duke e takuar Perëndinë në një nivel më të thellë. Të gjitha zotërimet materiale që kisha dikur, u zhdukën, por unë mund të këndoja: “Zoti është Bariu im, asgjë nuk më mungon” gjatë rrugës së kthimit për në shtëpi. Ishte rrëfimi im i vërtetë.

Gjatë kësaj kohe im atë kishte ndërruar jetë, por unë e fsheha divorcin tim prej mamasë dhe anëtarëve të familjes, dhe shtiresha sikur isha akoma e martuar, duke lënë zërin e ish-burrit tim në sekretarinë e telefonit. E kaloja të gjithë kohën e lirë me fëmijët

e mi. Doja të isha e përfshirë në të gjitha veprimtaritë e tyre shkollore dhe sportive, duke bërë punë vullnetare me nënat e tjera dhe duke bërë ato gjëra që më parë nuk i kisha bërë, për shkak të orarit tim të ngarkuar.

Kisha dështuar dy herë në martesë, por u ktheva te Perëndia, që mund të m'i plotësonte të gjitha nevojat e mia. Nisa ta kuptoja thirrjen time të vërtetë.

4. Takimi i mentorit

Thirrja e vërtetë ishte thjesht t'i shërbeja Perëndisë. Në fillim, kur shkova te takimi i lutjes, u ankova për situatën e jetës sime. Por kur erdhi Fryma e Shenjtë në zemrën time, u pendova mes lotësh. Kur e kuptova se isha një mëkatore, erdha për të kërkuar falje. Shqyrtova sesi e kisha përjetuar hirin e Tij, edhe kur kisha vazhduar të merrja vendimet e gabuara.

Kur e shihja situatën time prej një këndvështrimi të botës, unë kisha humbur gjithçka. Por, për çudi, nuk kisha qenë e lumtur, as kur kisha pasur shumë gjëra. Tani, gjatë ditës, shkoja në një dhomëz të vogël ku mbanim rrobat, e mbyllja derën dhe përjetoja miqësi të thellë me Perëndinë në errësirë.

Mikeshat e mia më nxisnin që ta merrja sërish në konsideratë martesën. Njëra prej tyre më tha se një burrë i huaj (jo-korean) do t'i rriste fëmijët e dikujt tjetër më mirë sesa një burrë korean. Fillova të lutesha për këtë. Me përvojat e divorceve të mia, mendova se nuk do të isha në gjendje të martohesha me një pastor ose një misionar, prandaj u luta që Perëndia të më jepte për burrë një plak të kishës. Pastaj do të përkushtohesha për t'i shërbyer Perëndisë si vullnetare për pjesën tjetër të jetës sime. U luta për një të huaj, të divorcuar, të gjatë, të pashëm, ku gruaja të ishte ajo që e kishte braktisur martesën e tyre. Dy muaj më vonë, Perëndia iu përgjigj lutjes sime 100 përqind duke dërguar Pastorin Folei.

Martesa ime me Pastorin Folei ishte takimi im me mentorin. Ai gjithmonë më ndihmon, më mbështet, dhe më do plotësisht. Pa të, unë nuk do të ekzistoj si personi që jam tani. Kur u takuam për herë të parë, ai profetizoi se unë isha si Jozefi i Biblës. Motrat e mia ishin xheloze për mua, por Perëndia do të më ngrinte lart, pasi ta mbaroja trajnimin e Tij. Me kalimin e kohës, burri im profetizoi më tepër gjëra për mua. Ai solli dy fëmijë në martesën tonë, dhe kështu bëra edhe unë. Është bekim nga Perëndia që ata të gjithë shkojnë mirë me njëri-tjetrin. Kjo ishte një gjë që e bëmë mirë ne si prindër: të modelojmë sesi t'i shërbejmë Perëndisë në jetët tona.

Më në fund, me ndihmën e Perëndisë, pata një martesë të suksesshme. Ai ma dha këtë gjë, pasi e kisha vendosur Perëndinë si prioritet për të siguruar për të gjitha nevojat tona. Pastori Folei gjithmonë më drejton lidhur me gjërat që do Perëndia që të bëj në jetën time. Prandaj ai është mentori im!

5. Kalimi i pragut të parë

Kapërcimi i pragut nga ana ime ishte vendimi im që të mos i ndiqja më qëllimet sipas botës e të mos veproja sipas mënyrave të botës, kur e ripërkushtova veten ndaj Zotit në shërbesat e lutjes në mëngjes. Me të vërtetë, në çastin që vendosa së pari ta ndjek Jezusin, ky ishte kapërcimi i pragut, por mendoj se unë ndenja tek ai prag dhe kurrë nuk ia dola mbanë që ta kapërceja atë në atë moment të rinisë sime. Kur u martova me Pastorin Folei, nisa ta kërkoja me të vërtetë Perëndinë dhe ta ndiqja thirrjen e Tij. Nuk mendoj më sipas mënyrave të botës ose të sillem sipas dëshirave të mia. Në vend të tyre, jetoj duke dalluar se cili është vullneti i Perëndisë. Aventura ime nisi me Pastorin Folei, kështu që nuk jam vetëm.

Fokusi im ndryshoi nga fëmijët e mi tek im shoq dhe Bibla u bë udhëzuesi ynë. Duke e ndjekur Fjalën e Perëndisë, Perëndia

bëhet i përgjegjshëm për gjithçka. Do t'i bindem Perëndisë, kudo që të më drejtojë. Mësova ta bëj Perëndinë prioritet në jetën time.

Në moshën pesëdhjetë vjeçare, përfundova gradën shkencore master në këshillim, doktoraturën në drejtim dhe gradën e seminarit në Kore, në mënyrë që Perëndia të mund të më përdorte si instrumentin e Tij plotësisht. Si njerëzit e tjerë, edhe unë dua të pushoj, por kam nevojë t'i bindem thirrjes së Perëndisë.

Fillimisht, në fakt, nuk doja t'i bindesha thirrjes së Pastorit Folei që t'i përkushtonim jetët tona për t'u shërbyer të krishterëve koreanoveriorë, që mbliidhen në fshehtësi, duke hequr dorë nga gjithçka që kishim. Ai kishte një ëndërr për këtë dhe kur ma tregoi, u zhgënjeva shumë. Duke u martuar me një pastor amerikan, unë doja të shkrihesha brenda shoqërisë amerikane dhe ta lija krejtësisht pas vetes popullin korean.

Kur u ktheva në Kore për të mësuar vallëzimin korean dhe për të shkuar në shkollë pasuniversitare, përfundova duke e urryer Korenë, pasi pashë sesi studentët duhej që të silleshin si skllëvër përpara profesorëve dhe mësuesve të valleve. Ishte kaq ndryshe nga ajo që kisha përjetuar si studente në Shtetet e Bashkuara, dhe vendosa që atëherë të mos kthehesha më në Kore. Por qëllimi i Perëndisë për jetën time ishte ndryshe nga i imi.

Unë e dija se do të duhej ta ndihmoja Pastorin Folei që të përmbushte thirrjen *e tij* sepse unë mund të flisja gjuhën koreane. Nuk mund ta refuzoja këtë thirrje, si njeriu që ka marrë shansin e fundit për t'i shërbyer Perëndisë. “Sepse mendimet e mia nuk janë tuajat, dhe rrugët tuaja nuk janë të miat,” - thotë Zoti.³⁴

Brenda disa viteve martesë, ne nisëm shërbesën e Koresë së Veriut, përmes Zërit të Martirëve. Perëndia na ka përdorur ne si instrumente të dobishëm për të bërë ungjillëzim në shkallë të madhe dhe punë dishepulluese në botë për koreanoveriorët.

³⁴ Isaia 55:8, NKJV.

6. Sprovat, aleatët dhe armiqët

Në historinë time, testi mori formën e mospasjes dëshirë nga ana ime për të takuar koreanë dhe për ta ekspozuar veten ndaj turpit dhe talljes së tyre. Doja ta hidhja pas krahëve të shkuarën time. Megjithatë po ndihesha sikur Perëndia po më thërriste dukshëm mua për t'u shërbyer me transparencë të gjithë atyre dhe duke ndarë jetën time me ta.

Duke u martuar me një amerikan, mendova se nuk do të kisha më nevojë për t'u takuar me koreanët. Doja sidomos, të shmangia të krishterët koreanë, prandaj isha e lumtur që u martova me një pastor amerikan. Nga ana e jashtme, të krishterët koreanë duken shumë të qetë dhe të përlulur, por shpesh ata i kritikojnë të tjerët privatisht, sidomos gratë si puna ime, të cilat kanë kaluar gjëra si ato të miat. Por pak muaj pas martesës sonë, unë besoj se Perëndia i dha Pastorit Folei, bashkëshortit tim, një ëndërr sipas të cilës ne do të duhej t'i linim pas të gjitha gjërat, për Korenë e Veriut. Ëndrra më zhgënjau shumë. Unë doja të isha si amerikanët dhe të jetoja mes tyre. Por nuk mund ta injoroja premtimin që i pata bërë Perëndisë për t'i shërbyer Atij dhe për të shkuar kudo ku Ai do të më dërgonte.

Pastori Folei pati pranuar një thirrje të vështirë. Nga ana financiare ishte e vështirë për ne, por ngaqë ai ishte një bashkëshort i mirë, unë isha falënderuese tërë kohën. Unë mund të isha falënderuese, ndonëse fëmijët e mi i kishin çorapet me vrima dhe iu duhej të shkonin në një shkollë të keqe në një zonë të ashpër, ku kishim lëvizur për të jetuar. Më përpara unë kisha pasur shumë para, por nuk isha e lumtur. Kurse tani, pa para, jeta ime ishte bërë e lumtur, me bashkëshortin, i cili besoj se më ishte dhuruar në mënyrë të mrekullueshme prej Perëndisë. Besoj se Perëndia nisi të më trajnonte mua për t'u marrë me çështjet financiare, kur unë nuk kisha hasur asnjëherë më përpara në vështirësi financiare.

Aleatët në historinë time janë Xhim Dau (Jim Dau), Edvin Balde (Edwin Baelde) dhe Flllojd Brobëll (Floyd Brobbel) nga

organizatat “Zëri i Martirëve” anembanë botës. Kur kaluam një kohë sfiduese, për shkak të një punonjësi të shërbesës, këta burra ishin ndihmë e madhe për ne. Perëndia na tregoi mjaft haptas se cilët na donin më shumë nga zemrat e tyre. Dashurinë e tyre nuk do ta harrojmë deri sa të vdes. Shpresoj që një ditë të mund t’ua shpërblej mirësinë që treguan me ne.

Armiku në historinë time është materializmi, që ka depërtuar në krishterimin e Koresë së Jugut. Kur isha duke u rritur në vitet gjashtëdhjetë e shtatëdhjetë, krishterimi në Korenë e Jugut kishte një vërtetësi të thjeshtë e të fuqishme. Në mendjen time kujtoj se kisha koreane ishte një kishë e vogël, me dyshe me prej kashte, me njerëz që binin në gjunjë, duke ngritur duart lart drejt Zotit me fytyra të dëshpëruara.

Kur u ktheva në Kore, kisha ishte bërë një ndërtesë e madhe, pastorët ishin bërë idhuj dhe të gjithë ishin fiksuar me tituj të tillë si pastor, plak ose dhjak. Ofertat shpenzoheshin më tepër brenda për brenda bashkësisë, sesa në udhëtime misioni. Kërkimi aq i dëshpëruar për Perëndinë ishte zhdukur, për shkak të bollëkut në jetën e anëtarëve dhe të bekimeve materiale. Të krishterët kanë një mbulesë të hollë besimi, e cila përqendrohet në dëgjimin e Fjalës e jo në bërjen e saj. Unë besoj se Perëndia do ta rindërtojë krishterimin korean me gjakun e martirëve dhe të të krishterëve të përndjekur, të cilët ndërmarrin rrezikun vetëm me anë të besimit.

Materializmi i të krishterëve në Korenë e Jugut ka një ndikim të madh tek dezertorët prej Koresë së Veriut. Me synimet më të pastra, kishat në Korenë e Jugut filluan t’u jepnin para dezertorëve nga Korea e Veriut për të ardhur në kishë.³⁵ Por kjo gjë hodhi idenë e gabuar në mendjen e dezertorëve koreanoveriorë. Shkolla e trajnimit të misionarëve nga Universiteti i Fshehtë (UF) për dezertorët koreanoveriorë, e cila drejtohet prej “Zëri i Martirëve” në Kore, po haste vështirësi për shkak të këtij

³⁵ International Crisis Group, “Strangers at Home: North Koreans in the South,” *Crisis Group Asia Report No. 208*, 14 July 2011, 26.

materializmi: studentët gjithnjë prisnin të paguheshin vetëm për t'u paraqitur në klasë. Kurse ne u kemi ndenjur besnikë parimeve tona për të mos i ngatërruar Perëndinë dhe paranë. Por, materializmi ka hyrë thellë në kishën e Koresë së Jugut, dhe ai e çrregullon punën time për Korenë e Veriut në çdo çast. Prandaj ai është armiku im.

7. Shpella më e brendshme në thellësi

Në historinë time, shpella më e brendshme në thellësi ishte angazhimi im i parë i plotë me një shërbesë amerikane, si përfaqësuese e popullit korean. Dhe m'u duk sikur ajo shpellë u përmbys mbi mua!

Pasi u martova me Pastorin Folei, ai vazhdoi të shërbente nëpër shumë shërbesa. Në fillim, ai u përqendrua te ndihma për njerëzit që jetonin rrugëve, bashkë me punën që bënte në kishë. Ne i merrnim në shtëpinë tonë njerëzit që po rikuperoheshin nga varësia e drogave, si pjesë e procesit të tyre të rehabilitimit për të mësuar sesi të jetonin një lloj të re jete. Përfundimisht, shumica prej tyre iu rikthyen drogës, dhe një burrë të cilin ne po e trajtonim si të ishte biri ynë, na tradhtoi dy herë brenda një dekade duke na shkaktuar pikëllim shumë të madh.

Ne e ndoqëm drejtimin e Perëndisë për në vende, ku përndryshe kurrë nuk do të kishim shkuar, nga Los Anxhelos në San Diego, në Hjuston dhe më në fund në Kolorado. Pikërisht këtu, ne lamë pas gjithçka për hir të një shërbesë amerikane. (Kjo ndodhi përpara se të nisnim punën për Korenë e Veriut.) Ne e lamë pozicionin tonë në kishë, punën tjetër të Pastorit Folei dhe madje edhe shtëpinë tonë, për t'u përqendruar mbi një organizatë të vetme. Pastori Folei punoi si zëvendës president me kohë të plotë i asaj organizate, dhe unë shërbeva si vullnetare me kohë të plotë, duke e prezantuar organizatën te komuniteti korean në Amerikë.

Bashkëshorti im e ka dhunti ngritjen e fondeve, kështu që në më pak se një vit, ai ishte në gjendje ta rriste në mënyrë të rëndësishme numrin e dhuruesve të organizatës. Por, në këtë proces, ne filluam të shihnim tendenca shqetësuese nga ana e themeluesve të organizatës në mënyrën sesi i shpenzonin fondet e reja që ngritëm. Ishte shokuese, sepse kur im shoq i adresoi këto shqetësime, ne na pushuan nga shërbesa. Sërish, unë përjetova vuajtje për bërjen e asaj që ishte e drejtë, në të njëjtën mënyrë siç kisha vuajtur kur erdha në Shtetet e Bashkuara për herë të parë, si grua e sapomartuar.

Ne u konsultuam me një avokat për ta hedhur në gjyq organizatën. Ai na nxiti që të vepronim ashtu dhe na tha që kishim shumë të drejtë për rastin tonë, por përfundimisht, pasi u lutëm për këtë gjë, Zoti na solli 1 Korintasve 6:7 në mendjet tona dhe ne e kuptuam se hedhja në gjyq e të krishterëve të tjerë nuk ishte gjëja e duhur, ndonëse ata na kishin rënë në qafë. Ishte një vendim i shtrenjtë: lëvizja për në Kolorado na la me borxhe dhe themeluesit e shërbesës u folën keq të tjerëve për ne. Edhe pse kishim zgjedhur ta përlëvdonim Perëndinë me anë të veprimeve tona, ne u katandisëm si varfanjakë të cilët tani kishin edhe një nam të dyshueshëm për shërbesë. Kurse ata që na tradhtuan, përfunduan si njerëz shumë të pasur, duke përfituar personalisht prej punës që kishim bërë ne në vend të tyre.

Kur u futa në shërbesën e krishterë me tim shoq, kisha pritjen se drejtuesit e shërbesës gjithnjë do të vepronin me etikë dhe me drejtësi. Kur drejtuesit e Krishterë në Kolorado na mashtruan më shumë se kushdo tjetër nga bota jobesimtare, e vura në dyshim ekzistencën e Perëndisë. Si mundej Ai ta lejonte të ligun të triumfante dhe të drejtin të vuante, madje edhe mes atyre që bëjnë shërbesë? Si mundej kjo organizatë të gjallëronte për një kohë aq të gjatë, por të ishte e ndërtuar mbi mashtrim? Pse Perëndia lejoi që unë dhe im shoq të shkonim atje? Ishte hera e parë në jetën time, kur e vura sinqerisht në dyshim nëse Perëndia ekzistonte.

Kur u bëra dizenjatore mode, e kisha injoruar Perëndinë. Tani ndihesha sikur, ose Perëndia po më injoronte mua, ose Ai nuk ishte real. Vendosa të kaloja tre muaj kohë për të kërkuar dhe për ta mbledhur mendjen një herë e mirë, nëse Perëndia vërtet ekzistonte.

Faktikisht, u luta për njëqind ditë, që Perëndia do ta shkatërronte atë organizatë, por në vend të kësaj, Perëndia shkatërroi mendimin mëkatar, hidhërimin dhe zemërimin në zemrën time.

8. Sprova e rëndë

Në fillimet e themelimit të “Zëri i Martirëve” në Kore, pati shumë vështirësi. Sprova ime erdhi në atë kohë. Njëri nga anëtarët tanë të personelit vidhte para nga llogaria bankare e shërbesës, sa herë që im shoq dhe unë ktheheshim në Shtetet e Bashkuara. Koreanët e tjerë vinin të punonin për ne, vetëm për shkak të mundësive që ne u siguronim për të vizituar Shtetet e Bashkuara dhe për të mësuar anglisht. Disa prej dezertorëve nga Koreja e Veriut të cilët i ndihmuam kur rrezikonin të humbnin jetët e tyre, na tradhtuan dhe u përpoqën të shkatërronin reputacionin tonë. Të tjerët thjesht merrnin ndihmë dhe zhdukeshin. Prapëseprapë në secilën prej këtyre situatave dhe në shumë të tjera, unë besoj se Perëndia më ka trajnuar mua dhe Zërin e Martirëve në Kore për t’u bërë më shumë si Ai. Përmes këtyre përvojave, ne vazhduam të mësonim përlulesinë dhe bindjen. Ne kemi arritur të kuptojmë se kjo është shërbesa e Perëndisë dhe jo e jona; ne besojmë se Ai do ta mbrojë atë, dhe kur Ai lejon që të përballemi me vuajtjen, ne mund t’i zëmë besë Atij.

Që të gjitha vështirësitë në Kore më drejtuan tek një rilindje personale. Më përpara unë isha e gatshme të isha pjesë e shërbesës, por nuk kisha trajnim. Gjithashtu u përpoqa të shërbeja me forcat e mia. Tani besoj se Perëndia është bërë guri i qoshes në martesën time, në jetën time dhe në shërbesën time. Besoj se nuk ka rëndësi

se çfarë më ndodh mua, Perëndia më sjell sërish në jetë, madje me besim edhe më të madh në Të.

Përmes sprovave të rënda me të cilat jam përballur, Perëndia më ka trajnuar dhe e ka forcuar akoma më tepër martesën tonë. Jam ndryshuar në një person që mund ta menaxhojë mirë punën e Perëndisë. Madje edhe njerëzit që më lënduan, u përdorën si instrumente nga Perëndia, prandaj unë duhet të jem falënderuese për ta dhe t'i konsideroj ata të çmuar.

9. Shpërblimi

Shpërblimi im janë personeli aktual dhe partnerët e “Zëri i Martirëve” në Kore. Dhe fëmijët e mi që erdhën nga martesa me Pastorin Folei, Trevor dhe Margaret, janë shpërblime veçanërisht të mëdha.

“Zëri i Martirëve” në Kore u themelua bashkë me tim shoq, Pastorin Folei. Kjo organizatë është shumë e pashoqe, ngaqë ajo lidhet me të krishterët kudo nëpër botë. Mungesa e lidhjes dhe bashkëpunimit me të tjerët ka qenë gjithnjë një pikë e dobët në kishën e Koresë së Jugut, por Perëndia po na lejon që ta bëjmë mirë këtë gjë në Korenë e Jugut. Kisha në Korenë e Jugut është rritur kaq shpejt, sa që tani po dërgon më tepër misionarë në pothuajse të gjitha vendet e botës. Pikat e forta të kishës në Korenë e Jugut janë të rëndësishme: guxim, pasion dhe fuqi. Kurse pika e dobët në kishën e Koresë së Jugut, përveç betejave të saj me materializmin, është mungesa e bashkëpunimit të saj praktik dhe strategjik me të tjerët.

Perëndia bën punë të madhe, kur ne bëhemi një. Unë lutem që Perëndia ta përdorë Zërin e Martirëve në Kore, si instrumentin e Tij për ta ndihmuar kishën e Koresë së Jugut që t'i mposhtë dobësitë e saj. Ne jemi një organizatë ndërkombëtare që përqendrohet tek bashkëpunimi, dhe Perëndia na ka vendosur në një vend, që është pasionant për misionin ndaj botës. Nëse Perëndia na përdor ne, për

të ndihmuar në mposhtjen e dobësive në kishën e Koresë së Jugut, mbretëria e Perëndisë do të jetë shumë produktive dhe efikase.

Jam falënderuese sesi Perëndia e përdor Zërin e Martirëve në Kore për të bërë një llojshmëri shërbesash që t'i ungjillëzojnë dhe t'i dishepullojnë koreanoveriorët. Këto gjëra përfshijnë punën e avokatisë së Zërit të Martirëve, programin e vetë-këshillimit Praso (Prasso), transmetimet në radio Zëri i Vërtetë i Martirëve, zbarkimin e Biblave me balona, Universitetin e Fshtetë dhe shkollat e trajnimit në Teknologjinë e Fshtetë, shërbesën me jetimët dhe shërbesën me shpërndarjen e pakove. Secili projekt është një gëzim dhe një privilegj.

Jam kaq e lumtur dhe e gëzuar kur mendoj se Perëndia na ka përdorur për t'i bërë të gjitha këto punë të shërbesës.

10. Rruga për kthimin

Në historinë time, rruga për kthimin përshkruan sesi unë, pasi u largova nga Koreja tridhjetë vjet më parë, u ktheva për t'i shërbyer një familjeje të re: familjes së Perëndisë në Korenë e Veriut dhe të Jugut. Në rrugën time të kthimit nisa ta lidhja atë familje me pjesën tjetër të botës. Koreja e Jugut kishte ndryshuar krejtësisht, që kur isha larguar unë dhe kthimi ishte sikur po vija në një vend të ri.

Im shoq dhe unë tani jetojmë në Kore, duke mbikëqyrur zyrën e “Zëri i Martirëve” në Kore.

Ndihem se jam rritur shumë përmes arsimimit tim formal dhe joformal dhe përmes gjërave që kam përjetuar. Tani unë mund ta aplikoj të gjithën këtë njohuri në shërbesë.

Si e krishterë, mendoj se me qëllim që të bëhem e dobishme për Perëndinë, më duhej të përjetoja thyerjen dhe përrulësinë, që nuk mund të fshihej prej të tjerëve. Në këtë mënyrë, ata që po përpiqesha t'i ndihmoja mund të shihnin tek unë të njëjtën thyerje që përjetonin ata vetë. Ata po fshiheshin prej frikës se të tjerët do t'i kritikonin, në të njëjtën mënyrë që isha kritikuar unë. Besoj

se Perëndia më përdor mua për t'u treguar atyre se ata nuk ka pse të kenë frikë ose ta fshehin dhimbjen e tyre. Besoj se ata mund të kenë shpresë, ngaqë mund ta shohin se Perëndia mund të përdorë edhe dikë si puna ime.

11. Ringjallja

Deri më tani unë ju kam treguar të gjitha telashet, zhgënjimet, tradhëtitë dhe thyerjen në jetën time. E hapa veten time mjaftueshëm që të zhgënjeheni prej meje e të më përçmoni. Dhe këtë e bëj qëllimisht, ngaqë përmes të gjitha këtyre gjërave, mësova për realitetin e ringjalljes. Në fakt, e vetmja mënyrë sesi mund të mësoni për realitetin e ringjalljes është ta përjetoni vdekjen e çdo shprese, ëndrrë, dëshirë dhe qëllimi, që keni në jetën tuaj. Më lejoni t'ju tregoj se ku e kam fjalën.

Nëse e lexuat me kujdes udhëtimin tim, do ta shihni se që nga çasti i lindjes sime e më tej, unë po kërkoja të ikja larg prej thyerjes. Pyesja veten se përse isha lindur në një familje që nuk kishte nevojë për një vajzë dhe kjo bëri që të kërkoja mënyra për t'u larguar prej atij identiteti të thyer të vetes sime. Më në fund, kjo më bëri që të martohesha me një burrë, i cili brenda një muaji ma shkatërroi atë pak plotësi që kisha kërkuar ta sillja në martesë. Kërkova largimin nga abuzimi tek muskujt e një burri, për të cilin shpresova se do të më mbronte, por gjatë viteve në këtë martesë, mësova se ajo që po bëja në të vërtetë, edhe në mes të këtij sukcesi të madh material, ishte se po kërkoja të shpëtoja prej thirrjes së Perëndisë në jetën time. Dëshiroja ta gjeja plotësinë tek vetja ime, të shpëtoja prej thyerjes tek dikush tjetër të cilit mund t'i zija besë, e jo tek Perëndia. Dhe e vërteta është se ai lloj largimi gjithnjë do të shpinte në vdekje.

Dhe pikërisht atje më shpuri vazhdimisht. Edhe në martesën time aktuale, doja të shpëtoja prej shoqërisë koreane, që të mund

ta fshihja thyerjen time prej të tjerëve. Por Perëndia e përdori thirrjen e tim shoqi për të më tërhequr mbrapsht tek vendi prej të cilit isha orvatur të largohesha. E lashë botën e punësimit në punë jofetare dhe kërkova të largohesha për në një botë që e mendoja se do të ishte me drejtues shërbese të shenjtë, të patëmetë dhe të drejtë. Ajo që zbulova ishte se *nuk ka drejtues shërbese të shenjtë, të patëmetë dhe të drejtë*; ata janë thjesht mëkatarë si unë. Madje u përpoqa ta krijoja familjen dhe shërbesën time si një vendstrehim për të ikur prej thyerjes sime, por përmes tradhtisë së personave që adoptuam, duke i hequr nga jeta e rrugës dhe prej bashkëpunëtorëve mashtrues, e kuptova sërish të vërtetën e madhe të udhëtimit të heroit: nuk ka largim prej thyerjes në jetë.

Ky tingëllon si lajm tejet i keq, por në fakt është krejt e kundërta. Vërtet, vetëm kur ne ndalojmë së kërkuari plotësinë tek njerëzit e tjerë dhe tek vendet e tjera, mund të vijmë në prehjen e së vërtetës se plotësia mund të gjendet vetëm në Perëndinë. Është ashtu siç thotë Pali te 1 Korintasve 1:26-27: “Vëllezër e motra, mendoni se çfarë ishit kur u thirrët. Jo shumë prej jush ishin të urtë sipas standardeve njerëzore; jo shumë ishit me ndikim; jo shumë ishit fisnikë nga lindja. Por Perëndia i zgjodhi gjërat e marra të botës për t’i turpëruar të urtët; Perëndia i zgjodhi gjërat e dobëta të botës për t’i turpëruar të fortët.”

Pikërisht në pikat më të thella të përvojave më të mëdha të thyerjes dhe tradhtisë, unë u rilinda. Po rrija ulur në shtrat, e brengosur, teksa mendoja për njërin prej burrave të pastrehë që e kishim ndihmuar, i cili tani na kishte dalë kundër, pas gjithë atyre viteve që ne i kishim ofruar dashuri dhe mikpritje. Sërish shtëpinë dhe familjen time i pushtoi thyerja. E gjithë ajo mirësi që kisha ofruar, tani dukej sikur ishte hedhur në gjiriz. Ndjeva peshën sesi kjo përvojë mund ta dëmtonte reputacionin tim dhe reputacionin e tim shoqi e të shërbesës sonë, për shkak se kaq shumë detaje të jetës sonë personale mund të bëheshin publike e të përdreshin për të na lënduar. Gjithçka ndihej e errët si vdekja.

Dhe pastaj, prej thellësisë së asaj errësire e të vdekjes, nga të çarat e shpirtit tim u ngrit një këngë. E gjeta veten duke kënduar Fjalët e Urta 29:25: “Frika e njeriut do të dalë se është një kurth, por kushdo që i beson Zotit mbahet në siguri.”

E sigurt! Kisha kërkuar tërë jetën për njerëz të sigurt e për një vend të sigurt, por në një çast tradhtie të rëndë, Perëndia më ringjalli dhe më tregoi se vetëm Ai është i sigurt. Ai gjithmonë do të na drejtojë në një udhëtim që i kapërcen shtigjet e njerëzve të thyer dhe të vendeve të thyera, ngaqë Ai është Shpëtimtari edhe i atyre. Ne nuk duhet të kërkojmë të largohemi prej thyerjes, por përkundrazi duhet t’i afrohemi Zotit, teksa Ai na mbart të sigurt në shpinën e Tij gjatë gjithë udhëtimit.

Rilindja nuk është largimi. Nuk është shpëtim prej njerëzve jo të sigurt apo të vendeve jo të sigurta. Përkundrazi është njohuria se kushdo që i beson Zotit mbahet i sigurt.


12. Rikthimi me eliksirin

Në historinë time, eliksiri jam unë! Sapo e mësova historinë e udhëtimit të heroit dhe të vërtetat që ofron ajo, e konsiderova veten dhe të tjerët krejt ndryshe. Shoh se kushdo është një hero në trajnim e sipër dhe se Perëndia udhëzon secilin prej nesh në një udhëtim, ku e gjithë dhimbja e vuajtja ka për qëllim që të na ndihmojë të rritemi e të bëhemi më tepër si Ai dhe në këtë mënyrë të jemi më të dobishëm në shërbesën e Tij. Besoj se Perëndia më bëri mua një “eliksir” për ta ndarë këtë me të tjerët.

Përjetova kaq shumë dështime në jetën time: dy martesë të prishura, një biznes i dështuar, vështirësi në shërbesë, dështime në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë dhe madje edhe kohë të vështira me fëmijët tanë. Por, besoj se Perëndia i ktheu të gjitha dështimet e mia në një eliksir, që unë mund ta përdor për t’i ndihmuar njerëzit e tjerë. Dhe unë besoj se jo vetëm që jam në udhëtimin e

një heroi, por gjithsecili, duke të përfshirë edhe ty, është në këtë udhëtim. Nëse nuk dorëzohemi, secili prej nesh do të marrë një shpërblim dhe një eliksir, të cilin mund t'ua sjellim atyre që na njihnin në jetët tona të zakonshme.

Në rastin tim si e krishterë, ndodhi sikur t'ia kisha dhënë mbrapsht Perëndisë penelin e jetës sime dhe Ai e bëri jetën time kaq të bukur. Unë isha vetëm një portret i njollosur dhe i rrjedhshëm, kurse Ai e transformoi rrëmujën time në një kryevepër arti. Dhe tani Perëndia më paraqet tek njerëzit e tjerë si shembull, duke u treguar atyre të jetojnë si unë: plotësisht me mirëbesim tek Ai dhe duke qenë në gjendje që të jem plotësisht transparente lidhur me dështimet e mia. Prandaj, unë besoj se Ai më përdor mua si një “eliksir,” që njerëzit e thyer, të rënë dhe të pashpresë të mund të arrijnë të kenë shpresë duke më parë, një shpresë që do t'i aftësojë ata për ta përfunduar “udhëtimin e heroit” tek i cili Perëndia i ka dërguar ata.



Vizatimi im është takimi mes meje dhe tim shoqi, duke simbolizuar bashkimin e Perëndimit me Lindjen. Ne e themeluan “Zëri i Martirëve” në Kore, që të shërbente si urë mes të krishterëve në Perëndim dhe në Lindje, nga ana e të krishterëve koreanoveriorë,

specifikisht dhe më gjerësisht, nga ana e të krishterëve të përndjekur kudo, përmes shoqërimit tonë me Zërin e Martirëve.

Në sytë e Perëndisë unë besoj se do të ketë një fuqi të mrekullueshme, nëse kjo urë mund t'i lidhë pikat e forta të njerëzve në të dyja anët. Organizata jonë mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm, ngaqë ne i njohim shumë mirë pikat e forta e të dobëta të secilit grup.

Po të hidhni një sy brenda ndërtesës së “Zëri i Martirëve” në Kore, ju do të vëreni se ka kaq shumë të huaj pothuajse nga e gjithë bota, që vijnë si vullnetarë në shkollat e programet tona. Koreanët e Veriut e të Jugut mblidhen bashkë për të ngrënë dhe për të marrë pjesë nëpër raste të ndryshme. Në këtë mënyrë, “Zëri i Martirëve” në Kore është një shijim paraprak i parajsës, ku do të mblidhen së bashku të gjitha kombet. Perëndia do të marrë lavdi dhe do të veprojë me fuqi, kur të gjitha vendet dhe organizatat të përpiqen për të njëjtën bashkësi të shenjtë.

Është Perëndia, jo ne, që e bën të shenjtë bashkësinë. Për njerëzit që janë të zhgënjyer dhe kanë hequr dorë nga gjërat në jetën e tyre për shkak të dështimeve, mangësive dhe mëkatit, ne duhet t'i ndihmojmë ata ta kuptojnë që janë në një udhëtim ku nuk ka rrugë pa krye: Perëndia ka ndërmend një destinacion, që nuk varet nga përsosmëria e tyre, por nga besimi i tyre i thjeshtë për të vazhduar të lëvizin përpara, madje edhe kur i kanë humbur krejt shpresat. Nëse ka ndonjë gjë për të mësuar nga jeta ime, është pikërisht kjo.

Një gjë që nuk e bëra, ishte të dorëzohesha, edhe në ato vite, kur pothuajse nuk i flisja fare Perëndisë. Unë eca përpara si përgjigje ndaj thirrjes së Tij. Lutem që përmes udhëtimit të heroit, ju gjithashtu do të nxiteni për të mos u dorëzuar, por përkundrazi për të vazhduar në udhëtimin tuaj, ashtu si unë dhe si ata koreanoveriorët, historitë e të cilëve do t'i lexoni tani. Nëse e bëni këtë, do të zbuloni se një ditë, edhe ju do të bëheni një eliksir për njerëzit në botën tuaj të zakonshme!

Kapitulli 2.

Znj. Hong: Udhëtimi i heroit për tek e vërteta

*Ushqejeni mendjen me mendime të mëdha; heronjtë
bëhen duke besuar në gjërat heroike.*

—Beniamin Dizraeli (Benjamin Disrael)³⁶

1. Bota e zakonshme

Unë linda në një familje të mirë. Kur im atë ishte djalosh, bëri sherr me të birin e një mbikëqyrësi japonez dhe sherri u përshkallëzua deri në përfshirjen e prindërve. Gjyshi im luftoi vetë me mbikëqyrësin japonez, gjë që rezultoi në dërgimin e gjyshit tim në një kamp përqendrimi si kriminel politik. Për fat të keq, ai vdiq atje, pak përpara se të mposhteshin japonezët në vitin 1945.

Për shkak të sakrificës së gjyshit tim, im atë u rrit në një familje që nuk i mungonte asgjë. Pasi u diplomua nga kolegji, ai punoi si roje i sigurisë kombëtare së bashku me trupat e patrullës kufitare.

Mamaja ime ishte koreane, që kishte lindur në Kinë. Edhe pse nuk kishte një histori të mirë familjare, ajo ishte shumë e pasur dhe mamaja e saj ishte në gjendje të rregullonte martesën për të. Ajo u martua me tim atë në moshën nëntëmbëdhjetë vjeçare dhe ata

³⁶ Benjamin Disraeli, *Coningsby: Or the New Generation* (Boston, MA: Adamant Media, 2000), 144.

patën shtatë fëmijë, përfshirë mua. Unë isha vajza më e madhe mes vëllezërve e motrave të mia. Familja ime ishte mirë ekonomikisht.

Mamaja punonte në një fabrikë veshjesh, me qëllim që të mund të hynte në Partinë Komuniste bashkë me pjesën tjetër të familjes së saj. Gjyshja ime ishte e para që u pranua në vitin 1945. Për shkak të prejardhjes së familjes sime, mendova se me patjetër unë do të bashkohesha me ushtrinë e do të shërbeja atje, që të arrija të futesha në Partinë Komuniste. Por im atë më pengoi ta ndiqja këtë shteg për në parti, sepse mendonte se një grua mund të detyrohej të sakrifikonte trupin e saj për të arritur sukses.

Në ato ditë fqinjët e mi më rekomanduan të lexoja gazetën *Rodong Simmun* (Puna) dhe të shkoja në kolegji për të studiuar transmetimet radiotelevizive, filmat dhe dramën. Kurse im atë nuk më dërgoi në kolegji; përkundrazi, ai këmbënguli që të rrija në shtëpi. Kështu që, unë u katandisa duke punuar për Qendrën Kërkimore të Kim Il Sung-ut. U bëra administratore e qendrës, duke dhënë leksione për historinë e Kim Il Sung-ut tek oficerët e qeverisë. Jeta e Kim Il Sung-ut përshkruhej në një seri prej 136 pikturave gjigante dhe ato tregonin historinë e lindjes së tij, fëmijërisë, adoleshencës dhe secilës arritjeje të rëndësishme që pati ai. Unë mund t'i shpjegoja që të gjitha ato, ngaqë i kisha mësuar përmendsh të gjitha detajet e historive. Truri im ishte aq i mprehtë saqë isha në gjendje të kujtoja gjithçka pasi ta kisha lexuar një ose dy herë informacionin shoqëruar. Shumë burra më adhuronin, por isha tepër arrogante për t'i hedhur sytë nga ata. Isha shumë krenare.

Unë ecja vërdallë, duke vënë duart pas shpine, me çelësat e institucionit që më vareshin nga gishtërinjtë. Gjithmonë vishesha me një kostum të mirë ose me një bluzë e fund tradicional korean. I injoroja përshëndetjet e punëtorëve dhe madje i shaja, nëse ata përpiqeshin të flisnin me mua. Megjithatë, tregoja pak mirësjellje kur më përshëndesnin anëtarët e kryesisë. I trajtoja burrat me arrogancë, por më në fund doli një burrë me të cilin rashë në dashuri.

Ai ishte drejtuesi i skuadrës së qendrës kërkimore dhe ai më donte vërtet. Ai ishte njëzet e shtatë vjeç, kurse unë njëzet. Ai donte që të vinte në shtëpinë time për t'u prezantuar me prindërit, por ata e kundërshtuan, duke këmbëngulur se unë isha tepër e re për t'u martuar dhe se së pari duhej të punoja shumë për t'u anëtarësuar në Partinë Komuniste. Unë u trishtova shumë, por i shkrova një letër të fundit atij dhe ne u ndamë.

E tregova besnikërinë time ndaj partisë duke punuar në minierë, si punë të dytë, për dy muaj. Mamaja ime më mbështeti, duke u dhënë si rryshfet një derr zyrtarëve të kompanisë së minierës. Gishtat e mi akoma kanë shenja të zeza, ngaqë punoja si lektore ditën për institutin, dhe gërmoja për qymyr natën.

Po ashtu u largova për një vit nga instituti për të organizuar regjistrin e familjes në kohën e rikonstruksionit të Qendrës Kombëtare për Regjistrimin. (Të jesh në gjendje ta provosh historinë e familjes tënde është thelbësore në Korenë e Veriut, ngaqë përndryshe nuk ke asnjë status.) Pas kësaj, u ktheva të punoja për qendrën për tre vite të tjera.

Më në fund, kur mbusha njëzet e katër vjeç, në vitin 1981, u pranova si anëtare e Partisë Komuniste. Isha përqendruar vetëm në anëtarësimin në parti, duke lënë mënjanë çdo mendim, përfshirë edhe martesën.

Një vit pasi u anëtarësova në parti, në vitin 1982, u martova me burrin tim të parë. Ai ishte nga Kanuon-du (Kangwon-do), por e kishte kryer shërbimin ushtarak në zonën time, Paekam, Rajangan-du (Ryanggang-do), Koreja e Veriut. Për shkak se ai ishte tejet i sjellshëm me mamanë time, ajo i kishte thënë atij se do t'i jepte për grua vajzën e saj (dmth mua), pasi ai të mbaronte ushtrinë. Pasi u lirua, ai u kthye shpejt në qytetin e tij të lindjes, por pastaj erdhi të qëndronte në Rajangan-du deri sa u martuam. Ai madje solli edhe të motrën me vete për t'u përgatitur për ceremoninë. Por unë nuk e kisha shumë me qejf martesën me të, ngaqë gjithnjë qëllimi im kishte qenë të martoheja ose me një oficer ushtrie, ose

me një zyrtar qeverie, kurse ky sapo e kishte përfunduar shërbimin ushtarak. Por mamaja ime këmbënguli që të martohesha me të, ngaqë ai ishte shumë punëtor.

Kështu që, përpara martesës ika dhe u fsheha për tri ditë në shtëpinë e një shoqeje. Por më në fund u ktheva në shtëpi dhe u martova me të, dhe shumë shpejt pas dasmës ne u kthyem në Kanuon-du, atje ku kishte lindur ai. Shtëpinë e kishte pranë fabrikave të çimentos që ishin të zbehura nga pluhuri dhe unë fitoja para duke dhënë leksione për Kim Il Sung-un në këto fabrika. Më pas lindi një djalë e një vajzë, por ngaqë nuk isha në gjendje të kujdesesha për të dy fëmijët, m'u desh ta dërgoja tim bir tek mamaja ime. Ndërsa vajzën e mbartja mbi shpinë kur punoja.

2. Thirrja për aventura

Kur punoja si lektore në fabrikë, ekonomia e Koresë së Veriut u bë shumë e pastabilizuar. Rroga ime nuk mjaftonte për ta ushqyer familjen, kështu që fillova biznesin tim. Blija prodhime kineze me çmim të lirë te zona ku kisha lindur unë dhe i shisja me çmim më të lartë këtu ku jetoja. Si fillim shita rroba, peshqira e çorape dhe më vonë, shita plehra kimike. Biznesi im shkoi mirë për pesë vjet.

Bashkëshorti im kishte një punë, por ai nuk mori asnjë kompensim prej qeverisë së Koresë së Veriut. Njerëzit punonin, por ata nuk mund të merrnin asnjë lloj pagese, dhe për këtë arsye ata vidhnin bakër nga fabrikat ku punonin dhe e shisnin atë që të fitonin pak para. Më vonë, unë e mbylla biznesin tim dhe im shoq nisi të tijin. Ai e shiste bakrin e vjedhur në Sinuixhu (Sinuiju) dhe i përdorte paratë për të blerë miell, të cilin e sillte mbrapsht për ta shitur.

E bëri këtë për tre vjet, duke shkuar vajtje-ardhje nëpër trenat elektrikë, që shpesh ndalonin papritmas për ditë të tëra, për shkak

të ndërprerjes së elektricitetit. Pastaj në një nga udhëtimet e kthimit për në shtëpi me vajzën tonë adoleshente, ata ishin në trenin e ngecur me pasagjerët e tjerë duke pritur që të kthehej rryma elektrike. Ajo u kthye, pikërisht kur trupi i tij kishte prekur aksidentalisht telin e korrentit. Shoku që pësoi e ngriti lart dhe e hodhi përjashta trenit, ndërkohë që pasagjerët e tjerë, përfshirë edhe vajzën tonë, e panë plot habi. Ata vështruan teksa treni largohej tutje, duke lënë në shesh trupin e tij të vdekur.

Vajza jonë nuk kishte asnjë ide se çfarë të bënte. Ajo vazhdoi edhe pak kohë në tren dhe pastaj zbriti, e pështjelluar. Ajo përfundoi duke ecur për afro gjashtëdhjetë li (afro njëzet e tre kilometra), një ditë e një natë të tërë, që të mbërrinte në shtëpi. Më në fund, asaj i ra të fikët te hyrja e derës së apartamentit tonë.

Vajza më tregoi se çfarë i kishte ndodhur tim shoqi, por unë nuk qava, ngaqë mendimet e mia të para ishin për ato dy çantat me miell, që mezi po prisja të m'i sillte, dhe ja ku kisha përpara vetëm vajzën time, pa asnjë ushqim.

Komshia më dha pesë kilogramë oriz, të cilat i ndava; mbajta disa për t'i shitur menjëherë, dhe disa për ta pasur për ritet e funeralit. Doja të shkoja në Sinuixhu (Sinuiju) për t'u përpjekur ta gjeja trupin e vdekur të tim shoqi, por nuk kisha mjaftueshëm para për biletën e trenit, prandaj vendosa t'i shpija të dy fëmijët e mi te shtëpia e prindërve të mi në Paekam, Rajangang-du, Koreja e Veriut.

Por, gjatë rrugës më kapën ethet paratifoide dhe humba vetëdijen. Kur i hapa sytë, e gjeta veten te shtëpia e prindërve të mi, pa fëmijët e mi. Mamaja ime i kishte dërguar ata tek ime motër, ngaqë nuk kishte fare ushqim për ta në shtëpi, sepse edhe ata po vuanin prej shkatërrimit ekonomik që po kalonte vendi. Ajo tha se nuk mundte dot t'i shpëtonte nipërit e mbesat e saj, ndërkohë që unë, vajza e saj, isha pothuajse duke vdekur.

Sapo mora pak forca, i solla prapë fëmijët në shtëpinë e mamasë sime. Për tre muaj, shita tofu (Shënim i Përkthyeses: tofu është

një substancë e prodhuar prej farave të sojës që përdoret për gatime vegjetariane kryesisht në guzhinën aziatike.), gjë që më mundësoi t'i ushqeja fëmijët dhe gjithashtu siguroja edhe diçka për ta ndihmuar mamanë time. Por nuk mjaftonte për të gjithë familjen, prandaj vendosa t'i lija fëmijët me prindërit e mi dhe të shkoja t'u kërkoja ndihmë të afërmve të mi në Kinë. Ishte viti 1997 dhe nuk kishte shumë ushtarë që ruanin kufirin. E kapërceva lumin Tumen në orën tre të mëngjesit.

Pasi e kalova lumin, gjeta kryetarin e një fshati koreano kinez, që më dha një biletë autobusi për të udhëtuar deri në Dalian, në provincën Liaoning të Kinës, ku jetonte xhaxhai im. Ndonëse nuk mundja dot të flisja gjuhën kineze, arrita të shkoja deri te zyra e avokatit të krahinës, ku xhaxhai im punonte si kryeavokati i krahinës. Ai më mori në shtëpinë e vet, kur i thashë si e kishte emrin mamaja ime.

Familjarët e mamasë sime më thanë se nuk kishin para për t'u dërguar prindërve të mi, prandaj më prezantuan me pronarin koreano kinez të një fabrike që prodhonte kimçi (Shënim i përkthyeses: Gjellë koreane pikante me lakra turshi.) Unë fitoja 200 juan (afro 32 USD) në muaj, plus strehimin në fabrikë. Pasi punova dhjetë muaj, isha në gjendje t'u dërgoja 1000 juan (afro 165 USD) familjes sime në Korenë e Veriut.

Pronari i fabrikës e rregulloi që të martohesha me një burrë koreano kinez. Por zbulova se në fakt ai më kishte shitur mua te ky burri koreano kinez për 3000 juan (afro 500 USD). "Burri" im i ri (nuk pati asnjëherë dasmë ose regjistrim martese) nuk e fliste gjuhën koreane, por dukej sikur më kuptonte pak kur flisja. Ai nuk punonte; thjesht pinte alkool përditë. Kunata dhe vjehrra ime më shihnin me përçmim dhe më keqtrajtonin shumë, ngaqë nuk flisja gjuhën kineze. Ato më detyronin t'i laja me dorë të gjithë rrobat e tërë familjes edhe pse kishin makinë larëse për rrobat. Më duhej t'u merrja leje atyre për të ngrënë dhe ato më lejonin vetëm sasinë më të domosdoshme e minimale për mbijetesë.

Kur im shoq dhe unë nuk mundëm të bënim fëmijë, vjehrra më dërgoi te një mjek për të zbuluar se çfarë nuk shkonte me mua. U turpërova kaq shumë. Por pasi më ekzaminoi, mjeku më deklaroi të shëndetshme dhe rekomandoi që im shoq të vinte për kontroll. Pasi e ekzaminoi tim shoq, mjeku e shpalli atë impotent, kështu që ne adoptuam.

Në vitin 2000, vjehrra dhe kunata ime shkuan në Korenë e Jugut për të fituar para. Ato premtuan se të gjitha paratë që do të fitonin në Korenë e Jugut do të m'i dërgonin mua, që ne të jetonim mirë. Por në vitin 2003, unë u kapa nga policia kineze, për shkak të budallallëkut të tim shoqi. Në fshat, kishte një vend pranë rajonit të policisë, ku mblidheshin njerëzit për të luajtur maxhong (Mah-jongg). Një ditë, kur im shoq ishte duke luajtur, ai e luajti mendsh gruan që punonte te restoranti pranë. Për këtë arsye, ajo raportoi në polici se bashkëshortja e tij ishte një koreanoveriore. Ishte pikërisht përpara Viti të Ri Kinez, ndaj as policët nuk është se po punonin vërtet atë muaj. Por pasi mbaruan festimet, policia erdhi të më arrestonte. Më morën për në rajonin e policisë duke mbajtur në shpinë beben tonë të adoptuar.

Njerëzit e fshatit erdhën dhe hodhën gurë në rajonin e policisë. Dhe ngaqë ata më pëlqenin shumë, kërkuan lirin tim, duke bërë titur: “Lirojeni atë! Ne e duam atë!”

Pavarësisht nga protestat e fshatarëve, unë u dërgova mbrapsht për në Korenë e Veriut. Në radhë të parë, nuk kishte qenë dëshira ime për të ndenjur në Kinë. Dëshira ime kishte qenë të bëja një vizitë të përkohshme, që të kërkoja para prej të afërmeve të mi atje. Kishin kaluar më tepër se pesë vjet, që kur isha larguar, por ndihesha sikur në fakt po kthehesha atje ku duhej të isha. E pashë këtë si një mundësi për të vizituar shtëpinë e prindërve të mi dhe të kontrolloja si ishin fëmijët, për t'u siguruar që po rriteshin mirë. Kështu që, ndërkohë që po largohesha nga Kina, ia dhashë beben tim shoqi dhe e bëra

atë të premtojë se do të dërgonte 3000 juan (afro 500 dollarë) në shtëpinë e prindërve të mi.

3. Refuzimi i thirrjes

Ishte për t'u habitur se oficeri i policisë kineze nuk m'i vuri prangat në tren, gjatë udhëtimit për në Korenë e Veriut, por përkundrazi më lejoi që të shkoja lirshëm në banjo. Kur e mendoj tani atë gjë, e kuptoj se ai po më lejonte të arratisesha, por unë e humba atë mundësi. Pasi kaluam në pikën e sigurisë kufitare në Onsong, më shpunë në burg në Departamentin Shtetëror të Sigurisë në Korenë e Veriut, teksa po më hetonin dhe po prisja gjyqin.

Në burg, rojet i kontrollonin jashtëqitjet e të burgosurve, ngaqë të gjithë ata që shkonin në burg me para, i mbështillnin ato me plastikë dhe i gëlltisinin, duke e ditur se do ta nxirrnin pas tri ditësh nga trupi. Po të kishte kujdes i burgosuri, ai ose ajo mund t'i merrte shpejt e shpejt paratë gjatë jashtëqitjes dhe t'i fuste shpejt në xhep, pa e vënë re rojet. Prandaj, nëse një i burgosur ngurron, ose lëviz në mënyrë të dyshimtë gjatë jashtëqitjes, atëherë rojet i bërtasin ose e rrahin.

Edhe unë, i gëlltita paratë që i kisha fshehur te pllazi i njëjës këpuçë. Pas tri ditësh, gjatë jashtëqitjes, si eksperte, i rrëmbeva paratë dhe i ngjeshja në xhep, pa më vënë re roja. Por kur u ktheva te vendi im në grupin e të burgosurve, të gjithë ata e dinin, për shkak të erës së tmerrshme. Por nuk e çava kokën për atë gjë, ngaqë dola me sukses. Gjithsesi, ngaqë isha shumë në ankth, pata dhimbje të forta stomaku, që e bënë gjithnjë e më të vështirë se zakonisht për ta gëlltitur qullin e burgut.

Jeta ime në burg ishte një pesëdhjetë ditësh në ferr. Një nga të burgosurit më dha një hapje për të më ndihmuar me dhimbjet e stomakut, por një nga rojet më kapi me atë hapje. Ai më ndëshkoi

duke ma përplasur kokën aq fort, saqë tingulli kumbues mund të dëgjohej anembanë burgut.

Si rezultat i hetimit, u dërgova në Qendrën e Trajnimit për Sigurinë Shoqërore. Atje nuk mund të dërgohen anëtarët e Partisë, prandaj, së pari ata ma hoqën statusin si anëtare e Partisë Komuniste.

Fillimisht unë nuk mund të ecja dot, ngaqë gjatë periudhës në burg, më kishin detyruar të rrija ulur tërë ditën. Por shumë shpejt pasi më lëvizën për tek Qendra e Trajnimit të Sigurisë Shoqërore, më detyronin të vrapoja përditë dhe të bërtisja “Trajnim me një mendje!” bashkë me të burgosurit e tjerë. Ne na detyronin të ngriheshim nga gjumi në orën 5:00 të mëngjesit dhe të shkonim të flinim në 10:00 të natës. Më kapën ethet e tifos, të cilat më dhanë diarre të vazhdueshme. Më në fund, kur isha thuajse e vdekur, më liruan pasi bëra një betim solemn për t’ia dedikuar pjesën tjetër të jetës sime Kim Il Sung-ut.

Mamaja ime solli një karrocë që të më shpinte në shtëpi, për shkak se nuk isha në gjendje të ecja aspak. Për shkak të fëlliqësisë në burg dhe në qendrën e trajnimit, kisha grumbuj morrash kudo nëpër trup e nëpër flokë. Im shoq më dërgoi 3200 juan (afro 520 dollarë) përmes tezes sime në Kinë, për tek familja ime në Korenë e Veriut, kështu që unë i dhashë 1000 juan (afro 165 dollarë) tim vëllai. Pjesën tjetër e shpenzova për të mbijetuar. Zbulova se vajza ime ishte në spital me tuberkuloz dhe im bir po jetonte si jetim (*kotjebi*, ose “zog pa vlerë”), duke gërmuar përreth tregut lokal për të gjetur diçka për të ngrënë. Ngaqë më kishin kapur në Kinë, nuk mund të merrja dot një kopje të regjistrimit tim të familjes. Nuk kishte asnjë mënyrë sesi mund të jetoja më në Korenë e Veriut. Për më tepër, Departamenti i Sigurisë Shtetërore, vazhdoi ta ruante shtëpinë time. Kështu që, më në fund vendosa të kthehesha në Kinë, për herë të dytë, por kësaj radhe duke i marrë me vete vajzën time dhe djalin tim.

U larguam nga shtëpia e prindërve të mi në tetor të vitit 2003. Ishte lamtumira e fundit me prindërit e mi.

4. Takimi i mentorit

Më përpara, kur e kalova lumin Tumen për herë të parë, një burrë koreano-kinez erdhi drejt meje, kur unë isha akoma duke parë vërdallë dhe po vlerësoja situatën. Ai më tha ta hiqja distinktivin e Kim Il Sung-ut, të cilin e kisha vënë. Ai ishte kreu i fshatit, një korean-kinez. Edhe pse nuk më kishte takuar më përpara, ai më mori në shtëpinë e vet, më lejoi të pushoja, më dha rroba për t'u ndërruar, një banjë për t'u pastruar dhe ushqim për të ngrënë. Kisha shumë kujdes dhe frikë, ngaqë kisha hall mos më shiste te dikush, por nuk kisha zgjedhje tjetër, përveçse ta pranoja ndihmën e tij. Pasi fjeta mjaftueshëm, ai më shpuri te stacioni i autobusit dhe më dha 10 juan (afro 2 dollarë) dhe shumë karamela, për të parandaluar trazimin e stomakut nga lëvizja me autobus. Sigurisht, unë takova një mentor, ose ndoshta një engjëll.

5. Kalimi i pragut të parë

Në tetor të vitit 2003, pasi e kalova lumin Tuman për herë të dytë, u ktheva te shtëpia e burrit tim në Kinë. Por familja e tij nuk më priti mirë, ngaqë kësaj radhe unë solla me vete fëmijët e mi. Vajza ime donte me ngulm të martohej, kështu që e lejova të martohej me një burrë koreano-kinez. Por edhe tani që kisha një fëmijë më pak për të jetuar me mua, vjehrra ime që kishte temperament të keq, u përpoq të më nxirrte nga shtëpia. Natyrisht, kishte kohë që e kishte harruar premtimin se do të m'i jepte mua të gjitha të ardhurat që kishte fituar në Korenë e Jugut.

Burri im u përpoq të më mbronte, por kjo vetëm sa e bënte të vlonte më keq zemërimi i vjehrrës sime. Gjithsesi, fshatarët ishin të lumtur që më panë sërish, dhe më mirëpritën. Ata madje u përpoqën për ta ndaluar vjehrrën time që të mos më raportonte në polici. Por ajo shkoi një nivel më lart, duke më raportuar te policia

e qytetit, e jo te policia e fshatit. Megjithatë, në fund, fshatarët më mbrojtën mua. Kur mbërriti në fshat policia e qytetit, që të më arrestonin, policia e fshatit më paralajmëroi që të arratisesha menjëherë. Unë ika me të katra nga dera e prapme e shtëpisë sime, pikërisht kur policia e qytetit hyri nga dera e përparme. Vrapova për te supermarketi dhe i kërkova pronares të më jepte hua 500 juan. Ajo e dinte se unë nuk do të isha në gjendje për t'ia kthyer huanë, por ma dha gjithsesi. U fsheha dhe im bir erdhi me mua.

Kërkova për një kishë në Çengdu (Chengdu), ngaqë e dija se shumë prej refugjatëve nga Koreja e Veriut kishin marrë ndihmë prej kishave. Kisha ku shkova unë, ishte një kishë katolike për koreanojugorët në Kinë. Njerëzit e kishës më testuan për të parë, nëse isha vërtet koreanoveriore, duke më detyruar të këndoja një këngë kombëtare të Koresë së Veriut dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të ndryshme për Korenë e Veriut. Pasi verifikuan se djali im dhe unë ishim prej Koresë së Veriut, ata na dhanë secilit prej nesh nga 600 juan (afro 100 dollarë).

Djali im punoi për një kompani atje, kurse unë punova si kujdestare shtëpie. Vazhdova të shkoja në kishë për shkak të mirënjohjes sime për ndihmën e tyre, edhe pse nuk dija asnjë gjë për Perëndinë. Në fakt, pothuajse gjithçka në shërbesat e adhurimit nga njëri vesh hynte e nga tjetri dilte. Por mund t'i ndiqja himnet, ngaqë ato ishin të ngjashme me këngët revolucionare të Koresë së Veriut.

Kisha u përpoq të na ndihmonte mua e tim bir që të shkonim në Korenë e Jugut. Nga ajo kohë, mora një telefonatë prej motrës sime, e cila gjithashtu ishte shitur, kur kishte ardhur në Kinë. Por ajo ia kishte dalë mbanë të arratisëj në Korenë e Jugut dhe kishte dëgjuar prej anëtarëve të familjes sonë në Kinë se ç'më kishte ndodhur mua dhe sesi të më kontaktonte. Ajo më inkurajoi që të vija në Korenë e Jugut me tim bir, prandaj unë vendosa të dezertoja.

Burri i vajzës sime ishte një pijanec, i cili e rrihte. Prandaj, kur erdhi për vizitë tek unë, i thashë asaj të arratisëj bashkë me ne.

Ajo erdhi me ne gjithë rrugën deri në Kunming, në Kinën Jugore, por për fat të keq, unë nuk kisha mjaftueshëm para për ta shpënë më tutje atë, dhe asaj iu desh të rikthehej në shtëpinë e të shoqit.

6. Sprovat, aleatët dhe armiqët

Për sa ka lidhje me sprovat, udhëtimi im i dezertimit ishte shumë i vështirë. Është e jashtëligjshme që koreanoveriorët të jenë në Kinë dhe sa më larg kufirit me Korenë e Veriut që të shkojmë, aq më e lehtë është që të na dallojnë, ngaqë ka gjithnjë e më pak koreano-kinezë. Neve na u desh të ngjiteshim nëpër shkëmbinj për të mos na parë njeri. Rrobat po më griseshin prej gjithë atyre ngjitjeve në shkëmbinj dhe rrugëve të vështira. Edhe forca po më binte. Në fund të udhëtimit, rashë përtokë nga stërmundimi i madh fizik, në një burg në Tajlandë. Kur më ra të fikët e rashë përdhe, e godita kokën dhe pësova tronditje. Për këtë arsye, m'u desh të rrija shtrirë, ngaqë i tërë trupi ndihej si i paralizuar.

Por kisha aleatë, edhe kur isha duke duruar sprovat e mia. Zakonisht, refugjatët koreanoveriorë udhëzohen prej shumë ndërmjetësve, teksa kalojnë përmes Kinës për në vendet e tjera, përpara se të fluturojnë për në Korenë e Jugut. Por në rastin tim, një kinez nga Han-i më udhëhoqi përgjatë të gjithë rrugës nga Kina deri në Tajlandë. Mbërrita e sigurt në Tajlandë, edhe pse kisha kaluar nëpër rrugë të ashpra, për shkak të efikasitetit të udhërrëfyesit që po më drejtonte, prandaj ai është aleati im.

Vjehrra ime në Kinë ishte si armiku im. Ajo dhe vajza e saj më trajtuan aq ashpër dhe gjithashtu bënë që të kisha një jetë të vështirë martesore. Kur nuk e flisja rrjedhshëm gjuhën kineze, ato më përbuznin dhe më abuzonin duke më rrahur. Gjithashtu, kur u ktheva nga Koreja e Veriut, vjehrra ime më raportoi te policia kineze, kështu që m'u desh të arratisesha.

7. Afrimi për te shpella më e brendshme në thellësi

Mendova se më mbaruan hallet, kur mbërrita në Tajlandë, por për shkak të stresit që e lashë vajzën në Kinë dhe prej nxehtësisë, më ra të fikët dhe e godita keq kokën. Mora tronditje të madhe, dhe m'u desh të rrija shtrirë atje, pa asnjë shpresë. Në të njëjtën qeli me mua ishin afro 150 refugjatë të tjerë nga Koreja e Veriut dhe ata nuk deshën të më ndihmonin. Kështu që, dalëngadalë, ata më shtynë për tek qoshja. Unë nuk mundja dot të shkoja në banjo me fuqitë e mia, por isha me fat që erdhi një misionar nga Koreja e Jugut dhe më ofroi ndihmë. U luta e dëshpëruar që të mund të arrija të shkoja në banjo me këmbët e mia.

Pas lutjes, isha në gjendje të rrija në këmbë duke u kapur pas hekurave të burgut. Pastaj iu luta sërish Perëndisë që të isha në gjendje të ecja. Ai u përgjigj dhe këmbët e mia morën pak forcë. Vazhdova t'i thërrisja Perëndisë: "Faleminderit! Faleminderit!" dhe praktikova duke bërë një hap pas tjetrit, tamam si një bebe. Pas kësaj, isha në gjendje të shkoja vetë në banjë. Një javë pasi kisha mbërritur në kampin e refugjatëve, policia e Tajlandës erdhi dhe më tha se do të nisesha për në Korenë e Jugut ditën tjetër.

Nuk e kisha unë radhën, por isha zgjedhur për të shkuar e para, për shkak të sëmundjes sime. Kur po paketoja, refugjatët e tjerë koreanoveriorë, që kishin tre ose katër muaj duke pritur, nisën të protestonin dhe madje i dërguan një peticion ambasadës së Koresë. Por punonjësi i ambasadës iu përgjigj atyre duke iu thënë se, kushdo që protestoi do të ishte i fundit për të shkuar në Korenë e Jugut dhe për këtë arsye ata pushuan së ankuari. Unë isha me fat që u largova nga kampi i refugjatëve brenda një jave dhe fluturova për në Korenë e Jugut. Pata ndjesinë se Perëndia e përdori tronditjen time për të më ndihmuar.

8. Sprova e rëndë

Sprova ime e rëndë në të vërtetë filloi pas vdekjes së burrit tim të parë. Pa pasur fare kohë për të vajtuar, m'u desh të gjeja një mënyrë për të mbijetuar. Mbijetova për një kohë të shkurtër duke shitur tofu në Onsong, ku jetonin prindërit e mi, por përfundimisht m'u desh ta kaloja lumin Tumen, që të merrja para prej të afërmeve në Kinë, ngaqë prindërit e mi nuk mundnin dot të më ndihmonin.

Edhe pasi shkova në Kinë, të afërmit e mi nuk mundën dot të më ndihmonin financiarisht, prandaj m'u desh të fitoja para duke punuar në fabrikën që prodhonte kimçi. Pastaj pronari më shiti te një burrë koreano-kinez, i cili nuk mund të fliste fare gjuhën koreane. Jeta ime martesore ishte vërtet e ashpër. Kunata dhe vjehrra ma bënë jetën të rëndë dhe më abuzonin keq fare, ngaqë nuk flisja gjuhën kineze. Kur jeta ime ishte bërë rrëmujë, u arrestova dhe u dërgova sërish në Korenë e Veriut. Gjatë burgut, kalova një krizë që ma kërcënonte jetën. Edhe pas kësaj, nuk munda të gjej dot asnjë mënyrë për të mbijetuar në Korenë e Veriut, kështu që u ktheva sërish në Kinë. Për shkak se ime vjehërr më raportoi, filloi një ndjekje e madhe kundër meje, saqë m'u desh të shkoja deri në Çengdu.

Por këto vështirësi më bënë të besoj te Perëndia dhe të vij në Korenë e Jugut. Në Tajlandë, ndërmjetësit më kërkuan të shkruaj një dëshmi. Shkrova vetëm një fjali dhe thashë diçka të tillë si: “Jam shumë falënderuese për Perëndinë, i cili po më dërgon në Korenë e Jugut.” Njerëzit qeshën me të, por ndonëse nuk dija shumë gjëra për Perëndinë, ajo fjali e vetme u shkrua me më tepër zemër nga sa mund të kenë të tjerët që shkruajnë një libër të tërë.

9. Shpërblimi

Kur rrija shtrirë në kampin e refugjatëve në Tajlandë, pasi më kishte rënë të fikët dhe pësova tronditje, pashë një ëndërr me

Jezusin. Deri atëherë, kurrë nuk kisha dëgjuar sesi kishte vdekur Jezusi, por e pashë Atë në ëndërr. Ai nuk ishte një i ri i shëndetshëm; Ai dukej i dobët, një burrë me pamje të brishtë. Unë po qaja përdhe, teksa Ai po mbante një kurorë me gjemba në kokë dhe po derdhte gjakun duke vdekur në kryq. Qielli befas u errësua dhe gjëmoi një bubullimë me zhurmë të madhe, teksa vetëtinte. Nisi shiu. Gjakun i tij i kuq u fshi tutje prej shiut. Kur e pashë atë skenë, bëra një orvatje ta mblidhja të gjithë gjakun e Tij në fundin që mbaja veshur, që të mos ikte tutje. Dhe fill pasi e pashë atë skenë u zgjova.

10. Rruga për kthimin

Kam qenë në Kinë në një udhëtim misioni përmes Universitetit të Fshehtë të “Zërit të Martirëve” në Kore. Kur u programua udhëtimi, unë kisha shumë frikë të shkoja, për shkak të mundësisë për të më kapur e për të më kthyer sërish në Korenë e Veriut. Kjo gjë më solli ndërmend tërë ato përvvoja të tmerrshme dhe sprova që kisha përjetuar në Kinë. Por shkova në atë udhëtim misionar me bindje të plotë.

Me frikë në mendje, sapo mbërrita, ndava ungjillin me një grua refugjate nga Koreja e Veriut, në bazën e dishepullimit dhe ajo e pranoi Jezus Krishtin. Kur isha në Kinë, isha e tmerruar tërë kohën. Por kur kthej kokën pas dhe mendoj, pasi u ktheva në Kore, e kuptova se Perëndia dëshiron të më përdorë mua, ngaqë unë kuptoj më tepër për gratë atje, për shkak të gjërave që kam përjetuar. Perëndia më përgatiti për punën e Tij duke përdorur sprovat e mia. E ndjeva fort thirrjen e Perëndisë.

Vendosa se do të jem një lajmëtare, për të mësuar Fjalën e Perëndisë që e mësova në Universitetin e Fshehtë dhe në shkollat e Teknologjisë së Fshehtë që drejtohen prej “Zërit të Martirëve” në Kore. Kam mësuar se nuk mundem të punoj e vetme; kam nevojë të shërbej bashkë me koreanoveriorë të tjerë, pasi t’i kem trajnuar ata.

Do ta filloj me ungjillëzimin në rrugë, duke shpërndarë fletushka dhe duke i drejtuar njerëzit në kishë. Ne mund t'i përdorim ndërtesat që dikur përdororeshin për institutet e Kim Il Sung-ut në çdo fshat. Te secila ndërtesë unë do të them: “Ne mund të jetojmë, nëse besojmë në Jezus Krishtin! Të gjitha fatet tona varen tek Ai. Mos besoni te një njeri, Kim Il Sung-u, por te Perëndia.”

Pas bashkimit, njerëzit do të jenë të pasigurt dhe të pështjelluar. Në këtë periudhë tranzicioni, ndarja e ungjillit do t'u japë atyre paqe dhe do t'i nxisë që t'i besojnë Perëndisë. Ne duhet të tregojmë të vërtetën se Kim Il Sung-u nuk është objekti i vërtetë i adhurimit, por që ai i ka mashtruar koreanoveriorët duke e kopjuar krishterimin dhe duke e zëvendësuar Perëndinë me vetveten.

Do të doja fillimisht ta ndaja ungjillin me familjen time dhe me të afërmit e mi. Jezus Krishti e tregon dashurinë e Tij ndaj nesh, duke vdekur në kryq për ne. Por qeveria e Koresë së Veriut na shpërlau trurin përmes teorisë komuniste të evolucionit, që të mos na lejonte ta dinim të vërtetën. Në fakt, ne jemi krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë. Koreja e Veriut e adhuron Kim Il Sung-un, duke e kthyer atë në një hero idhull, dhe duke thënë se ai është një njeri i gjallë e i pavdekshëm, por është e vërtetë se ai ka vdekur. Asnjë qenie njerëzore nuk është në gjendje të jetojë pa pësuar vdekjen, për shkak se Perëndia na bëri prej argjile. Ne përbëhemi prej trupave që prishen dhe prej shpirtave të pavdekshëm, që kur të vdesim, trupat tanë prishen, kurse shpirtat tanë jetojnë përjetë. Përgjigjja ndaj pyetjes se ku shkojnë shpirtat tanë do të thotë që ne duhet të besojmë te Perëndia. Ai i bekon përgjithnjë besimtarët, prandaj vdekja nuk zgjat përherë; shpirtat tanë jetojnë në Perëndinë, përgjithmonë, pa vdekur.

11. Ringjallja

Kur të ndodhë bashkimi dhe unë të kthehem në Korenë e Veriut, mund të has pak përndjekje dhe të quhem tradhtare. Edhe sikur

të më mohojnë dhjetë herë, do të vazhdoj të shkoj tek ata që më përndjekin për të ndarë ungjillin. Ne duhet të vazhdojmë t'u bëjmë vizita atyre që na përndjekin deri në fund.

Gjithashtu, Jezusi na tha që të kujdesemi për vejushat dhe jetimët, prandaj do të përkushtohem që t'u shërbej atyre dhe t'i ndihmoj. Edhe pse trupi im është i dobët dhe shumë pjesë të tij ndiejnë dhimbje, do të bëj më të mirën time për të kryer punën e Perëndisë. Është për t'u habitur: kurdoherë që bëj punën e Perëndisë, zbuloj se nuk ndiej dhimbje.

Nuk kam nevojë më për para. Edhe pse vendi im i punës këtu në Korenë e Jugut më kërkon të kthehem për të punuar për ta, Perëndia më ka dhënë mjaftueshëm gjëra tashmë. Nuk nevojiten më paratë. E vetmja punë që më duhet të bëj është të përhap ungjillin.

12. Rikthimi me eliksirin

Që tani e tutje, do të përgatitem të jem një ungjilltare, që do të ndajë ungjillin me koreanoveriorët, kur të ndodhë bashkimi mes Koresë së Veriut e të Jugut.

Së pari, po e kopjoj me dorë Shkrimin e Shenjtë, që Fjala e Perëndisë të më ngulitet në zemër e në tru. Deri tani kam kopjuar me dorë nga Zanafilla deri te Ligji i Përtërirë.

Së dyti, po e trajnoj veten duke regjistruar transmetimin e përditshëm në radio për në Korenë e Veriut, përmes programit “Zëri i Vërtetë i Martirëve” të “Zërit të Martirëve” në Kore. Në Korenë e Veriut, unë thjesht bëja propagandë koreanoveriore me kërkesën e qeverisë dhe fokusi im ishte që të bija në sy. Kurse tani, për shkak se jam duke regjistruar për Perëndinë, tek i cili kam besim, po regjistroj pasi e kam përgatitur mirë veten. Po bëj më të mirën që të jem e saktë me zërin tim teksa shpall çdo fjalë.

Më së fundi, jam duke u kujdesur mirë për veten duke u ushqyer si duhet dhe duke bërë ushtrime fizike. E marr shumë seriozisht

shëndetin tim. Gjithashtu shkoj rregullisht te mjeku dhe përpiqem të mendoj pozitivisht. Mendoj se arsyeja që vazhdoj të përjetoj sëmundje është, ngaqë Perëndia do që ta ndryshojë krenarinë time të fortë në përlësi. Prandaj, nuk e quaj si gjë të keqe sëmundjen time.

Ka kaq shumë punë për t'u bërë pasi të bashkohet Koreja. Nëse dua që t'u shpall ungjillin familjes sime dhe popullit të Koresë së Veriut, nuk do të mjaftonte edhe sikur të kisha dhjetë duar dhe këmbë. Kur të bashkohen, Koreja e Veriut do të dëgjojë më tepër koreanoveriore që ndajnë ungjillin, sesa koreanojugorë që e predikojnë atë.



Kur të ndodhë bashkimi, do t'i konvertoj që të gjitha Qendrat Kërkimore të Kim Il Sung-ut në kisha, duke iu vënë një kryq në majë të çdo ndërtese dhe në to, do të ndaj ungjillin, me engjëjt dhe me Perëndinë pranë meje. Pemët në vizatimin e mësipërm simbolizojnë popullin e Koresë së Veriut.

Kapitulli 3.

Profesori Ço: Mendësia e Heroit

Në marrëdhëniet tuaja me njëri-tjetrin, kini të njëjtën mendësi si Krishti Jezus.

— Apostulli Pal³⁷

1. Bota e zakonshme

Unë u linda në një qytet të vogël në Korenë e Veriut në fund të viteve 1930-të. U rrita në Pjongiang (Pyongyang), prandaj mësova për kulturën perëndimore që nga fëmijëria ime e hershme atje. Pjongiangu dikur quhej “Jeruzalemi i Lindjes,” ngaqë atje kishte shumë kisha përpara vitit 1945. Unë shkoja në kishë me një mikun tim dhe në atë mënyrë, arrita ta njihja Perëndinë.

Gjyshi im nuk ishte ndonjë pronar i madh tokash, por ai kishte disa mijëra pjong (pyong), (në Kore, njësia matëse për sipërfaqen, pjong, është afërsisht sa 0.093 metra katrorë) dhe familja ime ishte mirë nga ana financiare. Im atë studioi jashtë shtetit në Tokio, duke mësuar për sistemet e hekurudhave, pasi e mbaroi shkollën e mesme në Korenë e Veriut. Ai u kthye në Pjongiang dhe punoi për një kompani hekurudhash. Megjithatë, Qeveria e Koresë së Veriut pas vitit 1945 i trajtoi keq njerëzit e pasur dhe të arsimuar. Atyre iu dha një status shoqëror shumë i ulët.

³⁷ Filipianëve 2:5.

Si rezultat, im atë nuk u tregonte atyre se kush ishte në të vërtetë. Ai nuk ua tregonte atyre të gjithë historinë e familjes. Ai i tha qeverisë se vinte nga familja e një fshatari të zakonshëm, që të mund të shmangte klasifikimin si familje e keqe.

Unë shkova në shkollën fillore, shkollën e mesme dhe shkollën e lartë në Pjongiang. Luftova kundër forcave të Kombeve të Bashkuara për Kim Il Sung-un në Luftën e Koreve. Pas Luftës së Koreve, u largova nga ushtria.

Im atë ishte sekretari kryesor i drejtorit të transportit, përpara se të formohej Këshilli Popullor Demokratik i Koresë së Veriut. Pas Luftës së Koreve, u formua Republika Demokratike Popullore e Koresë, e cila zakonisht quhet Koreja e Veriut. Kim Il Sung-u i hoqi të gjithë zyrtarët e qeverisë që ishin arsimuar në Rusi. Ai gjithashtu hoqi qafe të gjithë ndjekësit e atyre “zyrtarëve të arsimuar në Rusi.” Mbikëqyrësi i tim ati ishte nga Rusia, prandaj babai im u etiketua si një zyrtar i arsimuar në Rusi. Por ai e kundërshtoi fort gjithçka që kishte të bënte me marrëdhënien me mbikëqyrësin e tij. Prapëseprapë, ai u pushua nga puna dhe u bë minator. Ai bëri të gjitha përpjekjet e mundshme për ta provuar pafajësinë e tij dhe më në fund u stabilizua në vitin 1963. Ai ishte aq i lumtur, duke kërcyer nga gëzimi dhe piu aq shumë alkool në funeralin e dikujt. Për fat të keq, ai u rrëzua dhe ndërroi jetë, për shkak të tensionit të lartë të gjakut.

Vetëm pasi u lirova nga ushtria në vitin 1959, zbulova se im atë u detyrua të bëhej minator, për shkak se ai ishte i shoqëruar me mbikëqyrësin e tij të arsimuar në Rusi. Atij iu desh ta lëvizte të tërë familjen e tij për në zonën e minierave. Kur i shkova për vizitë, ai më tha të mos i vija më atje, deri sa të kishte provuar pafajësinë e tij. Babai im donte që unë të bëhesha diplomat, por kjo tani ishte e pamundur, prandaj në vend të kësaj shkova në Hamkjonbuk-du (Hamkyungbuk-do), ku u bëra detar. Më vonë, studiova për inxhinieri kimike në kolegjin teknik për kimi atje dhe pasi u diplomova, dhashë mësim në një shkollë për tridhjetë vjet, e pastaj dola në pension.

2. Thirrja për aventura

Në Korenë e Veriut nuk jepen të ardhura financiare për pension, kështu që pasi lashë punën prej moshës, nuk kisha para. Edhe pse dikur kisha pasur një jetë relativisht si të klasës të lartë në Korenë e Veriut, ajo përfundoi kur mbarova punën prej moshës. Për më tepër, situata ekonomike në Korenë e Veriut u bë shumë më keq në të njëjtën kohë, në fund të viteve 1990-të. I ashtuquajturi “Marshi i Vështirësive” na shkatërroi. Me përjashtim të disa grupeve të drejtuesve, shumica e popullit në Korenë e Veriut vuajti tmerrësisht gjatë asaj kohe.

Qeveria e Koresë së Veriut nuk mundej dot të na jepte më racionet e ushqimeve. Sistemi i sigurimit të gjërave prej qeverisë u zhduk nga Koreja e Veriut. Fabrikat u mbyllën dhe furnizimi me ujë të rrjedhshëm ndaloi. Njerëzve iu duhej të jetonin në errësirë. Shumë njerëz vuajtën urie deri në vdekje. Dhe *kotjebi*, fëmijët e pastrehë të Koresë së Veriut, endeshin nëpër rrugë.

Njerëzit bërtisnin dhe vuanin shumë për të mbijetuar, por asnjëri nuk ua vinte veshin atyre e as nuk iu vinte keq për ta. Jeta në Korenë e Veriut ishte si ferr, pa asnjë shpresë. Prandaj, është si një ëndërr, që unë jam i gjallë dhe marr frymë sot. Unë u ktheva prej ferrit.

Këto rrethana tragjike më detyruan që të arratisesha nga Koreja e Veriut; megjithatë, nuk ishte një vendim që e mora lehtë. Ishte një situatë për jetë a vdekje.

Unë nisa të dëgjoja programet e radios nga Koreja e Jugut dhe SH.B.A. në vitin 1993. Prej këtyre transmetimeve mora idenë për lirinë. E mora radion prej të afërmeve të gruas sime që jetonin në Kinë. Në thelb, kur qeveria e Koresë së Veriut importonte radio, ata i rregullonin kanalet, që njerëzit të mundnin të dëgjonin vetëm transmetimet në radio të Koresë së Veriut. Por të afërmit e gruas sime bënë biznes edhe në Kinë, edhe në Korenë e Veriut, prandaj ata mund të sillnin radio të

zakonshme dhe unë kisha mundësi të dëgjoja sesi disa refugjatë koreanoveriorë mbërrinin të sigurt në Korenë e Jugut duke filluar nga mesi i viteve 1990-të.

Dikur, në vitin 1997, dëgjova një të njohurin tim nga Koreja e Veriut të fliste në një transmetim në radio në Korenë e Jugut. Historia më mrekulloi. Mendova ta provoja një herë edhe unë dezertimin. Ky program radioje më mbërtheu direkt drejt largimit tim!

Ekonomia e Koresë së Veriut në këtë kohë po përkeqësohej gjithnjë e më tepër. Për shkak të mungesës së elektricitetit, trenat vonoheshin me dy ose tri ditë. Kur vinte ndonjë tren, njerëzit përpiqeshin ta thyenin dritaren e trenit, që të futeshin brenda, në vend që të blinin biletën e trenit. Njerëzit vidhnin ushqim, ngaqë nuk kishin as edhe një gjë për të ngrënë. Ishte një kaos i plotë. E humba krejt shpresën për të jetuar në këtë vend kaosi, prandaj vendosa të largohesha nga vendi. Por atëherë sërish mendoja për kohën time të hershme nën sundimin japonez, dhe ndieja ndërjegjen të më brente, nëse largohesha. Në fakt, unë isha pothuajse duke vdekur nga uria, kështu që vërtet ishte një çështje për jetë a vdekje dhe më duhej të merrja një vendim: ose do të rrija në Korenë e Veriut dhe do të vdisja besnik deri në vdekje, ose do të vdisja duke u përpjekur të ikja prej këtij sistemi të çmendur.

Në ato ditë situata e familjes sime ishte rrëmujë fare, pasi dola në pension prej universitetit. Kur u jepja mësim studentëve, ata më siguronin disa ushqime ose gjëra për të cilat kisha nevojë. Por pasi dola në pension, nuk kisha asgjë për të bërë. Inteligjenca në Korenë e Veriut vetëm studiointe, prandaj ne nuk kishim aftësi për biznes dhe unë nuk bëja përjashtim nga kjo. Në ato ditë, kaq shumë njerëz, pjesë e inteligjencës së Koresë së Veriut, përfshirë edhe profesorët e universitetit, vuajtën urie deri në vdekje. Për këtë arsye, iu përgjigja thirrjes për ta kapërcyer me guxim lumin Tumen, me çdo lloj sakrifice!

3. Refuzimi i thirrjes

Nuk mundja dot ta merrja këtë vendim përnjëherësh dhe lëkundesha sa andej-këndej prej shqetësimeve të mia. Nuk arrija dot të flija mirë. Në mendjen time zhvillohej një betejë. Familja ime ishte shumë fort kundër arratisjes sime, por disi, unë avancova përpara pa u tërhequr prapa. Vendosa ta hedh në praktikë atë që e kisha planifikuar dhe menduar.

Shqetësimi im më i madh ishte se do lija pas vajzën time të martuar. Vajza ishte afër kohës për të lindur, por nuk mundja dot t'i tregoja për planin tim për t'u arratisur, ngaqë ajo ishte e martuar. Sapo martohej, një vajzë duhej të jetonte e të vdiste në shtëpinë e bashkëshortit të saj. Natën përpara se të largohesha nga Koreja e Veriut, thjesht i thashë asaj se do të shkoja diku të gjeja ca ushqim.

E kapërceva kufirin me tim bir, duke e rregulluar që ime shoqe të bashkohej me ne shumë shpejt pas kësaj. Pasi dolëm jashtë Koresë së Veriut, qëndruam në shtëpinë e dikujt pranë Naxhin-it (Najin), në anën kineze të kufirit. Vajza e pronarit të shtëpisë ishte fatorino në linjën e trenit që shkonte në Pjongiang. Përmes saj, unë arrita ta kontaktoj disa herë vajzën time.

Pasi im bir erdhi në Korenë e Jugut, ai u kthye në Samhap, përballë Horiong-ut (Hoeryong), që të mund të përpiquej të ndihmonte motrën e tij, që edhe ajo të arratisesh. Por ai u kap prej agjentëve të sigurisë kombëtare të Koresë së Veriut. Për fat të keq, nuk kam marrë asnjë lajm për të dhe më duhet ta konsideroj idenë se ai mund të jetë ende në ndonjë kamp përqendrimi atje. Kur koreanoveriorët kapen për herë të parë pas dezertimit të tyre, zakonisht ata dërgohen për shqyrtim paraprak te Këshilli Kombëtar i Sigurisë, në vendin ku jetonin dikur. Pastaj, ata dërgohen në një kamp përqendrimi aty pranë dhe kjo gjë më bën të besoj se ai mund të jetë në kampin e përqendrimit në Jodok (Yodok).

Pasi im bir shkoi ta ndihmonte të motrën që të arratisesh dhe nuk mora lajm prej tij për afro pesë ose gjashtë muaj, po më dukej se

po çmendesha. Dërgova dy herë një ndërmjetës që të përpiquej të merrte lajm prej tij, por dukej sikur im bir mbahej nën vëzhgim. Edhe ndërmjetësi vetë u kap prej agjentëve të sigurisë kombëtare. Situata ishte e vështirë. Edhe tani, unë ende nuk kam asnjë lajm për djalnin ose vajzën time. Thjesht shpresoj që të jenë mirë. Dikur u përpoqa të bëja një rit flijimi në ditëlindjen e tim biri, por gruaja ime e kundërshtoi atë gjë, ngaqë ajo beson dhe shpreson, se im bir mund të jetë ende gjallë. Sa herë që mendoj për tim bir e time bijë që janë në Veri, thjesht dua të vrapoj menjëherë drejt tyre!

Pasi erdhëm në Korenë e Jugut, sipas thirrjes sime, bëra shumë udhëtime të shkurtra anembanë, që të njihesha me vendin. Më merrte shumë malli për Korenë e Veriut, ngaqë dialektin që përdorin koreanojugorët nuk e njihja mirë, dhe ishte e vështirë për mua të përshtatesha me shoqërinë e Koresë së Jugut.

Kështu që, me qëllim që të përshtatesha, vendosa të gjej një punë. Gjeta punë në një kompani shpërndarjeje të ujit për dy vjet dhe pastaj punova si roje sigurie për tre vjet. Këto punë më ndihmuan që të përshtatem.

4. Takimi i mentorit

Pasi e kalova lumin nga Koreja e Veriut për në Kinë, ndenja në Kinë pak kohë dhe pranova ndihmë prej shumë njerëzve. Në Pekin (Beijing) isha i pastrehë për dyzet ditë. Pashë një tabelë që lexonte: “Yeongil Moenock,” e cila përkthehet “restorant për makarona petka” në qytetin Janxhi (Yanji), dhe mësova se ai drejtohej prej një pronari koreano-kinez. Pronari më prezantoi te një biznesmen nga Koreja e Jugut, kur po haja drekë. Ai bënte biznes me prodhime lëkure dhe ma garantoi sigurinë për gjashtë muaj. Ai madje më ndihmoi që të lidhesha me disa nga anëtarët e familjes në Korenë e Jugut, përfshirë kushëririn tim të dytë. Gjithkush që ka të afërm në Korenë e Jugut mund të aplikojë

për kartën e rezidencës, kështu që ata nisën të më ndihmonin me aplikimin.

Por, ata e ndaluan punën pas tre muajsh. Mora vesh se kishin shqetësim, së mos qeveria e Koresë së Jugut mund të dyshonte se mos unë isha spiun, për shkak të anëtarëve të familjes sime që kishin mbetur në Korenë e Veriut, dhe kishin frikë për veten e tyre se mos shpalleshin fajtorë, që po shoqëroheshin me mua. Në fillim, pesë prej të afërmeve të mi nga Koreja e Jugut kishin planifikuar të vinin në Pekin që të më takonin. Por kur shkova në aeroportin e Pekinit që t'i përshëndetja, vetëm njëri prej të pestëve mbërriti.

Këmbyem lajme për njëri-tjetrin për pesëdhjetë vitet e fundit dhe mëngjesin tjetër ai më dha dhuratë një pako të madhe: tetëdhjetë mijë juan, në kartëmonedhën kineze, (afro trembëdhjetë mijë dollarë).

U ktheva te qyteti kinez ku po rrinin gruaja dhe djali im. U përpoqa të bëja karta identiteti të rreme për ne të tre, me paratë që më dha kushëriri im i dytë. Mendova se me dokumentet e rreme të identitetit, familja ime mund ta vizitonte Korenë e Jugut, nëse na ftonin atje të afërmit tanë.

Gruaja ime punonte në një tendë birre atje. I bëra kartat e identitetit të familjes sime përmes pronarit të tendës. Por kur ai u kthye për vizitë në qytezën e tij të lindjes, u tregoi të gjithë banorëve atje gjithçka për ne, një natë kur ishte duke pirë alkool. Policia kineze e mori këtë informacion dhe na i mori kartat e identitetit. Në këtë kohë të vështirë, vetëm im bir ia doli mbanë të shkonte në Korenë e Jugut, kur po punonte si punëtor krahun në Ando.

Pas atij incidenti, ime shoqe dhe unë shkuam në Hanoi, në Vietnam. Im bir më kishte treguar tashmë sesi të shkonim atje, kështu që nuk ishte e vështirë për ne. Kur shkova të këmbëja para, një vietnamez na ndiqte si bisht nga prapa, ngaqë ne vërtet dukeshim ndryshe nga ata. Për shkak të atij burrit, ne u mbajtëm për dy ditë në rajonin e policisë. Dhashë ryshfet për të dalë dhe ne u kthyem mbrapsht në Kinë. Ndenjëm në një kishë, ku

kishin qëndruar më përpara im bir e ime bijë. Atje po planifikoja udhëtimin tonë të radhës, por për shkak të një raporti anonim, na kapën përsëri dhe na futën në burg pranë kufirit me Vietnamin.

Pasi dola sërish nga burgu, shkova i sigurt në Saigon nga Hanoi me ndihmën e një pastori nga Koreja e Jugut. Kur ndalova në një farmaci në Saigon, e pata të vështirë të komunikoja me farmacistin vietnamez. Pastaj ai thirri një djalë të ri. Djali i ri erdhi me një motoçikletë dhe më tha se do të më ndihmonte, nëse do të isha i ndershëm me të lidhur me veten time. Në fillim u shqetësova, por vendosa t'i tregoja atij për situatën time. Ai më mori mua e time shoqe në një shtëpi dhe pastaj ditën tjetër, na shpuri te lumi Mekong. Ne morëm një varkë, pastaj sërish me motoçikletë, derisa arritëm në shtëpinë e dikujt.

Pronari i shtëpisë ishte vendas, dhe po zhvoshkte drithin. Kur më pa mua, goditi dyshtemenë dhe tha: “Kamboxhia!” Ne e kuptuam se më në fund ishim të sigurt në Kamboxhia. Të gjithë njerëzit që na ndihmuam dhe na udhëhoqën për të ardhur në Korenë e Jugut për mua ishin mentorët.

5. Kalimi i pragut të parë

Kur po largohesha nga Koreja e Veriut, pikërisht para se ta kapërceja lumin, më vinin kujtime nga të gjitha llojet për rikthimin. Dëshira ime që të dilja jashtë atij tmerri sa më shpejt vërtet që shpërtheu me vull. Edhe pse Koreja e Veriut ishte bërë si ferr për mua, të gjithë njerëzit që doja ishin atje: prindërit, motrat e vëllezërit, miqtë e mikeshat, shokët e shoqet, fqinjët dhe natyrisht vajza ime. Fytyrat e tyre më dilnin përpara syve. Kur mendova t'u jepja lamtumirën, nuk mund ta përballoja dot si situatë, ngaqë më dhembte zemra dhe dukej sikur gjaku po më vlonte. Por unë nuk mundja dot të jetoja më atje, për shkak të jetës sime plot hidhërim në Korenë e Veriut. Mendova se isha vetë unë pronari i fatit tim

dhe prandaj duhej ta bëja veten të vendoste. Askush nuk do të ishte në gjendje ta ndalte dëshirën time për të shkuar në Korenë e Jugut.

Kur hodha hapin e parë në lumin Tumen, kockat m'i ngriu një erë e fortë veriore. Mbi të gjithë sipërfaqen e lumit ngriu akulli dhe edhe akulli ishte i mbuluar me borë përsipër.

Pas të gjitha vështirësive të mia, hodha hapat në ujin e lumit. Por nisi të lehte një qen kufiri. Një ushtar nisi të kërkonte vërdallë lumit me elektrik dore. Në atë çast im bir dhe unë u shtrimë në lumë si trupa të vdekur dhe nuk merrnim as frymë.

Befas më erdhi ndër mend Perëndia. I thirra shumë herë në zemër Perëndisë me të dyja duart e kapura bashkë, duke i thënë: “Shpëtomë, o Perëndi.” Pas pak kohe, ushtari u kthye mbrapsht dhe u largua bashkë me qenin e tij të kufirit.

U mrekullova. Me siguri ishte Perëndia ai që më ndihmoi! U mbusha me emocione dhe u mahnita, e vazhdova të thosha: “Faleminderit Perëndi,” duke përsëritur shumë herë. E kisha kërkuar Perëndinë, edhe pse nuk e njihja Atë.

Përpara Luftës së Koreve, në fakt kisha shkuar në kishë disa herë. Shkoja për shkak se nuk mund t'i refuzoja ftesat e miqve të mi. Njerëzit në kishë na mikpritën dhe na shërbyen drekën. Si dhurata mirëseardhjeje na dhanë fletore e lapsa. Unë shkoja në kishë më tepër për kohën e mirë dhe për dhuratat; gjithsesi, gjatë vizitave të mia fillova të dëgjoja për Perëndinë.

Mbaj mend që kënduam në kishë një himn që thoshte se Perëndia ka dhembshuri për të varfrit. Kur isha duke kënduar, mund ta dëgjoja zërin e Perëndisë në fjalët e himnit. Zemra m'u prek thellë prej Tij, edhe pse isha ende një djalë i ri.

Pas vizitës sime të parë në kishë, kur isha i ri, ia tregova këtë përvojë mamasë, por iu luta që të mos i tregonte babait tim.

Megjithatë, im atë shumë shpejt e mori vesh që kisha shkuar në kishë. Ai më ndëshkoi ashpër për këtë. Më bërtiti, e më tha se nuk do të më falte, po të shkoja sërish në kishë. Ajo ishte hera e fundit që shkova në kishë në Korenë e Veriut.

Im atë ishte një komunist fundamentalist, që ia kishte përkushtuar veten Partisë Komuniste të Koresë së Veriut, fill pas luftës së Dytë Botërore dhe ai me të vërtetë e urrente fenë.

Kur po e kapërceja lumin Tumen me tim bir, e kuptova se Perëndia kurrë nuk më kishte braktisur mua, edhe pse unë e kisha braktisur Atë. Ai më kishte çliruar dhe më kishte drejtuar për në liri, edhe pse unë nuk e njihja Atë. Perëndia gjithmonë ishte me ne. Fryma e Shenjtë jeton thellë në zemrat tona për të na treguar rrugën. Besoj se Perëndia më ndihmoi të largohesha nga Koreja e Veriut.

Jeremia 29:13 thotë: “Do të më kërkoni e do të më gjeni, kur të më kërkoni me gjithë zemrën tuaj.” Kur e kërkova Atë, Ai më lejoji të kaloja përmes telashit, i palënduar dhe më ndihmoi ta kaloja prapun.

6. Sprovat, aleatët dhe armiqtë

Së pari do të flas për sprovën time. Pasi e kapërceva lumin nga Koreja e Veriut për në Kinë, nuk ishte Kina vendi që kisha përfytyruar. Kinezët nuk i kishin ndihmuar koreanoveriorët, që ishin të varfër e të braktisur; përkundrazi ata i kishin injoruar dhe kishin kthyer fytyrat në anën tjetër.

Por unë pata aleatë. Një biznesmen koreanojugor në Pekin u kujdes për mua për gjashtë muaj. Ai madje më lidhi me të afërmit e mi në Korenë e Jugut.

Pastaj ishte aleati i dytë. Një ditë një oficer policie kinez më arrestoi, kur po prisja për një autobus. Ai më shpuri në rajonin e policisë, bashkë me fëmijët që kishin qenë afër meje. Oficerët e policisë më rrahën, ngaqë nuk mund të flisja gjuhën kineze. Ditën tjetër, oficeri i policisë solli një burrë koreano-kinez për të komunikuar me mua. Ai më tha se po përpiqesha t'i shisja ata fëmijët. Për këtë arsye, ata më arrestuan bashkë me fëmijët atje.

I thashë burrit koreano-kinez se po më fajësonin kot dhe iu luta të më ndihmonte. E gënjeva burrin koreano-kinez dhe i thashë se isha nga Hunçun (Hunchun) në Kinë. Burri koreano-kinez tha: “Oh, ai është qyteti im i lindjes!” Kështu që, ai foli në mënyrë shumë bindëse me policinë dhe ia doli mbanë të më lironte. Burri koreano-kinez ishte aleati im.

Kur jetoja në Korenë e Veriut, Shtetet e Bashkuara ishin armiku im. Kurse tani, familja Kim dhe qeveria e Koresë së Veriut janë armiq të mi. Vërtet më vjen shumë keq për tim bir e time bijë në Korenë e Veriut. Nuk di asnjë gjë për jetën e tim biri, pasi ai u kap duke u përpjekur ta ndihmonte të motrën të arratisë. Që atëherë, u shkëputa krejtësisht prej tij. Nuk mundem dot as të përdor ndonjë ndërmjetës për ta gjetur, ngaqë është shumë e rrezikshme për tim bir, po të përpiqem ta kontaktoj përmes një ndërmjetësi.

I ligu, Satani, është armiku im. Kur isha shpirtërisht i varfër, pasi erdha në Korenë e Jugut, u tundova të lidhesha e të bëhesha anëtar i një kulti që kishte emrin “Shin Çan Xhi” (Shin Chun Ji). Pa më thënë se kush ishin dhe duke përdorur lidhjet e afërta, ata më tërhoqën brenda kultit dhe ma bënë shumë të vështirë largimin.

7. Afrimi për te shpella më e brendshme në thellësi

Kur isha në Korenë e Veriut ëndrra ime ishte të vija në Korenë e Jugut. Por nuk ndodhi ashtu siç e kisha planifikuar unë. Guri im i parë i pengesës ishte se gjithmonë ndihesha i pasigurt, pa pasur karta identifikimi në Kinë. Bëra karta identifikimi false për familjen time, por ne u kapëm prej policisë kineze dhe ata na i morën kartat. Kjo gjë më bëri të shkoja tek shpella më e thellë e brendshme në jetën time, për shkak se isha kaq në ankth se mos na dërgonin mbrapsht për në Korenë e Veriut. Që ta fitoja me

urtësi këtë krizë, ndërmora një udhëtim të gjatë përmes vendeve të treta (vendeve përtej Kinës). U bë e mundur, për shkak të udhërrëfimit prej Perëndisë, sa herë që kisha vështirësi. Udhëtimi nga Koreja e Veriut në atë të Jugut ishte afrimi im për te shpella më e thellë e brendshme.

8. Sprova e rëndë

Qeveria e Koresë së Veriut ma shpërlau trurin, që ta urreja krishterimin. Mënyra sesi jetoja në rininë time tregon se sa shumë e urreja krishterimin. Pasi Koreja u bë e pavarur prej sundimit japonez, unë u rrita në Pjoniang dhe e dëshmova vetë procesin e zhvillimit të regjimit komunist në Korenë e Veriut.

Kur isha vetëm tetëmbëdhjetë vjeç, më rekrutuan në Ushtrinë Popullore të Koresë së Veriut për të luftuar kundër forcave të Kombeve të Bashkuara për familjen e Kim Il Sung-ut. Isha i gatshëm të luftoja deri në vdekje për vendin tim. Isha fiksuar pas kësaj ideje, por në të vërtetë, as nuk e dija se kush e kishte filluar luftën dhe për se po luftoja. Ishte një mrekulli që mbijetova.

Dikur, kur shihja filma me propagandë në Korenë e Veriut, i mallkoja dhe u bërtisja në ekran amerikanëve te filmi. Ma kishte shpërlarë trurin ideja komuniste se imperializmi amerikan ishte armiku më i keq i koreanoveriorëve.

Kurse tani kam një ide krejt ndryshe për amerikanët dhe perëndimorët e tjerë, pasi i takova ata personalisht në shkollën e misionit të “Universitetit të Fshtë të Zërit të Martirëve” në Kore. Ata na shërbyen si vullnetarë dhe janë jo vetëm mësues, por edhe shërbëtorë të përlulur të Perëndisë. Ata përgatitën drekë për ne dhe madje i lanë me gëzim pjatat tona. Ata na trajtuan me dashuri dhe u bënë miqtë tanë. Edhe pse nuk mund të flisja dot anglisht, ne prapëseprapë ia dolëm mbanë t’i ndanim ndjenjat tona me njëri-tjetrin.

Jam vërtet i nderuar që Pastori Folei është bërë miku im më i afërt. Pastori Folei më ka udhëzuar dhe drejtuar mua për te Zoti Jezus Krisht me dashurinë dhe përkujdesin e tij. Për shkak të tij, e kam mësuar Biblën hap pas hapi.

Kur e vizitova Muzeun e Luftës Koreane në një udhëtim me UF, kuptova faktin mahnitës se dhjetëra mijëra djem të rinj i sakrifikuan jetët e tyre në Luftën Koreane, që ta mbronin Korenë. Pastaj në një udhëtim tjetër me UF, pashë një flijim shumë më të rëndësishëm, që ishte bërë për ne shumë kohë më parë. Vizitova Varrezat e Januaxhin-it (Yanghwajin) për misionarët e huaj. Ne mund ta kishim harruar Perëndinë në rininë tonë, por Perëndia nuk na harroi kurrë.

Përpara Luftës së Koreve, kur isha fëmijë, kishte shumë kisha në Pjongiang. I mbaj mend kryqet në kambanaret e shumta anembanë qytetit.

Në ato kohë Koreja e Veriut kishte ca të krishterë. Mbjaj mend se ata shkuan në rrugën kryesore në mes të ditës, duke bërë titur: “Besojini Jezusit dhe shkoni në parajsë!” Por më vonë reformat ekonomike dhe shoqërore prej Partisë Komuniste dalëngadalë i ndaluan aktivitetet fetare.

Në emrin e reformës për tokën, të krishterët që zotëronin tokë u shpallën tradhtarë. Qeveria e Koresë së Veriut ua konfiskoi tokat.

Më në fund, qeveria e Koresë së Veriut, e shfuqizoi zyrtarisht fenë në Korenë e Veriut më 9 shtator 1948. Nuk kishte më kambanare. Nuk kishte më ungjilltarë. Nuk kishte më fletore shënimesh ose lapsa për dhurata. Drejtuesi i Koresë së Veriut, Kim Il Sung-u u bë një perëndi.

Shumë të krishterë u arratisën për në Korenë e Jugut. Kishat e Koresë së Veriut u pakësuan, për shkak të përndjekjes së madhe. Krishterimi u konsiderua se ishte armik i shtetit pas Luftës së Koreve.

Qeveria e Koresë së Veriut e ndaloi rindërtimin e ndërtesave të kishave të shkatërruara gjatë luftës. Ato i përkufizuan ceremonitë

fetare si “agjitacion kundër-revolucionar.” Ndërtesat e kishave që ishin të forta, u shndërruan në shkolla ose spitale.

Nga fillimi i viteve 1960-të, kishat nuk kualifikoheshin më si institucione zyrtare në Korenë e Veriut. Qeveria e Koresë së Veriut i kategorizoi qytetarët e Koresë së Veriut në pesëdhjetë e një grupe të ndryshme, përfshirë, për shembull qytetarët “thelbësorë”, “të paqëndrueshëm” ose “antagonistë”.

Të krishterët ishin kategorizuar si antagonistë dhe familjet e tyre u izoluan në mënyrë strikte. Qeveria i forcoi fushatat për propagandën antifetare anembanë vendit. Feja u shpall si një iluzion i rrezikshëm antikomunist.

Qeveria u përpoq ta eliminonte krishterimin përmes arsimit dhe administrimit. Ata prisnin që ai të zhdukej krejtësisht. Ata mburreshin se komunizmi kishte triumfuar, duke sjellë si dëshmi mungesën e aktiviteteve të krishtera.

Dhe kjo ishte mënyra sesi unë dhe bashkëqytetarët e mi ia kthyem shpinën Perëndisë për më shumë se gjashtëdhjetë vjet. Por, teksa e mbaja tim bir mbi copat e akullit që rrotulloheshin mbi ujin e lumit Tumen, mora zbulesën mahnitëse se Perëndia kurrë nuk ma ktheu shpinën mua.

Do doja shumë që t’ju thoja se, pasi e kapërceva lumin (dhe pasi Perëndia më drejtoi në siguri përmes të gjithë Azisë dhe më në fund në Korenë e Jugut), unë kurrë më nuk do t’ia ktheja shpinën Perëndisë. Por, kjo nuk doli e vërtetë. Në fakt, për mua (dhe për shumicën e koreanoveriorëve që arrijnë ta njohin Perëndinë) procesi i arritjes në besimin tek Ai dhe i dhënies së jetës sonë Atij është një sprovë që kërkon një kohë të gjatë dhe shumë riedukim, jo thjesht mrekulli. Gjithçka për mendimet e mia ishte e rrënjosur në një pikëpamje materialiste e cila e mohonte shpirtin. Ngaqë ajo pikëpamje e kishte kontrolluar nënvetëdijen time për tërë jetën time, unë nuk mund ta flakja dot tutje të menduarin tim materialist brenda një apo dy ditëve. Më është dashur një kohë e gjatë për t’ia kthyer shpinën ideologjisë

së Koresë së Veriut, dhe Universiteti i Fshehtë ka qenë një pjesë jetësore në këtë proces.

Nuk mund t'i harroj lehtë mësimet prej viteve të shkollës, se feja i çmend njerëzit, i bën të varur si opiumi. Në fakt, unë nisa të shkoja në kishë në Korenë e Jugut vetëm pas një periudhe të gjatë të ankthit mendor, teksa përpiqesha të kuptoja një botë që ishte më tepër sesa materialja.

Ka pesë vjet që vazhdoj të shkoj në kishë. Më vjen keq për humbjen e kohës, duke ardhur vërdallë dhe duke mos e ditur çfarë të bëja e ku të shkoja për shtatë vjet. Por jam mirënjohës që Perëndia ishte i gatshëm të më thërriste me durim për shtatë vjet rresht pas asaj nate në lumin Tumen.

Në fillim, teksa mësova për Perëndinë, isha si fëmijë, që jo vetëm ishte në gjendje të hante perimet, por po përpiquej të hante edhe mishin. Është shumë e vështirë për njerëzit që janë rritur si të krishterë ta kuptojnë si duket dhe si ndihet bota për dikë që është edukuar të besojë vetëm në ato gjëra që mund të shihen. Për fat të mirë, kishte njerëz që mund të ndihmonin, përfshirë studentët dhe stafin e Universitetit të Fshehtë. UF është njëri nga vendet e vetme që punon fort për ta kuptuar dhe transformuar mentalitetin koreanoverior për në besim në Krishtin, me anë të hirit të Perëndisë dhe duke e njohur me vërtetësi kulturën e Koresë së Veriut.

Jam ende duke u rritur në besim si dishepull i Krishtit, duke u varur vetëm te Fjala e Perëndisë dhe duke e gdhendur atë në zemrën time.

Dola përjashta një kulti me ndihmën e “Zërit të Martirëve” në Kore. E kuptova se ai ishte një grup heretik, kur po merrja arsim teologjik nga UF. Dikur shkoja te studimi i Biblës i atij kulti katër herë në javë. Vërtet doja që ta njihja Perëndinë dhe ata më kapën në kurth. Ishte një sprovë e rëndë.

Mora korrigjimin teologjik prej “Zërit të Martirëve” në Kore dhe UF dhe kam shkuar atje të shërbej si stazhier. Më në fund, sprovë ka përfunduar, dhe tani unë ndihmoj studentët e UF që

të bëhen misionarë për refugjatët koreanoveriorë dhe i ndihmoj ata ta mposhtin komunizmin. Gjithashtu i ndihmoj refugjatët koreanoveriorë që të largohen prej kulteve, bazuar mbi përvojën time të çmuar.

9. Shpërblimi

Shpërblimi im është Universiteti i Fshehtë që drejtohet prej “Zërit të Martirëve” në Kore, i cili u përdor prej Perëndisë për të më ndihmuar të dilja jashtë prej herezive të materializmit dhe prej kultit. Ata më dhanë korrigjimin teologjik për të fituar mbi sprovën time. Edhe pse isha mashtruar prej heretikëve, UF më ndihmoi që të shkoja në drejtimin e gabuar për të ungjillëzuar në Korenë e Veriut. Prej sprovës u bëra më i fortë dhe u mbusha më tepër me hir. E falënderoj Perëndinë vazhdimisht për procesin! UF ishte prapa këtij hiri!

Shumë kisha të Koresë së Jugut thjesht e shohin sesi dezertorët e rinj prej Koresë së Veriut bien viktimë të kulteve, kurse Universiteti i Fshehtë nuk vepron ashtu. Ashtu si Perëndia atje te lumi Tumen, UF kurrë nuk më harroi. Ata më shpëtuan prej kultit dhe m’i vunë këmbët sërish në shtegun e fortë.

10. Rruga për kthimin

Po të mundem dot të shkoj në qytetin tim të lindjes, Hamhung, pas bashkimit, së pari do të ndërtoj një kishë atje dhe do t’ia kushtoj pjesën tjetër të jetës sime ndarjes së lajmit të mirë si një ungjilltar. Do të doja të takoja miqtë e mi dhe t’u jepja atyre dhurata të vogla. Zakonisht miqtë e mi i pëlqejnë orat e dorës, prandaj po t’u jap atyre orë, kjo do t’i lumturonte. Në Korenë e Veriut, ora është akoma diçka e vlefshme. Gjithashtu, ora do të jetë

një kujtesë për mua, ngaqë ajo gjithmonë do të jetë vënë te kyçi i dorës së personit. Dua të kujtohem si një person i kujdesshëm, që thellohet në mendime dhe është i matur. Miqtë e mi më të mirë janë nga fëmijëria dhe ata ende jetojnë në Hamhung, por unë kam edhe miq të mirë nga koha e kolegjit gjithashtu. Ndoshta do të më duhet të marr më tepër se njëmbëdhjetë orë. Një dhuratë e dytë për miqtë e mi do të jenë të mbathurat e brendshme dimërore. Në Korenë e Veriut nuk ka rroba të brendshme cilësore.

Pas bashkimit, unë dua ta ndaj ungjillin duke filluar nga qyteti im i lindjes. Miqtë e mi të ngushtë do të jenë shënjestra ime e parë dhe pastaj ata do ta ndajnë ungjillin me njerëz të tjerë e kështu me radhë. Si rezultat, unë do të kontribuoj për ungjillëzimin e Koresë së Veriut.

Megjithatë, e kuptoj se do të ishte e vështirë për ata ta pranonin ungjillin në fillim. Por është një thënie koreane: “Nuk ka asnjë pemë, që nuk rrëzohet pasi ta kesh qëlluar dhjetë herë me sëpatë.” Në fund të fundit, ata do të dëgjojnë, nëse përpiqem me durim të madh. Herën e parë kur dëgjova fshehtas në radio për jetën në Korenë e Jugut, mendova: “*Sa histori e çmendur!*” Por pasi dëgjova dy ose tre herë, arrita ta besoja atë që po dëgjoja.

11. Ringjallja

Nëse kthehem në Korenë e Veriut, nuk mendoj se do të më mirëpresin që në fillim. Unë do të konsiderohesha tradhtar, për shkak se dezertova. Dhe ndoshta mund të kishte edhe xheloz, për shkak se ata në Korenë e Veriut vuanin urie, kurse unë haja mirë në Korenë e Jugut. Njerëzit në Veri vetëm sa do të shtireshin se ishin të gëzuar që më panë, kështu që do t’u kërkoj ndjesë nga thellësia e zemrës. Do të ishte shumë shqetësuese, nëse nuk do të mund ta fitoj besimin e atyre, të cilët më kanë munguar shumë.

Por, nëse duhet, do ta mposht atë me anë të lutjes dhe mbështetjes te Perëndia. Gjithashtu do të vazhdoj të bëj vepra mëshire dhe ta ndaj ungjillin dhe kjo do të më ndihmojë të përballem me xhelozinë e njerëzve dhe me mosbesimin e tyre ndaj meje. Edhe pse njerëzit mund të bëjnë thashetheme për mua, ngaqë rashë në kthetrat e një kulti, unë do të qëndroj fort duke u mbështetur te Perëndia. Ndiem sikur tashmë kam marrë trajnim prej Perëndisë në Korenë e Jugut, përmes përvojës sime të rënies në kurthin e heretikëve. Pavarësisht nga gjithçka, unë do t'u tregoj lajmin e mirë koreanoveriorëve. Do t'ju tregoj atyre dashurinë e Jezus Krishtit. Ashtu si kur vuajta, pasi u largova prej heretikëve, unë do t'i kërkoj përsëri ndihmë Perëndisë. Kjo do të jetë dëshmia ime për popullin e Koresë së Veriut!


12. Rikthimi me eliksirin

Udhëtimi që pata kur u largova nga Koreja e Veriut për në Korenë e Jugut, do të bëhet eliksir për popullin e qytetit tim. Kur ata ta dëgjojnë historinë time, do të pranojnë se bëra zgjedhjen e duhur për t'i besuar Perëndisë.

Që nga koha kur u largova prej Koresë së Veriut, Perëndia më ka mbrojtur gjithnjë dhe ka vazhduar të më trajnojë, me qëllim që të më bëjë një dishepull të Tijin. Siç e përmenda më parë, kur dëgjoja historinë e Koresë së Jugut në radio, mendoja se ajo histori ishte çmenduri. Por në fund fare, arrita ta besoj atë. Në të njëjtën mënyrë, miqtë nga qyteti im i lindjes mund të mos e pranojnë ungjillin, kur ta ndaj për herë të parë me ta. Por, nëse e dëgjojnë vazhdimisht ungjillin në mënyrë të përsëritur, dhe kur ta dëgjojnë historinë e udhëtimit tim, sesi Perëndia më udhëzoi gjatë dezertimit tim, ata do ta shohin arratisjen time si një zgjedhje të mirë. Ata do të bien dakord me zgjedhjen time, zgjedhjen që e bëra me Perëndinë.

Aktualisht jam duke marrë pjesë në një organizatë që quhet Solidariteti i Intelektualëve të Koresë së Veriut (SIKV). Afro 70 % e 130 refugjatëve të regjistruar në SKIV besojnë në Perëndinë. Por, kur e ndava ungjillin me ta, një person bëri rezistencë dhe akoma vazhdon të rezistojë, ndonëse ai erdhi në Korenë e Jugut pesëmbëdhjetë vjet më parë. Shumë prej tyre janë njerëz që e kundërshtojnë fort komunizmin, por ata ende nuk e pranojnë Perëndinë si duhet. Po të nis duke thënë: “Je—” duke iu referuar Jezus Krishtit, ata më ndalojnë përnjëherësh duke me bërë shenjë me duar që të mos flas. Do të praktikoj predikimin ndaj këtyre njerëzve si përgatitje për ungjillëzimin tim të ardhshëm në qytetin tim të lindjes në Korenë e Veriut.

Dëgjoj se ka shumë grupe heretike, që i përhapin besimet e tyre me një shpejtësi të tmerrshme, si sëmundjet pandemike, në Korenë e Veriut. Jam i sigurt se Zoti do të më përdorë mua dhe përvojën time me një kult për t’i ndihmuar koreanoveriorët. Në këtë mënyrë unë mbart një eliksir të çmuar.



Kapitulli 4.

Znj. Ahn Heroina e çalë

Mbreti pyeti: “A ka mbetur ende ndonjë i gjallë nga shtëpia e Saulit, të cilit të mund t’i tregoj mirësinë e Perëndisë?” Ziba iu përgjigj mbretit: “Ende jeton një djalë i Jonathanit; ai është i çalë në të dyja këmbët.”

—2 Samuelit 9:3

1. Bota e zakonshme

Unë linda në Kinë në fillim të viteve 40-të, si bija e tretë në familjen tonë. Pastaj prindërit e mi lindën tre djem në Korenë e Veriut. Koreja u çlirua nga sundimi japonez, kur unë isha katër vjeç. Im atë, një burrë shumë i arsimuar, solli mjekime nga Koreja e Veriut dhe hapi një farmaci në Kinë, por pasi Koreja u lirua prej Japonisë, të pasurve iu konfiskuan pasuritë e tyre. Për këtë arsye, familjes sime iu desh ta mbyllte biznesin dhe të kthehej në Korenë e Veriut. Im atë duhej të mbështeste familjen tonë prej tetë vetash duke qenë punëtor krahu dhe si rezultat i kësaj, ne jetonim në rrethana të vështira. Familjes sime iu caktua një status shoqëror shumë i ulët prej qeverisë së Koresë së Veriut, ngaqë më përpara ne kishim jetuar në Kinë dhe im atë kishte biznesin e farmacisë që e drejtonte vetë, plus kishim edhe tokë.

Të dy prindërit e mi ndërruan jetë në vitin 1966. Dy motrat e mia më të mëdha ishin të martuara, kurse unë isha e fejuar në atë

kohë. Motra ime më e madhe e dërgoi vëllain tonë të parë në ushtri, ndërkohë që ajo po kujdesej për dy vëllezërit e tjerë që ishin akoma të vegjël. Ajo u bë prindi i tyre.

Im atë vdiq nga kanceri në mëlçi; mamaja vdiq nga hemorragjia cerebrale. Ajo ndërroi jetë teksa po kujdesej për tim atë.

Unë u martova në vitin 1967, pasi ndërruan jetë prindërit e mi. Edhe pse im atë nuk kishte arritur dot të anëtarësohej në Partinë Komuniste, për shkak se kishte qenë i pasur, unë ia dola ta marr anëtarësimin në parti, duke punuar pothuajse deri në vdekje në një fabrikë ushqimesh, e cila prodhonte salcë soje, karamеле dhe ushqime të tjera. Familja ime kishte jetuar në rrethana të rënda, për shkak se im atë ishte punëtor krahu. Mendova se unë duhej të ndihmoja për ta ngritur familjen time në një rang më të lartë, kështu që punoja shumë për të hyrë në Partinë Komuniste. Burri im ishte një oficer ushtrie prej një familjeje të një rangu të lartë. Ai u diplomua nga Shkolla Revolucionare Flamuri i Kuq i Mangiungde (Mangyongdae) dhe punonte si mësues në brigadën e Huapjong (Hwapyong). Ai ishte i afërm me një kushërirë më të moshuar timen, dhe ajo na bëri bashkë.

Burri im ishte i sjellshëm me mua. Për shkak të talentit të tij për të kënduar, ai i shërbeu Kim Il Sung-ut dhe Kim Jong Il-it; megjithatë, ai vdiq nga kanceri në tru në më pak se njëzet muaj pasi u martuam. Ai ndërroi jetë, kur akoma ishte duke punuar fort në emër të qeverisë, duke i duruar dhimbjet. Ai u lavdërua si hero. Unë jetoja me familjen e tij në atë kohë, ngaqë im shoq vdiq, përpara se ne ta kishim përfunduar shtëpinë tonë. Unë isha shtatzënë dhe linda vajzën katër muaj pas vdekjes së tij. Në atë kohë, unë isha gjallë, por mezi ia dilja të jetoja. Gjithsesi, nga partia më bënë vizita dhe kujdeseshin shumë për mua, për shkak se im shoq konsiderohej një hero. Ata më ofruan një punë të mirë, e cila më ndihmoi ta mbështesja familjen time. Punova si përfaqësuese e klasës punëtore për të ashtuquajturën Lëvizja Çollima, e cila ishte orvatja e Kim Il Sung-ut për t'i nxitur punëtorët koreanoveriorë që të jepnin gjithçka nga vetja për ta rindërtuar Korenë e Veriut pas luftës.

Pesë vjet pas vdekjes së tim shoqi, u sëmura shumë keq. Ndenja shtrirë në krevat pa e ditur emrin e sëmundjes dhe mjekët e Lëvizjes Çollima erdhën të më vizitonin. Kryetari i lëvizjes dhe qeveritarët e tjerë menduan se unë isha e sëmurë, ngaqë isha bërë vejushë në moshë të re. Për këtë arsye, ata rregulluan që të martohesha me komandantin e njësisë 14 në divizionin e armatimeve të forcave ajrore.

Ai ishte dyzet vjeç, kurse unë tridhjetë. Ai ishte shumë i sjellshëm dhe fliste shumë mirë rusisht, anglisht e japonisht. Por ai ishte me hepatit. Kishte jetuar për një kohë të gjatë pa grua dhe pinte shumë alkool. Kur u martua me mua, ai kishte tre fëmijë.

Shëndeti m'u rikthye për pak kohë, pasi hëngra ushqim të përgatitur me katër koka lope, që na u shërbye nga një njësi e forcave ajrore. Burri im i dytë dhe unë patëm një djalë e një vajzë bashkë. Për fat të keq, mua m'u desh ta martoja vajzën time të parë, pa asnjë pajë, për shkak se vjehrra ime nuk e lejoi atë të vinte të jetonte me burrin tim të ri.

2. Thirrja për aventura

Burri im i dytë ndërroi jetë në vitin 1983 për shkak të hepatitit. Vajza ime nga martesja e dytë gjithashtu vdiq, gjatë lindjes. Ajo ishte e bukur dhe dilte mirë me mësimet. Djali im dhe unë jetonim në shtëpinë e vajzës sime, por pasi ajo ndërroi jetë, ne donim të iknim që atje. Im bir, që varej prej së motrës, donte të shkonte në Korenë e Jugut, kur ajo vdiq dhe as unë nuk doja të jetoja më në Korenë e Veriut. Shëndeti im përkeqësohej vazhdimisht dhe deri në atë kohë ecja me vështirësi të madhe. Habitesha, sesi do të mundja ta bëja udhëtimin për në Korenë e Jugut. Im bir tha se, fillimisht, ai do të shkonte në Korenë e Jugut, përmes Kinës dhe sugjeroi që unë ta ndiqja atë, pasi ai t'i kishte marrë masat e duhura për mua, që prej atje.

Unë mbërrita në Korenë e Jugut një vit pasi kishte mbërritur ai. Edhe pse ishte shumë i vogël në trup dhe i dobët që nga fëmijëria, im bir u bë një inxhinier i suksesshëm saldimesh dhe tani drejton biznesin e vet. Po lutem për tim bir që të bëhet si Jozefi i Biblës, që ai t'u shërbejë edhe shpirtërisht, edhe nga ana materiale vëllezërve e motrave të tij në Korenë e Veriut.

3. Refuzimi i thirrjes

Vajza ime e shtrenjtë vdiq gjatë lindjes. Unë nuk doja të jetoja më në Korenë e Veriut. Për këtë arsye, u arratisa. Kjo është arsyeja se përse nuk e refuzova thirrjen.

4. Takimi i mentorit

Së pari, mendova se do ta bëja udhëtimin për në Korenë e Jugut për shkak të djalit tim të përkushtuar. Por pasi besova në Perëndinë, e kuptova se ishte prej hirit të Perëndisë që erdha në Korenë e Jugut. Besoj se jam e vetmja që e ka kapërcyer lumin Tumen me një shpinë të përkulur, pa qenë në gjendje të ecja. Kur kalova pranë njërit prej rojeve, pothuajse u dorëzova. Por roja i patrullës kufitare i tha ndërmjetësit tim të më mbartte në shpinën e vet. E kalova lumin mbi shpinën e ndërmjetësit dhe sapo e kapërceva lumin, po na priste një makinë. Kalova direkt prej shpinës së ndërmjetësit te makina. Bëmë të njëjtën gjë, kur kaluam lumin Mudan.

Dhe kur mbërritëm te kisha që më ndihmoi, në katin e pestë të ndërtesës, unë isha sërish mbi shpinën e ndërmjetësit tim. Të gjithë misionarët atje, nga kisha koreane, u lutën që të më sillnin në Jug. Ishte një mrekulli. Pa ndihmën e Perëndisë, nuk do të kisha qenë në gjendje ta bëja atë. Ai më dërgoi të gjithë ndihmësit që më nevojiteshin, për të më sjellë në Korenë e Jugut.

5. Kalimi i pragut të parë

Unë humba dy bashkëshortë *dhe* vajzën time të dashur. Nuk doja më që të jetoja në Korenë e Veriut. Isha me fat që u arratisa dhe isha ndoshta i vetmi person invalid mes njëzet e pesë mijë dezertorëve koreanoveriorë që ia dolën ta realizojnë me sukses udhëtimin për në Korenë e Jugut. U largova prej Koresë së Veriut duke e ditur se nuk mund të kthehesha më atje.

Njerëzit e mi atje ndoshta nuk munden dot as ta imagjinojnë se jam akoma gjallë dhe gëzoj shëndet të mirë tani. Jam e sigurt se ata mendojnë që kam vdekur. Nuk isha atëherë i njëjti person siç jam tani. Shpina ime ka bërë shumë përmirësim, sa që tani mundem të ec vetë me ndihmën e bastunit, dhe në përgjithësi jam mjaft e shëndetshme. Shërbej si stazhiere në Universitetin e Fshehtë të “Zërit të Martirëve” në Kore dhe jam duke marrë pjesë në shërbesën e Perëndisë. Jam e mbushur me gëzim këtu në Korenë e Jugut. Por nëse Perëndia më dërgon sërish mbrapsht në Korenë e Veriut, që ta ndërtoj mbretërinë e Tij atje, unë do t’i bindem Atij.

6. Sprovat, aleatët dhe armiqtë

Vdekja e vajzës sime ishte prova ime. Po të mos kishte vdekur ajo, unë nuk do të kisha shkuar në Korenë e Jugut. Ndiej keqardhje që ime bijë humbi jetën e saj, por unë tani jetoj me paqe.

Perëndia më dërgoi aleatët: një ndërmjetës që më ndihmoi deri në Korenë e Jugut; rojën e patrullës kufitare, i cili i tha ndërmjetësit tim të më mbartte në shpinë; dhe misionarët e Koresë së Jugut në Kinë, që më mbështetën me lutje për të ardhur në Korenë e Jugut.

Armiqtë e mi janë drejtuesit politikë të Koresë së Veriut, që më kishin mashtruar. Dhe i ligu është gjithashtu armiku im. Unë jetoja mirë si anëtare familjeje e një heroji patriot, burrit tim, pa u shqetësuar si do të jetoja, por pavarësisht nga jeta me bollëk,

gjithmonë jetoja me ankth të madh, dhe nuk mund të flija dot mirë. Por pasi i besova Perëndisë, shqetësimet m'u zhdukën. Tani nuk jam financiarisht e pasur, por jam me të vërtetë e ngushëlluar, duke kujtuar një varg nga Bibla: "Pra, mos u shqetësoni, duke thënë: - Çfarë do të hamë?' ose 'Çfarë do të pimë?' ose 'Çfarë do të veshim?'" (Mateu 6:31)

7. Afrimi për te shpella më e brendshme në thellësi

Pata vërtet një kohë të vështirë për të ardhur nga Kina në Korenë e Jugut në vitin 2007. Shtatë refugjatë koreanoveriorë, duke më përfshirë edhe mua, morëm trajnim dishepullimi prej kishës kineze, por më vonë u kapëm prej sigurimit kombëtar kinez, ngaqë dikush i kishte informuar ata për ne. Unë nuk e flisja fare gjuhën kineze dhe vetëm mund t'i lutesha Perëndisë për jetët tona. Njëri prej nesh që fliste gjuhën kineze, u tha atyre se ishim familje, por agjentët e sigurimit kombëtar kinez nuk na besuan dhe na mbajtën nën arrest. Nuk kishte asnjë mënyrë për të dalë që atje, përveçse përmes lutjes. Shtatë veta nga grupi ynë, bashkë me vëllezërit e motrat nga kisha koreane, vazhduan të luten. Për habi, agjenti i sigurimit kinez, që na kishte kapur në mbrëmje, na liroi në agimin e së nesërme. Një misionar, që ishte me grupin tonë, u përpoq ta falënderonte atë duke i dhënë dyzet mijë juan (afro gjashtëdhjetë dollarë), por ai nuk i mori paratë. Lirimi ynë ishte i pamundur pa ndihmën e Perëndisë.

Më vonë, na ndaluan në një pikë kontrolli në Mianmar gjatë rrugës me autobus për në ambasadën e Koresë së Jugut. Unë nuk kisha mjet identifikimi, prandaj gjithçka që mund të bëja ishte të lutesha që të mos më arrestonin. Oficeri i policisë së Mianmarit thjesht kaloi pas nesh, edhe pse na pa. Pas asaj ngjarjeje, ne erdhëm në Korenë e Jugut të sigurt, pa ndonjë incident tjetër.

Kohët e fundit, vajza ime, që ende jeton në Korenë e Veriut, u bë vejushë dhe mbeti në rrethana të vështira për t'i rritur tre fëmijët e saj. I dërgova asaj dy milionë uon (afro dymijë dollarë). Por kur ajo më mori përsëri në telefon, nuk ia hapa, ngaqë nuk kisha asgjë tjetër që mund t'i jepja; gjithsesi më erdhi keq për të. Nuk mund ta predikoj drejtpërdrejt ungjillin me të, sa herë flisnim në telefon, por të paktën i thashë “Lutju Perëndisë.” Por ajo vetëm sa qeshi, pa e ditur kuptimin e Perëndisë.

8. Sprova e rëndë

Vuajta sprova të rënda, kur secili nga burrat e mi ndërroi jetë dhe kur vajza ime, nga martesë e dytë vdiq gjatë lindjes. Njerëzit më përçmonin, duke nxjerrë si shkak për vdekjet e tyre fatin tim të keq. Pasi i humba ata, nuk doja më të jetoja në Korenë e Veriut dhe beteja ime e brendshme kaloi në ekstrem. Kisha frikë nga njerëzit.

9. Shpërblimi

Së pari, shpërblimi më i madh që kam marrë është besimi në Jezusin. E pranova Jezusin, kur isha në Kinë. Më vonë, munda të bindesha për shpëtimin tim, teksa e përjetoja Perëndinë t'u përgjigjej lutjeve të mia. Erdha në Korenë e Jugut, për shkak të lidhjes së tim biri me një kishë në Suon (Suwon), në Korenë e Jugut, e cila u shërben koreanoveriorëve.

Shpërblimi i dytë që kam marrë, është se jetoj në Korenë e Jugut, që është si të jetosh në parajsë. Është ngazëllyese që arrita ta njoh Perëndinë, por ta përjetoja këtë ndërsa jetoja në Korenë e Jugut ishte gjë e mrekullueshme. I jam me të vërtetë falënderuese Perëndisë për këtë. Jam vërtet e lumtur në Korenë e Jugut, dhe ndonëse nuk jam e pasur, jam e mbushur me gëzimin që sjell paqja e Tij. Nuk ka

më shqetësime dhe unë ia jap të gjitha falënderimet Perëndisë. Kur isha në Korenë e Veriut, adhuroja të ligun. Zbavitesha me një besim supersticioz dhe bëja gjithçka që më kërkonte ai supersticionizëm; por prapëseprapë, kjo vetëm sa më mbushte me shqetësime dhe ankth.

Mësova plot vargje nga Shkrimi i Shenjtë përmes shkollës së trajnimit të misionarëve të Universitetit të Fshehtë të “Zërit të Martirëve” në Kore. Kur shkova në udhëtimin tim të parë me UF për në Kinë, isha falënderuese për atë mundësi dhe i mburresha për të, njerëzve rreth e rrotull meje. Kur isha në Korenë e Jugut, nuk munda dot të drejtoja askënd te Jezusi. Gjithnjë ndihesha fajtores që nuk isha në gjendje t’i drejtoja të tjerët te Perëndia. Ndryshe nga fëmijët e dezertorëve të tjerë nga Koreja e Veriut, im bir më nxiste për të shkuar në udhëtime misioni. Edhe pse nuk takova asnjë refugjat koreanoerior gjatë udhëtimit tim, unë mora pjesë në një projekt për të paketuar sende për ta në pako që përmbanin domosdoshmëritë jetike bazë si dhe literaturë që ndante lajmin e mirë të Krishtit. U ndjeva vërtet mirë që paketova afro njëqind pako të tilla.

10. Rruga për kthimin

Kur të bashkohet Koreja, së pari unë do t’ia tregoj lajmin e mirë familjes sime (vajzës sime dhe vëllezërve të saj të vegjël), të afërmeve dhe fqinjëve. Do t’u tregoj atyre se Jezusi është Shpëtimtari ynë dhe do t’u tregoj për Korenë e Jugut dhe sesi ai vend u bë i pasur me ndihmën e Perëndisë, për shkak se qytetarët e tij kanë besuar te Perëndia dhe i kanë shërbyer mirë Perëndisë.

Gjithashtu do t’u dëshmoj atyre të vërtetën se Jezusi erdhi për të na shpëtuar prej mëkateve të botës. Do t’u tregoj për Perëndinë, i cili më shpëtoi dhe iu përgjigj të gjitha lutjeve të mia.

Afro dy vjet më parë, im bir pësoi dëme të mëdha financiare, kur u përfshi me një skemë piramidale. Në atë kohë, ai tashmë kishte humbur 20 milion uon (afro nëntëmbëdhjetë mijë dollarë), por nuk

mund ta linte aq lehtë biznesin dhe paratë që kishte investuar në të. Unë qaj rrallë, ngaqë jam kokëfortë, por kur ndodhi kjo gjë, u luta për tim bir dhe qava. Dhe ditën tjetër, ai më thirri për të thënë se do ta linte biznesin piramidal. Zemra e tim biri nuk mund të kishte ndryshuar pa ndihmën e Perëndisë. Unë mund ta ndieja praninë e fuqishme të Perëndisë prej ndryshimit të tim biri, njëlloj siç e kisha përjetuar, kur u lirova nga arrestimi prej agjentit kinez të sigurisë.

Dua t'u tregoj të vërtetën koreanoveriorëve. Ata nuk e dinë që i kanë mashtruar, për shkak se kanë jetuar verbërisht në sistemin e Koresë së Veriut. Unë dikur isha një anëtare partie pasionante dhe besnike, që e kishin mashtruar se Kim Il Sung-u dhe Kim Jong Il-i vuanin nga uria së bashku me qytetarët e tjerë koreanoveriorë. Dhe mendoja se ne ishim duke vuajtur urie, ngaqë drejtuesit e tjerë nën familjen e Kim-it nuk qeverisnin mirë; gjithsesi, unë zbulova se Kim Il Sung-u dhe Kim Jong Il-i jetonin në pasuri e komoditet, sipas një libri të shkruar nga kuzhinieri i Kim Jong Il-it. Ne na kishin mashtruar të gjithëve. Unë dua t'u tregoj koreanoveriorëve të vërtetën dhe Ungjillin.

11. Ringjallja

Nuk mendoj se do të ketë pengesa të mëdha në rrugën tonë pas bashkimit. Por, edhe po të ketë, unë nuk do të kem frikë prej tyre dhe do t'i mposht ato. Unë madje isha besnike ndaj Kim Il Sung-ut dhe Kim Jong Il-it, kështu që, a nuk do të vdisja për Perëndinë që është më i madh se ata? Mendoj se doktrina e Koresë së Veriut e kopjon plotësisht Biblën. Prandaj, nëse koreanoveriorët e kuptojnë se i kishin mashtruar dhe pastaj u mësohet Bibla, patjetër që ata e pranojnë Jezusin si Shpëtimtarin e tyre.

Jam e vetëdijshme se njerëzit në Korenë e Veriut do të më përçmojnë kur të shkoj prapë atje, duke thënë se unë i vrava të dy burrat e mi dhe vajzën time; por unë nuk trembem fare prej kësaj. Më përpara unë nuk e njihja Perëndinë, por tani që besoj te Perëndia, kam vetë-siguri. Nëse

shkoj në Korenë e Veriut, njerëzit që më njohin, do të befasohen kur të më shohin. Kur ika prej atje, unë isha një vejushë e mëshiruar, e cila i kishte humbur burrat e saj dhe vajzën e saj. Shumë koreanoveriorë e dinë tashmë se Koreja e Jugut është një vend i mirë dhe i pasur, prandaj ata mund t'i konsiderojnë dezertorët koreanoveriorë si heronj. Ndonëse pothuajse të gjithë koreanoveriorët do të donin të shkonin në Korenë e Jugut, vetëm një në njëmijë arrijnë të arratisen. Prandaj, unë jam një shërbëto e zgjedhur prej Perëndisë.

12. Rikthimi me eliksirin

Unë po përgatitem për bashkimin e Koreve duke u lutur. Besoj se periudha e stazhit tim tek Universiteti i Fshthtë është pjesë e përgatitjes së Perëndisë për bashkimin. Do të shkoj me lajmin e mirë kur Koreja të bashkohet. Pastaj do të ndërtoj një shkollë Universiteti të Fshthtë në Korenë e Veriut. Për t'u përgatitur që të jem një instrument i mirë për t'u përdorur nga Perëndia, do të shërbej mirë si stazhiere.



Kapitulli 5.

Z. Kim: Udhëtimi ngurrues

*Si i mblidhni fijet e një jete të vjetër?
Si vazhdoni përpara, kur në zemrën tuaj, nisni ta
kuptoni, se nuk ka kthim prapa?*

—J.R.R. Tolkein³⁸

1. Bota e zakonshme

Unë linda në Sangam-dong, në qytetin Kimçek (Kimchaek), në vitin 1965. Prindërit e mi ishin punëtorë në një fabrikë hekuri dhe unë isha më i madhi prej fëmijëve të tyre, dy djem e dy vajza. Ngaqë xhaxhai im ishte partizan (që luftoi kundër japonezëve), jeta ime shkonte mirë. Në vitet 1970-të, Koreja e Veriut ishte e varfër, por njerëzit që emigruan nga Japonia në Korenë e Veriut konsideroheshin shumë të pasur. Për shkak të arritjeve të xhaxhait tim, unë jetova me të njëjtin nivel si koreano-japonezët, madje vishesha mirë edhe me pantallona prej stofi.

Sistemi arsimor i Koresë së Veriut përbëhej nga shkolla fillore, shkolla e mesme dhe kolegji. Kur isha në vitin e parë të shkollës së mesme, mësuesi më tha të merrja muzikën si drejtim kryesor, pasi më ekzaminoi grupin e gjakut, zërin dhe diapazonin, për shkak se ai zbuloi që kisha tonin e përsosur. Madje pata mundësi të këndoja

³⁸ J.R.R. Tolkein, *The Return of the King: Being the Third Part of the Lord of the Rings* (Boston, MA: Houghton Mifflin Harcourt, 2012).

në skenën e qytetit. Së pari studiova vokalet e më vonë luajta në flaut. Por, edukimi im fizik ishte i varfër.

Në Korenë e Veriut, nëse yt atë punonte te bashkia e qytetit ose e kryeqytetit, ose nëse një paraardhës i yti kishte punuar atje, të ardhmen e kishe të mirë. Por fëmijët, etërit e të cilëve nuk kishin pushtet ose ishin punëtorë krahu, kishin prirjen ta ndalnin artin e tyre. Ndonëse isha zgjedhur për grupin simfonik të Ushtrisë Popullore, ndihesha se nuk mund të isha i suksesshëm si artist, ngaqë historia ime familjare nuk ishte mjaftueshëm e mirë. Qëllimi im i vetëm, kur shkova në ushtri ishte ta dalloja veten si hero, që të mund të bëhesha anëtar i Partisë Komuniste.

Sot në Korenë e Veriut, shërbimi i detyruar ushtarak fillon në moshën shtatëmbëdhjetë dhe përfundon në moshën tridhjetë vjeçare. Kurse në ato ditë, ishte prej moshës shtatëmbëdhjetë deri në njëzet e shtatë, kështu që unë u lirova nga ushtria kur isha njëzet e shtatë vjeç.

Në fillimin e shërbimit ushtarak, unë përfitova prej kushërinjve të mi që po punonin në Departamentin e Shtetit të Koresë së Veriut, për shkak të babait të tyre partizan. Motra e tyre gjithashtu u martua me një burrë të një rangu të lartë në Pjongiang. Unë u bashkova me flotën detare dhe u pranova në Partinë Komuniste në moshën njëzet vjeçare. Kur u bashkova me flotën detare, në një anije kishte shtatëdhjetë detarë dhe unë isha i vetmi artist. Një zyrtar i partisë dhe një komandant ushtarak më caktuan si drejtues të ri për t'u kujdesur për të gjithë instrumentet që kishin në anije. Ngaqë një drejtues i tillë duhej të ishte anëtar partie, unë u bëra anëtar i Partisë Komuniste. Absolutisht u mahnita prej këtij pranimi të hershëm në parti. Mendova: *Si u bëra unë anëtar partie? Si munda të ndodhte kjo gjë, pa ndonjë përpjekje timen?*

Për pranimin në Partinë Komuniste, një koreanoverior duhej të gjente tre garantorë. Në rastin tim, kur njerëzit që njihja po përpiqeshin të hynin në parti, unë dola garantor tri herë. Shërbimi im ishte i lehtë. Thjesht më duhej të kujdesesha për instrumentet,

të formoja një bandë, t'i vija të praktikoheshin dhe të shkonim për të performuar nën drejtuesin politik. Mora tre rekomandime për të shkuar në kolegjin detar, por im atë ra nga një ndërtesë e lartë, sapo u regjistroi atje. Si rezultat, e humba mundësinë për të pasur një jetë të lehtë në kolegjin detar, ku vetëm duhej të bëja performanca. Im atë pas aksidentit mbeti me aftësi të kufizuara dhe mamaja ime u paralizua në vitin 1984. Kështu që, në vend që të shkoja në kolegji, vendosa t'u shërbeja prindërve të mi.

U lirova nga flota detare në tetor të vitit 1990. Shkova të punoja në qendrën e menaxhimit të pyjeve, dhe një nga kolegët e punës atje më prezantoi me gruan time të tanishme. Ne u martuam në vitin 1991.

Më përpara kisha njohur dy gra, por nuk u martova me asnjërën. Gruaja e parë që takova ishte njëzet e një vjeçare në atë kohë. Kur i propozova martesë, prindërit e saj kundërshtuan, ngaqë donin që vajza e tyre të martohej në moshën njëzet e tre ose njëzet e katër vjeçare. U lëndova prej vendimit të tyre. Gruaja e dytë që takova, ishte dy vjet më e re se unë, dhe ishte vajza e një menaxheri të peshkimit në Sinpo. Babai i saj më kishte shumë qejf mua, por krenaria ime nuk më lejoi që të martoheja me të. Pata ndjesinë se do të ishte e padrejtë për këtë grua, e cila kishte histori të mirë familjare dhe plot ëndrra, t'u shërbente prindërve të mi me aftësi të kufizuara. Mendoja se një laraskë duhet të jetojë me një laraskë tjetër.

Kur shkova të takohesha me gruan time të ardhshme, këtë aktualen, nuk pata përshtypjen më të mirë për të, por gjyshja dhe mamaja e saj ishin tërheqëse. U ktheva në shtëpi dhe i thashë tim eti se do të ishte mirë që ta takonin atë dhe pas një jave ajo u takua me prindërit e mi. Babait tim i pëlqeu, kështu që ai më dha lejen për t'u martuar me të.

Ajo ishte vajza e një bujku dhe bujqit në Korenë e Veriut gjithmonë do të preferonin të jetonin në qytet në vend të fshatit, prandaj për gruan time, ishte ngritje një hap më lart ardhja për

të jetuar në qytet dhe të ishte gruaja e një punëtori. Në fillim ne u shërbyem mirë prindërve të mi dhe pas pesë muajsh dolëm nga shtëpia. Pasi lindi vajza jonë, unë i solla prindërit sërish në shtëpinë time në prill të vitit 1993 dhe u kujdesëm për ta edhe për tre vjet të tjerë.

Në vitin 1989, qeveria e Koresë së Veriut organizoi një aktivitet në Pjongiang të titulluar “Festivali i Trembëdhjetë Botëror i Rinisë dhe Studentëve” që të fitonin para, por ai nuk doli i suksesshëm. Përpara atij aktiviteti, ne kishim mundësi të hanim çokollata ruse, por pas këtij dështimi ndërkombëtar, ne mund të hanim vetëm çokollata koreanoveriore. Madje edhe cilësia e karamелеve e biskotave ra shumë. Koreanoveriorët i quanin ato me nofken “biskota tulle”, për shkak se ishin tepër të forta për t’u kafshuar. Karamelet ishin si gurë. Por, pasi u lirova nga flota detare, e kuptova se problemet ekonomike të Koresë së Veriut ishin shumë më të thella sesa cilësia e biskotave.

Pasi vdiq Kim Il Sung-u në vitin 1994, jeta ime u vështirësua. Ngaqë punoja për qendrën e menaxhimit të pyjeve, nuk mund të sillja mjaftueshëm ushqim në shtëpi, që familja jonë të plotësonte nevojat e veta. Prandaj, gruaja ime blinte vegla hekuri, të tilla si sharra ose gozhdë, për t’i shitur në qytetet e ndryshme të provincave Hamgiong (Hamgyong) dhe Jangang (Yanggang). Mamaja ime kujdesej për vajzën tonë, kurdoherë që gruaja ime shkonte në këto udhëtime. Kur kthehej në shtëpi ime shoqe, ajo sillte misër ose patate prej provincës Hamgiong. Në vitin 1994, ne jetonim në provincën Huange (Hwanghae), larg prej këtyre dy provincave të tjera, prandaj ishte e vështirë për time shoqe ta mbartte ushqimin deri në shtëpi. Ajo po luftonte për mbijetesën e familjes sime. Kur vjehrra ime na erdhi për vizitë në vitin 1996, ajo zbuloi se e bija po vuante shumë dhe nuk i pëlqyen kufizimet e aftësive të prindërve të mi.

Përfundimisht, vjehrra ime bëri sherr me mamanë time dhe ajo këmbënguli që situata të ndryshonte. Lajmi i këtij sherri shkoi te motra ime më e madhe. Në atë kohë njerëzit e tjerë në Korenë e

Veriut vërtet po vuanin për të mbajtur frymën gjallë dhe po shisnin thuajse gjithçka vetëm për ushqime. Por për shkak të punës së vështirë të time shoqeje, ne mundëm t'i mbanim shumicën e gjërave, përfshirë disa pajisje shtëpiake, të tilla si makina qepëse, biçikleta, dhe televizori i ri dhe të paktën ne kishim qull të ujshëm për ta ngrënë. Motra ime më e vogël ishte një grua lakmitare dhe mendoi se po t'i lëviznim prindërit tanë tek shtëpia e saj, ajo gjithashtu mund të merrte bashkë me prindërit disa prej zotërimeve tona. Ajo madje solli xhaxhain tonë për t'i bindur prindërit e mi që të lëviznin.

Kur erdha në shtëpi prej punës atë mbrëmje, prindërit më thanë se donin që të largoheshin prej meje e të shkonin të jetonin me motrën time. E hodha poshtë këtë ide dhe pa ngrënë darkë, u përpoqa t'i bindja të vazhdonin të jetonin me mua. Por mosmarrëveshja jonë zgjati deri në orën tre të natës. Për shkak të stresit të madh, e godita xhaxhain tim në kokë me një vazo të madhe lulesh. U verbova prej zemërimit të zjarrtë dhe i dërgova tutje duke iu thënë: "Shërbejuni mirë prindërve të mi dhe mos më shkëlmi më në derë!" Të gjitha gjërat që kishim deri në atë kohë u morën prej motrës sime. E dija që kisha qenë një djalë i mirë dhe i kisha trajtuar mirë prindërit e mi, deri sa ata ishin në të gjashtëdhjetat e tyre dhe për këtë arsye kisha paqe të plotë me veten lidhur me faktin se si isha kujdesur për ta.

Një vit përpara se të largoheshin prej meje, shëndeti i babait tim u përkeqësua. Njerëzit në Korenë e Veriut thanë se cilido që ka sëmundjen e tim eti, në fillim do të fryhej e pastaj vdiste. Por unë e kurova sëmundjen e tij dhe akoma e kam aftësinë t'i shëroj njerëzit nga pothuajse çdo lloj sëmundjeje. Gruaja e xhaxhait tim të dytë ishte mjeke e mjekësisë orientale. Prej saj i mësova aftësitë mjekësore dhe gjithashtu studiova trajtimet bimore, ndërkohë që isha duke punuar për qendrën e menaxhimit të pyjeve. Edhe pse e shërova tim atë dhe i shërbeva atij me gjithë sa kisha, kur motra ime më e madhe erdhi për të kërkuar që prindërit të jetonin me të, im atë m'u ankua se ai nuk mundej dot të jetonte më me mua. Ai

tha se unë isha larg shtëpisë për shumë kohë dhe si rezultat nuk e menaxhoja mirë familjen time. Megjithatë, ngaqë isha anëtar partie, nuk kisha ndonjë zgjedhje tjetër, përveçse të punoja dhe për këtë arsye nuk merrja dot pjesë në gëzimet familjare.

Atëherë vajza ime ishte dy vjeçe, kështu që u kërkoja prindërve të gruas që të kujdeseshin për të. Por gruaja ime po vuante shumë, prandaj e nxora shtëpinë në shitje dhe e lashë punën. Vjehrra ime sugjeroi që ne të jetonim me ata dhe të merreshim me bujqësi dhe përfundimisht ne vendosëm të jetonim me ata, deri sa morëm një shtëpi tonën.

Familja e gruas sime kishte tre persona: vjehrrin e vjehrra dhe gjyshja. Tani familja u bë me gjashtë persona, përfshirë gruan time, vajzën tonë dhe mua. Por prindërit e gruas nuk kishin fare ushqim për të ngrënë. Edhe pse punonin shumë, të ardhurat ishin si një pikë uji në det. Ne hymë në shtëpinë e tyre në qershor, por nuk kishte fare ushqim për të ngrënë. Në fakt, si bujq, ata e kishin marrë racionin e tyre vjetor të ushqimit nëntorin e kaluar, por ai kishte zgjatur vetëm gjashtë muaj, kështu që të gjithë neve na u desh të mbijetonim me ushqimin që kishim sjellë me vete.

Bujqit e Koresë së Veriut duhet të sigurojnë shtatë kilogramë mish secili, si mbështetje për Ushtrinë Popullore, çdo vit. Për shkak se gjyshja e gruas sime kishte dalë në pension për shkak të moshës (ishte më tepër se pesëdhjetë e pesë vjeç), për të kërkesa ishte reduktuar në tre kilogramë. Si rezultat, të tre anëtarët e familjes së sime shoqeje duhej të siguronin në total 17 kg mish si mbështetje për qeverinë. Po të mos ishin në gjendje ta siguronin atë, qeveria do ta pakësonte me tre herë mbi sasinë e munguar racionin e orizit të familjes. Për shembull, nëse nuk e plotësonin me 6 kilogramë sasinë e kërkuar të mishit, atëherë ata do të merrnin 18 kilogramë më pak nga sasinë e ushqimeve që u takonin.

Në rastin e vjehrrës sime, ajo duhej të kishte marrë 250 kilogramë misër në racionin e saj, por familja nuk mundej dot të siguronte 17 kilogramë mish për mbështetjen e ushtrisë, kështu që

prej racionit të saj të misrit do të hiqeshin 51 kilogramë. Ajo mori vetëm 199 kilogramë. Prandaj, me këto shkurtime, gjithçka që ata kishin për të ngrënë ishin ushqimet që sollëm ne. Pavarësisht nga kjo situatë, oqeani siguronte leshterikë dhe bimë ujore, kështu që familja e gruas sime i përdorte ato për ushqim. Ata madje i thanin ato për t'i shitur dhe të paktën mund të hanin qull me perime.

Që të lëvizja, unë duhet të kaloja nëpër një proces me qendrën e menaxhimit të pyjeve; u desh të jepja shumë ryshfet. Më në fund, mora një certifikatë për të lëvizur më 1 gusht dhe nisa të punoj në një qendër biznesi për rritjen e peshkut. Mua më duhej t'i deklaruoja të gjitha prodhimet që kapeshin prej oqeanit, të tilla si peshqit, molusqet dhe bimët detare, por që të gjithë ne vidhnim ca nga produktet pas shpinës së zyrtarëve të qeverisë. I shisnim gjërat e vjedhura për të mbijetuar. Mendoj se regjimi i Koresë së Veriut ishte shkatërruar tashmë, për shkak se njerëzit nuk mundnin dot të mbijetonin, po të mos vidhnin. Kështu që edhe unë vodha.

Gruaja ime ishte fëmija e tretë mes pesë vëllezërish e motrash. Ajo kishte një vëlla më të madh, një motër më të madhe dhe dy motra më të vogla. Unë e ndihmova njërën nga motrat e saj më të vogla që të martohej. Kur ime shoqe dhe unë u martuam në Korenë e Veriut, gruaja ime solli dy batanije, kurse unë, si dhëndri, solla një batanije. Sipas traditës koreane, unë duhej të fusja para, veshje dhe një batanije në një kuti fejese të lyer me llak, që t'ia jepja ato gruas sime të ardhshme. Pastaj prindërit e saj do ta bënë vetë gjithçka që do të na duhej për jetën tonë pas martesës. Përpara se të lëvizja për në shtëpinë e prindërve të gruas sime, ne tashmë u kishim bërë dhurata dy motrave të mia për dasmat e tyre. Ne u dhamë atyre dy prej tre batanijeve tona, ngaqë ne nuk kishim mjaftueshëm para për t'u dhënë atyre ndonjë gjë tjetër, kështu që gjithçka që na kishte mbetur tani për vete ishte vetëm një batanije.

Vendosëm që atë batanijen e fundit t'ia jepnim kunatës sime për dasmë, bashkë me të gjitha pjatat që gruaja ime i kishte sjellë për martesën tonë. Pasi i dhuruam të gjitha batanijet tona, për vete

do të na duhej të përdornim një batanije të keqe. Por, kurdoherë që mendoj për këtë gjë, më lumturon, ngaqë pata ndjesinë se duke ia dhënë batanijen kunatës sime, unë po i ktheja diçka gruas sime, e cila kishte vuajtur kaq shumë për martesën tonë.

Pas dasmës së kunatës sime, i ndoqa ata deri te shtëpia e bashkëshortit të saj, si mik nderi. Ne shkua me tren për afro pesëqind li (afro 241.5 kilometra). Gjatë rrugës për në shtëpi, dëgjova se më kishte vdekur babai. Mbërrita në shtëpi katër ditë pas funeralit. Prindërit e gruas sime ishin në shtëpi, kështu që të paktën do t'i dëgjoja detajet nga dikush. Zbulova se im atë i kishte shitur të gjitha gjërat që i kishte marrë prej meje brenda dy ose tre muajve. Pas kësaj, ai nisi të vuante nga uria deri në vdekje. Nga njëra anë u ndjeva i përligjur, për shkak se babai më kishte trajtuar mua padrejtësisht, pavarësisht se kisha qenë një djalë i mirë dhe kisha bërë plot gjëra për të. Por nga ana tjetër, ai ishte im atë që më kishte lindur mua. Isha shumë i mërzhitur, kështu që dola fshehtas nga shtëpia dhe qava tinëz.

Të ardhurat e mia nga oqeani siguronin që anëtarët e familjes sime të ushqeheshin të gjithë. Katër muaj pas vdekjes së babait, erdhi të më shohë mamaja ime në maj 1997. Pavarësisht nga trupi i saj me aftësi të kufizuar, ajo eci në këmbë tridhjetë li (pak me tepër se 14.5 km), e vetme, për të më parë mua. Ajo dukej si lypëse dhe unë, në atë kohë, isha një zyrtar në komitetin e peshkimit në qendrën e biznesit. Ajo më kishte kërkuar atje me emër. Kolegu im erdhi të më tregojë se dikush kishte ardhur për të më kërkuar. Ishte mamaja ime! Nuk e imagjinoja dot që dikush mund të dukej ashtu. Rrobat i kishte të mbuluara me baltë dhe unë pyeta veten: *“Si mundej një zyrtar si puna ime të kishte një mama lypëse me këtë pamje të jashtme?”* U trishtova pa masë, aq sa nuk mundesha dot as të qaja.

E mora mamane menjëherë në shtëpinë time. Ushqimi më i mirë që kishim ishin makaronat petka me miell misri, kështu që ia shërbyem ato asaj. Ajo i hëngri me shumë nxitim, kurse unë qaja

përbrenda vetes. Ditën tjetër edhe motra ime më e madhe erdhi tek unë, duke kërkuar mamanë, pasi kishte dëgjuar se mamaja kishte humbur. I shërbyem edhe motrës makarona petka. Vjehrra ime e shihte me përçmim mamanë time, për shkak se sherri i tyre i fundit kishte qenë shumë i tmerrshëm. Unë përfundova duke fjetur me mamanë dhe me motrën në qoshe dhe i gënjeva prindërit e gruas, duke iu thënë se do t'i ktheja mbrapsht në shtëpitë e tyre mamanë dhe motrën time. Por unë nuk mund t'i dërgoja ato duarbosh, kështu që i binda të qëndronin në shtëpinë e një mikut tim. Më duhej të fitoja ca para për kthimin e tyre. Për fat të mirë, mora mbrapsht ca para prej një kolegu që më kishte marrë hua pesëqind uon më përpara, dhe nxora duke i gërmuar tridhjetë kilogramë molusqe, gjithashtu me vlerën pesëqind uon. Pastaj e mora mamanë time mbi shpinë dhe i kërkoja motrës ta mbante çantën me molusqe mbi shpinën e vet. Qava fort duke u ngjitur mbi malin, ku dikur jetonte familja e gruas sime.

Në atë kohë pesëqind ose njëmijë uon mjaftonte për ta quajtur dikë të pasur. Ia dhashë motrës sime këtë sasi të madhe parash dhe i thashë t'i shërbente mirë mamasë sime. I shpura në rrëzë të malit dhe m'u desh për vete ta ngjisja sërish malin që të kthehesha në punë. Pas kësaj, mamaja ime jetoi vetëm një muaj dhe ndërroi jetë më 27 prill. Dikush më tha se ajo kishte vuajtur urie deri ditën që vdiq. Nuk shkova në funeralin e saj, ngaqë kisha ndjesinë se motrat e mia ose daja mund të më kishin vrarë, duke menduar se unë isha ai që e kisha bërë atë të vuante urie deri në vdekje. Pas kësaj, të dyja motrat e mia u zhdukën në vitin 1997, kurse vëllai im i vogël shkoi në ushtri për shërbimin e tij të detyruar ushtarak.

Të ardhurat që fitonim unë dhe gruaja ime ndihmuan për t'i përmirësuar jetët tona. Të paktën ne mund të hanim oriz e misër. Në vitin 2004, për herë të parë erdhi një ndërmjetës për të na dhënë lajme për motrën time të vogël. Ai tha se ajo ishte në Kinë dhe donte të fliste me mua në telefon në Horiong (Hoeryong). Unë shkova atje dhe ndërmjetësi na lidhi me telefon dhe unë u habita

kur dëgjova se në fakt ajo ishte në Korenë e Jugut. Ajo më dërgoi një milion uon (afro njëmijë dollarë). Në vitin 2005, ajo e solli vëllain tim të vogël në Korenë e Jugut, fill pasi ai u lirua nga ushtria. Si fillim ndërmjetësi e gënjeu vëllain tim, që ta bënte atë të shkonte deri në Çonxhin (Chongjin). Pastaj ai e ndolli vëllain tim përmes lumit për në Kinë. Më në fund ndërmjetësi e dërgoi atë në Korenë e Jugut. Kështu pra, kur mbërrita unë në Horiong dhe e mësova të vërtetën për motrën e vëllain tim, pata ndjesinë se kisha nevojë për mbrojtje që të kaloja përmes kufirit për në Kinë. Për këtë arsye, i premtova një agjenti të sigurisë ushtarake njëqind dollarë, nëse ai do të më mbronte, deri sa ta kapërceja lumin dhe të mbërrija në Janxhi (Yanji).

Kur mbërrita në Janxhi, ndërmjetësi im mori në telefon një ndërmjetës tjetër. Ai më tregoi se motra ime do të vinte me avion nga Koreja e Jugut për të më takuar në Janxhi pas tre ditësh. Në atë kohë, vëllai im tashmë kishte mbërritur në Korenë e Jugut dhe po mbahej nën hetim prej Shërbimit të Inteligjencës Kombëtare. Kur mbërriti motra ime, ajo më dha një orë dore, tre çanta me rroba, kostume, çorape dhe kostume tradicionale koreane bashkë me njëmijë e njëqind dollarë. Kur e kapërceva lumin sërish për t'u kthyer në Korenë e Veriut, i dhashë agjentit të sigurisë njëqind dollarë dhe pjesën tjetër i shpura në shtëpi.

Ngaqë unë kisha rrogë të mirë në Kimcek (Kimchek), për pak kohë familja ime jetoi mirë. Në vitin 2008, unë u ktheva në Horiong për një telefonatë tjetër me motrën time më të vogël në Korenë e Jugut, që u organizua prej një ndërmjetësi. Ajo më tha se Shërbimi i Inteligjencës Kombëtare të Koresë së Jugut e kishte informuar atë se e kishin gjetur motrën tonë të humbur. Ajo kishte jetuar në Kinë për tetë vjet dhe sapo kishte mbërritur në Korenë e Jugut. Në këtë mënyrë, motra ime e vogël më lidhi në telefon me motrën tonë të madhe. Ishte ajo që i kishte bërë prindërit tanë të vuanin urie deri në vdekje. Ndonëse po ngurroja që të flisja me të, fola gjithsesi. Ajo më kërkoi që t'ia sillja të birin në Korenë e

Jugut, por unë nuk pranova ngaqë kjo gjë mund të më rrezikonte mua. I thashë asaj që t'ua kërkonte këtë gjë njerëzve të tjerë. Nuk kisha as edhe një mendim për t'u arratisur nga Koreja e Veriut, ngaqë po jetoja shumë mirë duke punuar në qendrën e biznesit të peshkimit dhe duke shërbyer si zyrtar në Departamentin e Sigurisë Shtetërore. Kjo u bë e mundur, për shkak se e kisha gënjyer qeverinë e Koresë së Veriut se të gjithë vëllezërit e motrat e mia kishin vuajtur urie deri në vdekje, e nuk iu thashë se ata ishin arratisur për në Korenë e Jugut.

2. Thirrja për aventura

Arsyeja se përse u arratisa nga Koreja e Veriut për në Korenë e Jugut ishte për shkak të motrës sime më të madhe, asaj problematikes, që i bëri prindërit të vuanin urie deri në vdekje. Ajo kishte dërguar shtatë ndërmjetës për t'ia sjellë të birin, por gjashtë ndërmjetës nuk ia dolën dot dhe i shtati u kap. Ai i rrëfeu gjithçka agjentit të sigurisë, përfshirë edhe dezertimet e vëllezërve e motrave të mia për në Korenë e Jugut. Unë e kisha fshehur këtë fakt, që të mund të jetoja si zyrtar. Por ai rrëfim tani e bënte të pamundur që unë të jetoja në Korenë e Veriut. Pas kësaj, agjencia e sigurisë dyshonte se edhe unë mund të përpiqesha të arratisesha, kështu që ata nisën të më mbanin nën vëzhgim për të gjithë kohën. Unë po jetoja në shtëpinë e vetme familjare, të rrethuar me një gardh, që kishte një mullar me kashtë misri në njërën qoshe të oborrit. Agjencia e sigurisë vendosi vëzhgues brenda mullarit, që të më zinin pritë, dhe ata i ndërronin turnet gjatë natës. Pesë ose gjashtë oficerë policie më vëzhgonin të fshehur përnatë. Nuk mundja dot të jetoja në atë situatë.

Ndërmjetësi që më ndihmoi për të biseduar në telefon me motrën time tani ishte bërë i njohur për agjentët e sigurisë vendore. Më në fund ata erdhën që të më arrestonin me makinë. Kur ata erdhën, unë

u kërkova fqinjëve që t'i gënjenin e t'u thoshin se unë po shkoja të shihja një mjek në spitalin e qytetit, për shkak të sëmundjes sime. U shpjegova se përhapja e thashethemit për arrestimin tim do ta bënte të pamundur që unë të punoja ose të bëja më biznes në fshat. Për fat të mirë, ata gënjyen për mua, përpara se të iknim.

Ne ecëm për katër orë me makinë nga Kimcek për në Çonxhin për tek agjencia e sigurisë së qytetit. Kryezyrtari, i veshur me rroba të thjeshta më përshëndeti. Kur ai më intervistoi, ishte shumë i sjellshëm dhe më ofroi cigare. Ky trajtim ishte shumë i ndryshëm nga ai që kishin përjetuar zakonisht kriminelët e tjerë. Ata rriheshin dhe i mbanin me pranga gjatë intervistave. Ai më tha se unë nuk dukeshja si njeri gënjeshtar.

Ndërmjetësi që më kishte shpënë në Horiong për telefonatën me motrën time ishte kapur. Gjatë hetimit, ai përmendi emrin tim, prandaj ata erdhën për të më arrestuar. I thashë agentit se ishte e vërtetë, me ndihmën e tij kisha biseduar me motrën time më të vogël në Kinë. E gënjeva që motra ishte në Kinë. Po t'i kisha thënë të vërtetën se motra ime ishte në Korenë e Jugut, do të kisha vdekur duke u dërguar në një kamp përqendrimi bashkë me familjen time.

Në atë çast e kuptova se më duhej të largohesha nga Koreja e Veriut dhe ishte një çështje o do të shpëtoja veten time, o të shpëtoja ndërmjetësin. Kjo do të thoshte se do të detyrohesha ta nxirrja ndërmjetësin që më kishte raportuar mua sikur ai ishte kriminel i keq që mund të përfytyrohet. E dija se ndërmjetësi i kishte vjedhur para motrës sime që të blinte një makinë për vete. Vendosa që t'i raportoja të gjitha ligësitë që ai kishte bërë, duke përfshirë edhe sesi kishte ndihmuar djalin e motrës sime të vogël të arratisë nga Koreja e Veriut. Duke shtuar ca informacion të rremë, e bëra atë të dukej si burri më i keq i botës. Gjithashtu gënjeva për gjërat që i kisha thënë motrës sime në telefon. Pretendova se i thashë asaj: “Motër, ti tashmë je një tradhtare e qeverisë sonë. Përse kërkon që të më bësh edhe mua si veten tënde?”

Gënjeshttrat e mia ishin aq të suksesshme, saqë ata më liruan brenda dy orë e gjysmë.

Makina me të cilën më kishin sjellë në qytet për hetimin pati një shpërthim gome rrugës, kështu që shefi më dha pesëdhjetë mijë uon që të kthehesha në shtëpi. Nuk kishte autobus për në Kimcek nga Çonxhini, prandaj mora një autobus për në shtëpinë e tezes sime që të rrija atje disa ditë. Kjo gjë rezultoi në pjesëmarrjen time në dasmën e vajzës së kumatit tim, gjatë kthimit tim për në shtëpi.

Kur mbërrita në fshatin tim, ndalova pranë shtëpisë së zyrtarit të sigurisë, i cili ishte ngarkuar për të më ruajtur mua. Zyrtarët e sigurisë në Korenë e Veriut janë që të gjithë lypës, gjithmonë përpiqen të hanë diçka, duke shkuar nëpër funerale ose dasma. Zyrtari po më priste, duke menduar se do të më kishte ndodhur ndonjë gjë e madhe, ngaqë më kishin marrë me makinë për në qytet.

Kur hyra në shtëpinë e tij me buzëqeshje, ai e uli kokën me trishtim. Unë i thashë se thjesht kisha shkuar në spitalin e qytetit për një trajtim mjekësor. Duke mbërritur në shtëpi, e takova sekretarin e Rinisë së Partisë Komuniste përballë shtëpisë sime. Ai ishte shqetësuar aq shumë prej zhdukjes sime, saqë nuk kishte qenë në gjendje të flinte.

Pasi vajza ime u diplomua prej shkollës së mesme, ajo u caktua të punonte në një aeroport ushtarak. Por ajo u kthye në shtëpi, që të kujdesej për gruan time, e cila ishte shumë e sëmurë. Mendja e sime bije ishte ndryshuar krejtësisht ndaj Koresë së Jugut, saqë ajo madje u përpoq ta bindte të ëmën të arratisë për atje. Gjatë kohës së saj në ushtri, miqtë e mikeshat e saj flisnin shumë për Korenë e Jugut. Ato madje provuan një produkt kozmetik të ardhur nga Koreja e Jugut me emrin “Aromë Pranvere,” i cili ishte prodhuar në kompleksin industrial të Kaesong-ut në Korenë e Veriut, por që menaxhohej prej Koresë së Jugut.

Kur i pa rrobat dhe gjërat e tjera jetike që na i kishte dërguar motra ime dhe të cilat i solla unë prej Kinës, asaj iu fiksua mendja

te Koreja e Jugut. Madje që përpara se të kapesha prej sigurimit të qytetit, vajza ime më kishte kërkuar që të arratisesha për në Korenë e Jugut. Arratisja ime për në Korenë e Jugut ishte patjetër thirrja ime.

3. Refuzimi i thirrjes

Kur po flisja me motrën time më të vogël, që kishte dezertuar për në Korenë e Jugut në vitin 2008, ajo më lidhi me motrën tjetër, e cila sapo kishte mbërritur në Korenë e Jugut. Lakmia e saj për gjërat që zotëroja unë rezultoi në ndërprerjen e marrëdhënies sime me prindërit e mi, dhe akoma më keq, në vdekjen e tyre nga uria. Por të gjitha këto ndjenja i varrosa në mendje, kur fola me të në telefon. Në atë kohë, ajo më pyeti nëse i biri ishte mirë në Korenë e Veriut. Në fakt, unë asnjëherë nuk e kisha takuar atë më parë, por e gënjeva duke i thënë se ai ishte mirë. Ajo më kërkoi t'ia dërgoja të birin në Korenë e Jugut, po të ishte gjallë ai. Por nuk pranova ta bëja një gjë të tillë, sepse kisha frikë se mos merresha nën hetim për vete. Në atë kohë, ata më dërguan një milion uon, që i kishin mbledhur për mua.

Kur erdhi dhjetori, mbërriti ndërmjetësi nga Çonxhin-i dhe tha se motra ime e madhe donte të fliste në telefon me të birin në Horiong. Por ajo tha se nuk i zinte besë askujt për ta shoqëruar të birin, përveç meje. Ndërmjetësi më kërkoi të shkoja me të për ta marrë tim nip, kështu që ne u larguam bashkë. Ndalua te shtëpia ku dikur jetonte motra ime dhe atje e takova nipin për herë të parë.

Për shkak se gjyshërit kishin vdekur dhe prindërit e tij kishin humbur, ai po jetonte me të xhaxhain nga ana e babait. Kur mbërrita, ai ishte ulur në kuzhinë. Ishte pesëmbëdhjetë vjeç, por nga shtati ishte i gjatë sa një shtatë ose tetë vjeçar. Rrobat e tij dukeshin sikur i përkisnin një lypësi. I thashë xhaxhait të tij se po

e merrja në një udhëtim për të festuar ditëlindjen e mamasë sime. Xhaxhai i tij më lejoi që ta merrja me vete, por më vuri në dyshim për shkak se u shfaqa papritur dhe gjithashtu ishte shumë i matur, ngaqë prindërit e djalit tashmë ishin zhdukur. Ia ndryshova rrobat nipit dhe i thashë xhaxhait të tij të mos shqetësohej. E sigurova se do ta ktheja nipin tek ai. Kur mbërritëm në Cunsan (Jongsung) gjatë rrugës për në Horiong, takova një ndërmjetës. Ai ishte një agjent sigurimi, që supozohej se do të më ndihmonte mua dhe nipin tim të lidheshim me telefon me motrën time.

Motra më kërkoi ta merrja djalin e saj nga Korea e Veriut në Korenë e Jugut. Por unë nuk isha gati, ngaqë kisha për detyrë të kujdesesha për varret e prindërve të mi. Koreja e Veriut ka një zakon që dhjetë vjet pas vdekjes së prindërve, duhet ta nxjerrin arkivolin prej druri lart, që t'i pastrojnë kockat pasi trupat të jenë kalbur krejtësisht. Pastaj kockat duhet të riorganizohen në një arkivol të ri të bërë prej çimentoje dhe prindërit varrosen sërish. Meqenëse vëllezërit e motrat e mia ishin zhdukur, unë i vizitoja varret e prindërve të mi dy herë në vit për t'u kujdesur për ta. Bërja e këtij veprimi supozohet se sjell bekim prej paraardhësve.

Krejt familja e gruas sime përbëhej nga zyrtarë të qeverisë, gjë që na e vështirësonte sjelljen ndërmend të arratisjes. Po të arratisesh gruaja ime, e gjithë familja e saj mund të lëndohej për shkakun tonë. Kjo është arsyeja përse, kur më kërkoi motra të arratisesha me të birin, unë i thashë asaj të gjente dikë tjetër, që t'ia shpinte të birin në Korenë e Jugut. Pasi fola me motrën time në Horiong, e shpura nipin sërish në shtëpi një ditë më vonë nga data që i kisha premtuar xhaxhait të tij. Deri atëherë, xhaxhai i tij e kishte raportuar mungesën tonë te Departamenti i Sigurisë Shtetërore. Për fat të mirë, ata e mbyllën çështjen, kur ne mbërritëm ditën tjetër. Deri në momentin kur u zbuluan gënjeshttrat për vdekjet e vëllezërve e motrave të mia, unë nuk kisha dashur të arratisesha nga Koreja e Veriut.

4. Takimi i mentorit

Ndërmjetësi që më ndihmoi të arratisesha nga Koreja e Veriut ishte mentori im. Ai u dërgua nga motra ime për të më ndihmuar mua që t'ia shpija të birin. Ai më shkaktoi disa probleme, por në tërësi, arratisja do të kishte qenë e pamundur pa njohurinë dhe përvojën e tij.

E takova xhaxhain e nipit tim dhe i thashë ta dërgonte nipin në Çilxhu (Jilju) më 26 maj. Pasi i dhashë atij pesëdhjetë kilogramë misër dhe pesëdhjetë mijë uon, i premtova se do ta ktheja nipin prapë në shtëpi, pasi të merrja pak ndihmë financiare prej mamasë së tij. Por ndërkohë që po prisja për nipin, pasi pjesa tjetër e familjes sime ishin mbledhur në Çilxhu për t'u arratisur, ai nuk erdhi. Koha nuk priste, për arsye se ditën tjetër e kisha lënë orarin për ta takuar ndërmjetësin, që do të na udhëhiqte nga Çilxhu për në Haiçen (Hyesan). Prandaj mora një kamion për të shkuar te shtëpia e nipit tim atë natë.

Kur mbërrita unë, nipi më tha se ai do të ndiqte këshillën e xhaxhait të tij dhe do të rrinte në Korenë e Veriut. U nxeha aq shumë me të, saqë e qortova, duke i thënë: “A të pëlqen që të hash qull të ujshëm?” E binda xhaxhain e tij ta lejonte djalin që të largohej duke i dhënë njëqind e pesëdhjetë mijë uon shtesë. Më në fund u largova prej atje me nipin tim. Ne ecëm për njëqind li (afro pesëdhjetë kilometra) gjatë natës. Më në fund, mbërritëm në Çilxhu. Ndërmjetësi na udhëhoqi të gjithëve ne prej atje për në Haiçen. Ne ecëm mes njëqind e njëzet dhe njëqind e pesëdhjetë li (gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë e katër kilometra) në ditë për tri ditë nga Çilxhu në Haiçen.

Pati rënë shumë shi gjatë dhjetë ditëve përpara se të mbërrinim ne në Haiçen. Lumi Amnok në kufi me Kinën ishte tepër i thellë për t'u kapërcyer nga ne. Ndërmjetësi tha se ai nuk mund të garantonte sigurinë tonë. Normalisht ndërmjetësi është përgjegjës për të paguar për ushqimin dhe strehimin prej tarifës që merr për shërbimin, por deri tani unë pagova për gjithçka si për ne, edhe për atë, gjatë

udhëtimit. Madje m'u desh të shpenzoja më tepër para për familjen e ndërmjetësit gjatë vonësës sonë prej shiut. M'u desh të siguroja për gjithçka që kishte nevojë ai, përfshirë një kamion plot me dru zjarri dhe njëqind kilogramë oriz. Pas dhjetë ditësh pritjeje në Haiçen, vendosa që ta kalonim lumin. Shiu po vazhdonte dhe lumi Amnok doli nga shtrati me mbi treqind metra. I thashë ndërmjetësit se unë do të isha përgjegjës për sigurinë e familjes sime.

5. Kalimi i pragut të parë

Arratisja ime prej Koresë së Veriut ishte kalimi i pragut të parë për mua.

Kur u mora nën hetim prej agjentit të sigurimit të qytetit, unë vendosa që të ikja bashkë me familjen prej Koresë së Veriut. Fola mirë, dhe kjo gjë ma shpëtoi jetën. Por e dija se një ditë e vërteta lidhur me arratisjen e motrave e vëllezërve të mi për në Korenë e Jugut do të dilte në shesh. Si rezultat, e dija që do të më duhej të arratisesha bashkë me familjen prej Koresë së Veriut.

Së pari, shkova në Horiong për ta marrë në telefon motrën time ngatërrestare. Ishte një ndërmjetës, i cili më lidhi mua me të përmes telefonit. I thashë asaj: “Motër, do bëj sipas vullnetit tënd, kështu që caktoje datën.” Ajo e kuptoi se për se e kisha fjalën. Kështu që ajo u përgjigj se do të dërgonte një person më 12 maj te shtëpia e hallës sonë në Çonxhin. Ajo më dërgoi pesëqind mijë uon për të mbuluar shpenzimet e dezertimit tonë.

Së dyti, iu ankova një zyrtari: “Zotëri, nuk mundem dot të jetoj më këtu në Kimcek! Të lutem m'i bëj gati dokumentet që të lëviz në Çonxhin, sepse këtu reputacioni im si zyrtar ka rënë shumë poshtë.” Në Korenë e Veriut duhen shumë dokumente për të lëvizur nga njëri qytet në tjetrin.

Edhe pasi i mora të gjitha dokumentet nga Kimcek-u, unë duhej të merrja dokumentet nga Çonxhin-i, ku do të shpërngulesha.

Dokumentet përfshinin një “Certifikatë për Qëndrim të Përkohshëm” (që na mundësonte për të jetuar përkohësisht në shtëpinë e dikujt), një “Certifikatë për Lëvizjen në Parti,” një “Certifikatë Pune” dhe një “Certifikatë Punësimi.” Që të gjitha këto kërkonin dhënien e ryshfetit që të vuloseshin. Duke shpenzuar shumë para, i përfundova si duhej që të gjitha dokumentet. Në fillim dërgova gruan time bashkë me djalën e vajzën në Çonxhin, duke u premtuar se do t’i takoja atje ata.

Pasi përfundoi i gjithë procesi i lëvizjes në Kimcek, unë shita shtëpinë, televizorin, dollapin e kuzhinës, tokën e gjithçka tjetër. Dhe pastaj përhapa fjalën se ne po shpërngulehim.

Së treti, siç e thashë më përpara, më duhej ta shpija nipin në Çilxhu (Jilju), ku supozohej se do të takoheshin familja ime me ndërmjetësin tonë.

Së fundmi, grupi ynë u mbledh në Çilxhu dhe ne udhëtuan për në Haiçen, ku shiu na e vonoi kalimin përmes lumit Amnok, që kishte dalë nga shtrati.

I thashë ndërmjetësit tim se unë do ta garantoja kalimin e sigurt të familjes sime dhe i kërkoja të na udhëhiqte për në zonën prej ku do të arratiseshim. Atë natë, ne u larguam fill pasi blemë në treg njëzet metra litar dhe pesë bidonë të zbrazët vaji (për pluskimin). Për të arritur te pika e arratisjes, neve na u desh të kalonim dalëngadalë teposhtë një bregu shkëmbor për tridhjetë li (14.5 kilometra). Më në fund, mbërritëm te pika prej ku do të arratiseshim. Ndërmjetësi im dërgoi një person që të vëzhgonte fshehtas pikën e kontrollit të armikut. Për fat të mirë, ajo ishte bosh. Atëherë unë nuk e njihja Perëndinë, por Ai më ndihmoi gjithsesi. Gjithçka që mund të bëja, ishte ajo që bënin të gjithë koreanoveriorët, kur ishin në hall: t’i ngrija sytë nga qielli dhe të kërkoja ndihmë prej Perëndisë së panjohur.

Në brigjet e lumit Amnok, sajova pesë doreza tek litari, një në çdo dy metra dhe vara një bidon vaji bosh pranë secilës prej dorezave. Kërceva i pari në lumë, i pasuar prej anëtarëve të familjes

sime. Pikërisht përpara se të largoheshim për të shkuar te pika e arratisjes, ndërmjetësi më tha se dje kishin vdekur dhjetë njerëz në lumë. U përpoqa të rrija më këmbë në ujë, por lumi ishte tepër i thellë. Perëndia ishte i mirë duke më udhëhequr drejt Kinës.

Një qen po lehte, kur ne mbërritëm në bregun tjetër të lumit, te toka. E kuptuam që ishim në kopshtin e dikujt, kështu që vrapuam dhe kapërcyem gardhin. Më në fund e pamë ku ishte teli i korrentit. Kjo ishte mënyra sesi do ta dinim në çfarë drejtimi të shkonim për t'u takuar me ndërmjetësit tanë. Vrapuam afro pesëqind metra, dhe unë mbërrita i pari te pika e takimit. Atje, ishin dy ndërmjetës që po na prisnin. Sapo i pashë, më ra të fikët, për shkak se fuqia më kishte lënë krejt. Ata thanë se po planifikonin të largoheshin pas një minute dhe do të ktheheshin mëngjesin tjetër, nëse ne nuk do të ishim paraqitur.

Ne shkuaam në shtëpinë e tyre me makinë, dhe mbërritëm pas gjysmë ore. Atje fola rehat me motrën time në Korenë e Jugut. Pasi i ndërruam rrobat tona të lagura dhe këpucët po ashtu të lagura, ne ndenjëm tri ditë dhe pastaj u larguam për të shkuar në Shenian (Shenyang). Për habi, kudo ku shkonim, na ndiqte pas shiu. Kisha merak, se do të na duhej të kalonim përmes një pike kontrolli te tuneli për në Shenian. Binte shi kaq i madh, sa që dukej sikur dikush po e zbraste ujin me kova njëra pas tjetrës. Si rezultat ajo pikë kontrolli ishte bosh. Sërish, Perëndia na ndihmoi ashtu si herën e kaluar. Ne kaluam të sigurt.

Në Shenian, unë fola prapë në telefon me motrën time dhe atje takuam një vajzë që kishte vënë syze por pa xhama në to. Ishte kulmi i modës, dhe kjo ishte diçka që kurrë nuk do ta imagjinonim në Korenë e Veriut. Ajo na shpuri në katin e dytë të apartamentit me qira, ku ajo jetonte bashkë me dy gra të tjera kineze. Zbulova se ajo për vete ishte një dezertore nga Koreja e Veriut dhe që të treja ato punonin si prostituta në Kinë. Vajza koreanoveriore na lidhi me një ndërmjetës në Pekin (Beijing). Prej saj mora vesh se ai do të vinte ditën tjetër.

Ai erdhi nga ora 11:00 paradite. Më kërkoi paratë, që të bënte karta identiteti false për ne. Ai doli dhe u kthye bashkë me kartat e identitetit false. Mëngjesin tjetër ne u nisëm që të gjithë për në Pekin. U ndamë në dy grupe. Vajza koreanoveriore mori dy fëmijët e mi dhe nipin, kurse burri nga Pekini më mori mua me gruan. Kur mbërritëm të sigurt në Pekin, grupit tonë iu bashkuan tre dezertorë të tjerë, kështu që u bëmë nëntë në total.

Destinacioni ynë tjetër ishte Kunming, në Kinë, ku kishte dymbëdhjetë pika kontrolli. Ne morëm një autobus për të udhëtuar pesëdhjetë orë. Gjatë rrugës morëm dy kuti me mango prej ndërmjetësit, por unë po kaloja një kohë të vështirë për shkak se kisha nevojë të shkoja urgjentisht në banjë. Ishte për t'u habitur që në autobusin tonë nuk hyri asnjë inspektor, dhe ne mbërritëm të sigurt në Kunming. Në hotel, në Kunming, të tre dezertoret femra u caktuan të rrinin në një dhomë dhe familja jonë u caktua të rrinte në dhomën tjetër. Ne fjetëm mirë, dhe madje edhe hëngrëm ushqim në një vend me pamje të mirë, ku përgatishnin ushqim korean.

Një anëtare e grupit tonë ishte një grua koreanoveriore dezertore, që dukej si njëzet e pesë vjeçare. Pas drekës, të dy ndërmjetësit e nxorën jashtë atë, por ajo u kthye me flokët e shpupuritur dhe me sytë që kishin shikim të zbrazët. Isha i sigurt se ajo ishte përdhunuar prej këtyre dy ndërmjetësve që po na udhëhiqnin.

U futëm në një makinë dhe shkuaam përmes një rruge me baltë brenda një fushe me banane. Kaluam më pas te një kamion dhe shkuaam me të përmes një mali në një zonë me moçal të kuq. Kamioni përpiquej të ngjitej lart, por rrëshqiste poshtë prej baltës. Më në fund, ata i vendosën gomat e borës, të cilat e ndihmuan kamionin të kishte fërkim me rrugën dhe vazhduam rrugën gjatë natës. Mendoj se njerëzit që vuajtën më tepër në atë udhëtim ishin dy shoferët e kamionit, ngaqë rruga ishte me baltë prej shiut të vazhdueshëm dhe ndryshimi i gomave doli një punë pa bereqet. Rrotat thjesht rrotulloheshin në vend për pjesën më të madhe të natës.

Më në fund e kaluam kufirin me Laosin dhe mbërritëm te lumi Mekong. Na futën të gjithëve në një varkë që ishte ndërtuar për jo më tepër se gjashtë persona. Meqenëse dija shumë gjëra për anijet, i paralajmërova të gjithë që kishin hipur në varkë të mos lëviznin, por në vend të kësaj, t'i vinin duart mbi bark, te pjesa e stomakut. Pas një ore, ne kaluam tek një anije tridhjetë e një tonëshe dhe lundruam poshtë lumit për gjashtë orë. Me të vërtetë më pëlqeu pjesa tjetër e lumit, kur kishte një pamje madhështore të statujave të shumta të Budës. Më në fund, anijen e tërhoqëm për te bregu i lumit, ku ishin ankoruar dy anijet e tjera. Atje ishte një tregtare kineze. Një nga anëtarët e grupit tonë ishte një grua koreanoveriore, e cila kishte jetuar dikur në Kinë, prandaj ne e nxorëm atë që t'i bënte pyetjet tregtares kineze. Ajo tha se ne ishim ende në Laos dhe do të na duhej të kalonim në anën tjetër të lumit, për në Tajlandë. Pas dy ose tre minutash, ne e kapërcyem lumin Mekong dhe mbërritëm në Tajlandë.

U kujtova për gjërat që më kishte thënë motra se duhej t'i bëja, sapo të mbërrinim në Tajlandë. Neve na duhej ta gjenim vetë policinë Tajlandeze, për shkak se në Tajlandë erdhëm pa ndërmjetës. Ne ecëm pa pushim dhe i pyesnim të gjithë kalimtarët për policinë. E përdornim fjalën në anglisht "police" bashkë me shenjat që mundnim të bënim me duar. Një burrë që po ngiste një motoçikletë na tha që të shkonim në të njëjtin drejtim me atë të tijin. Më në fund, përballë nesh ndaloi një makinë policie. Por polici nuk dukej zyrtar, ngaqë ai ishte me rroba civile. Ai e prezantoi veten si oficer policie dhe unë e pashë revolen të kapur pas rripit të beli të tij, kështu që u binda se ai ishte polic. Ai na shpuri të gjithë në rajonin e policisë dhe prapa tij ishte një shtëpi dykatëshe. Polici tregoi me gisht për tek ajo shtëpia dhe me duar bëri shenjën për të ngrënë dhe për të fjetur. Në katin e dytë gjetëm dezertorë të tjerë koreanoveriorë. E përqaftuam njëri-tjetrin me gëzim dhe qamë së bashku duke menduar për udhëtimin tonë të gjatë dhe të vështirë nga Koreja e Veriut në Tajlandë.

Ne i këmbuem paratë tona kineze në monedhën vendase të Tajlandës, ngaqë na duhej të blinim ca oriz. Atje ishim njëzet veta dhe na thanë se do të na duhej të prisnim, derisa të ishin të pranishëm dyzet dezertorë, përpara se të lëviznim që atje. Ndërkohë që po gatuanim oriz dhe po pushonim për disa ditë, mbërriti një grup tjetër koreanoverior. Ata udhëhiqeshin prej prostitutës koreanoveriore që ne e kishim takuar në Shenian. Ajo na tregoi se grupi që kishte ikur fill pas nesh, ishte kapur gjatë rrugës. Perëndia u kujdes përsëri për të gjithë ne!

Na dërguan në një qendër paraburgimi në Mae Sai. Për fat të mirë, nuk na vunë pranga hekuri, për shkak se ne kishim para të paguanim. Kostoja për gjyqin tonë ishte njëmijë baht, dhe tarifa e transportit për në qendrën e paraburgimit të imigracionit në Bangkok ishte gjithashtu njëmijë baht. Ne qëndruam në Bangkok për njëzet ditë dhe pastaj na dërguan me avion për në Korenë e Jugut. Ne e kishim kaluar lumin Amnok më 9 qershor dhe mbërritëm në aeroportin Ndërkombëtar të Inçën (Incheon) në Korenë e Jugut më 20 korrik.

6. Sprovat, aleatët dhe armiqët

Për sa ka të bëjë me testet, shërbimi i pleqve ishte testi më i madh për mua. Unë madje e zgjodha gruan time bazuar mbi nevojën që kisha për dikë që të më ndihmonte me prindërit e mi me aftësi të kufizuara.

Një test tjetër ishte kur motra ime më e madhe erdhi dhe i tundoj prindërit e mi për t'u larguar prej meje. Po të kishin jetuar mirë, pasi të largoheshin prej meje, unë do të ndihesha më mirë për ta. Në fakt, e vizitova shtëpinë e motrës sime për afro dhjetë herë, që të kërkoja faljen prej prindërve të mi. Por ata nuk më dëgjuan mua e nuk u kthyen për te shtëpia ime. Në vizitën time të fundit, unë madje solla një dokument me vete, të cilin e kisha krijuar, që

tregonte se, po të mos ktheheshin me mua në shtëpi, marrëdhënia jonë do të thyhej përgjithmonë. Ishte qesharake që im atë vendosi vulën mbi atë dokument. Im atë më tha se nuk isha unë personi për të cilin kishin nevojë ata. Në dy ose tre muajt e parë të jetesës me motrën time, ata të gjithë hëngrën mirë duke fituar para prej shitjes së zotërimeve të mia. Por ato nuk zgjatën më tepër se aq: im atë vdiq nga uria brenda gjashtë muajsh.

Edhe pse i kërkova në mënyrë të përsëritur që të më falte, duke i rënë në gjunjë, im atë nuk e ndryshoi mendjen. Kur ai e vulosi dokumentin që kisha përgatitur, unë e grisa dhe i thashë: “Nuk kam baba, dhe nuk do të të shoh më kurrë, edhe pasi të kesh vdekur.” Në Korenë e Veriut, kinezët quheshin “ddeanom,” ose tipa kokëfortë, për shkak të mungesës së fleksibilitetit të tyre. Im atë kishte lindur në Kinë, kështu që ai ishte shumë kokëfortë. Që kur mamaja ime u gjymtua, ajo thjesht ndiqte opinionin e të shoqit pa thënë asnjë fjalë.

Një meritë e tim eti ishte se ai jetoi deri në fund të jetës me gruan e tij me aftësi të kufizuara. Do ta pranoj këtë pikë të mirë që ai kishte. Gruaja ime vuajti shumë që ta ushqente familjen time, prandaj unë nuk u ndava prej saj dhe ne u arratisëm bashkë për në Korenë e Jugut. Në familjen time nuk ka divorce.

Sa për aleatët, aleati im është Perëndia, për shkak se Ai na ndihmoi që të shkonim të sigurt në Korenë e Jugut. Një aleat tjetër është motra ime ngatërrestare, që pagoi paratë për ndërmjetësin që ne të arratiseshim. Ajo, dukej qartë, e bëri këtë për hir të të birit, por prapëseprapë ajo është aleati ynë themelor. Ajo pagoi para tek një ndërmjetës për ne edhe pse tani do të më duhet t’ia kthej mbrapsht ato para.

Armiqtë e mi janë Kim Jong Il dhe Kim Jong Un. Ata janë personat që na bënë të vinim në Korenë e Jugut dhe të cilët na shkaktojnë këtë tragjedi. Të flasim troç, a ka ndonjë njeri që nuk ka dashuri për qytetin e vet të lindjes? Familja e Kim Il Sung-ut është armiku im. Ata i shqyen copash zemrat e familjes sonë.

7. Afrimi për te shpella më e brendshme në thellësi

Shpella ime më e brendshme në thellësi duhet të jetë koha kur nisën të dalin në sipërfaqe gënjeshttrat e mia për motrat e vëllezërit e mi. Kjo ishte sidomos e vërtetë gjatë kohës, kur u mora nën hetim, për shkak se ndërmjetësi ua kishte dhënë emrin tim agjentëve të sigurimit. Po të mos kisha shtuar gënjeshttrat për këtë ndërmjetës, nuk do të kisha qenë në gjendje të dilja i sigurt prej atje. Do të kisha përfunduar në ndonjë kamp përqendrimi bashkë me fëmijët e mi.

Qeveria e Koresë së Veriut zakonisht e detyron gruan të divorcohet prej burrit dhe ta lerë atë e fëmijët që të shkojnë në kampin e përqendrimit. Qeveria u jep grave mundësinë të zgjedhin, por 80 përqind e bashkëshorteve zgjedhin divorcin, që të shmangin vajtjen në kampe përqendrimi për veten e tyre. Pjesa tjetër e bashkëshorteve zgjedhin të shkojnë në kampe bashkë me familjet, për shkak se ato nuk duan të divorcohen.

8. Sprova e rëndë

Kur shërbeja si zyrtar në qendrën e menaxhimit të pyjeve dhe në qendrën e biznesit të peshkimit, unë isha në gjendje t'i merrja e t'i mbaja ato pozicione, ngaqë kisha gënjyer dhe kisha pretenduar se të gjithë vëllezërit e motrat e mia kishin vdekur prej urisë. Por në realitet, unë gjithnjë përballesha me sprovën e të qenit në dijeni se herët ose vonë e vërteta do të dilte sheshit.

Një sprovë tjetër ishte kur u sëmur gruaja ime. Nga shtatori i vitit 2011 deri në marsin e vitit tjetër, ajo vuajti me problemet e tretjes, shpinës, dhe sekrecioneve vaginale. Ajo humbi peshë dhe peshonte tani tridhjetë e pesë kilogramë. Unë e shërova me kurën time.

9. Shpërblimi

Shpërblimi im është se e gjithë familja ime mbërriti e sigurt në Korenë e Jugut.

E vlerësoj vërtet që Koreja e Jugut nuk ka asnjë jetë të detyruar organizative. Në Korenë e Veriut, ne duhej të bënim programe edukative të përditshme të caktuara prej qeverisë, të quajtura “marrëveshja arsimore.” Dhe një herë në javë na duhej të bënim takime për kritikë, të quajtura “marrëveshja për jetën”, ku ne do të kritikonim të tjerët dhe veten. Përditë do të na duhej të bënim njërin nga këto lloj takimesh. Nuk ishte fare një kohë e rehatshme, dhe për mua kjo ishte vërtet e rëndë.

Ajo gjë që e shihja sidomos të rëndë, ishte se kur nuk mundja dot të mendoja për ndonjë gjë për të cilën t’i kritikoja të tjerët ose veten time, më duhej të gënjeja, ose të sajoja disa probleme. Gjithmonë ne duhej të kritikonim veten, përpara se të kritikonim të tjerët. Nëse nuk do ta kritikoja veten time, nuk do të kisha rastin t’i kritikoja të tjerët, dhe sesioni nuk do mbaronte kurrë. Nuk kishte fare përjashtime. Sinqerisht, në rolin tim si zyrtar në Korenë e Veriut, më duhej t’i kritikoja gabimet e të tjerëve të tërë kohën. Për mua kjo ishte e vështirë. Ndonjëherë ndihesha tmerrësisht keq, që më duhej t’i shaja njerëzit, të cilët nuk mund të merrnin pjesë në ndonjë aktivitet, për shkak se nuk kishin mjaftueshëm energji si rezultat i të qenit të kequshqyer.

Njerëzit më pëlqenin shumë dhe ndoshta aftësitë e mia artistike ndihmuan për këtë. Unë i qortoja njerëzit fshehtas, kështu që qortimet e mia ishin si një lloj arti. Ose i bëja që të vinin te shtëpia ime dhe të prisnin ndonjë pemë atje për mua. Dhe pastaj u jepja ndonjë qortim të butë në të njëjtën kohë që u jepja ushqim, kështu që ata kishin ushqim për të ngrënë. Nuk ishte e domosdoshme që unë t’i qortoja njerëzit përpara të tjerëve. Metoda ime duket se është e ngjashme me mënyrën

e Jezusit. Edhe pse nuk dija asnjë gjë për Perëndinë, Ai dukej sikur po më mësonte mua.

Koreja e Jugut është parajsa për mua, kurse Koreja e Veriut është si një burg pa hekura. Edhe sikur të kishe bërë një gabim të vogël, të duhej të vazhdoje me marrëveshjen për jetën, marrëveshjen arsimore ose të shkoje në qendrën e trajnimit për riedukim.

Një arsye tjetër për të cilën e pëlqej Korenë e Jugut është se unë paguhem për aq sa punoj. Këto ditë në Korenë e Veriut, edhe po të punosh për një muaj të tërë, nuk fiton mjaftueshëm para sa të blesh një gjysmë kilogrami misër. Sa herë shkon në punë, në fakt humbet para.

Shëndeti i sime shoqeje është përmirësuar dukshëm, që kur erdhëm në Korenë e Jugut. Puna ime shëruese e mbajti gjallë atë, por prapëseprapë asaj iu desh të shtrohej në spital, sapo mbërriti në Korenë e Jugut. Asaj iu rikthye shëndeti duke ngrënë ushqime të shëndetshme, dhe pesha e saj aktuale tani është gjashtëdhjetë kilogramë. Edhe po të jesh i pasur në Korenë e Veriut, është shumë e vështirë të hash oriz të bardhë. Po të duash të hash oriz të bardhë, ndoshta për ditëlindje ose për një ditë feste, do të të duhet të llogarisësh për sa ditë nuk duhet të hash makarona petka prej misri.

Në Korenë e Jugut tridhjetë vezë kushtojnë pesë dollarë dhe unë mund të ha sa vezë të dua. Kurse në Korenë e Veriut nuk është e mundur që të hash as edhe një vezë të vetme. Prandaj, unë haja oriz me misër, në vend të vezëve. Kur jetoja në shtëpinë e prindërve të gruas sime, një vit ne patëm prodhim të mirë misri. Stomaku im nuk u ngop, edhe pasi hëngra njëzet kallingj të pjekur misri. Kur u martua kunata ime, bashkëshorti i saj solli kekë prej orizi. Pasi i hëngra ata, stomaku im u ndie i ngopur. Unë mund t'i ngrija peshë njëqind kilogramë në Korenë e Veriut, por jo për shkak të energjisë që kisha; kjo ndodhte për shkak të dëshpërimit tim. Koreja e Jugut është e mirë, për shkak se nuk kam më nevojë të shqetësohem se çfarë do të ha.

10. Rruga për kthimin

Të flas sinqerisht, vendi i vetëm ku dua të kthehem është qendra e paraburgimit në Mae Sai, në Tajlandë. Vërtet dua që bota ta dijë për të drejtat e njeriut në Korenë e Veriut. Kur shkoni te qendra e paraburgimit, mund të shihni plot shkrime në muret e qelive, të bëra prej dezertorëve koreanoveriorë. Ata shkruan atje gjithçka që kishin përjetuar. Dua të shkoj atje e ta regjistroj me video dhe pastaj ta përdor atë për t'i raportuar botës. Kjo do ta bënte regjimin në Korenë e Veriut që të rrëzohej më shpejt dhe pastaj të gjithë dezertorët koreanoveriorë mund të ktheheshin nëpër qytetet e tyre të lindjes.

Njerëzit në Korenë e Veriut mendojnë se një slogan themelor i komunizmit është: “Një për të gjithë, të gjithë për një.” Por tani njerëzit në Korenë e Veriut e kanë ndryshuar mendimin e tyre në: “Politika është për mua; unë kam mendimet e mia.” Prandaj, ndonjë ditë Koreja e Veriut do të përmbysset. Qytetarët e Koresë së Veriut flasin për këto gjëra me anëtarët e familjeve të tyre, por jo me dy ose tre veta të mbledhur bashkë. Ata kanë frikë se mos i raportojnë ose i dërgojnë në burg.

11. Ringjallja

Dëgjova se raporti i vdekjeve për shkak të vetëvrasjes mes dezertorëve koreanoveriorë është 16.3 përqind. Me sa mendoj unë, shansi që dikush të bëjë vetëvrasje varet nga personaliteti i individit. Nëse ka personalitet të mirë, ai do ta mposhtë mendimin e vetëvrasjes. Por nëse ka personalitet të keq (për shembull nëse është gjaknxehtë), ka më tepër të ngjarë të bëjë vetëvrasje.

E di se mund t'i mposht vështirësitë dhe vuajtjet e mia, për shkak se nuk dua t'i turpëroj fëmijët e mi, me vetëvrasjen e të atit. Prindërit e mi u përballën me vdekjen pasi më lënduan. Ata madje më thanë në fund: “Nuk kam nevojë as për fëmijën tim.”

12. Rikthimi me eliksirin

Kur të kthehem në Korenë e Veriut, dua të ungjillëzoj duke u bërë një misionar, pasi të diplomohem prej Universitetit të Fshthtë të “Zërit të Martirëve” në Kore. Gjatë udhëtimit për në Korenë e Jugut, unë i ngrita sytë lart drejt qiellit për të kërkuar ndihmë, pa e njohur Perëndinë. Në njëfarë mënyre me ndihmën e Perëndisë, unë erdha në Korenë e Jugut pa u kapur, dhe për këtë jam kaq shumë falënderues.

Kam mësuar shumë gjëra për Perëndinë prej Universitetit të Fshthtë, të cilat nuk i dija më parë. Mësova sesi Perëndia erdhi në botë në formë njerëzore, sesi u krijuan qeniet njerëzore, madje edhe si u formua bota. Mësimet e të gjithë folësve kanë qenë të mira dhe ndonëse mund të mos e kuptoj plotësisht çdo mësim, të paktën i kuptoj 60 përqind të tyre. Në të ardhmen, e di se do t'i kuptoj 100 përqind. Tani jam duke mësuar shumë më tepër prej pastorit tim vendor dhe prej sjelljes së njerëzve në kishë si shoferi zyrtar i autobusit të kishës.



Kur të ndodhë bashkimi, unë do të mbjell dhjetë kisha në Kimcek, një fshat në Detin e Lindjes, ku u lindi dhe u rriti. Arsyja se pse do të jenë dhjetë kisha është se nuk ka shumë koreanoveriorë që arratisen për në Korenë e Jugut dhe për këtë arsye ka vetëm pak dezertorë koreanoveriorë në Korenë e Jugut, të cilët janë nga Kimcek-u. Nëse mbillet një kishë në çdo *ri* (termi në gjuhën e Koresë së Veriut për *fshat*), do të duhet të jenë të paktën dhjetë kisha për ta mbuluar të gjithë zonën atje. Për t'i bërë njerëzit që të vijnë në kishë, do të na duhet të sigurojmë disa punë, por për fat të mirë, ngaqë Kimcek-u ndodhet në Detin e Lindjes, nuk duhet të jetë problem ose nuk duhet të jetë e vështirë për të krijuar shumë punë, përfshirë edhe peshkimin.

Unë isha kryetar i komitetit përgjegjës për përkujdesjen e njerëzve që ishin mbi tridhjetë e pesë vjeç dhe nuk mund të pranoheshin në Partinë Komuniste. Bazuar mbi përvojën që mora në këtë pozitë, besoj se i kam aftësitë për t'i bindur njerëzit të vijnë në kishë. Gjithashtu do të ftoj në kishë njerëzit që dikur më ndiqnin mua.

Koreja e Veriut ka ndërtesa të tilla si Instituti i Studimeve mbi Kim Il Sung-un, ose ndërtesa teatri apo kinemaje, të cilat në të ardhmen mund të bëhen kisha. Teatrot ose kinematë e Koresë së Veriut u Ngjajnë ndërtesave të kishave katolike në Korenë e Jugut. Skena kryesore është e mbuluar me tapiceri dhe atje vendoset projektori i filmit. Secili fshat ka një teatër dhe atje mbledhen afro pesëqind njerëz për secilën shfaqje filmi. Shfaqjet janë performanca propagande për Kim Il Sung-un ose filma për Kim Il Sung-un. Duke mbjellë një kishë në qytetin tim të lindjes, do ta ndaj fjalën e Perëndisë dhe ideologjinë e Tij me popullin koreanoverior, mendja e të cilit është e mbushur me ideologjinë e Juçe-s (Juche, Kim Il Sung-ismin).

Kur po mësoja për natyralizimin tim në qendrën e risistemimit tim në Korenë e Jugut, në Hanauon (Hanawon), besimtarët nga kishat Protestante, Katolike dhe nga Budistët na ftuan dhe na

dhanë vakte të lehta për të ngrënë. E përjetova personalisht secilën fe dhe më në fund zgjodha krishterimin. Vizita në kishë më ndihmoi ta kuptoja se Kim Il Sung-u nuk ishte Perëndia dhe se ne jetonim nën iluzione, për shkak se nuk e kishim njohur Perëndinë. Kur shumë koreanoveriorë vdiqën nga uria në vitet 1990-të, dëgjova se Kim Jon Il-i gjithashtu nuk flinte mirë dhe se ai mund të hante vetëm një top orizi. Megjithatë, në Korenë e Jugut unë zbulova se ai hante ushqimin më të shtrenjtë, që ia sillnin me aeroplan nga gjithë bota. Kur isha në Hanauon, shkova në një kishë katolike katër a pesë herë. Pasi u largova nga Hanauoni, vendosa të shkoja në kishën e krishterë Protestante, në vend të kishës Katolike, për shkak se kisha Protestante na jepte para.

Koreanoveriorët mësojnë në shkolla se misionarët që ndajnë Ungjillin janë njerëz të ashpër. Kjo është gjithashtu ajo që kam mësuar dhe menduar, përpara se të vija në Korenë e Jugut dhe të mësoja në mënyrë korrekte për Perëndinë. Tani mendoj se Perëndia është Ati i të gjithë njerëzve në botë. Kur të bashkohet Koreja e Veriut me atë të Jugut, do t'u tregoj njerëzve në Korenë e Veriut për Perëndinë. Kur e vizitova në Korenë e Jugut Universitetin e Fshtetë të “Zërit të Martirëve” në Kore, pashë një ëndërr sikur po ndaja Ungjillin në Korenë e Veriut.

Dielli në vizatimin tim simbolizon Perëndinë. Në Korenë e Veriut, dielli simbolizon Kim Il Sung-un dhe madje edhe slogani i vendit është “Dielli i Shekullit të Njëzet e Një-të, Kim Il Sung-u!” Gjithashtu vizatimi im përshkruan një të ardhme të shkëlqyer pas bashkimit.

Kapitulli 6.

Znj. Jang: Udhëtimi është një punë tejet e vështirë

*Nuk njoh askënd që ka mbërritur
në krye pa punuar shumë. Kjo është receta.
Nuk do t'ju shpjerë gjithmonë në majë, por do t'ju
shpjerë shumë afër saj.*

—Margaret Theçër (Margaret Thatcher)³⁹

1. Bota e zakonshme

U linda në Korenë e Veriut në vitin 1944. Unë isha më e madhja ndër tre vajza dhe një djalë. Deri në moshën pesë vjeçare, i ndiqja pas gjyshen, mamanë dhe tezen time, kurdoherë që ato shkonin në kishë. Gjyshja ime ishte e krishterë dhe gratë e familjes, përfshirë mamanë dhe tezen time, shkonin bashkë me të në kishë. Unë shkoja në kishën e qytetit tim për të marrë dhurata, si për shembull lapsa,

³⁹ Jena McGregor, "Margaret Thatcher, In Her Own Words," The Washington Post, April 8, 2013, lexuar më 11 Mars, 2014, http://www.washingtonpost.com/business/on-leadership/margaret-thatchers-best-quotes/2013/04/08/97abce78-a07d-11e2-82bc-511538ae90a4_story.html.

fletore dhe karamele. U rrita duke e parë gjyshen time si një model i të krishterit.

Por pas çlirimit të Koresë dhe vendosjes së qeverisë së Kim Il Sung-ut, pastorët ose u arrestuan prej qeverisë së Koresë së Veriut, ose u arratisën për në Korenë e Jugut. Kishat u zhdukën. Që nga ai çast e më tej, ne nuk mund të flisnim më për Perëndinë dhe gjyshja ime nuk m'i tregonte më historitë e Biblës. Por sa herë që pothuajse bëja aksidente, gjyshja do të më thoshte: “Perëndia të ndihmoi.” Gjithashtu, ndonjëherë e shihja mamanë që mërmëriste me vete përjashta dhe pas ca kohësh zbulova se ajo në ato çaste po lutej.

Dukej sikur e tërë familja ime u transferua prej qeverisë për në fabrikën kimike të Aoxhi-t (Aoji), përpara se të lindja unë, për shkak se ne ishim të krishterë. Gjyshja ime jetonte me tim atë (djalin e saj të dytë) dhe me ne, për shkak se xhaxhai im më i madh i shkaktoi qeverisë probleme të rënda. Ai u detyrua të punojë në minierën e qymyrit të Aoxhi-t. Mbaj mend se vetëm gratë e familjes sime shkonin në kishë, kurse xhaxhai im më i madh dhe babai im nuk shkonin.

Im atë ndërroi jetë kur isha tetë vjeç, prandaj mamasë sime i duhej të punonte. Ngaqë ajo ishte e ngarkuar në punë, unë duhej të kujdesesha për vëllain tim dhe për motrat e mia më të vogla. Madje edhe në ceremoninë e hapjes së shkollës sime fillore unë shkova vetëm fare. Duke u rritur isha shumë e vetmuar; megjithatë studioja e dëshpëruar, ngaqë e dija se mamaja ime punonte shumë që të më mbështeste.

U bëra mësuese pasi u diplomova nga kolegji. Mendova se e vetmja gjë që më duhej të bëja ishte të punoja me besnikëri dhe të kisha një jetë normale. Si rezultat i punës sime për arritjen e qëllimeve të mia, u bëra mësuese e shkollës së mesme të ulët, kur isha nëntëmbëdhjetë vjeç. Në moshën njëzet e katër vjeçare u martova me një inxhinier teknik, që dinte gjithçka për elektricitetin dhe bolierët në minierën e qymyrit ku punonte, por

veç këtyre nuk dinte ndonjë gjë tjetër. Prapëseprapë, ai ishte një bashkëshort i mirë. Minierat e qymyrit zakonisht shpërndanin racione ushqimore deri në vitet 1980-të, por sapo mbaroi kjo lloj mbështetjeje, erdhën shqetësimet.

2. Thirrja për aventura

Edhe pse kisha kaluar përmes “Marshimit të Vështirësive” për një kohë të gjatë, nuk e dija sesi do ta mbështesja familjen time. Bashkëshorti im, që kishte qenë jetim, u bë alkoolik dhe pinte në përpjekje për ta harruar vetminë dhe pikëllimin e tij. Unë vuaja nga vështirësitë e jetës, ndërkohë që ai ishte i alkoolizuar dhe kur nuk mundi të pinte dot më, ai nisi të sëmurej dhe vdiq në vitin 2002.

Ndërkohë që po kërkoja një mënyrë sesi të jetoja, mendova se do të jetoja mirë në një shtet tjetër. Prandaj, u largova nga Koreja e Veriut një vit pasi ndërroi jetë im shoq. Në qytetin ku jetoja, kishte shumë njerëz, të afërmit e të cilëve jetonin në Kinë dhe ata thanë: “Edhe ti mundesh të jetosh atje, sepse ti punon.” Doja t’i mbështesja fëmijët e mi, kështu që u nisa për në Kinë. Nuk kisha asnjë njeri që të më ndihmonte ta kapërceja lumin Tumen, prandaj e kalova e vetme atë rreth orës 8:30 të darkës dhe desh u mbyta atje. U mbajta fort deri në pikën e fundit të forcës sime. Një roje kufiri, që po e vëzhgonte lumin nga një tunel i nëndheshëm, nuk më vuri re, ngaqë e kalova lumin pa zhurmë. Por, kur pluskoja teposhtë lumit, iu luta Perëndisë dhe dëgjova një zë të thoshte: “Ec drejt, por shko lart dhe ec ngadalë, hap pas hapi!” Zëri erdhi nga një mal, nga ana e kundërt e lumit, si një jehonë. Do të thoshte se rrjedhat e sipërme të lumit ishin të cekëta. Teksa e ndoqa zërin, shkova lart dhe eca hap pas hapi dhe më në fund e kapërceva lumin. Mbërrita në Kinë e sigurt. Kur kthej kokën pas tani, jam e sigurt se dëgjova zërin e Zotit. Shkrimi: “Do të të

mbaj me dorën e djathtë të drejtësisë sime” (Isaia 41:10) u bë i vërtetë në jetën time.

Kur u largova për herë të parë nga Koreja e Veriut, djali im i madh ishte burgosur në një kamp pune. Nuk e dija nëse ai ishte i gjallë apo kishte vdekur. Ai u dërgua në kampin e punës, për shkak se ndihmoi një familje të ndjerë të dikujt, që ishte kapur nga ushtria e Koresë së Veriut gjatë luftës së Koreve. Nuk dëgjova asnjë gjë për të. Besoj se Perëndia më bëri mua guximtare dhe më ndihmoi t’i mposhtja vështirësitë dhe ta vija në rrezik jetën time për të shkuar në Kinë, duke i lënë dy djemtë e mi të tjerë dhe dy vajzat e mia në Korenë e Veriut.

Pasi mbërrita në Kinë, shtëpia e parë që vizitova i përkiste një dhjakeje të kishës. E pashë dhjaken të predikonte e të lutej dhe ta lavdëronte Zotin bashkë me të krishterët e tjerë të premtëve gjatë mbledhjeve të grupit qelizë në shtëpi. Pas kësaj, ajo më ftoi të bashkohesha me ta në shërbesën e së dielës për të adhuruar. Gjithashtu nisa të shkoja në studim Bible në shtëpinë e një vëllai e motre atje. Shpejt nisa të shkoja në kishë çdo të dielë me atë dhjaken. U pagëzova dhe rrëfeva besimin tim atje. U bëra një fëmijë i Perëndisë.

Në rrugën time për të shkuar në Korenë e Jugut, u dërgova mbrapsht në Korenë e Veriut tri herë. Njëherë, kur më kthyen mbrapsht në Korenë e Veriut, agjentët e sigurimit më torturuan dhe më rrahën. Një agjent siguri dyshoi se po përpiqesha ta shisja vajzën time, kështu që ai më solli për seancën e marrjes në pyetje tri herë dhe më rrahu pa mëshirë; gjithsesi mua më rrahën më pak se njerëzit e tjerë kur më kthyen sërish në Korenë e Veriut herët e tjera. Për shkak se jo shumë njerëz nga qyteti im i lindjes kapeshin, agjenti i sigurimit nuk mundi dot të nxirrte ndonjë informacion prej meje. Identiteti im nuk u zbulua. Në kampin e përqendrimit, një grua plakë që u kap në Kinë, u mor në pyetje ngaqë asaj i gjetën një Bibël, kur ishte në burg; megjithatë, më në fund atë e liruan, për shkak se ishte mbi tetëdhjetë vjeçare.

Në përpjekjen time të tretë për t'u arratisur prej Koresë së Veriut, një dezertor koreanoverior më prezantoi me një ndërmjetës, i cili do të më ndihmonte të mbërrija në Korenë e Jugut dhe kësaj radhe pata sukses. Ndenja në një ndërtesë në katin e tretë dhe kur atje u mbloodhën tetë koreanoveriorë, u larguam për të shkuar në Jug. Nënshkrova një kontratë se do të paguaja katër milionë uon (afro katër mijë dollarë), kur të mbërrija në Korenë e Jugut, por unë nuk kisha fare para. Morëm dy autobusë të ndryshëm dhe një tren dhe gjithashtu ecëm. Ne u larguam nga Kina më 4 shkurt dhe mbërritëm në Tajlandë në fund të shkurtit. Gjatë rrugës sonë për në Tajlandë, tetë veta, duke më përfshirë edhe mua, morën një varkë për gjashtë pasagjerë dhe pothuajse u mbytëm në të; megjithatë, këto lloj vështirësish nuk arritën dot të ma merrnin jetën. E riparuam varkën dhe mbërritëm në Tajlandë pas tetë orësh, vetëm dy orë më tepër se koha e zakonshme. Më në fund, mbërrita në Korenë e Jugut më 5 prill dhe duhej të kaloja përmes procesit të shqyrtimit prej Shërbimit Kombëtar të Inteligjencës dhe qendrës së risistemimit të refugjatëve në Hanauon (Hanawon). Më 26 qershor, ishte dita kur hodha hapin tim të parë drejt shoqërisë së Koresë së Jugut.

Vetëm vajza ime më e madhe mbërriti në Korenë e Jugut dhe jeton këtu. Nuk e di, nëse djali im më i madh është ende i gjallë në kampin e përqendrimit. Tre fëmijët e mi të tjerë janë ende duke jetuar në Korenë e Veriut.

3. Refuzimi i thirrjes

Kur isha ende në Korenë e Veriut, besoja se njerëzit jashtë Koresë së Veriut mund të merrnin gjithçka që donin, nëse punonin shumë për t'i arritur qëllimet e tyre. Por unë nuk pranova të largohesha nga Koreja e Veriut, ngaqë shqetësohesha se mos më

kapnin dhe mendova se kjo gjë do t'i sillte rezultate të këqija familjes sime. Në fund, gjithsesi, u arratisa nga Koreja e Veriut për në Kinë.

Shkoja në kishë me gjyshen dhe me mamane time kur isha fëmijë, dhe kurdoherë që ndodhte diçka e keqe, ato thoshin: “Perëndia të ndihmoi, kur ishe në siklet.” Besoj se vendosa të arratisesha nga Koreja e Veriut pa frikë, ngaqë e dija se Perëndia po më ndihmonte. Dezertorët e tjerë koreanoveriorë merrnin ndihmë prej ndërmjetësve, kurse unë isha e vetme për shumicën e përpjekjeve të mia për arratisje. Nuk ishte askush që mund të më ndihmonte, përveç Perëndisë. E kuptova se ato përvoja të vështira ishin prova prej Perëndisë. Jam e sigurt se gjyshja ime ishte duke u lutur, që Perëndia të më ndihmonte.

Kur mbërrita në fillim fare në Kinë, isha pesëdhjetë e pesë vjeç, do me thënë se nuk isha aq e vjetër dhe akoma mund të punoja shumë fort. Ndihoja me bujqësinë, kujdesesha për rritjen e misrit, mësoja nxënësit, bëja tulla dhe kështu me radhë. Bëra gjithçka që munda. Megjithatë, një ditë, një koreanoverior e rrahu një kinez dhe për këtë arsye që të gjithë koreanoveriorët u mblodhën nga fshati dhe u dërguan mbrapsht në Korenë e Veriut, përfshirë edhe mua.

4. Takimi i mentorit

Dhjakja koreanoveriore ishte mentorja ime e madhe dhe ndihmuesja ime. Shkova në shtëpinë e saj për herë të parë, pasi kalova lumin. Shkova në shërbesa adhurimi dhe takime të grupit qelizë bashkë me të. Teksa këndoja këngët e adhurimit, lutesha dhe dëgjoja shërbesat, erdha në besimin tim te Krishti. Ajo më ndihmoi të rritesha shpirtërisht. Frika m'u zhduk, kur mësova dhe lexova Biblën dhe më në fund mbërrita në Korenë e Jugut duke u lutur.

5. Kalimi i pragut të parë

Unë nuk kisha bërë regjistrimin në Kinë dhe nuk kisha asnjë mjet identifikimi kinez, prandaj më kapnin shpesh ata të sigurimit kombëtar kinez dhe më dërgonin mbrapsht në Korenë e Veriut, pasi më mbanin pak ditë në një shtëpi paraburgimi në Kinë; gjithsesi, unë gjithnjë përpiqesha të kthehesha në Kinë për ta kaluar pragun sërish. Edhe pse kapesha sërish prej sigurimit kombëtar kinez, unë vazhdoja si fëmijë i Perëndisë, e cila e njeh Fjalën e Perëndisë dhe është pagëzuar. Sa herë që më burgosnin, unë lutesha për lirinë tim nga burgu.

Kur po qëndroja në Kinë, isha gjithë kohën tejet e kujdesshme dhe kërkoja një vend për t'u fshehur, kurdoherë që dëgjoja zhurmën e ndonjë automjeti. Gjithmonë shqetësohesha se mos më kapte policia kineze. Kur vinte policia kineze, unë fshiheha në një vazo të madhe lulesh, në ndonjë dollap, ose ikja me vrap nëpër male. Kurrë nuk pata qetësi në shpirt. Kishat kineze nuk ishin më vende të sigurt për të qëndruar, për shkak se policia kineze i inspektonte këto kisha, duke shpresuar të gjente atje njerëz nga Koreja e Veriut.

Vendosa të shkoja në Korenë e Jugut, për shkak se kisha jetuar tërë ankth në Kinë. Jeta ime pa mjet identifikimi kinez nuk kishte qëndrueshmëri dhe kisha dëgjuar se mund të merrja dokumentet e identifikimit në Korenë e Jugut si rezultat i moshës sime. Përveç kësaj, Koreja është atdheu im. Po prisja që të mos kishte nevojë të më kthenin mbrapsht përsëri në Korenë e Veriut. U luta dhe i thirra Perëndisë që të më dërgonte ndihmën e Tij, duke kujtuar një pasazh në Bibël që thoshte: “Kërkoni dhe do t’ju jepet; kërkoni dhe do të gjeni; trokisni dhe dera do t’ju hapet” (Mateu 7:7). Unë kërkoja lirinë për të besuar lirshëm Perëndinë në Korenë e Jugut dhe që Perëndia ta hapte rrugën për në Korenë e Jugut. Në veçanti, kërkoja të takohesha me një ndihmues, që mund të më drejtonte dhe udhëhiqte për në

Korenë e Jugut, ngaqë nuk kisha asnjë person që mund të më udhëzonte në atë çast. Prita që të mund të kisha besim të fortë pasi mbërrita në Korenë e Jugut, një vend i bazuar mbi lirinë. Shkova në Pekin, dhe takova një ndërmjetës i cili mundi të më drejtonte për në Korenë e Jugut. Në atë çast unë nuk kisha fare para, por nënshkrova një kontratë ku premtova se do t'i jepja atij katër milionë uon (afro katër mijë dollarë), kur të mbërrija në Jug. U prezantova me të përmes një dezertori nga Koreja e Veriut, që erdhi në Jug nëpërmjet Kinës. Ai erdhi në Pekin prej Koresë së Jugut që të më ndihmonte. Perëndia e dërgoi atë tek unë si përgjigje ndaj një lutjeje.

6. Sprovat, aleatët dhe armiqët

Një nga provat në jetën time ishte kur u bëra mësuese për herë të parë. Nuk kisha rroba të përshtatshme për dimrin. Nuk kisha as batanije ose rroba shtesë, ngaqë mamaja ime e ve nuk mundej dot të më mbështeste. Një ditë ra zjarri dhe unë e shuahta atë me ujë, por u qulla kokë e këmbë. Duke mos pasur rroba të tjera me të cilat të ndërrohesha, më ngrinë duart, këmbët dhe hunda.

Durova edhe prova të tjera gjithashtu, duke përfshirë rritjen e pesë fëmijëve, kapërcimin e lumit Tumen ku pothuajse u mbyta dhe arratisjen prej agjentëve të sigurimit kombëtar kinez.

Aktualisht, mund t'i mposht të gjitha vështirësitë që do të kem në Korenë e Jugut. Kështu që nuk mendoj se ato vështirësi janë prova për mua. Unë nuk kam asnjë vështirësi financiare dhe nuk jam e vetmuar. Thjesht më merr malli për familjen time në Veri. Vajza ime më e madhe, që erdhi në Korenë e Jugut, po punon për një sallon masazhesh, por ajo nuk ka asnjë ditë pushim atje. Kur më merr malli për të, i shkoj për vizitë te vendi i punës.

Unë kam shumë aleatë të paharrueshëm. Dhjakja që më lejoi të rrija në shtëpinë e saj, kur isha në Kinë për herë të parë; një i huaj që më ndihmoi të arratisesha sërish për në Kinë, pasi më kthyen në Korenë e Veriut për herë të dytë; një çiklist i cili gënjeu qëllimisht garnizonin e kufirit për mua. Që të gjithë këta ishin aleatët e mi.

Një burrë i ri në moshë nga Koreja e Veriut, që jetonte në të njëjtin qytet në Kinë, ku isha edhe unë ishte armiku im. Ai u kap prej sigurimit kombëtar kinez, për shkak se rrahu një kinez. Me sa dukej, atij i thanë policët se, po t'u jepte atyre informacion mbi refugjatët e tjerë koreanoveriorë, atë do ta lironin. Ai deshi të shpëtonte veten, në vend që të na mbronte ne. Dëgjova se atë e dërguan në një kamp përqendrimi në Korenë e Veriut. Unë nuk e urrej më atë. Për shkak se Pastori Folei më mësoi t'i dua armiqtë e mi përmes Universitetit të Fshtetë të "Zërit të Martirëve" në Kore, tani kam keqardhje për të.

Pikërisht kur sapo u stabilizova në shtëpinë e siguruar prej mbështetjes së qeverisë në Korenë e Jugut, anëtarët e kishës M më vizitonin vazhdimisht për ta përhapur fenë e tyre. Në atë kohë nuk e dija se kisha M ishte një kult, kështu që shkova atje për dy vjet në të njëjtën kohë që po shkoja edhe te një kishë e shëndetshme koreane. Pastorja e kishës M nuk e dinte se isha nga Koreja e Veriut, por ajo e dinte se sapo kisha hyrë tek apartamenti. Në të njëjtën kohë, shtëpinë time e vizitonin edhe kishat e tjera.

Sipas përvojës sime, anëtarët e kishës M aktualisht e vendosin pastorin e tyre kryesor përmbi Perëndinë. Dhe pastori tha se ai i kuronte të sëmurët. Mua nuk më pëlqeu që ata e vendosnin besimin e tyre te pastori në vend ta vendosnin te Perëndia. Për këtë arsye, vendosa që të mos shkoja më te kisha M. Kur sapo ndalova së shkuari te kisha M, pastori që më solli në kishë vazhdonte të më merrte në telefon dhe të vinte për vizitë; gjithsesi unë nuk shkova ngaqë pata një argument të ashpër me ta në përpyekjen time për t'u shkëputur prej tyre.

7. Afrimi për te shpella më e brendshme në thellësi

Arsyet e mia për t'u përpjekur për të dalë nga burgu në Kinë lidheshin me dëshirën time për të mbërritur në Korenë e Jugut dhe me besimin tim të krishterë. Në atë kohë nuk kisha fare frikë, për shkak se tashmë kisha besim në Perëndinë dhe kisha guximin që Perëndia do të më ndihmonte të dilja prej atje. Unë vazhdova t'i lutesha Perëndisë, duke i kërkuar atij një sharrë. U luta bashkë me pesë shoqet e tjera të qelisë duke përdorur pasazhin nga Bibla që e përmenda më parë: “Kërkoni dhe do t’ju jepet; kërkoni dhe do të gjeni; trokisni dhe dera do t’ju hapet” (Mateu 7:7).

Pak ditë më vonë, një palë atlete zbritën nga tavani me disa tehe sharre të fshehura brenda tyre. Ka një histori prapa kësaj: një ditë, një gardiane burgu më dha një palë këpucë me taka të larta. Mendoj se asaj i erdhi keq për mua. Thjesht i lashë ato këpucët te koka e krevatit, pa i veshur. Pastaj afro dy ditë më vonë, ia dhashë ato këpucët dhe ca para një gruaje që u lirua nga burgu. I thashë asaj të më gjente një sharrë dhe ta fshihte atë në një palë atlete. I thashë se edhe atletet e veshura tej mase do të bënin punë. Nuk isha e sigurt, nëse ajo do të ma vinte veshin e do të m'i gjente gjërat që ia kisha kërkuar.

Pak ditë më vonë, ajo u lirua nga burgu, dhe futi katër tehe sharre në një gazetë, e futi rrotullën e letrës në një palë atlete, pastaj i futi atletet përmes tavanit. Tehet ishin me përmasa sa gishti i madh i dorës. Unë dhe katër shoqet e mia të burgut nisëm të sharronim me radhë. E linim të rridhte uji i rubinetit, që ta mbulonim zhurmën kur ishim duke sharruar. Na u desh një ditë e tërë t'i sharronim shufrat e hekurit. Pastaj i përdorëm shufrat e hekurit për të gërmuar një vrimë. Na mori një natë kjo punë. Atë natë, nga ora 3:00 e mëngjesit, i lashë të tjerat të dilnin dhe pastaj dola edhe unë. Ato ishin shumë më të reja nga unë, prandaj

ua dhashë rastin që të arratiseshin të parat. Unë u arratisa për në Pekin, duke kaluar përmes Xhillin-it (Jilin). Ishte arratisja e parë nga burgu prej të burgosurave femra, që nga çlirimi prej Japonisë më 15 gusht 1945. Zyrtarët e burgut u pushuan nga puna dhe arratisja jonë e suksesshme nga burgu e hodhi tërë Kinën në një pështjellim të plotë.

Unë nuk do të isha arratisur dhe thjesht do të kisha mbetur e trembur në burg, nëse nuk do ta kisha njohur Perëndinë. Isha në gjendje të kisha guximin dhe një qëndrim të fortë “po mundem” teksa studioja Biblën. Ishte mendja ime e fortë që më solli në Korenë e Jugut, me guxim, duke kaluar prova të vështira. Edhe pse të burgosurat e tjera më të reja thanë se ishte e pamundur, unë vendosa të arratisesha nga burgu dhe i binda ato që të përgatiteshin të arratiseshin me mua. Dhe më në fund ne ia dolëm mbanë me sukses, falë ndihmës së Perëndisë.

Isaia 41:10 dhe 43:3 thonë: “Pra, mos ki frikë sepse Unë jam me ty; mos u trondit, sepse Unë jam Perëndia yt. Unë do të të ndihmoj dhe do të të forcoj; do të të mbaj lart me të djathtën e drejtësisë sime” dhe “Sepse Unë jam ZOTI, Perëndia yt, i Shenjti i Izraelit, Shpëtimtari juaj; Unë e jap Egjiptin si shpërblesë për ty, jap Kushin dhe Sebën në vendin tënd.”

8. Sprova e rëndë

Unë nuk kam vështirësi financiare në Korenë e Jugut; megjithatë, jam disi e shqetësuar për shëndetin tim, sepse tani që po plakem vuaj nga artriti në gjunjët dhe në shpinë. Por besoj se me durim mundem t'i mposht provat emocionale me fuqinë e lutjes. Gjithashtu mund ta mposht vetminë, kur mbështetem te Perëndia dhe praktikimi i Fjalës së Perëndisë: “Gëzohuni gjithmonë; lutuni vazhdimisht; falënderoni në të gjitha rrethanat” (1 Thesalonikasve 5:16-18).

Një sprovë për të cilën mendoj është ajo, kur shkoja te kisha heretike. Atje, anëtarët e atij kultit bënë sherr me mua, dhe si rezultat mora më tepër hidhërim në jetën time. M'u deshën dy vjet, pasi nisa të shkoja tek ata, për ta kuptuar se ata besonin në një Perëndi të ndryshëm nga ai, të cilin tani kisha nisur ta njihja vetë.

Gjithashtu malli për fëmijët që i lashë në Korenë e Veriut më ndjek pas si fantazmë. Gjithmonë jam duke menduar për vështirësitë me të cilat ndoshta janë duke u përballur ata. Në Veri kam vajzën time më të vogël dhe dy djemtë më të vegjël. Ata mund të mos e dinë se vajza ime më e madhe dhe unë kemi ardhur të sigurt në Jug. Në Korenë e Veriut krimet më të mëdha janë të besosh te Perëndia, të mbash komunikim me njerëzit në Korenë e Jugut dhe të bësh trafikim të qenieve njerëzore. Për këtë arsye, unë nuk përpiqem të kontaktoj me fëmijët e mi atje. Po të merrej vesh se unë kisha mbërritur në Jug, kjo gjë do t'u sillte disavantazhe atyre.

Normalisht ndihem mirë kur shkoj në kishë, kur adhuroj dhe kur mendoj për Perëndinë. Por, kur jam vetëm në shtëpi, më merr malli për familjen time dhe të afërmit. Dita më e vetmuar ishte 26 qershori i vitit 2008, kur hyra në apartamentin tim në Korenë e Jugut. Nuk kisha asnjë njeri rreth vetes, me përjashtim të një dhome të zbrazët. U ndjeva kaq shumë e vetmuar. Por, afro tridhjetë minuta më vonë, një kishë e Koresë së Jugut mbërriti me një komplet batanijesh, një sobë gazi dhe një pajisje elektrike për gatimin e orizit. U përloja, duke menduar sesi Perëndia m'i plotësoi nevojat e domosdoshme, kur isha aq e vetmuar.

Pak më vonë, ndërmjetësi që më ndihmoi në Pekin, më erdhi për vizitë dhe më kërkoi ato 4 milionë që ia kisha premtuar atij; por unë kisha vetëm 3 milionë uon të regjistruar në librezën e bankës, që të gjitha ato më ishin dhënë, kur u largova nga qendra e ristabilizimit në Hanauon. I thashë, se ai mund t'i merrte të tre milionët uon, nëse do të më premtonte që të mos më vinte më për vizitë, por nëse planifikonte të kthehej, ai mund të merrte vetëm

2 milionë. Ndërmjetësi mori 3 milionë. Atë pasdite Kryqi i Kuq më dërgoi ushqim, duke përfshirë oriz, salcë specash të kuq, salcë soje, dhe pastë soje së bashku me serviset e tavolinës. Edhe gazi u lidh. E nisa jetën në Korenë e Jugut me asgjë. Ia përkushtova veten kësaj jete me vullnet të fortë.

9. Shpërblimi

Kurdoherë që kam qenë e sëmure dhe e vetmuar, më kanë ardhur për të më ngushëlluar miqtë nga kisha. Ngaqë e kam lexuar singërisht Biblën dhe e kam adhuruar Perëndinë me entuziazëm, jam emëruar dhjake në Kishën e Dong Munit (Dong Moon Church). Vëllezërit dhe motrat në këtë kishë kujdesen për secilin aspekt të jetës sime, duke më mbështetur për domosdoshmëritë e përditshme, përfshirë dhënien e garniturave për vaktet dhe sigurimin e batanijeve.

Zoti më thirri për të studiuar te shkolla e trajnimit të misionarëve të Universitetit të Fshehtë të “Zërit të Martirëve” në Kore dhe në shkollën e dishepullimit në Teknologjinë e Fshehtë (TF), që të bëhem një e krishterë më e mirë.

Në fillim nuk e kuptova rëndësinë e Shkollës së TF, por tani e kuptoj sesa të rëndësishme janë studimet e çmuara të Biblës në atë shkollë. Mësova pjesë të Shkrimit të Shenjtë, që i zbatoj në jetën time të përditshme. Për shembull, e kuptova se cilat ishin zakonet e mia të këqija, dhe vendosa të vazhdoja të kujdesesha për veten me pjesët e Shkrimit që kisha mësuar.

10. Rruga për kthimin

Kam kaluar përmes të gjitha vështirësive dhe tani jetoj një jetë madhështore; megjithatë, kurrë nuk e harroj Korenë e Veriut. Kur

të ndodhë bashkimi, jam duke përgatitur diçka për ta sjellë në Korenë e Veriut. Kam vendosur të sjell Ungjillin dhe ta përhap atë te jo të krishterët atje. Sidoqoftë, e di se do të përballem me vështirësi.

Do ta përfundoj shkollën e UF dhe do të nisem në një udhëtim misioni me UF për t'u përgatitur për ditën kur do ta predikoj Ungjillin në Korenë e Veriut. Jam duke u përpjekur t'i mësoj Shkrimet e Shenjta, t'i studioj dhe t'i praktikoj ato thellësisht. Pres që Koreja e Veriut të jetë e paorganizuar; megjithatë, të paktën do t'u mësoj Biblën mbrëmjeve familjes sime dhe të afërmeve në Korenë e Veriut. Së pari, do ta ndaj me ta hirin e Perëndisë dhe do t'u mësoj atyre Biblën, që të mund t'u tregoj atyre sesi ta përmirësojnë jetën e tyre përmes Fjalës së Perëndisë.


11. Ringjallja

Pres që të has vështirësi, kur ta predikoj Ungjillin në qytetin tim të lindjes në Korenë e Veriut. Padyshim do të ketë një grup njerëzish, të cilët do ta kundërshtojnë krishterimin dhe kishën. Ka të krishterë të fshehtë në Korenë e Veriut, për shkak se njerëzit nuk kanë lirinë e besimit fetar në Veri. Do t'i kontaktoj kishat e fshehta në Korenë e Veriut pas bashkimit dhe do t'u mësoj atyre fshehtas, duke fshehur veten. Do të vazhdoj të lutem për veten time, që të mund t'i mposht të gjitha llojet e mundimeve në të ardhmen me Fjalën e Perëndisë në zemrën time.

12. Rikthimi me eliksirin

Asnjë mjekim tokësor nuk mundet dot t'i shërojë njerëzit plotësisht. Perëndia është mjekimi më i mirë. Kur e ndjekim fjalën e Perëndisë dhe lutemi, kjo gjë është eliksiri.

Kur të bashkohet Koreja, unë do t'u predikoj Ungjillin familjes sime, të afërmve dhe miqve të mi në Korenë e Veriut me gjuhën e vjetër, që ta kuptojnë lehtë. Gjithashtu do të ndaj dëshminë time. Dhe do të ngre një kishë për ata që do ta dëgjojnë Ungjillin prej meje.



Jeta ime nuk ka qenë e lehtë. Por, kurdoherë që ka ardhur mundimi, unë jam lutur sipas Fjalës së Perëndisë. Perëndia i ka mbajtur të gjitha premtimet e Tij. Kur e kapërceva lumin Mekong për të dalë nga Kina, i kujtova dhe u mbështeta në fjalët e vargjeve të Isaia 41:10 dhe 43:3. Perëndia i mbajti me sinqeritet premtimet e Tij, pikërisht ashtu siç tha Ai se do të bënte në Bibël. Unë do t'u tregoj koreanoveriorëve për këtë, që ata të kenë të njëjtën përvojë me mua.

Do ta ndaj dëshminë time edhe me koreanojugorët. Kur u stabilizova në Korenë e Jugut, unë i humba të gjithë dhëmbët. Më referuan te një klinikë dentare falas për dezertorët nga Koreja e

Veriut, e cila drejtohej prej një kishe në Korenë e Jugut. Klinika dentare ishte në Jenxhi-don (Yangjae-dong), në Seul; gjithsesi unë nuk dija sesi të shkoja atje, ngaqë asnjëherë nuk e kisha marrë metronë ose autobusin dhe as nuk e dija se ku binte Jenxhi-don. Kështu që u luta që Perëndia të më udhëhiqte rrugës për te klinika dentare. Ditën tjetër mora një autobus me udhëzimin e një burri të ri në moshë. Fill pasi zbrita nga autobusi, gjeta njerëz që po tregonin me anë të tabelave rrugën për te kisha. Më në fund mbërrita te klinika dentare, pa humbur rrugën. Gjithashtu, nuk supozohej se do të isha në gjendje të merrja trajtimin atë ditë, për shkak të njerëzve të shumtë në listën e pritjes; megjithatë, kur u tregova atyre se prej sa larg kisha shkuar atje, ata më trajtuan brenda ditës. Kjo nuk do të kishte ndodhur pa udhëzimin nga Perëndia.

Kam pasur shumë vështirësi. Pothuajse vdiqa katër herë. Kurdoherë që pata vështirësi, u luta me detaje dhe Perëndia më dha përgjigje specifike. Nuk ishte kurrë një rastësi mënyra sesi dilja prej mundimit. Gjithçka ishte e përgatitur prej Perëndisë. Përmes këtyre përvojave, kam arritur të kuptoj se vullneti i Perëndisë me siguri do të bëhet. Këtë gjë do t'ua tregoj koreanoveriorëve, kur të kthehem atje.

Kapitulli 7.

Znj. Jun: Udhëtimi me patate mbi shpinën e saj

Pa dhimbje, nuk ka fitim.

— Benjamin Franklin (Benjamin Franklin)⁴⁰

1. Bota e zakonshme

U lindi në Kinë, në vitin 1944. Gjyshi im ishte një bujk që kishte marrë tokën me qira. Edhe pse nuk ishte i pasur, ai e dërgoi djalin e tij të parëlindur (babain tim) në Japoni për të studiuar, për shkak të dëshirës së tij që ta bënte të suksesshëm të paktën fëmijën e tij më të madh. Im atë ishte më i madhi ndër dy vëllezër dhe katër motra. Aftësitë e tij për të folur japonishten dhe anglishten ishin të mira, për shkak të arsimit që mori në Japoni dhe aftësitë e tij për gjuhën kineze ishin gjithashtu të mira, ngaqë ai u rrit në Kinë. Si rezultat, ai u bë një anëtar i inteligjencës, ngaqë fliste katër gjuhë. Të gjitha paratë që fitonte familja e tij shkuan për të financuar arsimimin e tij.

Mamaja ime ishte më e madhja ndër katër fëmijë. Prindërit e mi u martuan me mblesëri. Pasi Koreja fitoi pavarësinë, im atë u përpoq të shkonte në Korenë e Veriut për të ndihmuar në rindërtimin e kombit me zemër të pastër. Më në fund prindërit e mi patën në total dy djem dhe katër vajza, por në atë kohë ata kishin

⁴⁰ Bill Lamond, *Born to Lead* (New York NY: Penguin Books, 2006), 93.

vetëm dy djemtë dhe mua, kështu që na sollën ne në Korenë e Veriut. Për shkak se Koreja e Veriut bënte dallim sipas prejardhjes së njerëzve, dhe ngaqë qeveria ishte dyshuese ndaj njerëzve me arsim të lartë, studimet e tim eti në Japoni, do të kishin marrë shumë vëmendje, nëse hetuesit do ta kishin marrë vesh atë gjë. Të huajt që hynin në Korenë e Veriut hetoheshin që të gjithë. Për shkak të frikës së tij se mos arsimi që kishte do t'i shkaktonte probleme me klasifikimin e tij shoqëror, ai gënjeu para hetuesve dhe tha se ai u diplomua vetëm prej shkollës së mesme. Ai nuk u tregoi atyre për arsimin që mori në Japoni.

Nga viti 1953, ai po punonte për Komisariatit e Popullit në Horiong-jup (Hoeryong-yoop). Vitin tjetër, ai e kaloi testin për të gjetur një punë në lidhje me industrinë e filmit në Pjongiang, por ky plan u prish për shkak të luftës së Koreve. Pjongiang u bë një fushë beteje, kështu që nuk ishte një vend i mirë për të jetuar në atë kohë. Për këtë arsye, im atë vendosi se ne duhej të lëviznim për në Uonsan (Wonsan), ku bënte më ngrohtë dhe ku standardet e jetesës ishin më të larta. Ai mori në total dhjetë anëtarë të familjes, përfshirë edhe prindërit e tij, dy motrat e veta dhe krejt familjen tonë. Unë isha njëmbëdhjetë vjeç. Tregu në Uonsan kishte ushqime me bollëk, duke përfshirë peshk dhe patate të ëmbla, prandaj ai ishte qyteti i përsosur për të jetuar. E gjithë familja jonë jetonte mirë duke qenë të gjithë bashkë me ngrohtësi dhe paqe.

Kur mamaja ime ishte gati për të lindur në atë kohë, ajo shkoi të lindte në Kinë. Unë shkova me të në shtëpinë e gjyshes nga mamaja, e cila ndodhej afër lumit Tumen, në Horiong, Kinë. Ngaqë familja e mamasë sime jetonte në Kinë, ne shkonim shumë atje.

Megjithatë, pasi u shpërngulëm për në Cunpjong (Chŏngpyŏng), te Hemgiong-u Jugor (Hamgyong), në Korenë e Veriut, ne nuk e vizituam Kinën për një kohë të gjatë. Prandaj, në vitin 1961, kur unë isha nëntëmbëdhjetë vjeç, unë dhe ime më shkuaam për vizitë tek daja im në Kinë. Në atë kohë, siguria përreth zonës

së lumit Tumen nuk ishte aq e lartë, prandaj njerëzit mund të shkonin e të vinin.

2. Thirrja për aventura

Edhe pse ekonomia kineze nuk ishte e mirë në vitet 1960-të, Kina kishte shumë gjëra për të ngrënë, shumë më tepër sesa Koreja e Veriut. Si rezultat, unë nuk doja të kthehesha më në Korenë e Veriut, pasi i shkuam për vizitë dajës. Në fakt, gjyshërit e mi nga mamaja, donin që të hynin mbles për martesën time dhe unë doja të martohesha në Kinë e të stabilizohesha atje përgjithmonë, kështu që kjo ishte edhe dëshira ime. Por sigurimi kinez ishte shtrënguar shumë, dhe ëndrra ime për martesë në Kinë nuk u realizua kurrë. Kudo ku shkoja më kontrollonin, kështu që më në fund u ktheva mbrapsht në Korenë e Veriut.

3. Refuzimi i thirrjes

Kur u ktheva në Korenë e Veriut, fillova një punë. Por më pushuan nga puna, sapo qeveria e Koresë së Veriut zbuloi për kohën time në Kinë.

Kisha dëshirë të madhe për të studiuar, prandaj shkova në një shkollë teknike dhe mësova mjeshtëri për në kuzhinë. Pas diplomimit, u bëra receptioniste në një hotel. Atje u prezantova me burrin tim të ardhshëm dhe u martova me të kur isha njëzet e katër vjeç.

Ai ishte ushtar, jo oficer ushtarak, por një ushtar në fillimet e shërbimit publik ushtarak, që do të thoshte se edhe pasi ta kishte përfunduar shërbimin e tij të detyrueshëm ushtarak, ai do të vazhdonte të shërbente si ushtar. Ai ishte një njeri duarartë, që i zinte dora gjithçka, kështu që vuajtjet e mia prej punës përfunduan pasi u martova me të. Ai kishte aftësi për projektimin

e filmave, gjë që sot nuk është ndonjë gjë e madhe, por në atë kohë, ishte mjaftueshëm për ta tërhequr vëmendjen e tim eti. Ai ishte më i interesuar te njerëzit që kishin disa mjeshtëri speciale, sesa tek ata që ishin oficerë të rangut të lartë. Ngaqë im atë kishte studiuar për çështjet që kishin lidhje me filmat, atij i pëlqeu shumë bashkëshorti im. Për më tepër, im shoq ishte diplomuar prej një kolegji teknik dhe kishte aftësi të nivelit të lartë teknologjik për prodhimin e radiove.

Bashkëshorti im kishte një personalitet të mirë, ishte i përmbajtur dhe e donin edhe familjarët, edhe komshinjtë. Aftësitë e tij ndihmuan për financat e familjes sime dhe na lumturuan. Unë linda një djalë e tre vajza, por djali im vdiq kur ishte një muajsh. Im shoq ndonjëherë trishtohej, sepse ai nuk kishte djalë, por vetëm tre vajza. Por në kohën e “Marshimit të Vuajtjes”, ai ishte falënderues që kishte një gojë më pak për ta ushqyer. Vajzat e mia gjithmonë e ngushëllonin, kurdoherë që ai ndiente mungesën e një djali. Ato gjithmonë na trajtonin mirë edhe për ditëlindjet tona.

Sapo im shoq doli në pension prej ushtrisë, Koreja e Veriut pësoi “Marshimin e saj të Vuajtjes”, kur sistemi i racioneve ushqimore prej qeverisë përfundoi dhe shumë veta vuajtën urie. U përpoqa t’i shkoja për vizitë dajës tim në Kinë bashkë me vajzën time të dytë. Kishin kaluar tridhjetë e pesë vjet, që nga hera e fundit që i kisha shkuar për vizitë. Kisha shumë frikë për ta kapërcyer lumin, kështu që u përpoqa të gjeja një mënyrë për ta kontaktuar atë. Nuk kishte asnjë telefon dhe nuk më vinte ndërmend asnjë mënyrë tjetër për ta kontaktuar atë në distancë. Koreanoveriorët dikur përdornin fjalën *waegari*, (që do të thotë çafkë) për t’iu referuar atyre që kërkonin të afërmit e tyre nga ana kineze e kufirit. Waegari është një zog i madh si tip lejteku, që e kërkon ushqimin e tij kudo, duke përdorur qafën e tij veçanërisht të gjatë. Koreanoveriorët, që shkonin t’i kërkonin të afërmit e tyre kinezë të cilët mund t’i ndihmonin për nevojat e tyre të dëshpëruara ishin njëlloj si këto çafkat që e kërkonin ushqimin kudo.

Koreanoveriorët përpiqeshin të dërgonin letra dhe fotografi te të afërmit e tyre kinezë, përmes njerëzve që lejohej të bënin biznes e shkonin vajtje-ardhje mes Kinës dhe Koresë së Veriut. Kishte kaq shumë koreanoveriorë që thjesht vërtiteshin atje te kufiri në Horiong, duke pritur për një mënyrë sesi të kontaktonin dikë ose duke pritur ndonjë lajm për përgjigjen nga Kina. Por nëse korrierët kapeshin prej doganës së Koresë së Veriut me letrat dhe fotografitë tona, përpjekjet na shkonin kot.

Një ditë takova një burrë nga Samhap-i, Kinë, ku jetonte vajza e dajës tim. Ia tregova atij fotografitë e të afërmeve të mi dhe ai e njohu njërin nga njerëzit në foto: kushëririn tim. Kështu që i dërgova një letër dajës në Kinë përmes këtij burrit. Pesëmbëdhjetë ditë pasi kisha shkuar në Horiong (kjo ishte një javë pasi kisha dërguar letrën) mora një përgjigje nga daja, në fund të një dite në të cilën isha përpjekur të shisja shumë prej makaronave petka që i kisha bërë vetë. Madje pa e lexuar letrën, vrapova drejt vendit te kufiri, ku mendova se do të vinte daja për të më takuar, por më ndaloi vajza, ngaqë në letër daja im më kishte thënë se ai do të vinte në Namiang (Namyang).

Bashkë me vajzën morëm rrugën për në Namiang. Udhëtimi në Korenë e Veriut është i vështirë, ngaqë të duhet të kesh leje për të lëvizur nga njëra krahinë në tjetrën dhe gjithashtu transporti nuk është i sigurt. Leja ime e udhëtimit më shpinte deri në një pjesë të rrugës, nga Hemong (Hamheung) për në Horiong, por ne e gjetëm mënyrën për të shkuar në Namiang duke marrë një tren mallrash për njërin segment të udhëtimit. Kur mbërritëm në Namiang, atje kishte akoma më tepër njerëz që vërtiteshin në kufi, sesa në Hemong. Pasi ra ekonomia në Korenë e Veriut, kishte shumë njerëz që po i drejtoheshin kufirit dhe prisnin atje për ndihmë prej të afërmeve të tyre kinezë. Edhe pse ishte sezoni i punëve në bujqësi, ata thjesht prisnin prej të afërmeve të tyre në Kinë, për shkak se nuk kishte asnjë gjë që mund të bënin në bujqësi. Ndonjëherë njerëzit vdisnin me të vërtetë, duke pritur për të afërmit e tyre.

Kur të afërmit ia dilnin mbanë të ribashkoheshin, ishte si ai i pasuri që përshëndet lypësin. Njerëzit nga Kina dukeshin të pastër e të rregullt, kurse ata nga Koreja e Veriut dukeshin të pistë dhe të dobët. Disa njerëz nga Kina madje ua jepnin rrobat e veta të afërmve të tyre nga Koreja e Veriut.

Daja im i dytë mblodhi prej të afërmve tanë të tjerë atje dy thasë të mëdhenj me oriz, një çantë me rroba dhe katërqind uon, e m'i dërgoi ato përmes djalit të kushëririt tim më të madh, pasi mori letrën time. E shita orizin që atje në kufi, pasi ishte shumë i rëndë dhe pastaj shkova në Çonxhin me tren e me makinë. Bleva disa gjëra që më nevojiteshin për dasmën e vajzës atje në Çonxhin dhe pastaj u ktheva në shtëpi.

Afro një vit më vonë, në vitin 1999, mora një tren nga Hemong për në kufi. Shkova me njerëzit nga Hemong, të cilët i pata takuar rrugës për në Horiong. Ecëm përgjatë gjithë natës. Së pari, kapërcyem lumin Tumen dhe pastaj ecëm për afro 40 kilometra për në Samhap, Kinë, dhe pastaj që atje ecëm për në Çishin (Jishin), Kinë, ku jetonte daja im. Në ato ditë, kufiri nuk ishte fare i bllokuar. E gjeta numrin e telefonit të dajës duke i pyetur njerëzit, sapo kaluam në anën kineze të kufirit. Nuk qe e vështirë për mua ta gjeja numrin e tij të telefonit, ngaqë ai zotëronte një mulli.

Gjithmonë i kisha treguar vajzës sime për Kinën dhe sesi jeta që bënim në Korenë e Veriut nuk ishte jeta e vërtetë e një qenieje njerëzore. I thashë asaj se kishte një mënyrë tjetër për të jetuar, të tillë si ajo në Kinë. Vajza ime më e vogël shkoi në Kinë për herë të parë, kur ishte njëzet e katër vjeçe. Asaj i kishte bërë kaq shumë përshtypje stili i jetesës së kinezëve, që ishte dukshëm superior nga i koreanoveriorëve, saqë ajo nuk dëshoi më të kthehej në Korenë e Veriut. Për këtë arsye, e lashë atë në Kinë dhe u ktheva pas një muaji të bashkëshorti im në Korenë e Veriut. Njerëzit e tjerë dilnin nga Koreja e Veriut që të vinin në Kinë, kurse unë duhej të kthehesha mbrapsht në Korenë e Veriut për bashkëshortin tim.

4. Takimi i mentores

Mentorja ime ishte vajza ime më e vogël. Ajo më kontaktoi shtatë vjet, pasi e kisha lënë atë në Kinë. Edhe pse daja im ishte kujdesur për të, ajo prapëseprapë kishte vuajtur shumë. Edhe përpara se të largohej nga Koreja e Veriut, ajo gjithmonë studionte shumë dhe ishte përgatitur të shkonte në kolegji. Por ajo nuk mund të shkonte dot në kolegji në Korenë e Veriut, për shkak se vëllai më i madh i burrit tim ishte arratisur nga Koreja e Veriut për në Korenë e Jugut.

Në Kinë, ajo i kaloi provimet dhe u bë mësuese për fëmijët e misionarëve, që jepnin mësim në Universitetin e Shkencës dhe Teknologjisë në Janbian (Yanbian). Ajo ndihej e braktisur dhe e vetmuar tërë kohën në Kinë, për shkak se gjithnjë rrinte fshehur prej oficerëve të policisë kineze. Kur dëgjoji këngën: “Ti linde për t’u dashur” (You were born to be loved), ajo u mbulua krejtësisht prej hirit të Perëndisë. Edhe pse shqetësohej se mund ta përjashtonin nga puna, po t’u thoshte ndonjërit prej misionarëve që ajo në fakt ishte nga Koreja e Veriut, ajo gjithsesi i tregoi njërit prej misionarëve gjithçka për jetën e saj. Ai e gjeti një mënyrë që ajo të pranohej në universitet atje për të studiuar shkenca kompjuterike për një vit. Ajo u diplomua atje dhe filloi punë te një sekser koreanojugor që punonte në Shangai. Ajo punoi atje për tre vjet dhe pastaj shkoi në Korenë e Jugut. Rroga e saj mujore ishte njëmijë e pesëqind juan (afro dyqind e pesëdhjetë dollarë).

Ajo e mësoi gjuhën kineze për gjashtë muaj, që të mund të mbijetonte në Kinë. Një herë ajo mendoi të përpiquej të vinte në Korenë e Jugut duke u futur tek ambasada e Koresë së Jugut në Pekin, me ndihmën e një dezertori koreanoverior nga Koreja e Jugut. Të tjerët e nxitën atë për ta provuar këtë metodë të rrezikshme. (Koreanoveriorët nuk lejohet të vijnë në Korenë e Jugut përmes ambasadës së Koresë së Jugut në Kinë, për shkak se kjo gjë shkakton shumë probleme për Korenë e Jugut me kinezët. Për këtë arsye koreanoveriorët duhet të kalojnë përmes Kinës dhe

pastaj të kontaktojnë zyrtarët koreanojugorë në një vend të tretë, si Laosi, Tajlanda, Kamboxhia ose Mongolia, që të kenë mundësi të vijjnë në Korenë e Jugut.) Ajo hoqi dorë, për shkak se siguria përreth ambasadës së Koresë së Jugut ishte tepër e lartë.

Ajo shkoi tek Ambasada amerikane në Kinë, duke prezantuar dokumentet prej një kompanie amerikane në Korenë e Jugut dhe duke pretenduar se ajo duhej t'i dorëzonte ato dokumente. Fillimisht ata u përpoqën ta kthenin mbrapsht atë, për shkak se dërgimi i dokumenteve prej saj nuk ishte i regjistruar në listën e ambasadës. Por pastaj ajo u foli atyre në gjuhën kineze dhe këmbënguli se duhej t'i dorëzonte menjëherë dokumentet. Më në fund ajo kaloi pas portës së dytë dhe të tretë. Pas kësaj, ajo shkoi te kati lart i ambasadës ku takoi një grua afrikano-amerikane dhe i kërkoi asaj ndihmë në anglisht. U bë përnjëherësh shqyrtimi i rastit dhe atë e dërguan në Singapor. Pastaj, më në fund ajo erdhi në Korenë e Jugut.

Kur vajza ime më ftoi për herë të parë në Korenë e Jugut, pas shtatë vitesh, im shoq ishte ende gjallë. Edhe pse isha e paralizuar në gjysmën e djathtë të trupit, kujtesën e kisha të paprekur dhe flisja mirë. Ishte hiri i Perëndisë. Ia kishim dalë mbanë të mbanim lidhje mes nesh përgjatë atyre shtatë viteve duke shkruar letra për tek adresa e dajës tim në Kinë, të cilat ai pastaj na i dërgonte neve. Në letrën e saj, ajo tha se po na i dërgonte neve të gjitha paratë që kishte fituar përgjatë tre viteve të fundit. Për një kohë të gjatë bashkëshorti im dhe unë kishim diskutuar se kush do të duhej të shkonte në kufi për t'i marrë paratë. Vendosa të shkoj unë, për shkak se kisha merak se mos dikush mund t'ia vidhte paratë tim shoqi.

Mbërrita në Horiong e sigurt me anë të një ndërmjetësi, që më kishte dhënë letrën nga vajza ime. Kur arrita të flas me time bijë përmes një celulari kinez që atje, në fillim nuk munda dot ta dalloja zërin e saj, ngaqë kishin kaluar shtatë vjet. Për këtë arsye i bëra asaj pyetje të detajuara lidhur me cilët ishin emrat e anëtarëve të familjes sonë dhe cila puçërr në trupin e saj kishte

lënë vrage. Më në fund, u binda se ishte ajo! I mora paratë prej saj përmes ndërmjetësit dhe pastaj u ktheva e sigurt në shtëpi. Ajo më kërkoi që të shkoja në Korenë e Jugut, por nuk mund ta bëja këtë gjë, për shkak të tim shoqi. Ai as edhe një herë të vetme nuk kishte treguar se donte të arratisesh, prandaj unë as nuk mund ta mendoja fare për të shkuar në Korenë e Jugut.

Për fat të mirë, nuk kisha nevojë të punoja për shkak të parave që na dërgoi vajza ime e vogël. Përpara kësaj, unë kisha qenë kudo, duke përfshirë Cençin (Jangjin), Cançin (Chungjin) të Kanuando (Kangwondo), Içun (Ychun) dhe Mjuçen (Musan), për të shitur gjëra. Kudo ku shkoja, më duhej të shpenzoja shumë para për lejen e udhëtimit. Më duhej të isha e fortë nga fillimi deri në fund të jetës sime, për shkak të paaftësisë së tim shoqi për të fituar para.

Vajza më kontaktoi sërish pas një viti që na kishte dërguar paratë. Kjo ndodhi pesë muaj, pasi kishte ndërruar jetë im shoq. Kësaj radhe, ishte madje shumë më e vështirë se zakonisht për mua që të merrja lejen e udhëtimit për në kufi. Marrja e një lejeje udhëtimi ishte e kushtueshme, zakonisht shkonte te pesëmbëdhjetë mijë uon. Për më tepër, kryetari i fshatit tim më ruante me dyshim, ngaqë ai mendonte se mos arratisesha për në Kinë. Madje edhe një agjent i sigurimit kombëtar, caktoi një person për të më ruajtur. Kur ndërmjetësja e dërguar prej vajzës sime erdhi tek unë, erdhi për vizitë edhe agjenti gjithashtu. I thashë agjentit se ndërmjetësja ishte vajza e një partnerit tim në biznes, nga Cenxhin (Changjin), përpara se të paralizohesha. Ndërmjetësja na siguroi lejen e udhëtimit brenda dhjetë ditësh. Atë natë ne u larguam nga shtëpia, pa i parë as kryetarin e fshatit, as agjentin e sigurimit kombëtar.

Ndërmjetësja dhe unë kishim dy arka të mëdha me domate dhe dy kuti të mëdha dreke. Morëm një autobus personal i cili ishte tridhjetë herë më i shtrenjtë nga treni. Na u desh të kalonim nëpër dhjetë pika kontrolli të sigurimit. U ndalova në njërën pikë kontrolli të sigurimit, për shkak se unë isha me origjinë nga Kina

dhe ne po shkonim në Haiçen, afër kufirit. I gënjeva ata duke u thënë se po shkoja atje vetëm. Por sapo i gjetën dy kompletet e shkopave të ngrënies në çantën time të drekës, ata më pyetën se i kujt ishte kompleti i dytë i shkopave. Iu përgjigja se vajza ime mund ta kishte vënë një komplet tepër, pa e ditur se unë tashmë e kisha vënë timin atje. Pati plot gjëra që ngritën dyshime për ta, që nga leja ime e udhëtimit dhe bagazhi im. Por ata menduan se do të ishte krejtësisht e pamundur për mua që të arratisesha nga Koreja e Veriut, për shkak se fytyra ime ishte e errët, unë çaloja, dhe shpinën e kisha të përkulur prej paralizës. Udhëtuam për më tepër se dhjetë orë për të shkuar atje, ku një tren normalisht mund të të shpinte për tri orë.

Ata e detyruan autobusin të ndalonte në secilën pikë kontrolli të sigurimit për shkakun tim. Në mënyrë të pashpjegueshme, leja ime e udhëtimit u zhduk në pikën e shtatë të kontrollit të sigurimit. Qava me zë të lartë, ngaqë mendova se do të ngecesha atje, në pamundësi për të shkuar as para, as prapa. Rojet e pikës së kontrollit i pyetën njerëzit e autobusit, nëse e kisha pasur lejen e udhëtimit në pikat e mëparshme të kontrollit dhe ata dolën garant për mua. Kështu që, rojet më lanë të kaloja e sigurt përmes të treja pikave të fundit të kontrollit. Pasi i kalova të gjitha pikat e kontrollit, e kontrollova sërish çantën time, ngaqë nuk e besoja dot se do ta kisha humbur lejen e udhëtimit. Ajo ishte pikërisht atje! Besoj se Perëndia e fshehu lejen time, që të më sillte në Korenë e Jugut, ngaqë rojet e sigurimit në disa nga pikat e fundit të kontrollit nuk më ndaluan fare gjatë gjithë rrugës për në Haiçen! Mendoj se ata nuk dyshonin se unë do të arratisesha, për shkak se isha gjysmë e paralizuar, çaloja, dhe kisha shpinën të përkulur.

Kur mbërrita në Haiçen fola me vajzën time më të vogël. Ajo më tha që të shkoja në Kinë. Por në atë çast, ndalova dhe mendova shumë për dy vajzat e tjera të miat, duke gjykuar se veprimet e mia do t'u shkaktonin dëm atyre. Por vajza ime këmbënguli, që të paktën të kaloja kufirin për në Kinë, që ajo të mund të vinte

atje për të më takuar dhe për të më dhënë paratë. Kështu që, unë punësova ndërmjetës që të më ndihmonin ta kaloja kufirin e të shkoja në Kinë.

Pasi u largova, qeveria e Koresë së Veriut i kërcënoi vërtet vajzat e mia. Kurse tani ato janë mirë, për shkak se janë shumë njerëz që kalojnë matanë kufirit; është diçka më e zakonshme. Gjithashtu, qeveria e injoron ekzistencën time, ngaqë ata mendojnë se qyteti im i lindjes është në Kinë dhe se unë tashmë duhej të kisha vdekur për shkak të sëmundjes sime.

Vajza ime mori ndihmë të madhe prej një grupi të caktuar për të drejtat e njeriut gjatë largimit tim, kështu që ajo punoi për atë grup për tre vjet, duke dërguar balona në Korenë e Veriut. Pastaj, ajo punoi si vullnetare te biznesi që e kishte ndihmuar atë të shkonte në Korenë e Jugut. Edhe unë mundohem të shlyej me sa mundem. Vajza ime i përdori të gjitha paratë që kishte për largimin tim, kështu që tani ajo më ka vetëm mua. Kur po përgatitesha që të shkoja në një udhëtim misioni për në Kinë, si pjesë e arsimit që po merrja në Universitetin e Fshtëtë të “Zërit të Martirëve” në Kore, ajo më ndaloi, ngaqë unë jam gjithçka që ajo ka.

Perëndia e dërgoi vajzën time si mentoren time për të më udhëhequr rrugën drejt Koresë së Jugut. Pastaj Perëndia më dërgoi në shkollën e UF për të studiuar Biblën, që ta njoh Atë më mirë.

5. Kalimi i pragut të parë

Edhe pse qyteti im i lindjes ishte në Kinë dhe unë kisha shkuar atje shumë herë, vajza ime në këto ditë më ndalon që të shkoj atje. Por shkolla e misionit të UF kërkon që studentët të shkojnë për një udhëtim misioni në një vend ku ka koreanoveriorë, të tillë si Kina. Shkolla do të më lejojë të diplomohem pasi të shkoj në Kinë dhe të trajnoj refugjatët koreanoveriorë në Kinë. Kjo do të thotë t’u shërbej atyre që janë ashtu si isha unë përpara. Por nuk mundem

dot të shkoj në Kinë për shkak të kundërshtimit prej vajzës sime. Ky është akoma pragu i parë, që ende pret kalimin tim.

6. Sprovat, aleatët dhe armiqtë

Një sprovë që pata për pothuajse krejt jetën time si e rritur në Korenë e Veriut ishte se im shoq ishte i zgjuar, por nuk ishte guximtar. Me qëllim që ta shmangnin vuajtjen nga uria në Korenë e Veriut, njerëzit duhej të ishin të ashpër dhe të mendonin: *Që të mbijetoj unë, duhet të vdesësh ti*. Kurse im shoq kurrë nuk ishte i sigurt në vetvete dhe për këtë arsye, unë duhej të punoja shumë fort, që ta mbështesja familjen time, pasi ai doli në pension prej ushtrisë. Madje për shtatë vjet rresht, mua m'u desh të mbartja ngarkesa patatesh prej njëqind kilogramësh për në Cenxhin. Lëkura ime mori ngjyrë kafe të errët prej djegieve të shumta nga dielli.

Koha më e keqe e jetës sime ishte gjatë “Marshimit të Vuajtjeve”. Unë nuk kisha shtëpi, nuk kisha as ushqim, as rroba. Bëra gjithçka që mundesha për t'u kujdesur për ushqimin e tim shoqi. Jeta ime mund të kishte qenë shumë më e lehtë dhe më e lumtur, nëse do të kisha ikur në Kinë në atë kohë. Por më duhej të kthehesha në Korenë e Veriut për shkak të tij.

Vajza ime më e vogël është aleatja ime. Ajo është ndihmuesja ime, që më solli në Korenë e Jugut. Jam gjithnjë mirënjohëse për të.

Presidenti i mëparshëm i Koresë së Veriut, Kim Il Sung-u është armiku im. Nëse ai nuk do ta kishte filluar luftën e Koreve, im shoq dhe vëllai i vet nuk do të ishin ndarë. Por, ngaqë vëllai i tij shkoi në Korenë e Jugut, kjo gjë e bëri shumë të keqe historinë e familjes sonë, duke sjellë si rezultat mosmarrjen e asnjë përfitimi për fëmijët tanë në Korenë e Veriut. Pa luftën, unë nuk do të isha ndarë prej dy vajzave të mia më të mëdha, e nuk do të isha e ndarë copash, siç jam tani.

7. Afrimi për te shpella më e brendshme në thellësi

Unë e mbështeta tim shoq për shtatë vjet, pasi ai doli në pension nga ushtria. Besoj se kjo ishte periudha më e errët e jetës sime. Kur ai ishte ushtar, nuk pati kurrë rastin të mendonte për ta vizituar Kinën. Por edhe pasi e mbaroi karrierën e tij ushtarake, mendja e tij e dobët dhe kokëfortë e parandaloi që ta kalonte lumin Tumen për t'u futur në Kinë. Po të mos kisha ndenjur unë me të, ai do të kishte vdekur nga uria! Unë shkova e erdha në Cenxhin për biznesin tim, që ta ushqeja atë. Por edhe unë gjithashtu isha kokëfortë dhe naive, prandaj njerëzit më mashtronin shumë në biznes. Prandaj, unë doja të shkoja në Cenxhin, i cili ndodhet më tepër në anën e fshatit, sesa Hemong-u. Gjithashtu, Cenxhin-i është me lartësi 1800 metra mbi nivelin e detit më lart sesa Hemong-u, kështu që temperatura atje është më e ulët dhe klima më e ashpër.

Burri im shërbeu në ushtri për shtatëmbëdhjetë vjet më shumë sesa shërbimi i detyrueshëm ushtarak prej njëzet vjetësh. Kështu që, ai shërbeu në ushtri për tridhjetë e shtatë vjet në total. Por, kur ai e mbylli punën me ushtrinë, ne nuk kishim shtëpi, as mbështetje dhe nuk na kishte ngelur asnjë gjë. Po të kishim pasur një shtëpi, do të kisha bërë biznes më të lehtë e më të sigurt, si për shembull, mund të kisha qepur rroba ose të shisja ushqim nga shtëpia. Por nuk kishte mundësi fare që të ndodhte kjo. Nuk na ngeli asnjë gjë në shtëpi, ngaqë na u desh t'i shisnim të gjitha pajisjet tona shtëpiake një e nga një. Së pari, e shitëm televizorin tonë dhe pastaj i shitëm uniformat ushtarake të tim shoqi, batanijet tona, mobiljet tona e kështu me radhë. Më në fund, m'u desh të lëvizja për në Cenxhin që të bëja biznes atje, për shkak se nuk na kishte mbetur më asnjë gjë për të shitur.

Kur e kisha biznesin tim, ne jetonim në shtëpi dhe shkonim gjatë ditës vajtje-ardhje në fshat. Përpara se të largohesha nga

shtëpia për të shkuar te biznesi im, përgatisja të gjithë ushqimin për tim shoq, që ta hante në shtëpi. Rruga për te biznesi ishte shumë e vështirë. Ndonjëherë më duhej të kaloja përmes maleve të larta, ose të shkoja me makinë përmes një rruge ku kishte nëntëdhjetë e nëntë kthesa. Herë të tjera lëkura e qafës më pritej, ngaqë fërkohej me kabullin e një shtylle elektrike.

Gjithashtu pata një biznes për riparim rrobash në Cenxhin. Njerëzit do të thoshin: “Ma bëj këtë gjë!” dhe unë ua bëja siç e kërkonin. Punova me një llojshmëri biznesesh dhe isha shumë e njohur dhe gjithmonë e mirëpritur.

Kur doli në pension, burri im mori një stallë prej ushtrisë, e cila ishte thjesht një vend i madh katror e i zbrazët. Kështu që, unë shita gjashtëqind kilogramë patate për t’i siguruar paratë e domosdoshme që ta rimodeloja stallën e ta bëja shtëpi të banueshme. M’u deshën shtatë vjet për ta bërë këtë gjë. M’u desh t’i bëja gjithë këto lloje gjërash gjatë gjithë kohës, ngaqë im shoq asnjëherë nuk kishte besim në vetvete.

8. Sprova e rëndë

Kur e kisha furrën e pjekjes, zakonisht ngrihesha nga gjumi në orën dy të natës për të bërë ushqimin, që ta shisja te tregu. Kur mendoj sesi jeta ime nuk kishte fare pushim, duke u çuar herët në mëngjes, duke përgatitur ushqimin për ta shitur, e pyesja veten se kur do të merrnin fund këto vështirësi. Ky mendim i pafund dhe i pashpresë për jetën time ma bëri të vështirë për të vazhduar.

Ndonjëherë jetimët endacakë ma vidhnin bukën te tregu dhe unë dorëzohesha për atë ditë. Së pari, jetimi që ishte kapo vinte e ma trazonte tavolinën dhe pastaj jetimët e tjerë vinin dhe i merrnin bukët që kishin rënë përdhe. Kështu që, një ditë vendosa të mos bëja më biznes, dhe në vend të kësaj bëra bukë për t’ua dhënë atyre. Pas asaj dite, ata nuk erdhën më të ma ndërprisnin biznesin.

Pasi bëra biznes atje për shtatë vjet, u afrova aq shumë me ta, saqë isha në gjendje t'i përshëndetja si miq. Akoma e mbaj mend një drejtues simpatik të grupit të fëmijëve jetimë.

Shtëpia ime ishte përtej rrugës nga tregu. Kështu që, njerëzit që vinin te tregu dhe jetonin larg tregut, i bënë kapicë mallrat e tyre përballë shtëpisë sime duke pritur për transportin. Por, unë u afrova edhe me ata. Madje i ndihmoja ata që t'i shisnin mallrat e tyre.

Në fshat nuk kishte spitale. Atje kishte vetëm klinika mjekësore. Kështu që, ndërkohë që bëja biznes atje, unë shisja edhe ilaçe. I blija ilaçet nga tregu i madh dhe i shisja te tregu i fshatit. Ilaçet kishin rëndësi për jetët e njerëzve, kështu që mora përgjegjësinë për shitjen e tyre shumë seriozisht dhe isha shumë e ndërgjegjshme për të. Unë shisja vetëm ilaçe prej Kombeve të Bashkuara. Kurse disa njerëz shisnin ilaçe që i kishin bërë vetë, për shembull, duke i përzier ato me miell. Arrita të fitoja besimin e klientëve të mi, ngaqë ilaçet e mia vepronin mirë. Një ditë e humba kutinë time të ilaçeve dhe ata shkuan e ma gjetën, për shkak të besimit që kisha fituar te njerëzit.

9. Shpërblimi

Jeta në Korenë e Jugut është një bekim nga Perëndia për mua. Por bekimi më i madh që kam marrë është njohja e Perëndisë. Unë jetoj mirë në Korenë e Jugut. Kam mjaftueshëm për të ngrënë, dhe rroba për të veshur, dhe mund të jetoj pa pasur asnjë shqetësim. Nuk ka bekime më të mëdha se këto gjëra! Pamundësia e vajzës sime për të shkuar në kolegji në Korenë e Veriut ishte keqardhje e madhe për të, por tani ajo është duke bërë gjithçka që do të bëjë, madje edhe në moshën tridhjetë e shtatë vjeçare. Ajo tani është reportere në Kanada dhe është në lidhje dashurie me një spanjoll.

Kur vajza ime më e vogël më bindi për të ardhur në Kinë, unë shqetësohesha për dy vajzat e tjera të miat në Korenë e Veriut dhe ndonëse vajzat e mia patën ca vështirësi në fillim, tani ato

janë duke kaluar mirë. Vajza ime e dytë pati vështirësi financiare, ngaqë kohët e fundit asaj i vdiq i shoqi.

Fola me vajzat që janë në Korenë e Veriut në majin e kaluar. Nuk mund ta ndaja dot Ungjillin specifikisht me to, por u thashë të luteshin kurdoherë që të kishin vështirësi, dhe pas lutjes Perëndia do t'i ndihmonte ato.

10. Rruga për kthimin

Unë ndryshova pasi mbërrita në Korenë e Jugut dhe i besova Perëndisë. Madje edhe pamja ime e jashtme ndryshoi krejtësisht. Nëse Koretë bashkohen, unë do të kthehem në Korenë e Veriut si një lajmëtare e Perëndisë. Do t'i ungjillëzoj koreanoveriorët dhe do të ndaj me ta historinë sesi e pranova unë Jezusin. Do t'u tregoj sesi kishat në Korenë e Jugut më mikpritën me dashuri, dhe personalisht do të ndaj plotësinë e lajmit të mirë me vajzat e mia, me nipërit e mbesat, dhe me fqinjët e vjetër.

Kim Il Sung-u gjithnjë u premtoi njerëzve se ai do t'u siguronte atyre oriz të bardhë dhe supë me mish viçi, por ai nuk mundej dot ta mbante fjalën që jepte. Unë do t'u them atyre se ishte Perëndia ai që më dha mua oriz të bardhë dhe mish viçi, për shkak se Perëndia e bekoj Korenë e Jugut e jo Kim Il Sung-un.

Unë do të shkoj në Korenë e Veriut me para dhe me Biblën. Dua të ble një makinë të mirë për dhëndrin tim, ngaqë ai është shofer. Do të ishte gjë shumë e mirë, nëse e gjithë familja ime do të shëtiste me atë makinë.

11. Ringjallja

Sipas opinionit tim, kur të ndodhë bashkimi, do të ketë shumë njerëz të varfër në Korenë e Veriut, kështu që ne ndoshta mund

të mos jemi në gjendje t'ua plotësojmë të gjitha nevojat atyre dhe mund të mos ketë mjaftueshëm gjëra për t'ua dhënë. Edhe po ta ndajmë Ungjillin, njerëzit nuk do të besojnë lehtësisht te Perëndia që në fillim fare. Prandaj do të na duhet t'u dhurojmë vazhdimisht dashuri, që ata të hapin zemrat e tyre dhe ta dëgjojnë Ungjillin e të besojnë në Perëndinë. Ne duhet të jemi të durueshëm e të vazhdojmë t'u ofrojmë ndihmë atyre.

Edhe po t'u japim shumë ndihmë financiare atyre, nuk do të ishte mjaft. Kur njerëzit ankohen, ne duhet t'u tregojmë atyre mësimet të rëndësishme, duke i mësuar se ne nuk duhet të varem vetëm në gjërat që na japin të tjerët. Në fakt, nuk duhet t'ua futim gati në gojë gjithçka që kërkojnë. Përkundrazi, ne duam t'i ndihmojmë ata që të ngrenë një themel të të qenit të pavarur dhe me vetëbesim.

12. Rikthimi me eliksirin



Dua t'u them banorëve të qytetit tim: “Pa dhimbje, nuk ka fitim,” dhe “Vështirësitë e vuajtjet” nuk do të jetë fundi i botës për ne. Perëndia do të na bekojë e do të na shpërblejë me hirin e Tij, nëse ne vazhdojmë ta marrim veten nga vështirësitë dhe i besojmë Perëndisë. Ne vuajtëm nën regjimin e familjes së Kim Il Sung-ut, por më në fund, Perëndia do të na bekojë edhe ne me gjëra të mira. Tani bashkimi ka ardhur dhe bashkim do të thotë fundi i vuajtjeve. Prandaj, besoni në Perëndinë dhe Ai do të na bekojë neve ashtu si bekoi Korenë e Jugut.”

Pamja ime e jashtme është e ndryshme nga ajo që kisha në të shkuarën. Fytyra ime ishte e errët, por tani ka ndryshuar aq shumë, saqë miqtë e mi në Korenë e Veriut nuk do të më njohin dot. Në Korenë e Veriut, fytyra ime ishte plot me shqetësim dhe ankth, gjithmonë duke vrarë mendjen se prej nga do të më vinte vakti tjetër ushqimor. Dua t'u tregoj atyre ndryshimet në pamjen time dhe do të bëhem një dëshmitare për Perëndinë.

Kapitulli 8.

Z. Li: Ecja me zvarritje e heroit

*Nëse nuk mundesh të fluturosh, atëherë vrapo;
nëse nuk mundesh të vraposh, atëherë ec, nëse nuk
mundesh të ecësh, atëherë zvarritu; por çfarëdo që të
bësh, do të të duhet të vazhdosh të ecësh përpara.*

—I Përndershmi Dr. Martin Luter King, i Riu (The
Reverend Dr. Martin Luther King Jr.)⁴¹

1. Bota e zakonshme

Unë linda në Colnanam-do (Jeollanam-do), Koreja e Jugut, në vitin 1940, gjatë sundimit kolonial japonez; megjithatë, shumë shpejt pas lindjes sime, prindërit e mi, motra më e madhe, vëllai më i madh dhe unë lëvizëm për në Kinë, sepse nuk qemë në gjendje ta duronim jetën nën japonezët.

Pasi jetova në Kinë për njëzet vjet, vendosa të shkoj me shokët e mi për të jetuar në Korenë e Veriut. Ngaqë isha korean, m'u duk ide e mirë që ta mësoja gjuhën e kulturën koreane, prandaj u largova prej prindërve të mi, prej motrës dhe vëllait, që mbetën në Kinë. Në Korenë e Veriut gjeta punë në një fabrikë tekstilësh, ku prodhoni letër dhe pulpë dhe endnim copa tekstilësh prej drurit.

⁴¹ Jim Bickford, *American Comeback* (Las Vegas, NV: American Comeback-Publishing, 2013), 36.

U martova në vitin 1969 dhe familja ime u kategorizua në grupin “qytetarë të përgjithshëm” në mes të pesëdhjetë e një grupeve të ndryshme, në të cilat vendoseshin qytetarët e Koresë së Veriut.

Grupi i përgjithshëm nuk ishte aq i keq. Patjetër që është më i mirë se grupi “antagonist”. Familjet e njerëzve që u arratisën për në Korenë e Jugut kategorizohen në atë grup. Edhe pse unë isha nga Koreja e Jugut, mua nuk ma dhanë statusin “antagonist”, për shkak se unë erdha në Veri prej Jugut. Për fat të mirë, edhe babai i gruas sime ishte njeri i respektuar dhe trajtohej mirë, për shkak të arritjeve të tij në Luftën e Koreve.

Pronarët e tokave, që kontrollonin sipërfaqe të mëdha toke, kapitalistët që drejtonin fabrika dhe i shfrytëzuan punëtorët gjatë sundimit kolonial japonez, intelektualët që punuan si përkthyes, dhe njerëzit, anëtarët e familjeve të të cilëve dezertuan për në Jug, që të gjithë këta u regjistruan si “antagonistë” prej qeverisë. Njerëz të tillë nuk u lejuan të futeshin në Partinë e Punëtorëve të Koresë së Veriut, e cila njihet zakonisht si Partia Komuniste. Nga ana tjetër, rangi i fshatarëve u mbështet prej qeverisë së Koresë së Veriut.

Gruaja ime i përkiste një familjeje të mirë në grupin e përgjithshëm, gjë që do të thoshte se ajo mund të shkonte në shkollë të mira, ose të punonte si zyrtare. Kur u martuam, isha njëzet e nëntë vjeç, kurse gruaja ime ishte njëzet e katër. Ne patëm një vajzë dhe dy djem. Nuk ishim as të pasur, as të varfër. Në ato kohë (ndryshe nga sot), qeveria e Koresë së Veriut shpërndante rregullisht ushqim, në varësi të numrit të anëtarëve të familjes. Shërbimi shëndetësor dhe arsimi ishin gjithashtu falas. Ishte koha më e mirë.

Megjithatë, sistemi ekonomik u paralizua në vitet 1990-të. Që nga ajo kohë e tutje, qytetarët e Koresë së Veriut nuk merrnin më ushqim falas, shërbim shëndetësor falas ose arsim falas. Së pari, shpërndarja e ushqimit u rrallua. Ne merrnim ushqim ndoshta një herë në dy javë. Pastaj racioni i orizit për pleqtë u reduktua nga katërqind gram në treqind gram. Pastaj qeveria e ndaloi fare shpërndarjen e tij.

Djali im i parë, i lindur në mesin e viteve 1970-të, donte të futej në ushtri, por nuk e kaloi ekzaminimin fizik. Ai u dërgua të punojë në një minierë qymyri bashkë me shokët e shoqet e klasës së tij. Familja ime dhe unë lëvizëm për në një qytet pranë lumit Tumen pothuajse në të njëjtën kohë. Unë punova në një fabrikë që prodhonte mallra të nevojshme për jetën e përditshme, të tilla si sapuni dhe produktet e letrës. Djali im i dytë ishte student në atë kohë, kurse vajza ime u martua.

2. Thirrja për aventura

Dhjetë vjet, pasi u shkatërrua sistemi i furnizimit ushqimor prej geverisë, shpërtheu uria. Kishte një thënie atëherë se të marrët tashmë kishin vdekur nga uria dhe ata që mbijetuan ishin të mençurit; megjithatë, në kohën e urisë, të qenët i mençur nuk të jepte ndonjë dobi. Ajo gjë që vëzhgova ishte se njerëzit e zgjuar arratiseshin për në Kinë, për të kërkuar ushqim. Shumë njerëz largoheshin nga qyteti dhe po rritej numri i shtëpive të zbrazëta. Unë vendosa të shkoj në Kinë, që të mos vdisja nga uria prej budallallëkut.

Pati shumë fëmijë që vdiqën nga uria. Kur nënat e tyre u larguan për të shkuar në Kinë, që të fitonin para, fëmijëve u jepeshin tridhjetë karamela dhe u kërkohej që të hanin një karamelë në ditë, derisa të ktheheshin mamatë në shtëpi. Por shumë prej tyre vdiqën, përpara se t'u ktheheshin mamatë. Në disa qytete, deri në 70 përqind të fëmijëve dhe pleqve vdiqën nga uria. Për fat të keq, 10 përqind e tyre u qëlluan për vdekje, zakonisht kur kapeshin duke vjedhur. Ndoshta një 20 përqindësh tjetër vdiste nga ngricat. Vdiqën kaq shumë njerëz, saqë dukej sikur kishte ndodhur një luftë, por pa asnjë të shtënë armë.

Njëri nga djemtë e mi tashmë kishte ikur në Kinë, përpara sesa unë dhe gruaja ime vendosëm të shkonim edhe ne. I shitëm që të gjitha gjërat e shtëpisë sonë dhe tokën, që të arrinin të

nxirrnim afro tetëdhjetë dollarë për të paguar një ndërmjetës si udhërrëfyes, që të na ndihmonte për t'u arratisur. Në Korenë e Veriut, njerëzit nuk mundën dot të blejnë e të shesin shtëpi. Është veprim i paligjshëm. Megjithatë, njerëzit e bënë një gjë të tillë.

Ndërmjetësi udhërrëfyes më drejtoi mua dhe gruan time përmes lumit Tumen. Teksa po e kapërceja lumin, pashë shumë trupa njerëzish të kapur nëpër degët e pemëve. Qava me pikëllim për trupat pa jetë, duke menduar sesi familja e Kim Il Sung-ut ishin mirë e bukur, ndërkohë që qytetarët e Koresë së Veriut vdisnin.

Në Kinë, shumica e burrave koreanoveriorë konsiderohen të padobishëm dhe nuk është e lehtë të gjesh një vend për të jetuar. Gratë koreanoveriore shiten te burrat beqarë kinezë. Në varësi të pamjes së tyre, gratë koreanoveriore shiten për deri në pesëqind dollarë, disa mund të shiten edhe për treqind dollarë, ose, për gratë e shëmtuara, për njëqind ose pesëdhjetë dollarë.

Gruaja ime vuajti prej tensionit të lartë të gjakut dhe prej një sëre sëmundjesh pas muajve të vështirësive në Kinë. Sëmundjet e saj, në fakt, nisën që në çastin kur kapërcyem lumin. Na u desh të ngjiteshim në një kodër të thepisur, ta kapërcenim lumin me ujë të ftohtë, të ecnim përmes fushave të gjera, të kërcenim mbi trupat e pjetë, të ndalonim, kur perëndonte dielli dhe t'i zhvishnim lëvoret e pemëve për t'i ngrënë. Ne trembeshim, kur kafshët hungërinin dhe binin përtokë nga uria. Ne e dëgjonim zhurmën e pikave të ujit pesë metra larg dhe zvarriteshim për atje, që ta lagnim fytyrën e tharë. Kur ktheh koka pas tani, e kuptoj se ishte hiri i Perëndisë, që të paktën ne kishim ato pikat e ujit për të mbijetuar. Më në fund, takuam një familje kineze Han, të cilët rrisnin bagëti. Një nga të afërmit e fermerit, e solli makinën e tyre te vendi ku ishim dhe na shpuri me makinë mua e time shoqe për te ferma e tyre. Atje, gruaja ime u shërbente familjes së tyre: ajo kujdesej për fëmijën e tyre dhe gjithashtu për të hedhur jashtëqitjet e një pacienti që ata e kishin në shtëpi. Unë u prezantova te një shtëpi tjetër. Detyra ime ishte të prisja dru.

3. Refuzimi i thirrjes

Për afro gjashtë muaj pronari i shtëpisë, që ishte kinez, më rrihte shumë ngaqë nuk mund të flisja dot gjuhën kineze. Një ditë, qava me zë të lartë dhe humba durimin për shkak të abuzimit. Pronari më raportoi te policia kineze dhe më futën në burg në Tumen, në Kinë. Policia kineze më akuzoi që isha arratisur nga Koreja e Veriut dhe për këtë arsye më rikthyen në një burg në Korenë e Veriut.

Në burgjet e Koresë së Veriut njerëzit brutalizohen. Kur isha në burg, një oficer policie e shkëlmoi në bark një grua shtatzënë, me qëllim që ajo ta abortonte fetusin. Oficeri ia shtrëngonte barkun me këmbët e tij, që ta detyronte me forcë abortimin. Më në fund prej mitrës së saj doli përjashta fetusin dhe ai e hodhi atë në koshin e plehërave. Ai e fajësoi atë që ngjizi fëmijë me një burrë kinez, pasi u përpoq të arratisjej prej Koresë së Veriut.

Në rastin tim, iu desh një javë për të kaluar zbulimet paraprake. Pas një jave erdhi policia e qytetit tim dhe më morën për në burgun e atjeshëm. U detyrova të punoj atje për tetë muaj. Për çdo vakt, ne të burgosurve na jepnin shtatëdhjetë kokrra misri dhe ujë të nxehtë të kripur me gjethe lakre. Unë punoja katërmëdhjetë deri në gjashtëmbëdhjetë orë në ditë, zakonisht prisja dru, dhe ndonjëherë punoja në një fermë. Zakonisht më dërgonin përjashta në mëngjes për të punuar, pastaj merrja drekën e varfër, pastaj punoja sërish dhe kthehesha në burg rreth orës 7-8 të mbrëmjes për të ngrënë darkë.

Pas tetë muajsh u lirova nga burgu. Oficerët e policisë më urdhëruan të mos e kapërceja më lumin, por pavarësisht gjërave që thanë ata, unë e kalova lumin sërish. Nuk kisha asnjë vend ku të jetoja në Korenë e Veriut. Prita dy ditë dhe pastaj eca përgjatë bregut të lumit për afro treqind metra, duke kërkuar për një vend ku lumi ishte i ngushtë dhe i cekët. Pastaj notova përmes lumit.

4. Takimi i mentorit

Kur e kapërceva lumin, takova një burrë kinez Han. Ai ishte njeri i mirë dhe më ndihmoi shumë. I thashë se po kërkoja për një vend ku të punoja që të fitoja para. Ai më dha një tridhjetë dollarë dhe më tha të shkoja ta gjeja time shoqe. Ai bëri më të mirën që dinte për të komunikuar me mua. Ai gjurmoi karakteret kineze mbi pëllëmbën time (disa prej të cilave ne nga Koreja e Veriut i njohim) dhe gjithashtu përdorte gjeste me duar.

Ai gjithashtu më drejtoi te një kishë që ndodhej dhjetë kilometra larg lumit. Vëllezërit dhe motrat e kishës më mirëpritën dhe një burrë koreano-kinez më ndihmoi ta gjeja time shoqe. Kur shkova te shtëpia ku punonte ime shoqe, pronari na nxori me shkelma përjashta shtëpisë së tij. Unë kisha ndenjur atje për vetëm dy ose tri ditë, por pronari ishte i shqetësuar për praninë time. Nga ana tjetër, gruaja ime kishte duruar një kohë më të vështirë nga imja, edhe pse unë kisha qenë i detyruar të punoja në një burg të Koresë së Veriut. Ajo fyhej prej pronarit të shtëpisë dhe shpesh ai e godiste në kokë.

Pasi na nxorën përjashta shtëpisë, bashkë me time shoqe shkua te motra ime, e cila jetonte në Kinë; megjithatë, ajo nuk mund të na ndihmonte dot. Përveç këtyre gjërave, ne të gjithë ishim të shqetësuar se mos na kapte policia në shtëpinë e saj. Do të kishte qenë problem i madh, nëse do të kapeshim prej policisë, për shkak se ne ishim qytetarë të Koresë së Veriut.

Pas shumë pak kohe gruaja ime vdiq në një hambar të vjetër, pasi kishte qenë e sëmurë për një kohë të gjatë, që kur kishte mbërritur në Kinë. Ajo nuk mori fare përkujdesje shëndetësore. Im bir mbërriti në Kinë me afro tremijë e dyqind dollarë, një javë pasi ime shoqe ndërroi jetë dhe vetëm një ditë përpara se asaj t'ia digjnin trupin. Unë e vajtova vdekjen e saj. Ma theu zemrën dhe më solli pikëllim të plotë. Ishim takuar që kur ishim të rinj dhe

kishim kaluar përmes vështirësive së bashku për afro dyzet vjet. Ajo shkoi e para në parajsë, pasi ishte trajtuar si një qen, ose më keq, në Kinë.

Kurse unë, u lashë mbi tokë. Im bir më prezantoi me një ndërmjetës, i cili do të më drejtonte për në Korenë e Jugut.

5. Kalimi i pragut të parë

Mbërritja në Korenë e Jugut ishte kalimi i pragut të parë për mua. Ishte ndryshe nga vajtja në Kinë, për shkak se sapo shkela në Korenë e Jugut, unë nuk mund të kthehesha dot më në Korenë e Veriut.

Dëgjova, prej tim biri dhe nga transmetimet në radio e në televizion, se Koreja e Jugut renditej e nënta ose e dhjeta mes vendeve më të pasura në botë. Për këtë arsye, unë prisja që Koreja e Jugut të ishte si një parajsë tokësore. Aspiroja të mësoja saldimin dhe doja të fitoja para, që të mund të bëja çfarëdolloj gjëje që të dëshiroja. Mendoja se nuk kishte asnjë gjë, që nuk mund ta bëje, po të kishe para. Paraja ishte jeta dhe ajo vendos gjithçka, si pushteti ose autoriteti në një shoqëri kapitaliste. Kjo është e vërtetë, me përjashtim të kishës.

Kam shumë gjëra për të bërë. Dua të lexoj dhe të studioj libra letërsie, libra shkencorë dhe Biblën. Ngaqë shumë njerëz në botë janë të etur për ta njohur në thellësi Biblën dhe madje janë gati edhe të përndiqen për të jetuar sipas Biblës, edhe unë doja të dija më tepër për të. Prandaj, e studiova me shumë zell, sapo mbërrita në qendrën e Shërbimit të Sigurimit Kombëtar në Korenë e Jugut. Madje unë dua të shkruaj edhe një temë diplome mbi Biblën. Do të bëj më të mirën time për ta mësuar Biblën, ngaqë jam një person i cili nuk dorëzohet lehtë, sapo ta kem marrë vendimin për të bërë diçka. Megjithatë, në moshën shtatëdhjetë e katër vjeçare, nuk kam kujtesë të mirë.

6. Sprovat, aleatët dhe armiqtë

Sprova në jetën time ishte të qenët në një situatë, ku nuk pata shumë para, pushtet ose autoritet. Për këtë arsye, sipas standardeve të botës, unë isha i pashpresë.

Një nga aleatët e mi ishte ndërmjetësi, që më ndihmoi kur kapërceva lumin Tumen për herë të parë. Për shembull, ai më tregoi ku ishte lumi i cekët ose i thellë.

Një aleat tjetër imi ishte Z. Kim, një ndërmjetës koreano-kinez në të pesëdhjetat. Ai më gjeti rastësisht dhe më ndihmoi të ngrihem, kur shtrihesha pa lëvizur përdhe, atje në male. Ai shkroi emrin dhe adresën e tij në një letër, kur më ndihmoi. Pasi mbërrita në Korenë e Jugut, u përpoqa ta ftoj atë në Kore, por ai nuk u lejua ta merrte vizën. Gjithashtu e kontaktova atë, ngaqë doja t'ia shpërbleja mirësinë që tregoi ndaj meje. Për këtë arsye, i dërgova një letër nëpërmjet një burri kinez, që vinte shpesh në Korenë e Jugut për punë dhe pastaj kthehej në Kinë. Z. Kim nuk m'u përgjigj mua, por ai ma përcolli mesazhin përmes burrit kinez. Z. Kim tha se ai thjesht më ndihmoi mua si një qenie njerëzore, që ka vlera morale, pa pasur asnjë pritshmëri për shpërblim. Unë e vlerësoj vërtet atë. Tani e kuptoj se mësova shumë gjëra prej tij.

Një aleat tjetër i imi është kisha koreano-kineze në Kinë. Ka shumë misionarë nga Koreja e Jugut, të cilët bashkëpunojnë me kishat koreano-kineze për t'i ndihmuar dezertorët koreanoveriorë, që përpiqen të shkojnë në Korenë e Jugut.

Një nga armiqtë e mi është një roje burgu, atje ku isha burgosur unë. Ai ishte më barbar sesa oficerët e burgut japonez, që shquheshin për brutalitetin e tyre.

Një armik tjetër i imi është pronari i shtëpisë në Kinë, ai për të cilin punoja unë. Ai më abuzoi duke më dhënë shpulla në faqe e duke më shkelmuar. Kur qava me zë të lartë, pa qenë në gjendje ta kontrolloja më veten, për shkak të keqtrajtimit të tij, pronari

më akuzoi përpara policisë dhe përfundimisht mua më zvarritën mbrapsht për në Korenë e Veriut.

7. Afrimi për te shpella më e brendshme në thellësi

Vuajta gjatë rrugës për në Korenë e Jugut, duke kaluar përmes Kinës dhe vendeve të tjera. Dezertorët koreanoveriorë duhet të hyjnë e të dalin në një mënyrë që nuk bie në sy. Për këto arsye, shumicën e kohës ne shkojmë përmes rrugëve të pasme, përmes kodrave, luginave dhe shkëmbinjve. Ndonjëherë rrëzohesha në rrugë për shkak të urisë dhe pastaj thjesht zvarritesha përpara. Mbj mend se më në fund mbërrita në një fushë, pas rrëzimeve dhe zvarritjeve të përsëritura. Një bujk më gjeti dhe më dha pak ushqim. Mezi ia dola të mbijetoj.

Udhëtimi nga Koreja e Veriut për në jetën normale në Korenë e Jugut më mori më tepër se një vit. M'u deshën katër muaj për të mbërritur në Tajlandë nga Kina, duke kaluar përmes Laosit, Vietnamit dhe Mianmarit. U burgosa në Tajlandë për tre muaj. U deshën shtatë muaj në total për të mbërritur në Korenë e Jugut. Pastaj, sapo mbërrita, m'u desh të rrija në qendrën e Shërbimit të Sigurimit Kombëtar për dy muaj dhe në qendrën e risistemimit në Hanauon për tre muaj. Grupi i dezertorëve koreanoveriorë, që mbërritën në Korenë e Jugut me mua kishin udhëtuar me ndërmjetës përmes rrugëve të ashpra me shkëmbinj të thepisur, gjithmonë të uritur.

8. Sprova e rëndë

Më në fund unë mbërrita në Korenë e Jugut, duke i shpëtuar vdekjes; megjithatë sprovat nuk ndaluan së ardhuri. Pata

vështirësi për ta kuptuar dialektin e Koresë së Jugut, kur shikoja televizor, kur lexoja gazetën, ose kur shihja tabelat. Koreanojugorët shpesh përdorin fjalë që për mua tingëllonin të huaja, prandaj unë nuk mund të komunikoj dot rrjedhshëm me koreanojugorët. Njerëzit më shmangnin ose madje edhe më mallkonin, kur nuk kuptoja se çfarë thoshin. Unë lëndohesha prej qëndrimit të tyre. Ndonjëherë, kur shihja ndonjë tabelë të shkruar vetëm në anglisht, pyesja ndonjë kalimtar aty pranë për kuptimin e tabelës. Nuk e dija kuptimin e fjalëve *supë* ose *qendër*, ngaqë ndonjëherë këtu fjalët janë në anglisht ose në gjjuhën kineze, por jo në ndonjërin dialekt korean që unë njihja. Duke mos e ditur kuptimin e fjalëve të huaja, jeta ime e përditshme ishte e mbushur me vështirësi.

Njëherë, kur më erdhi në shtëpi një hidraulik për të rregulluar tualetin, nuk e kapa mirë fjalën *kaçavidë*, se m'u dëgjua si "lodra". Hidrauliku më shau dhe më quajti budalla. Unë u zemërova aq shumë me të, sa e nxora përjashta me shkelma. Një gjë e mirë këtu në Korenë e Jugut është se unë kam lirinë të mos bëj ato gjëra, që nuk dua t'i bëj. Prapëseprapë, unë në fakt duhej të kisha kërkuar me modesti që të më shfajësonte për moskuptimin e asaj që po më thoshte hidrauliku, dhe t'i kisha treguar se jam nga Koreja e Veriut. Por unë thjesht reagoja keq, ashtu siç më kishin trajtuar të tjerët keq mua, me zemërim. E kuptoj se ky është gabimi im, dhe se unë nuk sillem gjithmonë mirë.

9. Shpërblimi

Ndonëse akoma kam ca vështirësi në komunikimin me koreanojugorët, unë jetoj një jetë të lumtur në Republikën e Koresë. Është një vend demokratik dhe unë kam një apartament me ushqim, rroba dhe pajisje shtëpiake. Qeveria e Koresë së Jugut më mbështet me apartamentin dhe me disa nga shpenzimet

e jetesës. Më janë ofruar gjashtëqind e pesëdhjetë dollar në muaj për pesë vjet dhe më pas treqind e pesëdhjetë dollarë në muaj. Përveç këtyre, unë marr njëzet kilogramë oriz çdo dy muaj, si dhe siguracionin mjekësor. Edhe kisha ime më mbështet. Mua madje më kanë dhënë edhe kimçi, një gjellë tradicionale koreane, të fermentuar, të bërë me perime dhe një llojshmëri erëzash. Gjithashtu unë marr rroba, ushqim dhe gjellë. Jam mbështetur prej qeverisë së Koresë së Jugut, prej kishës sime dhe fqinjëve të mi. Megjithatë, ndonjëherë ndihem sikur jam një barrë, për shkak se unë vetëm marr ndihmë prej të tjerëve, dhe nuk jap asnjë gjë si këmbim. Për këtë arsye, jetoj me kursim, që të mund të kursej para, për ta shlyer hirin që kam marrë. Do ta shlyej atë tek njerëzit e qytetit tim të lindjes.

Mbi të gjitha, unë kam marrë hirin e Perëndisë. Tani e di se Perëndia flijoi Birin e Tij të vetëm, Jezus Krishtin, në kryq për të më shpëtuar mua, një mëkatar kaq i pavlerë. E mësova këtë përmes Universitetit të Fshthtë të sponsorizuar prej Zërit të Martirëve në Kore. Përveç këtyre gjërave, unë kam një vend ku të jetoj dhe ushqim për të ngrënë. Shpërblimet që kam marrë janë hiri i Perëndisë dhe pasuria materiale.

10. Rruga për kthimin

Do të bëj pasuri dhe do ta kursej atë, me qëllim që t'ua shpërndaj të afërmyve të mi në Korenë e Veriut, kur Koreja të bashkohet. Do të printoj mijëra Bibla për t'ua shpërndarë koreanoveriorëve. Është detyra ime ta ungjillëzoj Korenë e Veriut duke ngritur kisha dhe duke përhapur ungjillin. Me patjetër do të kthehem në qytetin tim të lindjes, kur Koreja të bashkohet; por, nuk mund të kthehem duar bosh. Do të sjell afro dyzet e pesë mijë dollarë dhe do të formoj një kishë me miqtë e mi të vjetër dhe me të afërmit e mi. Do t'u jap atyre para.

Plani im, ai i madhi, është t'u jap para atyre që janë të dobët dhe të varfër, ashtu siç isha unë dikur. Do t'i jap njërit pesëqind dollarë, kurse tjetrit njëmijë dollarë.

Unë do të vendos sasinë e parave që do t'u jap, bazuar në situatën e personit, kushtet e jetesës, ose gjendjen mendore. Për ata që janë duke vdekur, do të sigurohem që ata të marrin njëmijë dollarë. Dhe do t'i lejoj personat që i marrin paratë t'i ndihmojnë të tjerët me paratë që do të marrin. Unë nuk do t'u jap para atyre që të bëjnë kisha, por do të doja t'i mësoja ata që të besojnë në Perëndinë. Kjo nuk do të thotë se kushdo që shkon në kishë do të financohet. Do të financoj vetëm ata që besojnë te Perëndia dhe që janë të gatshëm t'u shërbejnë të tjerëve. Nëse dikush e mohon besimin te Perëndia ose refuzon t'u shërbejë të tjerëve, ata nuk do të financohen prej meje. Nuk do t'i mësoj ata me para, por dua t'i mbështes njerëzit që dëshirojnë ta njohin Biblën me sinqeritet.

Nëse Fryma e Shenjtë vjen në Korenë e Veriut, regjimi diktatorial do të zhduket dhe do të vendoset një qeveri demokratike (e cila garanton të drejtat e njeriut), që njerëzit të mundin të jetojnë të lumtur në liri dhe me stabilitet financiar. Edhe pse ka të krishterë të fshehtë për momentin në Korenë e Veriut, ata nuk mund ta zbulojnë besimin e tyre pa u përndjekur prej qeverisë diktatoriale. Kjo është arsyeja pse ka vazhduar deri më tani regjimi i Kim Jong Un-it. Nëse ky regjim diktatorial rrëzohet, kishat do të mbijetojnë përgjithmonë në Korenë e Veriut.

11. Ringjallja

Pres që të ketë rrëmujëra prej forcave të majta pro-Koresë së Veriut, kur vendet tona të bashkohen në të ardhmen. Ata që mbështesin familjen e Kim Jong Il-it dhe sillen si agentë të fshehtë në Veri do të përpiqen ta prishin rritjen e kishave, kur të vendoset

qeveria demokratike. Gjithsesi është e dukshme: unë nuk do të heq dorë nga përhapja e Ungjillit dhe Biblës. Përkundrazi, do ta mposht këtë pengesë.

12. Rikthimi me eliksirin

Njerëzit në shtëpi atje do të më admirojnë dhe do të mendojnë se unë e gjeta rrugën e duhur dhe bëra zgjedhjen e duhur, ndaj do të duan ta ndjekin shembullin tim. Edhe pse dikur pata shumë vështirësi dhe pothuajse isha duke vdekur, tani jam duke jetuar një jetë të kënaqshme. Njerëzit do të më admirojnë. Njerëzit mund të kenë vështirësi dhe përvoja të dhimbshme. Gjithashtu ata mund të hasin në ndonjë krizë dhe të përballen me vdekjen. Por, nëse nuk mundim dot t'i mposhtim këto vështirësi, ne nuk kemi asnjë shpresë. Është një thënie e vjetër: “Me përpjekje të vazhdueshme për ta ngjitur malin, nuk ka asnjë mal që njerëzit nuk mund ta ngjisin dot.” Kjo do të thotë se një njeri mundet ta mposhtë cilëndo vështirësi ose krizë, për sa kohë që ai ose ajo përpiket vazhdimisht. Ashtu siç premton kjo thënie e vjetër, unë do të jem në gjendje t'i mposht vështirësitë në të ardhmen, kur të kthehem në Veri për të themeluar kishat.

Mendoj se njerëzit bekohen në të njëjtën masë me të cilën i durojnë vështirësitë. Ne nuk duhet t'i ngacmojmë të dobëtit, t'i shfrytëzojmë ata për para ose për kënaqësi, ose t'i vrasim. Si dezertorë koreano-veriorë, ne nuk mund të fitojmë para lehtësisht, por përkundrazi, na duhet të përpiqemi shumë më tepër për të siguruar jetesën. Do t'u tregoj njerëzve atje në shtëpi, se ata mund të arrijnë të jenë të lumtur edhe pas shumë vështirësive. Do t'u them atyre, që ta dinë se nuk ka dreka falas. Gjithashtu, do t'i inkurajoj ata t'i ndihmojnë të tjerët, ashtu siç ata vetë u ndihmuan prej të tjerëve. Ne duhet ta shkëmbejmë dashurinë.



Ribashkimi i Koreve do të thotë se regjimi i Koresë së Veriut do të jetë rrëzuar. Shpërndarja e parave ose rrobave do të jetë ndihmë për njerëzit në Korenë e Veriut, por ajo që është më e rëndësishmja, unë do të doja të ndaja dëshminë time për Perëndinë me miqtë e mi të vjetër. Do të sjell afro njëmijë kopje të Biblës dhe afro njëqind kostume për veshje, duke e pajisur të paktën një qytet me Frymën e Shenjtë. Këta njerëz do ta ndjekin Perëndinë, duke i rrezikuar jetët e tyre. Së pari, unë do të jem një model i mirë për veten time dhe që ta arrij këtë, jam duke e studiuar Biblën me gjithë zemër e me gjithë forcën time në shkollën e trajnimit të misionarëve të Universitetit të Fshehtë. Nuk kam bërë as edhe një mungesë dhe as nuk kam qenë me vonesë asnjëherë, as nuk jam larguar herët nga shkolla.

Kapitulli 9.

Znj. Seo: Lufta për çdo hap

*Në të vërtetë po ju them se, kur ishe më
i ri, visheshe vetë dhe shkoje ku të doje; por kur të
plakesh, do t'i shtrish krahët dhe dikush tjetër do të
të veshë e do të të shpjerë atje ku nuk
do të doje të shkoje.*

— Gjoni 21:18

1. Bota e zakonshme

Unë linda në Nampo (Nampho), Koreja e Veriut, në fillim të viteve 1960-të. Jam fëmija e parë mes dy djemve dhe tre vajzave. Im atë ishte pilot, por e përmbushi detyrën e tij, kurse mamaja ime punonte si anëtare e stafit botues të një gazete.

Familja ime dikur jetonte në një shtëpi të vogël njëkatëshe në Nampo. Gjyshja ime sillej shumë ashpër me mamamë time dhe prindërit e mi u divorcuan, kur unë isha tetë vjeçe. Pasi u divorcua nga im atë, mamaja jetoi dhe punoi në një fabrikë. Motrën time më të vogël dhe mua na rriti gjyshja, kurse motrën e dytë më të vogël e rriti tezja ime në Pjongiang.

Gjyshja ime ishte shumë e sertë dhe strikte me mua dhe motrën time. Ajo kishte nofkën “Mbreti Gjyshe.” Mbaj mend që ndonjëherë hanim dajak prej saj. Gjyshja më disiplinonte mua dhe motrat e mia në mënyrë shumë strikte, në mënyrë që të tjerët të mos na korrigjonin.

Im atë ishte futur në burg, për shkak se ai kishte luftuar me të tjerët. Ai u dënua me pesë vjet burgim, por u përzgjedh si i burgosur model dhe u lirua me kusht pas vetëm tre vitesh. Ai u caktua në Haiçen, pasi u lirua dhe për këtë arsye familja jonë u shpërngul atje. Një vit më vonë, prindërit e mi u pajtuan dhe edhe mamaja ime erdhi në Haiçen. Mamaja tha se ajo vendosi të pajtohej me tim atë, për shkak se kishte merak për mua. Familja jonë u mblodh sërish bashkë, kurse motra ime më e vogël, e dyta, u rrit prej tezes. Mamaja ime lindi vëllain tim më të vogël në Haiçen.

Unë nuk isha e lumtur për jetën në Haiçen, për shkak se ishte një qytet provincial dhe unë më përpara kisha jetuar në Nampo. Por familja ime ishte e lumtur. Unë kisha talent për artet dhe sportet dhe njerëzit më donin, ngaqë isha e shkëlqyer.

Në Haiçen, im atë punoi për Departamentin Shtetëror të Sigurimit (SPSD). Ai i mbikëqyrte punëtorët koreanoveriorë në Bashkimin Sovjetik. Ai jetoi në Bashkimin Sovjetik për tre vjet. Ai pagoi paratë për dasmën time dhe ndihmoi me përgatitjet, kur u kthye në Haiçen. Ai madje më bleu edhe këpucët e dasmës.

Ishte dikush me të cilin kishim dy vjet që takoheshim e doja të martohesha me të. Punoja për një zyrë dizajni arkitekturor, si fillestare, pasi isha diplomuar prej kolegjit, dhe ky burri, bashkëshorti im i ardhshëm, ishte arkitekt në të njëjtën zyrë. Ai kishte studiuar për ndërtim në universitet. Ne punonim bashkë dhe nisëm të shoqëroheshim; megjithatë prindërit e mi e kundërshtuan martesën tonë, për shkak të prejardhjes së tij të keqe: njëri nga të afërmit e tij ishte arratisur për në Korenë e Jugut. Unë këmbëngula me kokëfortësi, se doja të martohesha me tim shoq, pavarësisht kundërshtimit të zjarhtë prej prindërve të mi. Një herë m'u desh të hidhesha poshtë nga kati i tretë i pallatit, për të ikur prej rrahjeve të tim eti. Mendoj se kisha dashur të shkëputesha prej shtëpisë, për shkak se isha rritur nën kujdesin shumë strikt prej gjyshes sime.

Luftova me tim atë për martesën time për afro një vit. Më në fund, im atë i kërkoi motrës së tij më të madhe ta vinte në

provë bashkëshortin tim të ardhshëm. Halla ime e vuri në provë atë për tri ditë dhe pastaj në fund, ajo dha aprovimin e im atë përfundimisht ra dakord të më lejonte të martohesha me të.

Pasi u martova me tim shoq, të cilin e doja, unë jetova e lumtur. Ne patëm dy djem. Nuk njihja asgjë, përveç dashurisë për tim shoq. Pasi u martova, pata plot mundësi për të dëgjuar e për të lexuar për botën jashtë Koresë së Veriut. Seritë e plota të literaturës botërore mbulonin një mur të tërë në raftet e një dhome në shtëpinë tonë.

Vjehrrin im ishte shkrimtar, kurse vjehrrja ishte pianiste, që ishte diplomuar nga Universiteti i Arteve. Bashkëshorti im i kishte pranuar kulturat e huaja dhe kishte njohuri të thelluar për to, për shkak se ai kishte lexuar libra të letërsisë botërore, që kur ishte fëmijë. Ai gjithmonë donte të shkonte në Korenë e Jugut. Ai madje dëgjonte një transmetim në radio prej Koresë së Jugut.

Djemtë e mi u ndikuan prej të atit të tyre, kështu që edhe ata kishin plot njohuri për vendet e huaja dhe kulturat e tyre. Ata i admironin këto vende të huaja dhe dëshironin që të shkonin atje. Që kur blemë një televizor në vitin 2006, unë shikoja telenovelat dhe filmat nga Koreja e Jugut, duke përfshirë *Dae Jang Geum*, një seri televizive për një kuzhinier mbretëror, *Jumong*, një seri televizive për një person historik të Koresë dhe *The Hole*, një film korean. Kur shikoja telenovelat dhe filmat koreanë dhe kur pashë fotografitë e të afërmeve të burrit tim, që jetonin në Korenë e Jugut, mendova se Koreja e Jugut ishte një vend i pasur. Dëshiroja të shkoja në Korenë e Jugut, por nuk kisha guxim. Rruga për të shkuar në Jug, ishte bllokuar prej paralelit të 38-të.

Bashkëshorti im ishte fizikisht i dobët, dhe shëndeti i tij u përkeqësua, përpara se ai në fund të ndërronte jetë. Ne kishim qenë së bashku për tetëmbëdhjetë vjet. Ai kishte shikim të dobët, prandaj mbante syze, dhe kishte dhimbje prej artritit reumatoid. Ai ishte, jo vetëm një bashkëshort dhe baba i mirë, por gjithashtu një

person i talentuar. Ishte për të ardhur keq, që im shoq, i cili kishte lexuar shumë libra dhe ishte kaq i ditur, ndërroi jetë kaq herët.

2. Thirrja për aventura

Unë e mbështesja familjen time duke shitur pjesë këmbimi automjetesh në tregje, por pësova tri ishemi në vitin 2006 dhe gjysma e trupit tim u paralizua. Unë as nuk mundja të flisja dot. Duke kthyer kokën pas tani, mund ta shoh se arsyeja e rrëzimit tim ishte nga të punuarit e tepërt. Mbaja barra të rënda mbi shpinë çdo ditë.

Merrja mjekimet nga spitali dhe rrija shtrirë në shtëpi, e sëmurë. Djemtë e mi nisën të fitonin para për të siguruar jetesën. Djali im më i madh jepte mësimë futbollit në sallën e djemve dhe fitonte edhe më tepër para duke dhënë mësim me orë shtesë. Djali im i dytë jepte mësim klarinete në sallën e djemve dhe fitonte edhe më shumë para duke dhënë mësimë kitare si orë shtesë. Familja ime mundej të jetonte për shkak të djemve të mi. Familja ime për atë kohë ishte më e pasura e lagjes.

Mendova që t'i martoja të dy djemtë, tani që i kisha kushtet financiare për ta përballuar. Djali im më i madh u martua në prill 2009, dhe unë jetova me të dhe me nusen e tij. Por unë doja të shkoja të jetoja në Kinë, ngaqë nuk doja t'u bëhesha barrë atyre. Nusja e djalit tim kishte të afërm në Kinë, kështu që ajo fliste gjjuhën kineze dhe ne shkonim shpesh atje. Familja ime vendosi të më lejonte të shkoja në Kinë, dhe unë e kapërceva lumin Jalu (Yalu), në Pjonganin Verior (North Pyongan), në Korenë e Veriut. Vetëm djemtë e mi dhe nusja e djalit të madh e dinin që e kapërceva lumin, duke u drejtuar për në Çangbaek (Changbaek). Djali im i dytë erdhi me mua që ta kapërcenim lumin bashkë dhe të më drejtonte për te shtëpia e të afërmeve të nuses së djalit tim; gjithsesi unë dhe ai u kapëm në Dandong dhe u dërguam në burg në Sinuixhu (Sinuiju), në Korenë e Veriut.

3. Refuzimi i thirrjes

Ne u mbajtëm në burg në Sinuixhu për një muaj, përpara se të na dërgonin te rajoni i policisë në Haiçen. Djali im më i madh shpenzoi shumë para, që të më nxirrte mua nga rajoni i policisë në Haiçen, kurse djalin tim të dytë e dërguan në kampin e punës në Haiçen; megjithatë edhe ai u lirua shpejt, sapo djali im i madh i pagoi paratë për lirimin e tij.

Në vitin 2010, e gjithë familja ime vendosi të arratiseshim për në Korenë e Jugut. Për këtë arsye, ne i shitëm të gjitha pronat, përfshirë edhe televizorin tonë dhe u përhapëm anembanë vendit. U bëra vizitë prindërve të mi për t'u thënë mirupafshim dhe pastaj kapërcyem lumin Jalu. Nuk e hiqja dot nga mendja aspiratën për të ikur nga Koreja e Veriut, sapo e kisha provuar për herë të parë atë ikje. Nuk doja më të jetoja në Korenë e Veriut. Pa liri, në Korenë e Veriut është errësirë e plotë. Djali im i madh dhe gruaja e tij më siguruan duke thënë se ata do të më gjenin, kudo që të shkoja. Ata më inkurajuan që ta kaloja lumin Jalu, prandaj më në fund e kalova atë lumë sërish në janar.

Nusja e djalit kontaktoi atë burrin kinez Han, i cili na kishte udhëhequr, kur isha bashkë me djalin tim të dytë, për te shtëpia e të afërmeve të nuses së djalit të madh, kur e kaluam për herë të parë lumin Jalu. Pasi e kapërceva lumin, e mora në telefon dhe ai më shpuri me makinë në shtëpinë e tij. Por ai dukej sikur m'u afrua me qëllime të këqija. Kur e takova atë në udhëtimin tim të parë në Kinë, në vitin 2009, ai dukej sikur po përpiquej të merrte vesh, nëse kisha burrë apo jo. Edhe pse mund të mos e kuptoja mirë gjuhën kineze, aq pak arrija ta merrja vesh. Kështu që, iu përgjigja se bashkëshorti më kishte vdekur. Ai u përpoq të më shpinte në shtëpinë e tij në atë kohë, por i kërkova që të më shpinte te destinacioni im. Ai nuk ma vuri veshin fare. Ndërsa po bënim pazarin për këtë, djali im i dytë dhe unë u zbuluam, dhe na dërguan mbrapsht në Korenë e Veriut. Kurse kësaj radhe, ai më

shpuri mua direkt në shtëpinë e vet. Ky burrë kinez Han, kishte tre fëmijë gjithsej, por kur shkova në shtëpinë e tij, atje ishte vetëm një djalë.

4. Takimi i mentorit

Djali im i dytë dikur punonte si mësues i edukimit fizik në një shkollë sportive. Drejtori i shkollës na vinte për vizitë në shtëpi dhe kalonte kohë me dy djemtë e mi. Ai u tregonte histori për përvojat e tij të udhëtimeve jashtë shtetit, dhe i inkurajonte ata, kur e humbën babain e po kalonin një kohë të vështirë. Ai ishte si një baba zëvendësues për ta. Megjithatë, nuk dukej gjëja e duhur nga ana shoqërore, që një burrë i bën vizita të shpeshta shtëpisë së një gruaje të ve. Pavarësisht nga kjo, ai ishte një mbështetje e madhe për mua nga ana mendore, për shkak se në atë kohë unë po vuaja pas vdekjes së tim shoqi, dhe askush tjetër nuk erdhi për vizitë ose për të ndihmuar.

5. Kalimi i pragut të parë

Pasi më mori ai burri kinez Han, unë thjesht vendosa të jetoj në shtëpinë e tij, pa menduar për gjërat që doja apo nuk doja. Unë isha e sëmurë dhe nuk mund të flisja dot as edhe një fjalë në gjuhën kineze. Ishte njësoj si të isha memece. Kjo funksionoi për mbijetesën time pa u ankuar. Kisha një mal me punë për të bërë.

Tre muaj, pasi mbërrita, djali im i madh më mori në telefon, përpara se të hipte në aeroplanin për në Korenë e Jugut nga Tajlanda. Ai mori në telefon sërish nga Hanauon-i, qendra e risistemimit në Korenë e Jugut. Ai tha se jo shumë kohë, pasi kisha ikur unë për në Kinë, të dy djemtë e mi bashkë me nusen e djalit të madh ishin larguar nga Koreja e Veriut.

Sapo e pata këtë lidhje me tim bir, po ruaja rastin që të arratisesha nga shtëpia e këtij burrit kinez Han; mirëpo, nuk ishte aq e thjeshtë të largoheshe prej tij. Një ndërmjetës më dha një hapësirë dy-ditore, për të shkuar te të afërmit e nuses së djalit tim në Janxhi, prej ku, pastaj do të udhëtoja për në Korenë e Jugut. U përpoqa të arratisesha dy herë, por të dyja përpjekjet dështuan. U ktheva në shtëpi duke qarë, e kapur prej burrit kinez Han. Një herë ai më ndoqi me motoçikletën e tij, kurse herën tjetër më ndoqi me makinën e vet.

Më në fund, burri kinez Han u arrestua prej policisë, ndërkohë që ishte duke mbledhur stika pishe. Ai u arratis prej rajonit të policisë në një krahinë tjetër, kështu që tani ishte rasti im për të shpëtuar! E mbylla derën dhe vrapova për te stacioni i autobusit që të merrja autobusin për në Janxhi, sapo djali i tij shkoi në shkollë në mëngjes. Kishin kaluar shtatë muaj, që kur mbërrita në Kinë. Mora një autobus për të shkuar në shtëpinë e të afërmit të nuses së djalit tim në Janxhi. Nusja e djalit tim kishte shumë të afërm, që jetonin në Janxhi, ngaqë e ëma e saj ishte rritur në Kinë. Megjithëse nuk kisha fare para për të marrë autobusin, i premtova shoferit të autobusit se do ta paguaja biletën, kur të mbërrija në Janxhi. Prindërit e nuses së djalit tim paguan, kur mbërrita unë. Djali im i madh dërgoi një ndërmjetës në Janxhi, dhe më në fund unë nisa rrugën për në Korenë e Jugut.

6. Sprovat, aleatët dhe armiqtë

Pasi ndërroi jetë im shoq, duhet ta mbështesja familjen time duke shitur pjesë makinash në tregje. Mbaja barra të rënda mbi supe ditë për ditë, për tre vjet rresht. Ishte e rëndë për trupin tim, thjeshtë si grua që isha. Pësova ishemi tre herë në vitin 2006 dhe u bëra pjesërisht e paralizuar. Kjo ishte prova më e rëndë që më është dashur të duroj ndonjëherë.

Në lidhje me aleatët, unë jetova me tim shoq vetëm për tetëmbëdhjetë vjet, por ai më deshi shumë. Mendova se mënyra për ta dashur tim shoq ishte ta lejoja atë të bënte çfarë të donte, ndërkohë që unë kujdesesha për pjesën tjetër të botës. Dhe mendoja se ai mund të ma kthente dashurinë duke u kujdesur për shtëpinë tonë. Burri im kujdesej me zell për shtëpinë tonë dhe po ashtu edhe për djemtë tanë. Me tim shoq bëja një jetë të lehtë dhe të rehatshme. Ai përgatiste darkën për mua, prandaj kisha mundësi që thjesht të haja darkën e të pushoja pasi kthehesha nga puna. Ai madje nxirrte edhe ujin nga pusi dhe i riparonte duke qepur rrobat e sportit të fëmijëve. E ndieja dashurinë e madhe të tim shoqi, kur ai përkujdesej me zell për shtëpinë tonë. Një ditë, kur po kërkoja një komplet me gjëra për qepje, ndieva mall të vërtetë për tim shoq, pasi ai kishte ndërruar jetë.

Gjyshja ime ishte një armik për mua, ngaqë ajo na disiplinonte mua dhe motrat e mia me shumë ashpërsi. Nuk më pëlqente gjyshja, por më vonë arrita ta kuptoja atë. Arsyeja që e urreja ishte sepse ajo na godiste ne dhe ishte e ashpër me mamanë time, gjë që rezultoi në divorcin e mamasë e të babait tim. Gjithsesi, prindërit e mi u pajtuan më vonë.

7. Afrimi për te shpella më e brendshme në thellësi

Kur më kapën mua bashkë me djalin tim të dytë dhe na dërguan në burg në Sinuixhu, mendova se më kishte ardhur fundi. Më shpunë në burg për herë të parë në jetën time. Burgu dukej si ai që e kisha parë në një film për martirët patriotë që morën pjesë në lëvizjen anti-japoneze gjatë periudhës koloniale japoneze. Jetoja në një dysHEME të ftohtë prej çimentoje, vetëm me pluhur lëvoreje orizi për ta ngrënë për të tre vaktet e ditës. Njerëzit vuanin nga

kapslëlëku, për shkak se kishin për të ngrënë vetëm pluhur orizi të ngurtësuar. Ata madje rrinin duke qarë në tualet. Djali im i dytë rrinte në qelinë përballë times. Ai u bë drejtues i shokëve të qelisë, me pushtet. Kur u dërguam në rajonin e policisë në Haiçen, pas kohës që kaluam në burgun e Sinuixhu-t, unë arrita të shkoj drejt e në shtëpi nga rajoni i Haiçenit. Djali im i madh pagoi shumë para, që të më nxirrte prej burgut.

Pasi im shoq ndërroi jetë, ne lëvizëm nga shtëpia jonë njëkatëshe, për në një apartament, për të reduktuar shpenzimet e jetesës. Punova fort për të siguruar jetesën duke shitur pjesë këmbimi automobilash nëpër tregje. Gjithashtu shisja verë orizi dhe ushqim të bërë në shtëpi te posta kufitare ushtarake në kufirin mes Koresë së Veriut dhe Kinës, në Haiçen. Rojet e postës kufitare me raste ma ndërprisnin punën. Në atë çast, unë duhej t'u jepja atyre ca para ose cigare si formë ryshfeti.

8. Sprova e rëndë

Përpara se ta kapërceja lumin Jalu për herën e dytë, bleva një grusht opium prej kunatit tim të vogël. Vendosa se do të bëja vetvrasje, nëse më kapnin. Dezertorët e tjerë koreanoveriorë bënë të njëjtën gjë, e kapërcenin lumin me drogë me vete, duke rrezikuar jetën, për shkak se nuk donim që të duronim përvoja të turpshme sërish në burg.

Unë pa diskutim që u turpërova në burg. Kur më dërguan në burg për herë të parë, nuk kisha rroba për t'u ndërruar. Isha me nëntëmbëdhjetë gra të tjera në qeli. Një gardiane na kontrollonte dhe veshjet tona, ndërkohë që ne rrinim në këmbë lakuriq. Për mua kjo ishte një provë e rëndë, për shkak se kurrë nuk kisha qenë në burg dhe as nuk isha trajtuar me kaq paturpësi më parë. Rojet e burgut më ruanin, edhe kur kryeja nevojat personale në tualetin e qelisë. Ndonjëherë më qortonte gardiani për sasinë e kohës që

kaloja në tualet. Më duhej të përdorja copa të prera veshjesh si letër tualeti.

Një sprovë tjetër që kalova ishte, kur më rrëmbeu ai burri kinez Han dhe kur nuk mundja dot as të dilja fare përjashta nga shtëpia. Nuk mundja dot të flisja gjuhën kineze dhe gjithmonë shqetësohesha se mos më kthenin mbrapsht në Korenë e Veriut.

Pse Perëndia lejoi që t'i kaloja të gjitha këto sprova? Mendoj se Ai më përgatiti mua që t'i përdorja përvojat e mia për të ndihmuar gratë koreanoveriore, të cilat po hasnin situata edhe më të këqija nga të miat, duke më lejuar mua të përjetoja këtë vuajtje dhe dhimbje. Aktualisht, dhimbjet që durova nuk janë aq të këqija sa ato që kanë duruar gra të tjera koreanoveriore, të cilat i njoh; megjithatë, Perëndia lejoi të përjetoja mjaft vështirësi, që të mund t'i kuptoja gratë e tjera koreanoveriore, ndërkohë që po shkoja e sigurt për në Korenë e Jugut.

9. Shpërblimi

Besimi në Perëndinë si Ati im është shpërblimi që kam marrë. Në Hanauon, te qendra e risistemimit të refugjatëve në Korenë e Jugut, ishte e detyrueshme të kishe një besim fetar. Ne duhej të zgjidhnim mes Krishterimit Protestant, Katolicizmit dhe Budizmit. Unë nuk e njihja mirë Perëndinë në atë kohë dhe muzika e këngëve të Ungjillit ishte tepër e zhurshme për mua. Për këtë arsye, shkova në kishën katolike.

Pasi u largova nga qendra e Hanauon-it, ishte e vështirë të gjeja një kishë katolike pranë shtëpisë sime. Afër asaj kohe, një grup njerëzish nga Shoqëria e Misionit për Botën të Kishës së Perëndisë, një kult, më erdhën për vizitë, me qëllim që të më ungjillëzonin; megjithatë, pas tre ose katër vizitash, unë arrita ta dalloja se ata nuk i besonin Perëndisë së vërtetë, por i zinin besë Ahn Sang Hong-ut, drejtuesit të kultit. I ndërpreva takimet me ta dhe nisa

të shkoja te një kishë e Ungjillit të Plotë, pranë shtëpisë sime. Por nuk ishte shumë interesante të shkoja në kishën Ungjilli i Plotë pa pasur asnjë koreanoverior tjetër atje.

Në atë kohë, unë shkova te Shkolla Teknologjike e Universitetit të Fshehtë (TUF) të “Zërit të Martirëve” në Kore, pasi isha prezantuar prej një dezertoreje koreanoveriore. Mezi arrita ta merrja rekomandimin prej pastorit, siç kërkohej. Shkova në Shkollën e TUF për gjashtë muaj dhe atje mësova siç duhej për Perëndinë. Pastaj vazhdova studimet në shkollën e trajnimit të misionarëve të Universitetit të Fshehtë të “Zërit të Martirëve” në Kore, i cili ishte një kurs njëvjeçar. Teksa kam arritur ta njoh Perëndinë e Vërtetë, kam arritur të kuptoj se unë jam një mëkatore, edhe pse jam e sinqertë. Gjithashtu zbulova se pa njohjen e Perëndisë, isha duke e humbur jetën time kot. Edhe sikur një njeri të jetë i zgjuar, nëse nuk e njeh Perëndinë, jetën e ka të padobishme.

Teksa kam arritur ta njoh Perëndinë dhe t’i besoj Atij, gjithashtu kam arritur ta njoh qëllimin e jetës sime. E kuptoj se Perëndia i përdor dobësitë e mia dhe përvojat e vështira. Kjo është arsyeja se pse kërkoj ta njoh më tepër Perëndinë; megjithatë, tani duket sikur njoh vetëm një të tretën e Perëndisë. Më pak se 10 përqind e dezertorëve koreanoveriorë, nga ata rreth e rrotull meje, njohin Perëndinë. Unë gjithashtu nuk dija për Perëndinë, kur isha në Korenë e Veriut, por arrita të mësoj shumë për Perëndinë, kur po shkoja në TUF dhe në UF. U përpoqa të lutesha përditë përballë kryqit atje. Jam më e etur për ta njohur Perëndinë, sesa për të fituar para.

10. Rruga për kthimin

Shkova në disa udhëtime misioni në Kinë si studente e UF. Takova jetimë dhe gra dezertore nga Koreja e Veriut. Një grua koreanoveriore që e takova, po shtirej se ishte koreano-kineze, që ta fshihte identitetin e saj. Ajo ishte një dhjake, që kishte shkuar në kishë për një kohë

të gjatë; megjithatë, ajo nuk dukej sikur e kishte harruar krejtësisht lakminë e saj për para, edhe pse ajo thoshte se i besonte Perëndisë dhe shkonte në kishë. Doja t'i tregoja asaj, se ajo duhet ta hiqte qafe lakminë e saj, por në të njëjtën kohë, mendova se ajo kishte besim më të mirë në Perëndinë nga sa kisha unë. Të paktën, ajo po përpiquej të mësonte më shumë për Perëndinë, ndërkohë që jetonte në një vend të huaj. Mendoj se mësova më tepër gjëra për vete, sesa u mësova të tjerëve, kur shkova në këto udhëtime misioni.

Kur të bashkohen Koreja e Veriut me atë të Jugut, unë dua të kthehem në qytetin tim dhe t'i takoj prindërit, familjen dhe kunatin. Do doja t'u tregoja atyre për Perëndinë, në vend që t'u jepja dhurata. Besoj se kunati im dhe familja e tij do ta pranojnë Perëndinë shpejt, sapo ta dëgjojnë ungjillin, ashtu siç e pranova edhe unë Perëndinë shpejt. Unë do t'u them atyre: "Kam jetuar dhe i kam rritur mirë të gjithë fëmijët e mi deri tani, për shkak se kam besuar në Perëndinë. Ju gjithashtu duhet ta njihni Perëndinë hap pas hapi." Dhe unë gjithashtu dua të themeloj një shkollë të UF në qytetin tim.

11. Ringjallja

Natyrisht, do të ketë disa pengesa e vështirësi kur ta ngre shkollën e UF, pasi të kthehem në Korenë e Veriut. Do të kushtojë shumë para. Po të has vështirësi, ngaqë nuk do të kem sasinë e duhur të parave, unë nuk do të pushoj së luturi duke i kërkuar ndihmë Perëndisë. Ne nuk duhet të mbështetemi te njerëzit, por duhet të besojmë te Perëndia, kur përballemi me vështirësi. Kurdoherë që jam përballur me sfida, jam mbështetur te Perëndia, duke besuar fort se Perëndia do të sigurojë për mua. Mund të fitoja çfarëdo gjëje që më nevojitej, teksa mbështetesh te Perëndia, në vend që të ndihesha e liruar prej gjërave të dukshme. Perëndia plotësoi secilën nga nevojat e mia. Kjo është mënyra e vërtetë për të jetuar si Jezusi, i cili është ringjallur.

12. Rikthimi me eliksirin

Për ta përmbushur ëndrrën time për të ngritur një shkollë të UF në Korenë e Veriut, së pari unë duhet ta mbaroj për vete semestrin e fundit të shkollës së UF të “Zërit të Martirëve” e të dal mirë. Pastaj do të kaloj edhe një vit tjetër në UF si praktikante. Do t’i mësoj koreanoveriorët një e nga një, për gjërat që kam mësuar në Universitetin e Fshehtë. Mendoj se do të mblidhen të paktën njëmijë njerëz, kur ta filloj UF në qytetin tim. Kur të mblidhen njerëzit, unë mund të mësoj njëmijë njerëz duke i ndarë ata nëpër klasa me nga njëzet studentë. Kjo do të thotë që do të ketë pesëdhjetë klasa. Gjithashtu do të formoj grupe të vogla me nga pesë persona, dhe do të caktoj nga një drejtues në çdo grup. Kjo është arsyeja se përse duhet ta studioj me dëshpërim Fjalën e Perëndisë.



Kapitulli 10.

Z. Park: Udhëtimi në hapat e mamasë së tij

*Ti ke qenë një vajzë e adhureshme,
grua e përgjegjshme, nënë e dashur.
Mbetet për t'u parë, nëse do të të
mund të të imitoj dot ty.*

— Hema Ravi⁴²

1. Bota e zakonshme

Unë u lindi në Tenkën (Tanchon), Hemgiong-u Jugor (South Hamgyong), në Korenë e Veriut, në vitin 1984. Babai im dikur ishte kapiten anijeje, kurse mamaja ime punonte për qeverinë e Koresë së Veriut për të fituar monedha të huaja. Mamaja ime vinte prej një rangu të mirë shoqëror. Njëri nga dajat e mi madje ishte pilot.

Nga ana tjetër, im atë ishte prej një rangu të ulët shoqëror. Gjyshi im ishte nga ishulli Xhixhu (Jeju), në Korenë e Jugut. Ai erdhi në Veri gjatë Luftës së Koreve dhe atje takoi gjyshen time. Babai dhe mamaja ime u takuan dhe u martuan në Korenë e Veriut. Unë u caktova në një rang shoqëror mjaft të mirë, për shkak se nga ana e mamasë sime ishin shumë të mirë, edhe pse nga ana e babait tim nuk ishin aq të mirë.

⁴² Hema Ravi, "Ode to Mother," Poem Hunter, August 13, 2009, lexuar më 11 Mars 2014, <http://www.poemhunter.com/poem/ode-to-mother-2/>.

U rrita në një familje të dashur. Kur e kthej kokën pas, im atë e donte shumë time më. Ai shpesh e ndihmonte mamanë time në mirëmbajtjen e shtëpisë. Jo shumë bashkëshortë i ndihmojnë gratë e tyre me punët e shtëpisë në Korenë e Veriut, por babai im e bënte shumë këtë gjë.

Kam dy motra më të mëdha. Motra ime e parë ishte strikte, kurse motra e dytë ishte e sjellshme. Motra ime më e madhe më rrihte, kur nuk e dëgjoja atë. Ajo më rrihte shumë, kur isha i vogël.

Mamaja ime u arrestua për herë të parë në vitin 1999, kur ajo solli fletushka Ungjilli me figura të printuara, prej Kinës, dhe ua tregoi ato koreanoveriorëve të tjerë. Ndërkohë që mamaja ime ishte në burg, im atë ishte shumë pranë vdekjes, për shkak të kancerit të lëkurës. Për këtë arsye, motra ime më e vogël shkoi në Kinë në vend të mamasë, për të fituar para për mjekimin që duhej për të kuruar kancerin e tim eti. Që prej asaj dite, nuk kam dëgjuar më për të. Kur ajo u largua nga shtëpia, unë isha katërmbëdhjetë vjeç. Ajo nuk i tregoi tim eti se po shkonte në Kinë, por më tha mua. Më tha se ajo do të shkonte te vendi ku shkonte dikur mamaja ime në Kinë për të fituar para për mjekimin e tim eti; megjithatë, këto ishin fjalët e fundit që dëgjova prej saj. U përpoqa ta ndaloja atë që të mos shkonte në Kinë, për shkak se ajo nuk e njihte rrugën, por ajo u nxitua për të ikur, e shqetësuar për babain tonë. Pasi ajo u largua, njollat e kuqe, si kokrra susami mbi shpinën e tij u bënë gjithnjë e më të mëdha. Më në fund, ato u zmadhuan e u bënë sa një tas supe. Dhe prodhuan qelb. Kockat e brinjëve i dukeshin përmes plagës së mbushur me qelb. Për trajtimin u përdor më tepër sesa një metër pambuk.

Nuk kam marrë asnjë lajm nga motra ime, që kur ajo iku për në Kinë.

Im atë vuajti nga sëmundja e tij për një vit. Plaga e mbushur me qelb u shërua dalëngadalë. Qelbi helmues doli krejtësisht përjashta. Deri kur u lirua nga burgu mamaja ime, pas një viti e gjysmë, im atë ishte kuruar plotësisht. Vërtet mendoj se kjo ishte një mrekulli.

Mamaja ime shkoi në Kinë për të kërkuar motrën time, por më në fund nuk arriti ta gjente. Mamaja filloi një biznes orizi me paratë që fitonte im atë nga mjalti i prodhuar prej bletëve të tij. Kështu që, të paktën familja ime nuk vuante urie.

Motra ime më e vogël kishte thënë se ajo do të vizitonte një shtëpi në Kinë, të cilën e njihte mamaja ime, por kontakti i mamasë sime në Kinë tha se motra ime nuk kishte shkuar atje. Pas kësaj, motra ime më e madhe u martua në Korenë e Veriut. Kunati im punonte si shofer në ushtri. Rangu i tij shoqëror nuk ishte i keq.

Mamaja ime doli nga burgu për herë të dytë në vitin 2002 dhe unë shkova në ushtri në vitin 2003. Kur isha shtatëmbëdhjetë vjeç, që është mosha normale për shërbimin ushtarak, im atë e kundërshtoi vajtjen time në ushtri, duke u shqetësuar për shëndetin tim dhe për rritjen fizike. Prandaj unë shkova në ushtri më vonë.

Ndërkohë që unë po kryeva shërbimin tim ushtarak, mamaja shkoi sërish në Kinë, dhe ajo solli oriz, para, mjekime dhe gjëra të tjera nga Kina për t'i ndarë me fqinjët e saj. Por ajo u akuzua prej dikujt që ajo e kishte ndihmuar, për shkak se i ndante këto gjëra me njerëzit falas. Po të mos i kishte ndarë falas, ajo nuk do të ishte akuzuar. Mua më dhanë një lirim të turpshëm nga ushtria në vitin 2004, për shkak se ajo u dërgua në burg sërish. Unë kisha qenë në ushtri për më tepër sesa një vit, por u detyrova të largohesha. Në ditën e lirimit tim, më dhanë thjesht një stilolaps dhe një copë letre, ku më kërkonin ta shkruaja emrin tim dhe kampin e batalionit, ku kisha shërbyer. Arsyeja e lirimit tim ishte e shkruar tashmë në letër: prindërit e mi nuk e praktikonin mirë rolin e prindit dhe kjo gjë kishte ndikim të keq në jetën e përbashkët.

Megjithatë, unë nuk ndihesha aq keq, sepse kur isha në ushtri, isha i uritur dhe e urreja gjendjen e urisë. Mua më jepnin tre vakte në ditë, kurse ushtarët që kishin qenë në ushtri për më tepër kohë se unë, hanin më tepër. Ata i merrnin racionet e ushqimit që u takonin ushtarëve të rinj. Mua me jepnin vetëm një të tretën e asaj që më takonte, dhe pjesën tjetër e merrnin ata.

Vështirësitë që kisha në ushtri, nuk ishin vetëm për ushqimin, por edhe për jetën e përbashkët. Mua më kërkonin, që të mos kritikoj vetëm veten time, por edhe ushtarët e tjerë, por unë nuk doja që t'i kritikoj të tjerët. Po të mos kisha dikë tjetër për të kritikuar, më duhej të merrja leje nga miku im për ta kritikuar atë, që ta përmbushja kërkesën. Dhe unë nuk lejohesha të shkoja në shtrat për të fjetur, po të mos i kisha mësuar përmendsh sloganet për Kim Il Sung-un dhe Kim Jong Il-in.

Kur u ktheva në shtëpi në vitin 2004, edhe mamaja ime u kthye në shtëpi prej burgut. Ajo nuk kishte kaluar shumë kohë në burg (vetëm tetë ose nëntë muaj) për shkak të rangut të saj të mirë shoqëror. Unë isha i lumtur që u ktheva në shtëpi, por gjithashtu edhe i trishtuar, për shkak se fqinjët e mi më shihnin me përçmim, ngaqë unë u lirova pa nderime nga ushtria.

Nuk e fajësova mamanë time, por ndihesha keq. Iu ankova asaj se, përse i kishte ndihmuar të tjerët dhe përse vetëm ajo duhej të shkonte në burg. Iu ankova lidhur me, përse e bëri ajo familjen tonë që të konsiderohej si reaksionare. Mamaja tha se ata, që ajo i ndihmoi, ishin njerëz të cilët na kishin ndihmuar neve, kur kishim nevojë për vete. Gjithashtu, mamaja tha se, ne duhej t'ua predikonim Ungjillin njerëzve që i njihnim më nga afër, për shkak se Perëndia na ndihmoi ne, kur ishim në hall. Mamaja ime nuk e ndante Ungjillin me njerëz, që i kishte takuar vetëm një ose dy herë, por me miqtë e saj të vjetër. Ajo u tregonte njerëzve, se sëmundja e babait tim ishte shëruar në mënyrë të mrekullueshme, dhe ne mund të jetonim mirë deri më tani, për shkak se Perëndia e kishte udhëzuar familjen tonë. Teksa shoh mbrapa gjërat që ka bërë ajo, mund të vë re se ajo i ungjillëzonte të tjerët duke i ndihmuar ata.

Nisa të shisja DVD me dramat koreane, pas lirimimit tim të turpshëm nga ushtria. E fillova biznesin i vetëm, por më vonë me mua u bashkua një miku im. Edhe atë gjithashtu e kishin liruar pa nderim. Atij iu desh të ikte nga ushtria, për shkak se i ndihmonte

njerëzit ta kalonin kufirin. Ne fituam shumë para me biznesin tonë të DVD-ve.

Kur isha në këtë biznes, takova një pastor. Ai na sugjeroi që në secilën pako me nga njëqind DVD me drama, të futnim dy ose tre DVD të krishtera me histori të animuara nga Bibla dhe predikime. Ai dukej sikur kishte pritur për mua e për mikun tim, kur kishte dëgjuar se ne sillnim DVD me drama koreane te tregtari i DVD-ve në Kinë.

Ne mund të shkonim në Kinë lehtësisht duke shpenzuar shumë pak para, për shkak se miku i mikut tim ishte ushtar, dhe ai na lejonte të kalonim. Së pari, vetëm miku im dhe unë i pamë DVD-të e krishtera. Ne i shitëm DVD-të normale me drama te shitësit me pakicë; por, pasi njiheshim me shitësit me pakicë, u jepnim atyre DVD-të e krishtera për t'i parë. Një shitës e kishte filluar biznesin e DVD-ve pesë vjet më parë se ne, kështu që ai e dinte punën për DVD-të e krishtera. Ai dukej sikur ishte i krishterë, për shkak se thjesht tha: “Është normale të japim DVD të krishtera bashkë me DVD-të e rregullta.” Po të mos kishte qenë i krishterë, ai do të më kishte akuzuar mua se isha një kriminel politik.

Duke parë DVD-të, pashë njerëz që predikonin dhe adhuronin. Kur i pashë të krishterët koreanojugorë që qanin në një shërbesë adhurimi, mendova se ata kishin lirinë, që ne nuk e gjenim dot prej Kim Il Sung-ut ose Kim Jong Il-it. Të krishterët dukeshin sikur ishin të lirë dhe autentikë. Për këtë arsye, unë mund të besoja se Perëndia ekzistonte vërtet. Këta të krishterë koreanojugorë nuk dukej sikur kishin ndonjë frikë.

Fitova tonelata parash përmes biznesit tonë për tre vjet. Bleva një motoçikletë dhe i shpenzoja paratë pa problem. Edhe mamaja ime vazhdoi ta mbante biznesin e saj të orizit. Kur shiste njëqind deri në dyqind kilogramë oriz në ditë, ajo mund të fitonte mjaftueshëm para, sa të siguronte nevojat e familjes sonë për një ose dy ditë. Biznesi me orizin ishte i llojit më të ulët të biznesit në Korenë e

Veriut. Megjithatë, duke kryer këtë lloj biznesi, ajo kishte mundësi të takonte shumë njerëz të varfër dhe t'i ndihmonte ata.

Në fakt, mamaja ime ishte një shitëse me shumicë. Njerëzit që donin të shisnin me pakicë, nuk kishim mjaftueshëm para sa të fillonin më vete. Ata merrnin hua pesëqind kilogramë oriz prej mamasë sime, pastaj e paguanin mbrapsht atë, pasi kishin nxjerrë fitim në biznesin e tyre. Nuk ishte e lehtë të mbartje orizin e rëndë dhe mamaja ime mund të ishte marrë me një biznes shumë më të lehtë, por ajo donte të merrej me biznesin e orizit për t'i ndihmuar të varfrit. Ajo ua shiste orizin të varfërve me çmim më të lirë sesa çmimi mesatar. Ndërkohë që situata financiare në Korenë e Veriut përkeqësohej dhe teksa mamaja ime vazhdonte t'i ndihmonte të varfrit, prindërit e mi grindeshin më shpesh. Unë gjithashtu e ndihmoja pak mamanë time, kur situata ekonomike nuk ishte e mirë.

Mamaja ime e shiste një kilogram oriz për nëntëqind uon, në vend që ta shiste për njëmijë uon, që ishte çmimi normal. Po ta shiste me çmimin normal, ajo jepte oriz shtesë. Një shitës me shumicë në Nampo, e shiste orizin me gjysmë çmimi. Për shembull, ai shiste orizin me vlerë prej dhjetëmijë uon, për pesëmijë uon. Ai mund t'u shpërndante oriz falas të varfërve, por në vend të kësaj, ai ua shiste atyre orizin me një çmim tejet të ulët, që të shmangte inspektimin prej qeverisë së Koresë së Veriut; megjithatë, u mor vesh se ai po mbështetej me para nga Koreja e Jugut për t'i ndihmuar të varfrit. Atë e ekzekutuan. Shumica e koreanoveriorëve e dinin për këtë ngjarje, për shkak se ajo u quajt një skandal i madh në Korenë e Veriut.

Për shkak të kësaj, mamaja ime hoqi dorë nga biznesi me orizin dhe filloi biznesin me mjekimet. Ajo sillte mjekime nga Kina dhe shkonte e vinte shpesh atje, por unë nuk e shoqërova atë kur shkova në Kinë për biznesin tim me DVD-të. Personaliteti i saj dhe i imi nuk përputheshin, për shkak se ajo përpiqej t'ua jepte gjithçka të varfërve gjatë rrugës së kthimit për në Korenë e Veriut.

Kur mbërrinte në shtëpi, ajo kishte vetëm më pak se një të tretën e orizit që e kishte sjellë nga Kina. Mua nuk më pëlqente, që ajo t'ua jepte të gjitha gjërat të varfërve, prandaj nuk e shoqëroja.

Mamaja ime vazhdoi të merrej me biznesin e mjekimeve. Im atë ishte diplomuar nga universiteti dhe ishte bërë kirurg ushtarak, përpara se të martohej me mamanë time. Pasi e kreu shërbimin e detyruar ushtarak, ai trajtonte edhe pacientët me ishemi. Ai i trajtonte anëtarët e familjes së tij dhe fqinjët me akupunkturë (mjekim me gjilpëra). Të dy prindërit e mi filluan të punonin së bashku. Kur nuk vepronin mjekimet, ai i trajtonte pacientët me akupunkturë. Biznesi i tyre shkonte mbarë.

Unë bleva një shtëpi dhe jetoja më vete bashkë me një mikun tim. Vazhdova të merresha me biznesin e DVD-ve, deri sa u largova nga Koreja e Veriut. Në Korenë e Veriut, fëmijët e zyrtarëve të Departamentit të Sigurisë së Shtetit ose të zyrtarëve të tjerë, merreshin me biznesin e DVD-ve. Për këtë arsye, ata mund ta shmangnin me lehtësi kontrollin e biznesit. Unë fitova kaq shumë para, dhe mund të shpenzoja më tepër nga sa bëj tani në Korenë e Jugut, sepse biznesi im shkonte shumë mirë.

2. Thirrja për aventura

Në Pjongiang ka një agjenci qeveritare të titulluar Korpusi i 109 Çështjeve të Biznesit dhe ata i godasin bizneset e DVD-ve. Disa nga partnerët tanë në biznes ishin fëmijë të oficerëve të policisë dhe zyrtarëve të tjerë ekzekutivë nga Pjongiangu. Ata më thanë se Korpusi i 109 Çështjeve të Biznesit do të më sulmonte mua me mamanë time. Kjo është arsyeja se përse u largova kaq shpejt nga Koreja e Veriut; megjithatë, mamaja ime vendosi të rrinte në Korenë e Veriut, për shkak të babait tim dhe motrës së madhe.

E dashura ime ishte infermiere, por unë nuk e solla qëllimisht atë në Korenë e Jugut. Babai im bënte një analizë në ambulancën

e qytetit për ta rinovuar licencën e tij për mjekimet kineze. E dashura ime ishte vajza e kryetarit të zyrës shëndetësore të qytetit dhe unë e takova atë kur po kryeja një porosi për babain tim tek ajo zyra. Ne filluam të shoqëroheshim bashkë. Ajo ishte zemërmirë dhe bukuroshe. Ne kishim dy vjet që takoheshim bashkë dhe shkonim shpesh në park, shkonim në plazh me motoçikletë, bisedonim dhe i premtuam njëri-tjetrit një të ardhme të lumtur. Pastaj, kur sapo do të arratisesha nga Koreja e Veriut, e takova atë për pesëmbëdhjetë minuta dhe i thashë se më duhej të arratisesha për në Korenë e Jugut. Ajo donte të ikte me mua, por unë i thashë asaj të rrinte. Ajo po qante, por unë ika.

Rruga që përdorja dikur për të shkuar në Kinë e për të ardhur që atje ishte bllokuar, prandaj m'u desh të merrja një rrugë të panjohur. Që të ishe i përfshirë në biznesin me DVD-të, dhe sidomos të sillje DVD të krishtera në Korenë e Veriut, të duhej mbrojtje nga policia dhe prokuroria. Kur merresha me biznesin e DVD-ve, fëmijët e oficerëve të policisë dhe prokurorëve ishin afërsisht në një moshë me mua, kështu që unë merrja shumë mbështetje prej tyre. Ata më thanë të merrja një rrugë tjetër, kur u arratisa nga Koreja e Veriut.

Gjashtë prej nesh u arratisëm së bashku. Në grupin tonë kishte katër burra e dy gra. Shumica prej tyre ishin fëmijë të oficerëve të policisë. Ika bashkë me ta, për shkak se mendova se do të shmangia kapjen prej policisë, kur isha me ta. Kur ishim afër Kinës, ne u ndamë për të shmangur dyshimet. Unë shkova vetëm me njërën nga vajzat. Të gjashtë ne premtuam të bashkoheshim sërish në Kinë; por, unë nuk u takova më me të tjerët sërish. Vajza që e solla në Jug, ishte dikush që më kishte ndihmuar ta drejtoja biznesin e DVD-ve në Veri. E solla atë në Kinë dhe pastaj deri në Korenë e Jugut, ngaqë ajo dhe familja e saj mund të kishin qenë në telashe, për shkak të mbështetjes së saj për biznesin tim.

Pasi mbërrita në Kinë, u fsheha nëpër male dhe vizitova një pastore me të cilën mbante kontakte mamaja ime. Mendova se

ajo do të më ndihmonte, por ajo refuzoi. Ajo kishte frikë të më ndihmonte, ngaqë shqetësohej se mos ajo vetë do të ndëshkohej prej autoriteteve kineze po të më fshihte mua. Për këtë arsye m'u desh të endem sa nga njëri vend në tjetrin. U stabilizova në një shkollë seminari në Harbin, e cila drejtohej nga misionarët e Koresë së Jugut, dhe qëndrova atje për tre muaj. Kur isha atje, dëgjova se mamaja ime ishte kapur prej Departamentit të Sigurisë Shtetërore. Doja të mbërrija sa më shpejt në Korenë e Jugut, që ta ndihmoja familjen time.

U largova i vetëm nga shkolla për në Qingdao dhe e gjeta rrugën për në Korenë e Jugut.

Në një holl hoteli, gjeta një libër të botuar në Korenë e Jugut. Mora në telefon atë numrin e printuar në kapakun e pasmë të librit. I tregova personit që u përgjigj se isha një koreanoverior dhe i kërkova të më tregonte sesi të vija në Korenë e Jugut. Personi më tha se ai do ta merrte vesh dhe se unë duhej t'i telefonoja përsëri pas tri ditësh. Kur e telefonova pas tri ditësh, ai më prezantoi me një dezertor koreanoverior, i cili pastaj më prezantoi me një misionar koreanojugor. Misionari më pyeti për motivin e ardhjes në Korenë e Jugut dhe më tha ta shkruaja dëshminë time. Pastaj misionari e rregulloi mënyrën sesi të shkoja në Korenë e Jugut.

Destinacioni ynë i fundit në Kinë në rrugën tonë për në Korenë e Jugut ishte Harbini, ku misionari e kishte rregulluar që të vinte të na takonte dikush. Kështu që, unë solla vajzën dhe ndenja në Harbin tek vendtakimi, një han. Pesë koreanoveriorë, përfshirë vajzën dhe mua, u mblodhën atje, gati për të shkuar në Korenë e Jugut. Na u desh të prisnim për koreanoveriorët e tjerë, që ishin programuar për të mbërritur atje. Por pas pesëmbëdhjetë ditësh në han, neve na mbaruan paratë, dhe na u desh të lëviznim për në një kishë koreano-kineze. Ne ndenjëm në kishë edhe për një pesëmbëdhjetë ditësh tjetër.

Një muaj pasi vajza dhe unë kishim mbërritur në Harbin, erdhi ndërmjetësi dhe grupi ynë u largua për në Korenë e Jugut. Ne

kaluam përmes Laosit dhe Tajlandës. Në grup ishin në total tetë veta dhe udhëtimi zgjati afro katër muaj. Ne qëndruam në Laos për tri ditë, por na u desh të rrinim në Tajlandë për tre muaj, deri sa qeveria e Koresë së Jugut të na lejonte të shkonim atje.

3. Refuzimi i thirrjes

Një herë, gjatë qëndrimit tim në Kinë, u përpoqa të kthehesha në Korenë e Veriut. Jeta në Kinë nuk ishte e lehtë, dhe të krishterët që takova në Kinë ishin shumë të ndryshëm nga mamaja ime. Ata nuk donin të sakrifikonin fare, ashtu siç bënte mamaja ime. Mamaja ime i ndihmonte të tjerët dhe e mbante besimin e saj te Perëndia, duke sakrifikuar veten. Kur i shihja të krishterët e tjerë që nuk sakrifikonin fare nga vetja e tyre, më bëri të ndjeja keqardhje për mamamë time. Prandaj, doja të isha me të, qoftë i gjallë, qoftë i vdekur.

Misionarët që e njihnin mamamë time, nuk e ndihmuan atë, kur ajo u kap prej Departamentit të Sigurimit të Shtetit. Dhe pastorja që i predikoi në fillim ungjillin mamasë sime, nuk më ndihmoi mua, por më nxori përjashta, ngaqë kishte hallin e vet, se mos e dërgonin në burg ose mos i duhej të paguante një gjobë prej njëzet mijë juan (afro tremijë e treqind dollarë). Kur i besova për herë të parë Perëndisë, besova në Perëndinë e mamasë sime, në vend që të kisha vetë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me Perëndinë. Por, kur pashë njerëz që besonin në të njëjtin Perëndi si mamaja ime, por që ishin të fokusuar vetëm për t'u përkujdesur për veten e tyre, u zhgënjeva prej tyre.

Përpara se të përpiqesha ta kaloja sërish lumin për t'u kthyer në Korenë e Veriut, u luta për një orë, duke i kërkuar Perëndisë që të më drejtonte për kthimin te shtëpia ime. Gjithashtu e pyeta, nëse Perëndia donte që unë të kthehesha. Pastaj, e kalova lumin Tumen në orën 4 të mëngjesit. Eca përmes një rruge të madhe

dhe pastaj kalova nëpër male e pyje. Më në fund, kalova pranë një objekti të zi, për të cilin mendova se mos ishte ndonjë lloj peme e vogël. Por objekti më bërtiti: “Kush je ti?” dhe tërhoqi këmbëzën e armës, kur unë isha në gjysmë të rrugës. Ishte një roje kufiri. Garnizonet e kufirit zakonisht bëjnë roje me turne dhe ka një hapësirë prej tridhjetë minutash, kur ata këmbëjnë vendet me njëri-tjetrin; por dita kur unë e kapërceva lumin Tumen ishte 31 dhjetori, një ditë përpara Vitit të Ri, dhe rojet po rrinin në gatishmëri pa ndërprerje. Unë nuk e dija situatën, por thjesht e kalova lumin dhe m’u desh të vrapoja për në Kinë me këmbët zbathur. Lumi Tumen ishte në kohën e zbatcës, por prapëseprapë kishte pak ujë, kështu që unë thjesht iu futa lumit me vrap për ta kaluar në këtë ditë akull të ftohtë.

Vrapova në malet e Kinës këmbëzbathur. Katër ushtarë koreanoveriorë, të stacionuar përgjatë kufirit në çdo pesëdhjetë metra më ndoqën nga pas. Vrapova për tek malet për afro dymbëdhjetë deri gjashtëmbëdhjetë kilometra që nga ora 4 e mëngjesit. Ushtarët më në fund pushuan ndjekjen ndaj meje, kur ishte mesi i ditës. Unë pothuajse kisha ngrirë.

Isha lutur, përpara se ta kapërceja lumin. I kisha kërkuar Perëndisë të më drejtonte në rrugën për në Veri, nëse ky ishte vullneti i Tij. Unë isha lutur për pothuajse një orë. Pasi nuk ia dola dot të arratisesha, kur ora kishte shkuar afro 2 e pasdites dhe rojet nuk po më ndiqnin më, m’u lehtësua ankthi. E kuptova se Perëndia nuk donte që unë të kthehesha më në Veri.

Më vonë mendova për t’u futur në ambasadën e Republikës së Koresë në Kinë, por njerëzit e tjerë më këshilluan se ishte e rrezikshme, nëse kapesha brenda ambasadës. U përpoqa të futesha në ambasadë për tre ose katër ditë, por pastaj bëra një plan tjetër më vonë dhe takova atë misionarin që e përmenda më herët, bashkë me Znj. Folei.

Kisha qenë në Kinë për nëntë muaj. E kuptova se Perëndia nuk donte që unë të kthehesha në Korenë e Veriut.

4. Takimi i mentorit

Mentorja ime është mikesha ime që më tha të arratisesha prej Korpusit të 109 Çështjeve të Biznesit, kur jetoja në Korenë e Veriut. Mamaja ime dhe babai i saj ishin të njohur mes tyre tashmë. Babai i saj ishte kreu i departamentit të policisë. Shoqja ime mori fjalë prej babait të saj, se qeveria synonte të na inspektonte mamanë time dhe mua dhe më tha se ne duhej të arratiseshim. Mamaja ime më la të largohesha vetëm, për shkak se ne nuk duhej të kapeshim së bashku.

Babai i shoqes sime ishte i krishterë. E pashë atë të sillte një Bibël nga shtëpia ime, në një mbrëmje dimri kur nata ishte e gjatë. Pozicioni i menaxherit të departamentit në një rajon policie ishte mjaft i lartë. Kur ai na erdhi për vizitë në shtëpi, për mua ishte një gjë tepër e madhe të ulesha për bisedë. Babai im mbante bletë, dhe ai e përdorte mjaltin në mjekimet që bënte. Në Korenë e Veriut mjalti përdorej shpesh si mjekim. Prandaj, kur babai i shoqes sime na erdhi për vizitë në shtëpi, babai im i shërbeu verë mjekësore me mjaltë, e cila ishte e mirë për bronket. Unë nuk mund ta kontaktoja shpesh këtë zyrtar, për shkak se ai ishte i një rangu kaq të lartë. Vajza e tij, shoqja ime e biznesit, ishte një nga shitëset kryesore të DVD-ve në qytetin tim. Pozita e lartë e babait të saj, ndihmoi për ta mbështetur biznesin e saj dhe ajo fitoi shumë para.

5. Kalimi i pragut të parë

Unë nuk mund të kthehem sërish në shtëpinë time, deri sa Koreja të ribashkohet. Arsyeja se përse nuk shkoj më në shtëpi është se Perëndia e bllokoi rrugën time, kur u përpoqa të rikthehem atje.

Pasi u largova nga qendra e ristabilizimit të refugjatëve në Hanauon në Korenë e Jugut, unë kurseva 8 milionë uon për t'ia dërguar familjes sime në Korenë e Veriut. Unë nuk haja shumë,

ose nuk harxhoja para për lumturinë time; qëllimi im ishte të dërgoja sa më shumë para që të ishte e mundur tek familja ime. Një dezertor tjetër koreano-verior më prezantoi me një ndërmjetës koreano-kinez, të cilin ai e kishte përdorur më përpara për të dërguar para. Dezertori më siguroi se ndërmjetësi ishte i besueshëm. Ndërmjetësi më tha se familja ime i mori me siguri paratë që ua kisha dërguar; megjithatë një ndërmjetës tjetër në Korenë e Veriut më tha se familja ime nuk kishte marrë as edhe një gjë. Zbulova se ndërmjetësi koreano-kinez nuk i kishte dërguar në Korenë e Veriut ato 8 milionë uon.

Unë shkova në Kinë për ta gjetur ndërmjetësin koreano-kinez, që t'ia merrja mbrapsht paratë, por ai më injoroi. Nuk pranova ta lija rehat. Pas nëntëmbëdhjetë ditësh, ai më në fund më ktheu vetëm 2.8 milionë uon (afro 2800 dollarë). Kur isha në Kinë, vizitova vendet ku kisha kaluar përgjatë rrugës për në Korenë e Jugut, të tilla si bregun e lumit Tumen, Qingdao-n dhe Harbin-in.

Koreja e Veriut është pragu për mua, por mendoj se Perëndia do të më lejojë që të kthehem atje, kur Koreja të bashkohet.

6. Sprovat, aleatët dhe armiqët

Pata shumë prova, kur mbërrita në Korenë e Jugut. Njerëzit më lënduan ose më mashtruan, ngaqë unë nuk dija shumë gjëra për kulturën koreanojugore. Për shembull, njerëzit në Korenë e Jugut janë shumë individualistë, dhe si të tillë, ata nuk e vrasin shumë mendjen, nëse njerëzit e tjerë hanë ushqim ose jo. Ata madje as nuk kujdesen për bashkëpunëtorët e tyre. Kjo ishte pjesa më e vështirë për mua për ta pranuar.

Njerëzit që më ndihmuan të vij në Korenë e Jugut janë aleatët e mi. Misionari i Koresë së Jugut, që punonte për “Zërin e Martirëve” në Kore më prezantoi me Pastorin Folei dhe Znj. Folei. Ata ngritën një ofertë për mua nga e gjithë bota përmes “Zërit të Martirëve”,

për shkak se unë isha një i krishterë i fshehtë. Perëndia përdori vëllezër e motra të krishterë nga e gjithë bota për të më sjellë në Korenë e Jugut. Situata ime për të ardhur në Korenë e Jugut përmes mbështetjes së të krishterëve nga e gjithë bota ishte diçka speciale.

Armiku im është Kim Jong Il-i. Nëse Kim Jong Il-i nuk do të kishte qenë lakmitar, qytetarët e Koresë së Veriut nuk do të kishin qenë duke vuajtur. Ai ishte lakmitar për para, prandaj e mbajti në pushtet qeverinë e tij diktatoriale, ndërkohë që populli i Koresë së Veriut po vdiste nga uria.

7. Afrimi për te shpella më e brendshme në thellësi

Pasi mbërrita në Korenë e Jugut, unë isha i gjallë, por nuk ndihesha si i gjallë. Ndhiesha si pa mendje, pa pasur ndjenja fare. Dhe kisha dyshime për të pasurit e një jete komode për vete në Korenë e Jugut, pa familjen time.

E gjithë zemra dhe shpirti im ishin me mamanë dhe me familjen time. Kur mendoj për mamanë time, ndiej keqardhje për të, se ajo pati kaq shumë vështirësi për shkak të besimit të saj në Perëndinë. Një herë, një njeri që dikur punonte për Departamentin e Sigurimit Shtetëror, më tha se ai mund të më sillte një fotografi të mamasë sime, e cila ishte bërë kur ajo ishte në burg, gjatë hetimit të saj paraprak. “Zëri i Martirëve” në Kore m’i dha paratë që të më ndihmonte ta merrja atë fotografi, por plani dështoi. Unë thjesht i humba paratë dhe nuk arrita dot të gjej një mënyrë për ta shpëtuar mamanë time.

I kërkoj vërtet ndjesë “Zërit të Martirëve” në Kore, të cilët më mbështetën nga Kina për në Korenë e Jugut. Kur po e gjeja mënyrën sesi të jetoja, ata më ndihmuan të vij në Korenë e Jugut dhe janë përkujdesur për mua; megjithatë nuk ua kam shlyer akoma mirësinë që treguan ndaj meje, por përkundrazi e kam

tradhtuar besimin e tyre në mua vazhdimisht. Kur sapo u largova nga qendra për risistemimin e refugjatëve në Korenë e Jugut, më ftuan ta ndaja dëshminë e mamasë time tek organizatat e “Zërit të Martirëve” në Evropë, të cilat më mbështetën në rrugën time për në Korenë e Jugut. Kështu që, unë premtova ta bëja atë gjë.

Pastor Folei, Drejtori Ekzekutiv i “Zërit të Martirëve” në Kore, u kishte bërë thirrje organizatave “Zëri i Martirëve” anembanë botës, të sillnin në Korenë e Jugut nëntë të krishterë të fshehtë; por unë nuk arrita dot ta mbaja premtimin me “Zërin e Martirëve” në Kore për të shkuar në Evropë që të ndaja dëshminë time, por në vend të kësaj, shkova në Kinë për t’u përpjekur t’i merrja mbrapsht ato 8 milionë uon, që supozohej se duhej t’i ishin dërguar familjes sime në Veri. Gjithashtu e theva premtimin me të krishterët anembanë botës, të cilët më shpëtuan jetën në Kinë. Pas saj, “Zëri i Martirëve” në Kore ndihmoi me përpjekjet për të sjellë një fotografi të mamasë sime nga Koreja e Veriut, kur ajo ishte në burg atje, por përpjekja dështoi. Unë nuk mund ta mbaja dot besën ndaj “Zërit të Martirëve” në Kore, edhe pse ata vazhdonin të përpiqeshin të më ndihmonin mua.

Në mars të vitit 2011, dëgjova se mamaja ime ishte ekzekutuar. Kjo ishte koha më e rëndë për mua. Unë haja ushqim, por nuk dukej se vija re shumë se çfarë po haja. Nuk doja që të jetoja më. Isha i gjallë, por nuk ndihesha i gjallë. Ndieja keqardhje për mamamë time, e cila u ekzekutua për mbajtjen e besimit të saj në Perëndinë dhe për anëtarët e familjes sime që u shpërndanë për faj të krimit të mamasë sime.

Më vjen keq për atë që i ndodhi mamasë sime. Kur u arratisa nga Koreja e Veriut, pasi mora informacionin se një agjenci qeveritare po vinte nga Pjongiangu për të më kapur mua dhe mamamë time, mamaja ime vendosi të qëndronte në Korenë e Veriut dhe më la mua të ikja vetëm. Ajo shqetësohej se unë do të vdisja, nëse edhe ajo arratisesh bashkë me mua. Agjencia qeveritare nuk do ta kishte vëmendjen tek unë, ndërkohë që po përqendroheshin të kapnin mamamë time.

Nëse babai im dhe motra ime e madhe nuk do të ishin në Korenë e Veriut, unë do ta shkruaja historinë e mamasë sime dhe do të bëja fletushka e do t'i përhapja kudo ndër popullin e Koresë së Veriut. Do të doja t'u tregoja njerëzve se është gënjeshtër që familja ime u bë spiune dhe rebele, por që mamaja ime u ekzekutua për besimin e saj të krishterë. Në kohën kur mamaja ime u kap, kishte shumë njerëz të cilët ajo i kishte ndihmuar. Por shtatë apo tetë prej tyre, ose e mohuan se e njihnin mamamë time, ose e akuzuan atë. Tërbohem nga inati, teksa e kujtoj këtë gjë. Nëse mamaja ime nuk do t'i kishte ndihmuar ata, familja ime do të kishte jetuar mirë. Ata pretendonin ta njihnin mamamë time, kur merrnin ndihmë prej saj, por ia kthyen shpinën, kur ajo ishte në hall. Mendova se mamaja ime ishte budallaqe, por në të njëjtën kohë më vinte keq për të.

8. Sprova e rëndë

Mendoja se duhet të bëhesha një misionar, e ta ndiqja mamamë time; megjithatë akoma nuk e kam vendosur, nëse do të bëhem misionar. Kur dëgjova për vdekjen e mamasë sime, kjo ishte sprova më e rëndë. U shqetësova aq shumë prej asaj që dëgjova, sa që punova tri ditë rresht pa asnjë pushim fare në një fabrikë që prodhonte telefona inteligjent (smartphone). Nuk mund të mendoja për asgjë, ndërkohe që isha duke punuar fort. Punova natë e ditë për afro katër muaj dhe kurseva më tepër se 15 milionë uon (afro pesëmbëdhjetë mijë dollarë). Por i humba të gjitha paratë duke më mashtruar të tjerët dhe duke i shpenzuar kot të tjerat.

Është shumë e trishtueshme t'ua tregoj sesi më mashtronin me paratë. Pasi ma hodhën disa herë, unë ndalova së takuari njerëzit. Edhe pse mund t'i takoja njerëzit, i trajtoja ata me dy mendje. Kur njerëzit janë të mirë, i trajtoj mirë ata. Kur ata janë të këqij, i trajtoj keq. Në këtë mënyrë, kam mundësi të mos lejoj që të më mashtronjë më.

Njëherë u përpoqa të bëhesha misionar, por nuk doja ta zhgënjeja sërish Znj. Folei, ngaqë më përpara e pata zhgënjyer atë në disa raste. Nuk mund të vendos lehtë për t'u bërë misionar në këtë situatë, ngaqë nuk i kam kualifikimet themelore.

9. Shpërblimi

Mësimet që kam marrë prej vështirësive dhe sprovave që kam kaluar janë shpërblimi im. Ato më kanë mësuar të kaloj kohën me gjëra me vlerë, dhe të jem i mençur, kur takohem me njerëz të rinj.

10. Rruga për kthimin

Po t'i takoj miqtë e mi koreanoveriorë në Kinë, do të doja t'i ndihmoja ata. Po të kem para mjaftueshëm për t'i sjellë ata në Korenë e Jugut, do të doja t'i mbështesja për të ardhur në Korenë e Jugut. Kur të ribashkohet Koreja, jam i sigurt se unë do të jetoja i lumtur me miqtë e mi.


11. Ringjallja

Për shkak se bëja vizita të shpeshta në Kinë dhe mbaja lidhje me koreanoveriorët në Veri edhe pasi mbërrita në Korenë e Jugut, më trajtuan sikur të isha një spiun. U pikëllova për këtë. U largova nga Koreja e Veriut pa pasur një vend ku të jetoja; megjithatë nuk u mirëprita në Korenë e Jugut. Për mua, të më akuzonin se isha spiun, është e njëjta gjë si vdekja.

I kërcënova zyrtarët e Shërbimit të Sigurimit Kombëtar të Koresë së Jugut dhe oficerët e policisë se nuk do ta zija me dorë stilolapsin për të shkruar as edhe një gjë, derisa të takohesha ballë për ballë

me personin që më akuzoi mua. Pa as edhe një hetim, më shfajësuan për tri ditë. Është gjë e turpshme, që qeveria e Koresë së Jugut më konsideroi se isha spiun, pa pasur asnjë dëshmi. Është më keq se në Korenë e Veriut. Unë u tërbova fare nga nervat për këtë gjë.

12. Rikthimi me eliksirin



Miqësia është eliksiri. Unë dua të kaloj kohë me miqtë e mi, ashtu siç i kam skicuar në këtë vizatim. Dua të ec dorë për dorë me miqtë, që duan të jenë me mua, por nuk munden dot, për shkak të situatës. Shoqëria në Korenë e Veriut nuk është e mirë. Njerëzit mund të ndahen nga njëri-tjetri, për shkak të parave, bizneseve të tyre ose për shkak të besimit të tyre të krishterë. Në vizatimin tim, të dy njerëzit që janë në secilën anë time, janë miqtë e mi që punuan me mua në biznesin e DVD-ve në Korenë e Veriut. Njerëzit

e tjerë në vizatim janë miqtë që më ndihmuan, kur kisha nevojë. Disa prej tyre rrëfyen se ishin ata që shisnin DVD, kur u kapë unë për shitjen e tyre.

Unë vizatova një bebe, ngaqë gjithashtu dua të kaloj kohë me fëmijët. Imagjinoj se do të zbuloj që miqtë e mi tani janë bërë me fëmijë. Gjithashtu vizatova edhe një lepur. Normalisht lepujt i kanë frikë njerëzit dhe Ikin me vrap prej tyre, por lepurit që vizatova unë ka qejf t'i ndjekë nga pas njerëzit. Vizatova njerëz të vegjël me një stilolaps të zi dhe pa asnjë ngjyrë nën pjesën me ngjyra të vizatimit tim. Këta njerëz që rrinë pranë ujit përfaqësojnë njerëzit e rangut të lartë. Ata e kanë bërë situatën të vështirë për njerëzit e dobët si unë, për shkak të pozitës së tyre ose parave. Ata do të poshtërohen dhe turpërohen për ligësitë e tyre.

Nëse rikthehem në Korenë e Veriut, do të doja t'i takoja së pari miqtë e mi. Do të doja të sillja shumë para. Do të sillja afro 300 milionë uon (afro treqind mijë dollarë) për të blerë oriz, rroba dhe gjëra të tjera për miqtë e mi. Ndërkohë që miqtë e mi qëndruan në Korenë e Veriut, unë kam përjetuar shumë vështirësi për të shkuar në Korenë e Jugut dhe mësova shumë gjëra të rëndësishme, të cilat do t'i ndihmojnë edhe ata, po t'i dinë ato.

Mbi të gjitha unë dua t'u them miqve të mi: “Ne patëm drejtuesit e gabuar: Kim Il Sung-un dhe Kim Jong Il-in.” Dua që ata ta dinë se kjo është arsyeja që koreanoveriorëve iu desh të jetonin me vështirësi. Gjithashtu, unë dua t'u tregoj miqve të mi për botën që arrita ta njoh përmes vuajtjeve të mia. Koreanoveriorët nuk kanë zotërime të tyre. Ata nuk e njohin vlerën e emrit të tyre. Gjithçka është në pronësinë e qeverisë dhe Kim Jong Un-it; kurse në Korenë e Jugut, edhe një fletë letre është e imja dhe gjithçka që kam është e imja. Në Korenë e Veriut, edhe një fletë letre i përket Kim Jong Un-it, ndërkohë që emri im nuk ka asnjë vlerë. Dua t'u tregoj miqve të mi se atje përtej kufirit është një botë e ndryshme, po që se ata do t'i duronin vështirësitë ashtu si unë.

Në Korenë e Veriut, njerëzit e shpërfillnin mamanë time dhe familjen time, për shkak se mamaja ime besonte në Perëndinë dhe qeveria i detyronte njerëzit t'i shpërfillnin të krishterët; megjithatë, kur të kthehem në Korenë e Veriut, do t'u tregoj njerëzve se Perëndia në të cilin besoi mamaja ime, nuk është i rremë. Sidoqoftë, mamaja ime u qëllua për vdekje për besimin e saj të krishterë. Gjithashtu, unë do t'u tregoj atyre se vendimi i mamasë sime për t'i besuar Perëndisë ishte një zgjedhje e zgjuar, pavarësisht se prej atij vendimi vuajtën një ose dy njerëz. Pastaj do t'u them atyre se unë kam qenë mirë, për shkak të Perëndisë. Unë dua t'ia rikthej nderin mamasë sime në këtë mënyrë.

Kapitulli 11.

Znj. Hur: Udhëtimi drejt martirizimit

*Zoti do t'ju drejtojë gjithmonë; ai do t'ua
plotësojë nevojat në tokën e zhuritur nga dielli dhe
do t'jua forcojë kockat tuaja.*

— Isaia 58:11

1. Bota e zakonshme

U lindi në Kinë më 3 mars 1930. U martova me një burrë që ishte nga Seuli, në Korenë e Jugut, kur isha shtatëmbëdhjetë vjeçe. Babai i tij ndërroi jetë, kur ai ishte tre vjeç, dhe e ëma i ndërroi jetë dy vjet pas vdekjes së të atit. Atij iu desh të paguante për funeralin e së ëmës duke lypur para prej njerëzve. Ai u bë jetim dhe punoi si dado për fëmijët për ca kohë, përpara se të bëhej ushtar në Luftën e Çlirimit të Kinës, kur ishte shtatëmbëdhjetë vjeç. Por ai u plagos në luftë dhe e liruan nga ushtria. Kur unë mbusha gjashtëmbëdhjetë vjeç, ky burrë, i cili kishte punuar si dado për fëmijët më propozoi martesë. Mamaja ime nuk më lejoi të shkoja në shkollë, por ajo donte që unë të martohesha me të. Kështu që, unë u martova me të, kur isha shtatëmbëdhjetë vjeç. Në Kinë kishte plot toka të pazëna nga njeri, kështu që ne mund të kishim aq tokë sa të donim. Nuk do të kishte asnjë problem, për sa kohë që i punonim e i kultivonim mirë tokat.

Pasi u martuam, unë lindi fëmijën tonë të parë, një vajzë, kur isha tetëmbëdhjetë vjeç. Pas dy vitesh, lindi një vajzë tjetër. Pas lindjeve, unë nisa të vuaja prej cistitit. Për këtë arsye, nuk mund të punoja dot në fermë, edhe pse jetoja atje. Në vend të kësaj, punova në një qendër përkujdesjeje për fëmijët, ku ndizja zjarrin në mëngjes, duke mbartur tre fëmijë përpara e një tjetër mbi shpinë. Burri im ishte shumë i mirë për kultivimin e orizit, dhe për këtë arsye qeveria e Koresë së Veriut sugjeroi që ai t'ua mësonte teknologjinë e kultivimit të orizit njëqind njerëzve. Koreja e Veriut siguroi gjithçka, që ai dëshiroi. Ai kultivoi oriz për katër vjet atje, dhe neve na u desh të lëviznim për të jetuar në Korenë e Veriut, kur qeveria kineze dha urdhër që të rinjtë duhej të shkonin atje për ndërtimin e vendit. Në atë kohë, autoriteti i Partisë Komuniste ishte shumë më i fuqishëm sesa autoriteti i presidentit të tanishëm. Kështu që, ne shkua në Korenë e Veriut, kur isha njëzet e katër vjeçe. Ishte viti 1954.

Edhe pse im shoq merrej me bujqësi në Korenë e Veriut, dhe nuk kishte arsim, ai kishte inteligjencë të jashtëzakonshme. Qeveria e Koresë së Veriut sugjeroi që ai të punonte në një rajon policie; megjithatë, ai vendosi të shkonte në një shkollë për menaxhim ekonomie, ngaqë ishte analfabet. Ai shkoi në shkollë, kur fëmijët ishin të vegjël. Ne morëm racionet vetëm për një vit, ngaqë erdhëm prej Kinës, por prej vitit që pasoi, mua më duhej të punoja në fermë ditë e natë për të siguruar jetesën. Për tre vjet rresht, përpara se të diplomohesh im shoq nga shkolla, ne hanim vetëm qull barishtesh. Pasi u diplomua burri im, jetesa jonë u përmirësua shumë. Për të thoshin se ishte një njeri duarartë, që i zinte dora gjithçka, dhe ai ishte mjeshtër shumë i zoti, i cili madje bënte që uji të rridhte edhe përmes tubacioneve të dëmtuara.

Unë lindi vajzën tonë më të vogël pas katërmëdhjetë vitesh martesë. Konsultova shumë mjekë lidhur me si të lindja një djalë, por përfundova me një vajzë tjetër. Burri im nuk u ankua kurrë që nuk kishim një djalë. Ai kishte personalitet të mirë dhe kurrë nuk më rrahu ose nuk më mërzi për gjërat e shtëpisë.

Të treja vajzat tona u martuan, dhe unë iu gëzova jetës me tim shoq për një kohë të gjatë. Pastaj ai ndërroi jetë, kur ishte shtatëdhjetë vjeç, në vitin 1997. Unë isha gjashtëdhjetë e dy, kur ai iku nga kjo botë. Ai u nderua prej të gjithëve për punën e tij të vështirë si mjeshtër i zotë e i mirë. Nëse dikush vinte në Korenë e Veriut duke pasur ditëlindjen ose vendbanimin nga Seuli, ata trajtoheshin keq, për shkak të prejardhjes së tyre të keqe; gjithsesi, qeveria e Koresë së Veriut nuk e trajtoi tim shoq si një person prej Seuli.

Një ditë ai hapi derën e një serre, dhe u lëndua prej avujve të qymyrit brenda serrës. Për shkak të kësaj, ai vuajti nga problemet me një valvul të zemrës. Gjithashtu ai vuajti nga krizat me duart e këmbët për dhjetë vjet. Unë i bëja masazh dhe injeksione. Dhe pastaj ai ndërroi jetë prej asaj sëmundjeje.

2. Thirrja për aventura

Ndërkohë që kujdesesha për tim shoq për disa vjet gjatë sëmundjes së tij edhe unë bëra një aksident për vete. Një ditë, shkova te mullinjtë dhe më ranë thasët e orizit mbi këmbë. Për shkak se këmba m'u thye, më shtruan në spital për një kohë të gjatë. Befas, nuk kishte asnjë njeri që të kujdesej për tim shoq dhe për këtë arsye ai ndërroi jetë më herët nga sa pritej. Jo shumë kohë më vonë, vajza ime e parë, e cila jetonte në Pjongiang vdiq prej zjarrit. Pastaj disa muaj më vonë, vajza e saj e parë pati një aksident në trafik, teksa punonte si oficerë policie e trafikut rrugor. Vajza ime e dytë rrinte fshehur, për shkak se kishte hyrë në borxhe, dhe për këtë arsye ajo nuk mund të kujdesej dot për mua. Unë po rrija me vajzën time më të madhe. Burri i saj vinte gjithmonë i dehur në shtëpi. Unë isha shumë e inatosur me atë dhe i thashë, se do të shkoja në Kinë, edhe sikur të më duhej të zvarritesha deri atje. Që kur humba burrin dhe vajzën e parë, unë u përballa me situata shumë të vështira. Nuk kisha asnjë njeri tek

i cili të kërkoja ndihmë në Korenë e Veriut, dhe për këtë arsye vendosa të arratisesha nga Koreja e Veriut dhe të shkoja të vizitoja motrat e mia në Kinë. Në atë kohë, nuk isha në gjendje të ecja mirë. Prandaj, kur i tregova familjes se do të shkoja në Kinë, disa prej tyre donin të bashkoheshin me mua dhe të vinin edhe ata në Kinë. Besoj se Perëndia i rregulloi të gjitha këto ngjarje, me qëllim që të më thërriste mua për të ardhur në Korenë e Jugut.

3. Refuzimi i thirrjes

U bëmë pesë veta që erdhëm në Kinë: vajza ime më e vogël, djali i saj, vajza e saj, vajza e dytë e vajzës sime më të madhe dhe unë. Motra ime më përshëndeti me gjithë zemër në takimin tonë të parë, por pak kohë më vonë ne u bëmë barrë e rëndë për të, ngaqë nuk fitonim fare para. Ajo nisi të më mërzhiste duke më kërkuar të largoheshim, por ne nuk kishim se ku të shkonim tjetër. Kështu që, jetuam atje edhe një vit tjetër, me përjashtim të vajzës së dytë të vajzës sime të parë. Neve na kapën, kur një fshatar na raportoi tek autoritetet. Unë nuk e flisja gjuhën kineze, prandaj thashë me anën e përkthyesit: “Nëse doni, na merrni! Ne nuk u kthym në Korenë e Veriut me vullnetin tonë, por u detyruam të kthehemi prej qeverisë kineze. Bashkëshorti im ishte në Luftën për Çlirimin e Kinës, dhe ai u plagos në luftë ndaj u lirua nga ushtria. Neve na u desh t’i zbatonim urdhrat e qeverisë për të lëvizur në Korenë e Veriut, kurse tani, edhe pse ishte urdhër, ne nuk mundnim dot të jetonim më në Korenë e Veriut. Edhe tani, nëse doni të na dërgoni atje, atëherë dërgonani!”

Pasi fola unë, ata na detyruan të paguajmë një gjobë, por ne u lejuam të vazhdonim të jetonim në Kinë. Unë nuk dëshiroja që të ktheheshim në Korenë e Veriut. Kisha shumë kujtime të trishtta atje, duke u kujdesur për burrin tim dhe duke punuar ditë për ditë për dhjetë vjet rresht. Gjithsesi, dikur, unë u përpoqa ta kaloja lumin për t’u kthyer në Korenë e Veriut. Megjithatë, mbesa më

ndaloi, duke thënë se ne duhej të vdisnim së bashku. Kështu që, unë u ktheva sërish në shtëpinë e motrës sime. Ne i ishim bërë barrë motrës sime në shtëpinë e saj në Harbin, Hiajlongxhiang (Heilongjiang), në Kinë, për katër vjet.

4. Takimi i mentores

Motra ime ishte mentorja ime e parë. Ajo e ushqeui vajzën time dhe e ndihmoi atë që të shmangte trafikimin. Dhe ajo u kujdes për familjen time me pesë veta për pesë vjet; jam vërtet mirënjohëse për të. Motra ime u martua me një burrë kinez Han, dhe pati dy vajza e një djalë. Pasi u martuan, fëmijët e saj u ndanë prej saj, të jetonin më vete. I shoqi ishte një zyrtar qeverie, prandaj rrethanat jetësore të tyre ishin të mira. Vajza e saj menaxhonte një bar ku këndonin karaoke, dhe unë munda të punoja atje si punonjëse shërbimi. Por, unë nuk mundja dot të flisja gjuhën kineze, prandaj në të vërtetë pata një kohë të vështirë atje, që zgjati goxha.

Mentori im i dytë ishte Perëndia. Mbesa ime punoi si përkthyes në Kinë. Ajo mori një ofertë nga një biznesmen koreanojugor, që ne të lëviznim në Kinën Jugore. Ai më pyeti se përse rrija e vetmuar në shtëpi dhe më ungjillëzoi, duke më ftuar në kishë. Ai më tha: “Nëse shkon në kishë, do të zësh miq të mirë dhe fëmijët e tu do të bekohen.”

Një të premte të veçantë, natën, në vitin 2007, vajza ime më e vogël, nipi, mbesa dhe unë shkuam në një takim lutjeje në kishë, i cili zgjati gjithë natën. Anëtarët e kishës po luteshin vërtet fort dhe i bënin thirrje Perëndisë atë natë. Mendimi im i parë në atë çast ishte se njerëzit që shkojnë në kishë duhet të jenë të çmendur. Prandaj, po mendoja që të mos shkoja më në kishë; megjithatë, mora kaq shumë telefonata nga kisha, sa që më në fund shkova atje përsëri. Por, për disa muaj nuk kuptoja as edhe një gjë në kishë, lidhur me këngët e lavdërimit dhe studimin e Biblës Nisa

të shkoja në kishë nga janari, por nuk shkova me zell deri nga maji; gjithsesi, dhjakja më e moshuar nga kisha më inkurajonte vazhdimisht për të shkuar në shërbesat e kishës, dhe më tha se unë duhej ta kisha çelësin e parajsës, si grua e moshuar. Prandaj, vendosa me mendjen top: “Unë duhet ta adhuroj Perëndinë mbi njëqind herë, dhe do të arrij ta njoh Atë!” Vendosa të shkoja në një takim lutjeje të titulluar “Takimet e Lutjes së Mesnatës të Danielit” me rastin e Pashkës në atë vit.

E përjetova Perëndinë si të gjallë përmes këtyre takimeve të lutjeve dhe erdha në besim. Të gjitha sëmundjet e mia u zhdukën. U ndryshova krejtësisht prej këtyre takimeve. Madje përjetova edhe një mrekulli nga Perëndia, përpara se të niste një takim lutjeje. Nga shtëpia ime duheshin dymbëdhjetë minuta ecje deri te ndalesa e furgonit të kishës. Unë kisha probleme me shpinën dhe me këmbët, kështu që i kërkoja shoferit të vinte të më merrte direkt te shtëpia, por ai nuk pranoi. Në atë kohë, vendosa t’i lutesha Perëndisë, që dëgjon lutjet, e të mos hiqja dorë prej shkuarjes në takim. Pastaj, në mënyrë të mrekullueshme, Perëndia siguroi që furgoni i kishës të vinte deri te shtëpia ime për të më marrë. Ishte përvoja ime e parë e përgjigjes ndaj lutjes, dhe prandaj doja ta ndaja vërtet dëshminë time me të tjerët. Gjithmonë ndihesha aq nervoze për të folur përpara të tjerëve, sa që kisha mbetur si memece tërë jetën. Por ditën tjetër, unë ndava dëshminë time gjatë kohës së adhurimit.

Në të vërtetë nuk kisha besim, por e falënderova Perëndinë që pata mundësi të vija në kishë me furgon. Tërë jetën time unë kisha jetuar si analfabete, isha e sëmurë dhe nuk flisja. Mamaja ime kishte një çrregullim gjenetik, që shpinte në verbim, dhe ajo ishte e verbër për pesëmbëdhjetë vjet. Edhe daja im gjithashtu u verbua dhe mamaja ime në këto rrethana vrau veten. Kur mbusha shtatëdhjetë vjet, edhe mua m’u errësuan sytë. Një biznesmen më solli një Bibël me shkronja të mëdha, por unë nuk mundja ta lexoja dot atë.

Pastaj shikimi im u bë normal, kur mora pjesë në një takim lutjeje. Në atë kohë, mora një ftohje dhe për këtë arsye vajza më shpuri në

spital. Pasi më bënë një injeksion, nisa ta lavdëroja Perëndinë. Pastaj befaz, sytë m'u ndriçuan! Mund të shihja qartë gjithçka në spital. Prandaj, e pyeta vajzën time, nëse ajo besonte në Jezusin. Ajo më pyeti se çfarë ndodhi. Kështu që, i tregova se më ishte rikthyer shikimi i syve. Njerëzit që nuk më njihnin, do të mendonin se po gënjeja. Dikur mbështeteshë te muri i kishës, për shkak të dëmtimit të shpinës, por edhe shpina ime dalëngadalë po përmirësohej.

Gjatë një takimi lutjeje të së premtes, që zgjati tërë natën, vërtet doja ta ndaja dëshminë time. Fryma e Shenjtë më nxiti në zemër, prandaj doja të thosha: “Lutjuni Perëndisë. Perëndia është një Perëndi i gjallë.” Atëherë m'u hap goja dhe u ngrita e ndava dëshminë time përpara të gjithëve atë natë. Të gjithë më panë të befazuar.

Pasi mbërrita në Korenë e Jugut, një zyrtar i agjencisë së sigurimit të Koresë së Jugut ma pa këmbën. Ai u habit dhe më pyeti, sesi kisha ecur me këmbën të thyer. Unë nuk mund të ecja dot për më tepër se pesëdhjetë metra. Rrugës për në Tajlandë, eca përmbi male të lartë dhe rrugë me borë me këtë këmbë të thyer, përmes lutjes. Për shkak të cistitit, varesha nga injeksionet për tërë jetën time, por u shërova nga ajo sëmundje, kur u luta në takimin e lutjes herët në mëngjes.

5. Kalimi i pragut të parë

Përpara Pashkës, një muaj marsi, kur isha ende në Kinë, më zuri gjumi në mes të një takimi lutjeje herët në mëngjes. Në një ëndërr, Moisiu më tha: “Zbrit poshtë dhe bëj diçka.” Kur u zgjova nga ëndrra, nxora përfundimin se duhej të bëja diçka. Vazhdova të lutesha për disa muaj dhe shkova në një takim ungjillëzues (për misionarët) në kishë. Doja t'i ungjillëzoja të tjerët, por për shkak se isha në Kinë, nuk mund të takoja dot asnjë koreanoverior që ta ungjillëzoja. Prandaj vendosa të shkoja në Korenë e Jugut përmes

Tajlandës dhe t'i ungjillëzoja refugjatët koreanoveriorë, që do t'i hasja përgjatë rrugës. Ky ishte i vetmi qëllim i imi për të shkuar në Korenë e Jugut. Më në fund, prej udhëzimit të Perëndisë, munda të vij në Korenë e Jugut me nipin dhe mbesën që janë të dy fëmijët e vajzës sime më të vogël. Kapërceva malin dhe lumin drejt Tajlandës. Perëndia dërgoi një shtyllë zjarri dhe një re që e drejtoi dhe e mbrojti familjen time.

6. Sprovat, aleatët dhe armiqët

Kur jetoja në Kinë, familja ime ishte në gjendje të mirë ekonomike, ngaqë im shoq kultivonte oriz; megjithatë, qeveria kineze e detyroi familjen time të lëvizte për të jetuar në Korenë e Veriut. Unë nuk doja që të lëviznim. Pasi familja ime lëvizi për në Korenë e Veriut, im shoq shkoi në shkollë dhe ne vuajtëm shumë, duke përfshirë ushqimin vetëm me qull për të mbijetuar. Ishte sprova ime e parë: të dërgoheshim në Korenë e Veriut prej qeverisë.

Sprova e dytë ishin të gjitha vështirësitë që përjetova në Korenë e Veriut, përpara se të vija në Kinë. Pata gjithë ato vështirësi të hershme, të tilla si: thyerja e këmbës, vdekja e burrit, vdekja e vajzës dhe aksidenti i mbesës sime të parë. Të gjitha ato ndodhën në të njëjtin vit.

Sprova e tretë ishte shëndeti im i lig. Pasi m'u lëndua këmba, nuk mund të ecja dot mirë. Pas lindjeve kisha vuajtur shumë prej cistitit; megjithatë, që të gjitha këto sëmundje u shëruan prej hirit të Perëndisë, ndërkohë që unë lutesha në takimet e lutjeve në mesnatë në Kinë. Në atë kohë unë çaloja, por pasi u ktheva nga tualeti në një takim lutjeje, këmba ime u zgjat duke marrë pamjen e formës L, dhe kështu mund të ulesha tamam.

Sa për aleatët, besoj se Perëndia është aleati im. Pasi besova në Perëndinë, mund ta pranoja se Perëndia bënte gjithçka në jetën time. Nuk kurseva dot para kurrë, por kisha oriz për të

jetuar. Kur kthej kokën prapa, jeta ime ishte e gjitha nën hirin e Perëndisë. Tani u them gjithmonë nipit e mbesave të mia: “Nëse doni që të shkoni në kolegji, duhet t’i luteni Perëndisë.” Vajza ime thotë se Perëndia është i gjallë; ajo thotë se e ka parë këtë përmes jetës sime. Vajza ime thotë se jam e bekuar që ndiej gëzimin e jetës. Për këtë arsye, nuk do ta shkëmbeja Perëndinë me asgjë në këtë botë.

Kur mendoj për armiqtë, kujtohem se qeveria kineze e shpërbleu tim shoq, për shkak se ai ishte hero i Luftës për Çlirimin e Kinës, edhe pse ishte plagosur; megjithatë kur familja ime lëvizi për në Korenë e Veriut që ta rindëronte vendin pas Luftës së Koreve, qeveria e Koresë së Veriut nuk ia njohu fare atij plagosjen në luftë. Ne jetuam vetëm me qull për tre vjet gjatë kultivimit të tokës. Edhe pse na nderuan për kultivim të mirë, nuk u trajtuam mirë, për shkak se ne erdhëm nga Kina. Ne ishim heronj, përpara se të largoheshim nga Kina për të shkuar në Korenë e Veriut, por unë ndihesha keq për trajtimin që na bënë. Ata u bënë armiqtë e mi.

7. Afrimi për te shpella më e brendshme në thellësi

Në maj të vitit 2010, unë isha në burg në Tajlandë. Ndenja me të burgosura tajlandeze, dhe njëra prej tyre kontrollonte burgun. Njëra prej të burgosurave më shqetësonte mua dhe të gjithë të burgosurat e tjera koreanoveriore. Ajo ishte në katin sipër timit, dhe kur krihej flokët m’i hidhte mua bashkë me tartabiqët; gjithsesi unë u lirova nga burgu pas dymbëdhjetë ditësh. Kjo ishte shumë kohë e shkurtër, krahasuar me të tjerët. Erdha në Shërbimin e Sigurimit Kombëtar në Korenë e Jugut në qershor të vitit 2010. Dymbëdhjetë ditë ishin një kohë jashtëzakonisht e shkurtër burgu për një refugjate koreanoveriore.

Nipi i njërës prej zonjave kishte vënë një varëse kineze për hajmali. Unë lutesha kundër varëses së tij hajmali. Një pasdite, ai po vërdallosej rreth meje dhe u rrëzua sipër meje, kështu që m'u thye sërish këmba. Ma vunë këmbën në allçi deri sipër te kofsha. Pasi ma vunë allçinë, ndieja dhimbje kudo nëpër trup, dhe e kisha të vështirë të lëvizja. Për më tepër, për shkakun tim, ne u vonuam nga dalja prej Agjencisë së Sigurimit. Mbesa ime qante e ulërinte, për shkak se po e vonoja unë.

Isha e sëmurë, dhe asnjë nga situatat rreth meje nuk ishte e mirë. Një ditë, thjesht unë nisa t'i lutesha Perëndisë, teksa rrija ulur përdhe. "Perëndi, nëse Ti më do mua, të lutem shëroma këmbën sa më shpejt të mundesh." Dhe pastaj u rrëzova. Por allçia në formën L mbi këmbën time u drejtua dhe kocka ime u vendos në vendin që duhej. Përjetova një mrekulli!

8. Sprova e rëndë

Vështirësia e parë që përjetova në Korenë e Jugut ishte kanceri në zorrë i vajzës sime. Vërtet doja që vajza ime të ishte në gjendje të jetonte në Korenë e Jugut; megjithatë, ajo vdiq në qendrën e risistemimit në Hanauon (Hanawon), në Korenë e Jugut, dhjetë ditë përpara datës kur duhej të lirohej. Prapëseprapë ishte hiri i Perëndisë. Unë u ngushëllova, për shkak se ajo arriti të vdiste në Korenë e Jugut. Funerali iu mbajt në qendrën e risistemimit në Hanauon. Ata u përkujdesën për funeralin e saj.

Ishte edhe një sprovë tjetër, që rezultoi të ishte bekim për mua. Pa e ditur unë, im shoq kishte pasur një djalë përmes një marrëdhënieje jashtëmartesore me një vejushë në fshat. Por pasi lindi ky djalë, im shoq nuk bëri më tradhti bashkëshortore me dashnoren e tij. Kështu që, për njëzet e pesë vjet, unë nuk e dija që ai kishte një djalë. Edhe pse fshatarët më tregonin për këtë fakt, unë nuk e besoja atë. I besoja më tepër tim shoqi.

Megjithatë, një ditë, zbulova se ishte e vërtetë: i biri i tij erdhi tek unë, me qëllim që të regjistrohej në qeveri si djali i tim shoqi. Por unë nuk u tërbova kundër askujt. Përkundrazi, e falënderova Perëndinë, që më në fund kisha një djalë, që i ngjante tim shoqi. E pëlqeja vërtet atë djalë dhe gjithashtu i pëlqeja edhe nipërit e mbesat që më erdhën prej tij. Prandaj, kurdoherë që ai vinte tek unë, e trajtoja me një zemër mirënjohëse. Më erdhi keq për të, ngaqë unë u largova për në Kinë, tre vjet pasi e kisha takuar atë, dhe nuk isha në gjendje t'i tregoja se ne do të largoheshim.

Përpara se t'i besoja Perëndisë, gjithmonë mbushesha me shqetësime. Por, pasi i besova Atij, zemra ime ka qenë gjithmonë e mbushur me gëzim dhe paqe, pavarësisht nga të gjitha vështirësitë dhe sprovat, për shkak se Perëndia ka qenë me mua gjatë gjithë kohës.

9. Shpërblimi

Unë u shërova nga cistiti, nga këmbët e paekuilibruara dhe nga shikimi i dobët. Për më tepër, tani jam duke jetuar në Korenë e Jugut. Këto janë bekimet e mia dhe shpërblimet nga Perëndia. Më përpara jetoja si një trup i vdekur. Kur isha në Korenë e Veriut, isha e sëmurë dhe nuk kisha fare vetëbesim. Por, pasi arrita në Korenë e Jugut, jam bërë vërtet falënderuese dhe ndihem e lumtur, plot me gëzim dhe paqe prej Perëndisë. Kur nisa t'i besoja Perëndisë në Kinë, u shërova prej shikimit të dobët dhe prej pesëdhjetë e dy viteve me cistit, ndërkohë që merrja pjesë në takimet e lutjeve të mëngjesit. Gjithashtu, u shërova nga këmba e thyer, ndërkohë që ndodhesha në ndërtesën e Shërbimit të Sigurisë Kombëtare. Të premten që shkoi, mora pjesë në një takim lutjeje në mëngjes dhe mësova përmendësh një himn: “Ora e Ëmbël e Lutjes.” Më pëlqejnë vërtet që të gjitha vargjet. Kam mësuar përmendësh më shumë se njëqind himne.

10. Rruga për kthimin

Shkova tek Universiteti i Fshehtë, që drejtohet prej “Zëri i Martirëve” në Kore. Si pjesë e programit arsimor, ndërmora një udhëtim misionar për në Kinë. Përpara se familja ime të shkonte në Korenë e Veriut, unë e kisha folur gjuhën kineze për tre vjet. Vuaja me të vërtetë për ta folur mirë atë gjuhë. Por, kur shkova në Kinë për udhëtimin misionar, takova një grua kineze Han. Perëndia m’i solli sërish ndër mend të gjitha fjalët kineze që kisha mësuar, me qëllim që t’i jepja dëshminë time asaj gruas. E gjitha kjo ndodhi pasi e kisha harruar gjuhën kineze gjatë dyzet e tre viteve në Korenë e Veriut!

Pastaj, takova një pastore gjatë udhëtimit misionar. Pashë se pastorja vishte doreza edhe gjatë verës, për shkak të trajtimit që merrte për kancerin e mëlçisë. Pavarësisht nga gjendja e saj fizike, ajo e përhapte lajmin e mirë me tërë fuqinë e saj. Unë lutem akoma për shërbesën e saj.

Më vjen vërtet keq për vajzat e reja që takuam, kur isha në udhëtimin tim, të cilat ndiheshin se nuk mundeshin dot të besonin në Perëndi, për shkak të rrethanave të tyre. Ato janë viktimat të trafikut të paligjshëm të qenieve njerëzore. Më vjen vërtet keq, që nuk mund të sillja dot shumë njerëz te Zoti Jezus Krisht! Tani jam e gatshme ta ndjek Perëndinë kudo që të më thërrasë për hir të Ungjillit, ngaqë nuk kam frikë prej asgjëje.

Kur shkova në udhëtimin misionar, takova fëmijë të vegjël nga Koreja e Veriut, që hynin ilegalisht në Kinë. Doja vërtet që t’i shpëtoja fëmijët e vegjël për të dalë prej tragjedisë së tmerrshme, që ata përjetojnë në Korenë e Veriut. Askush nuk dyshonte që unë isha koreanoveriore, ngaqë kisha lindur në Kinë dhe flisja me një theks nga Shenian-i (Shenyang). Disa kisha koreanogugore, në fakt i sjellin fëmijët në Korenë e Jugut nga Kina, nëse dikush mundet t’i nxjerrë ata prej Koresë së Veriut. Kështu që, unë mendova se mund ta bëja një gjë të tillë. Gratë e moshuara koreanoveriore mund ta kapërcejnë lumin pa u inspektuar, nëse u japin si ryshfet para ose ushqim patrullave

kufitare. Tani lutem vërtet për këto gjëra. Djali i vogël i vajzës sime të parë tani është tridhjetë e dy vjeç, dhe ai është martuar e jeton në Korenë e Veriut, në Hai-Çen (Hye-San). Dua të shkoj e ta takoj atë.

Për shkak se u rrita në Kinë, kinezët nuk më shohin mua si koreanoveriore, ngaqë unë flas me theksin e Kinës verilindore. Jam e sigurt se nuk do të më kapin kurrë, nëse e përhap lajmin e mirë në Kinë, për shkak të theksit tim në gjuhën kineze. Njerëzit më trajtojnë si një person koreano-kinez, që aktualisht jeton në Korenë e Jugut. Kur e vizitova Kinën në udhëtimin tim, takova një person nga zona e kufirit me Korenë e Veriut. Gjyshja e tij shkon e vjen nga Koreja e Veriut, dhe edhe unë dua që të bëj të njëjtën gjë. Dua t'i sjell ata fëmijët e vegjël nga Koreja e Veriut në atë të Jugut. Dua që ata të rriten atje. Nuk e kam frikë qeverinë e Koresë së Veriut.

11. Ringjallja

Nëse do të shkoja në Korenë e Veriut për ungjillin, mund të më kapnin. Por, nëse më kapnin dhe më ndëshkonin, kjo do të thoshte martirizim i lavdishëm dhe vdekje e nderuar. Tani jam mbi tetëdhjetë vjeç. Mund të vdes lehtësisht për Zotin tim, me falënderim të plotë.

Jam shumë e mirë për të mësuar përmendësh vargje nga Shkrimi i Shenjtë dhe himne. Unë jam një Bibël që ecën. Po të më kapnin agjentët e sigurimit kombëtar të Koresë së Veriut, dhe të më burgosnin, atëherë unë do t'u dëshmoja për Ungjillin shoqeve të mia të burgut, rojeve të burgut, dhe madje edhe vetë agjentëve të sigurimit kombëtar.

12. Rikthimi me eliksirin

Nëse ndonjëherë Koreja e Veriut dhe ajo e Jugut do të bashkohen, unë dua të kthehem në Veri për ta përhapur Ungjillin. Por, edhe sikur

të mos ndodhë bashkimi, prapëseprapë unë dua të kthehem. Me qëllim që t'i ndihmoj të varfrit në Korenë e Veriut. Ata nuk kanë para, dhe supozoj se unë mund të shpie ca para atje, si një lloj eliksiri. Por teksa mendoj për këto gjëra, nuk e vras shumë mendjen për paratë. Paraja nuk është në të vërtetë e rëndësishme për mua. Mendoj se vetë Ungjilli është eliksiri për të cilin kanë nevojë koreanoveriorët.

Perëndia është aq i plotfuqishëm, sa që Ai më bekon mua edhe përmes jobesimtarëve. Njëherë bëra operacion tiroiden. Shoqja ime e dhomës në spital nuk besonte në Perëndinë. Kur dola nga spitali, bashkëshorti i shoqes së dhomës sime atje më shpuri me makinë mua dhe familjen time në shtëpi. Ai e mbushi frigoriferin me ushqime. Ai nuk ishte besimtar, dhe madje as nuk ishte miqësor me mua. E pashë atë vetëm për një javë në spital. Por Perëndia e përdori atë për të plotësuar nevojat e mia. Kjo është mënyra sesi e di se hiri i Perëndisë mjafton më tepër sesa paratë njerëzore.



Unë dua që bashkëqytetarët e mi koreanoveriorë ta përjetojnë eliksirin e hirit të Perëndisë pikërisht ashtu. Përhapja e eliksirit të Ungjillit është nderi më i madh që mund të imagjinoj. Unë dua të vdes për hir të Ungjillit, duke u treguar njerëzve për Perëndinë. Dua t'u tregoj bashkëfshatarëve të mi sesi hiri i Perëndisë më ndryshoi krejtësisht mua. Dua t'u tregoj atyre Perëndinë!

Gjithashtu unë dua t'ia tregoj lajmin e mirë motrës sime në Kinë. Dua t'i shkoj për vizitë asaj. Fshatarët do të befasohen prej ndryshimeve të mia. Do t'ua tregoj veten time atyre si provë të plotë të hirit të Perëndisë.

Përfundimi:

Udhëtimi juaj

Deri tani ju keni lexuar për udhëtimet individuale të njëmbëdhjetë heronjve. I dymbëdhjeti është juaji për ta treguar.

Nëse ju jeni të ngjashëm disi me ne të njëmbëdhjetët, udhëtimet e të cilëve i paraprijnë tëndit në këtë libër, ju mund ta gjeni veten duke menduar: *Mendoj se e kuptoj idenë bazë të udhëtimit të heroit dhe sesi mund të zbatohet ajo në jetën time, por nuk e kam fare idenë se ku ta filloj shkrimin.* Ja ku është lajmi i mirë: ju nuk filloni fare duke e shkruar atë.

A e mbani mend te hyrja, ku ju nxita që t’i kushtonit vëmendje të veçantë ilustrimeve të bëra nga secili hero në çdo kapitull? Ato ilustrime janë më tepër sesa rregullim vitrine për historitë. Ato janë aktualisht “fara” e historisë, vendi ku zë rrënjë historia e secilit prej heronjve.

Prandaj, teksa uleni për ta nisur procesin e ritregimit të historisë së jetës suaj sipas kornizës së udhëtimit të heroit, më lejoni t’ju jap të njëjtën këshillë që ua dhashë të dhjetë bashkudhëtarëve të mi koreanoveriorë. Është e njëjta këshillë, që e mësova edhe për vete: filloni ta shkruani udhëtimin e heroit duke skicuar vizatimin e skenës së përfundimit të udhëtimit tuaj.

Dikur i trajnoja dezertorët koreanoveiorë për të nisur shkrimin e udhëtimit të tyre të heroit, duke iu dhënë atyre një fletë të printuar bukur me dymbëdhjetë kuti të vogla bosh, nga një për secilin nga hapat e udhëtimit të heroit. U tregoja atyre të skiconin përvijimin

e historisë së tyre duke shkruar në secilën kuti një përmbledhje të shpejtë lidhur me sesi e kishin përjetuar ata atë hap të veçantë. Mendova se prej këtij përvijimi, pastaj do të ishte e lehtë që ata ta vishnin me detaje secilin hap, duke e larguar ca ankthin e të parit të një flete bosh dhe të vrarjes së mendjes se nga t'ia fillonin. Por kur e provova këtë qasje, zbulova diçka shumë të rëndësishme: ka ndryshim shumë të madh mes udhëtimit të heroit dhe një punimi teze shkencore.

Udhëtimi i heroit ka një radhë të përcaktuar dhe ka strukturë me logjikë pas saj, por është një lloj radhe, strukture dhe logjike shumë e ndryshme nga ajo që përdorni ju, kur përpiqeni të argumentoni diçka ose të fitoni një argument. Historitë e mira rrallë burojnë prej përvijimeve, dhe treguesit e mirë të historive kanë një mënyrë për t'i lejuar historitë ta ndërtojnë veten gjatë tregimit.⁴³

Sidomos me udhëtimin e heroit, ka diçka në lidhje me të, e cila e sfidon paraprakisht përvijimin. Të njëmbëdhjetë ne, udhëtimet e të cilëve tregohen në këtë libër, zbuluam se vërtet na duhet që ta tregojmë plotësisht njërin hap të udhëtimit, përpara se të shfaqet hapi tjetër. Ky është vërtet lajm i mirë për shkrimin e udhëtimit tuaj të heroit: sapo të nisni shkrimin, do të habiteni sesi në mënyrë të natyrshme njëri hap drejton për te tjetri. Ju ndoshta mund të keni filluar ta vini re këtë në disa prej udhëtimeve të treguara në këtë libër. Teksa heroi e tregon udhëtimin, biseda për botën e zakonshme në mënyrë disi të natyrshme të shpie drejt e tek thirrja për aventurë, e cila disi natyrshëm të shpie drejt e te refuzimi i thirrjes.

Natyrisht, nuk funksionon ashtu gjithmonë. Në udhëtimet që ju lexoni këtu, ndoshta i keni vënë re disa raste, ku heroi kthehet sërish në tregimin e tij ose të saj për udhëtimin dhe e përsërit një seksion ose disa detaje më vonë të një hap tjetër. Është krejtësisht e pranueshme; në fakt, është mënyra e vetme sesi funksionojnë historitë e vërteta. Paragrafët në punimet afatgjata nuk e përsëritin veten, kurse detajet në histori po. Thjesht vëzhgojeni mënyrën sesi i tregojmë historitë në

⁴³ Linda A. Chisolm, *Charting a Hero's Journey* (New York, NY: The International Partnership for Service Learning, 2000).

jetët tona të përditshme. Ne do ta përsërisim shpesh një detaj, duke e rregulluar atë pak më ndryshe çdo herë. Ndonjëherë ne e bëjmë këtë për ta theksuar. Ndonjëherë kjo ndodh, ngaqë ne mund ta kemi zbuluar kuptimin e një detaji të veçantë të përvojës sonë, vetëm kur na ftojnë t'i hedhim një sy atij në një mënyrë të re.

Për shembull, shumë dezertorë koreanoveriorë janë mësuar me të menduarit për arratisjen e tyre prej Koresë së Veriut si një veprim prej dëshpërimit, si e vetmja zgjedhje që kanë në dispozicion, si më e mira në një tufë me opsione të këqija. Bisedoni me ata për pak kohë lidhur me të dhe do ta kuptoni arsyen përse: ngaqë në historinë për Kim Il Sung-un që u rri në mendje atyre, ata janë tradhtarë të vendit të tyre dhe të familjeve të tyre.⁴⁴ Shumë shpesh anëtarët e familjes së tyre, që ata lanë pas ndëshkohen në vend të tyre.⁴⁵ Kjo është një barrë mendore pothuajse e paimagjinueshme, dhe i shpie dezertorët teposhtë rrugëve të pashkelura nga shumë njerëz. Disa nuk pranojnë të bisedojnë, e as të mendojnë për këtë gjë. Disa nuk e kalojnë dot atë, dhe më në fund i japin fund jetës prej fajit.⁴⁶ Disa kthehen mbrapsht në Korenë e Veriut në një përpjekje të gabuar për të kërkuar amnisti për anëtarët e familjes së tyre.⁴⁷ Shumica, gjithsesi tregojnë një histori viktime. Ata do t'ju thonë se ishin të detyruar për t'u larguar nga Koreja e Veriut dhe ata mbartin një lloj hidhërimi, që i gjymton psikologjikisht, kundër regjimit të Koresë së Veriut, i cili i ktheu ata në viktime. Pa

⁴⁴ Heonik Kwon and Byong-Ho Chung, *North Korea: Beyond Charismatic Politics* (Lanham, MD: Rowman & Littlefield, 2012), 34.

⁴⁵ Kim Joon-Ho, "Pyongyang Moves to Identify Defectors," Radio Free Asia, March 12, 2012, lexuar më 11 mars 2014, <http://www.rfa.org/english/news/korea/defectors-03122012163808.html>.

⁴⁶ WooTaek Jeon, ChangHyun Hong, ChangHo Lee, Dong Kee Kim, Mooyoung Han, SungKil Min, "Correlation between Traumatic Events and Posttraumatic Stress Disorder Among North Korean Defectors in South Korea," *Journal of Traumatic Stress* 18, no. 2 (April 2005): 147-54.

⁴⁷ Choi Song Min, "Re-defections chalked up by Musan NSA," Daily NK, November 13, 2012, lexuar më 23 nëntor, 2012, <http://www.dailynk.com/english/read.php?catId=nk01500&num=10028>.

dashje, ata pastaj mbyllën vetëm në tregimin e asaj historie që ka në qendër Kim Il Sung-un, për pjesën tjetër të jetës së tyre.

Megjithatë, pyetini po këta dezertorë koreanoveriorë: “A keni marrë ndonjëherë një thirrje për aventurë?” dhe ata pothuajse pa asnjë ndryshim do t’ju tregojnë sesi arritën të largoheshin nga Koreja e Veriut. Në këtë tregim, ngjarja e largimit nga Koreja e Veriut është e njëjtë, por ata nuk janë më viktimë, por aventurierët, të cilët arritën të zbulojnë se ata janë në kërkim të një eliksiri për të sjellë shërim tek ata që ndodhen në botën e tyre të zakonshme. Ai identiteti i ri hap një botë shumë më të gjerë mundësish për pjesën tjetër të udhëtimit të tyre, nga sa do të mundej ndonjëherë identiteti i një viktime.

Në të njëjtën mënyrë, ju mund të zbuloni se ka elemente mjaft të njohur në vetë historinë tuaj, që ju do t’i hasni krejt ndryshe, teksa mendoni për thirrjet, refuzimet, mentorët, aleatët, sprovat, shpellat e brendshme, ringjalljet dhe eliksirët. Ashtu si me heronjtë dezertorë koreanoveriorë, historitë e të cilëve i lexuat këtu, disa elemente të udhëtimit tuaj mund ta rishfaqin veten shumë herë. Shkruajini ato nën sa më shumë hapa që t’ju vijnë ndërmend. Një pjesë e udhëtimit të heroit është zbulimi se historitë që ju i menduat se i dinit shumë mirë, në fakt janë shumë më shumëplanëshe, nga sa e kishit imagjinuar më përpara. Është njësoj si kur e rilexon një histori Bible për herë të njëqindtë dhe vëren diçka të dukshme, të cilën për ndonjë arsye nuk e kishte vënë re më përpara. Ashtu është pikërisht sesi vepron Perëndia.

Ka edhe një aspekt tjetër të punës së Perëndisë i cili shpesh tenton të harrohet prej nesh, teksa i rrëfejmë me hollësi udhëtimet tona: jetët tona nuk janë tonat. Pikërisht këtë gjë na e kujton Apostulli Pal te I Korintasve 6:19. Udhëtimi i heroit na kujton gjithmonë për të njëjtën gjë. Kjo është arsyeja se përse hapi përfundimtar nuk quhet “Të lumtur përgjithmonë”, por përkundrazi quhet “Rikthimi me Eliksin.” Ju mund të zbuloni se ajo historia e jetës suaj, që ishte shumë e njohur, të rezultojë si mjaft e panjohur, teksa e kuptoni se udhëtimi juaj nuk synon të përfundojë me të qenët i kënaqur ju vetë me gjithçka që ndodhi më përpara, por përkundrazi

me sjelljen nga ana juaj të një eliksiri jetëdhënës në atë botën e zakonshme, që ju e latë përkohësisht prapa, kur iu përgjigjët thirrjes suaj për aventurë.

Dhe kjo është arsyeja se përse është e rëndësishme të filloni ta tregoni historinë tuaj duke nisur me hapin e dymbëdhjetë, përpara se të ktheheni te hapi i parë. Nëse tregoni nga fillimi në fund, ju mund të përfundoni pa dashje në një kërkim për vetëpërmbytje, ku armiq të tuaj janë ata që ju bllokojnë shtegun. Kjo gjë mund t'ju bëjë juve një viktimë të fuqisë së tyre të pamposhtshme. Filloni me kujtesën se fundi i udhëtimit tuaj përfshin bekimin e atyre mes të cilëve filloi ai udhëtim. Kujtohuni se ju do t'i bekoni ata me ato gjëra që keni marrë përgjatë shumë rreziqeve, me anë të hirit të Perëndisë. Nëse i bëni këto gjëra, atëherë edhe vështirësitë tuaja, edhe fitoret tuaja do të duken shumë të ndryshme.

Prandaj, nxirrni një fletë letre të madhe bosh, merrni ca ngjyra, bojëra ose lapsa me ngjyra, dhe përgatituni ta skiconi hapin e dymbëdhjetë, fundin e udhëtimit tuaj: rikthimi me eliksirin. Kujtohuni se ky është hapi që ne e përkufizuar kështu:

Rikthimi me Eleksirin. Eleksiri është një mjekim shërues. Në jetën e përditshme, eliksiri zakonisht nuk është një mjekim fjalë për fjalë. Përkundrazi, është diçka që ju e mësuar përgjatë udhëtimit tuaj dhe që mund ta merrni mbrapsht në botën e zakonshme për të filluar t'i shëroni të tjerët.

Për dezertorët koreanoveriorë, që i trajnoj, e them në këtë mënyrë: vizatoni një pamje të asaj që përfytyroni, kur të ndodhë bashkimi. Çfarë do donit të bënit, kur të ktheheni në Korenë e Veriut? Cili është eliksiri që merrni me vete, dhe kujt do t'ia shpini?

Për ju, si lexuesi i tanishëm, unë do të thoja kështu: kur t'i mposhtni vështirësitë që keni përballuar në të shkuarën, që po përballoni tani ose që do të përballoni në të ardhmen, në jetën tuaj, cilin/cilën do ta ndihmoni me suksesin tuaj dhe në çfarë mënyre?

Vini re se bërja e pyetjes në këtë mënyrë ju pengon të vizatoni një pikturë sikur keni fituar llotarinë ose sikur keni lëvizur të jetoni në një ishull tropikal, shumë larg shqetësimeve tuaja. Jeta jote është për ty. Rikthimi me eliksirin do të thotë se ju i keni mposhtur vështirësitë që po hasni për momentin, dhe keni triumfuar mbi plagët që keni marrë në të shkuarën. (Gjithashtu do të thotë se ju i keni mposhtur vështirësitë që nuk ju kanë dalë akoma përpara. Do flasim pas pak më tepër mbi këtë.) Gjithashtu do të thotë se ju keni gjetur diçka me vlerë të vërtetë në udhëtimin tuaj, dhe se udhëtimi juaj është i plotësuar, kur ta sillni atë “eliksir” mbrapsht tek ata që i njihnit, përpara sesa të fillonte aventura juaj.

Filloni duke i lënë pak vend imagjinatës suaj përmes vizatimit të skenës e jo duke e shkruar me fjalë. Vizatimi do t’ju ndihmojë ta bëni konkret dhe specifik vizionin tuaj. Mos u befasoni, nëse në vizatimin tuaj do të keni më tepër gjëra nga sa menduat se po përpiqeshit t’i përcillni. Sapo ta keni mbaruar vizatimin, shkruani për përshkrim të shpejtë të asaj pamjeje, si diçiturë. Nëse është e mundur, kërkojuni njerëzve tek të cilët keni besim ta shohin atë pamje, t’ju bëjnë pyetje për të, dhe t’ju thonë se çfarë gjërash i shohin interesante atje.

Dezertorëve koreanoveriorë, që trajnoj unë, u bëj pyetje lidhur me vizatimin e tyre, të tilla si: Çfarë do të thotë secila veçori e këtij vizatimit? Pse e përfshive secilën pjesë? Cilët je duke vizatuar? Çfarë po bën ti? Kush është identiteti yt? Kush tjetër është i pranishëm? Pse janë ata atje? Edhe ju mund të përpiqeni t’ia bëni vetes këto pyetje.

Pasi të ketë përfunduar vizatimi juaj, do ta keni shumë më të lehtë për të nisur ta shkruani historinë e udhëtimit tuaj të heroit. Është interesante se, sapo ta dini fundin e historisë, do ta keni më të lehtë për ta ditur se çfarë të përfshini në fillim. Personazhet që dikur ishin dominantë në format e mëparshme të historisë suaj, nuk do të duken më kaq imponues ose të pamposhtshëm. Të parët e gjërave “me syrin e Perëndisë” do të zbulojë se ato kthesat e komplotit të mëparshëm që dukeshin të vogla, në fakt ishin mjaft të mëdha. Gjithashtu mund të zbulojë se ato kthesat e mëparshme

të komplotit që dukeshin shumë të mëdha, në fakt ishin më të vogla, nga sa mund të duken në të tashmen.

Teksa shkruani, mos mendoni thellë. Thjesht shkruani për gjërat në botën tuaj të zakonshme. Shkruani lidhur me vendin ku lindët, kush ishin prindërit tuaj, si ishte jeta juaj, çfarë ngjarjesh madhore e shënonin fëmijërinë tuaj. Të gjithë ne shpesh i harrojmë këto elemente kryesore të historive tona. Të ankoruarit e udhëtimit tuaj në botën e zakonshme, fillimi atje dhe rikthimi atje me eliksirin, ka një mënyrë për të na ndihmuar të mposhtim mendjengushtësinë tonë dhe tendencën tonë për t'u fokusuar (tepër shumë) mbi vendin ku jemi pikërisht tani në historinë tonë. Ken Sande, themeluesi i Shërbesave të Paqebërësve dhe Urtësia Relacionale 360 (Peacemaker Ministries and Relational Wisdom 360), rekomandon për çiftet e martuara që kanë probleme mes tyre të kalojnë kohë për t'i parë së bashku albumet e fotografive të tyre. Kjo ka një mënyrë për të na kujtuar për rrënjët e identiteteve tona, se prej nga kemi ardhur dhe kush jemi ne.⁴⁸ Shkrimi për botën tuaj të zakonshme është vërtet ndihmues për këtë.

Teksa e shkruani udhëtimin tuaj, ka shumë të ngjarë që do të vini në çastin e tanishëm shumë më përpara sesa tek hapi i dymbëdhjetë. Kjo do të thotë se, në udhëtimin tuaj të heroit disa hapa ndodhen në të ardhmen. Një aspekt interesant i kornizës së udhëtimit të heroit është se vështirësitë këmbëngulin deri në fund të udhëtimit. Në fakt, hapi i njëmbëdhjetë, ringjallja, sugjeron se sfida më e madhe që do të hasni në jetën tuaj nuk ka ardhur akoma.

Kjo është shumë e vështirë për ta përpunuar. Njerëzit tentojnë të mendojnë pozitivisht. Ne nuk presim vështirësi, dhe patjetër ne nuk duam të mendojmë se e ardhmja do të jetë akoma më e vështirë nga ato gjëra që kemi përballuar deri më tani. Askush nuk thotë: “Bashkëshorti im do të kryejë kurorëshkelje” ose “Unë

⁴⁸ Ken Sande, “Church Discipline: God’s Tool to Heal and Restore Marriages,” in *Pastoral Leadership for Manhood and Womanhood*, ed. Wayne Grudem and Dennis Rainey (Wheaton, IL: Crossway Publishing, 2003).

do të përballem me një sëmundje që kërcënon jetën.” Si mund të shkruajmë për vështirësitë që nuk janë materializuar akoma pa u shqetësuar, pa u bërë me paranoja ose pesimistë? A nuk do të ishte më mirë, thjesht t’i linim bosh këto pjesë?

Jo, dhe ja ku është arsyeja përse. Unë u them dezertorëve koreanoveriorë që i trajnoj se thelbi i tregimit të vështirësive në të ardhmen nuk është që t’ua ngrejë pa shkak gjendjen e tyre të ankthit. Është që t’i ndihmojë ata në mënyrë realiste për të pritur në sferën e sigurisë virtuale se i presin disa probleme serioze në të ardhmen, probleme që do t’i tronditin ata deri në palcë. Është e rëndësishme të përfytyrohet ringjallja që vjen pas asaj tronditjeje me siguri po aq të madhe. Në atë mënyrë, kur materializohen problemet që tronditin jetën, ne i përballim ato me besim dhe shpresë.⁴⁹

Kështu që, teksa i shkruani pjesët e udhëtimit tuaj që nuk kanë ndodhur ende, nuk ka nevojë të trilloni trauma të mundshme, të tilla si pabesia në martesë ose sëmundjet. Në vend të këtyre, shiheni me kujdes, nga afër, me lutje atë vizatimin që bëtë në hapin e dymbëdhjetë, rikthehuni me eliksirin dhe pyeteni veten: Çfarë vështirësish nuk i keni hasur ende në udhëtimin tuaj, që ka të ngjarë t’i hasni gjatë rrugës së të bërit realitet të vizatimit tuaj?

Këto nuk janë pyetje të lehta për t’i bërë ose për t’iu përgjigjur. Ju mund ta gjeni veten duke bërë pyetjen: *A funksionon me të vërtetë korniza e udhëtimit të heroit?* Kjo do të thotë, a iu del më mirë secilit prej dezertorëve koreanoveriorë (dhe madje edhe mua) të mësojmë t’i tregojmë historitë e jetëve tona individuale si udhëtim heroit?

Patjetër do të përgjigjem në formën pohore dhe ndoshta mund të ofroj disa dëshmi ngazëllyese prej burrave e grave, historitë e të cilëve ju i lexuat në këtë libër. Por më shumë unë do të sugjeroj me përlësi se pyetja është bërë në vendin e gabuar, për arsyet që i përmenda te hyrja: Perëndia nuk i dha askujt një histori viktime.

⁴⁹ Cait O’Dwyer, *Imagining One’s Future: A Projective Approach to Christian Maturity* (Rome, Italy: Editrice Pontificia Università Gregoriana, 2000).

Ashtu siç e shpalli Pali te Romakëve 8:37, ne jemi më shumë se fitimtarë për shkak të Krishtit Jezus. Udhëtimi i heroit nuk është as magjik, as profetik. Gjërat që shkruani nuk do të ndodhin, thjesht ngaqë ju i shkruat ato. Nga ana tjetër, udhëtimi i heroit mund të ndihmojë për aftësitë tuaja dalluese. Është një kornizë që na ndihmon të përqendrohemi në aspektet e historisë sonë, të cilat përputhen me ato që na tregon Bibla për veten tonë. Më tepër sesa çdo dëshmi ose studim kërkimor, Bibla është vendi ku do t'ju drejtoja për t'ju inkurajuar që ta ndërmerrni udhëtimin e heroit, dhe për ta marrë atë seriozisht.

Më lejoni t'ju jap një inkurajim e këshillë të fundit, përpara sesa të nиси t'i regjistroni të dymbëdhjetë hapat e udhëtimit tuaj: shkruajini ato në një copë të veçantë letre e jo në këtë libër. Unë vetë e kam shkruar dhe rishkruar udhëtimin tim të heroit disa herë, përfshirë edhe një redaktim të fundit, përpara se ta dorëzoja për botim këtë libër. Arsyeja nuk është për të korrigjuar parashikimet e pasakta të së ardhmes, ose për ta ndryshuar rrënjësisht vizionin që shoh përpara në hapin tim të dymbëdhjetë. Kjo është për t'i kujtuar vetes se historia nuk më përket mua, por Zotit. Unë vetëm mund ta kuptoj atë “si përmes një xhami, të errët,” siç tha apostulli Pal.⁵⁰ Kjo do të thotë se teksta vijnë e shpalosen muajt e vitet, unë fitoj mendjemprehtësi më të madhe jo vetëm për në të ardhmen, por edhe për në të shkuarën. Është mënyra ime për ta nderuar Perëndinë që më zbuloi sesi Ai është duke më përdorur mua dhe historinë time në ndonjë mënyrë të vogël për t'i përmbushur qëllimet e Tij në botë.

Tani është koha që ju të zbuloni të njëjtën gjë për veten tuaj. Zoti ju bekoftë teksta e zotëroni udhëtimin tuaj të heroit për veten tuaj dhe për lavdinë e Perëndisë.

Brenda teje jeton ende një hero.

⁵⁰ 1 Korintasve 13:12

Pasthënie:

Ecja së bashku përgjatë udhëtimit tuaj si hero

E nisa këtë libër duke e kushtuar atë si një libër shprese, një libër të cilin mund ta shihni si të dobishëm dhe tek i cili mund të ktheheni në të ardhmen tuaj ashtu sikurse udhëtimi i heroit tuaj lëviz duke u alternuar sa para - prapa, anash, del nga harta dhe ndonjëherë edhe ngecet fare në vend. Gjithashtu ju tregova sesi edhe të tjerët si ju, me hirin e Perëndisë, ia dolën mbanë t'i përdornin mjetet e këtij libri për të mësuar sesi t'i ringjizin dhe t'i ritregojnë historitë e tyre.

Dua ta përfundoj këtë libër me një shënim, për të cilin lutem se do të jetë po aq shpresëdhënës, për një dhuratë, të cilën nuk e kam përmendur akoma. Është një dhuratë të cilën Zoti ia garanton secilit person, që është i gatshëm ta pranojë thirrjen e tij për t'u nisur në udhëtimin e heroit. Është dhurata e vetë pranisë së tij: “Dhe sigurisht unë jam me ju gjithmonë, deri në fund të epokës.”⁵¹

Nuk ka dyshim se shoqëria është thelbësore për udhëtimin e heroit. Ne jemi të bekuar, ashtu siç e premtoi vetë Zoti, që të kemi shoqërinë e Tij në udhëtimin tonë të Heroit! Ai është në dispozicionin tonë përmes Fjalës së Tij, Biblës, dhe gjithashtu përmes lutjes dhe drejtimit të Frymës së Shenjtë. Por Ai gjithashtu është në dispozicionin tonë përmes popullit të Tij: vëllezërve dhe motrave në Krishtin, që janë nëpër udhëtimet e veta të heroit.

⁵¹ Mateu 28:20b

Për shembull, në rastin tim, unë pata shoqërinë e dhjetë bashkudhëtarëve, domethënë të dhjetë vëllezërve dhe motrave dezertorë koreanoveriorë, historitë e të cilëve përbëjnë këtë libër. Teksa e lexoni librin, ju mund ta keni marrë të mirëqenë se unë veprova si një guidë turistike për secilin prej tyre, duke ua mësuar atyre udhëtimin e heroit, sikur unë të kisha mbërritur tashmë në destinacion dhe po u jepja atyre drejtimet sesi të bashkoheshin me mua në vijën e përfundimit. Kjo padyshim nuk është e vërteta. Apostulli Pal shkroi këtë lidhur me udhëtimin e tij të heroit:

Jo se unë e kam kapur (çmimin), ose kam mbërritur tashmë tek vendi i synuar, por unë këmbëngul që ta kap atë, për të cilën Krishti Jezus më kapi mua. Vëllezër e motra, unë akoma nuk e konsideroj veten se e kam kapur. Por bëj një gjë: Duke harruar ato që janë prapa dhe duke u prirur drejt atyre që janë përpara, unë ndjek me këmbëngulje qëllimin për të fituar çmimin për të cilin Perëndia më ka thirrur drejt qiellit në Krishtin Jezus.⁵²

Në Bibël nuk ka guida turistike për udhëtimin e heroit. Edhe Jezusi është portretizuar si një bashkudhëtar!⁵³ Sot ne kemi një emër për këta “shoqërues udhëtimi”, të cilët ecin përbri nesh dhe na ndihmojnë t'i kuptojmë udhëtimet tona duke na siguruar me disa nga mjetet që ata kanë marrë nëpër udhëtimet e tyre. Ne i quajmë ata trajnerë.

Ka kuptim që nuk mund të jesh në udhëtimin e heroit pa pasur trajner, ngaqë pa një trajner ne kurrë nuk mund ta kuptojmë se ky udhëtim në të cilin jemi nisur është një udhëtim heroit. Edhe fakti që po e ndaj me ju kornizën e udhëtimit të heroit është një vepër trajnimit; pas së gjithash, unë ua propozova si një mjet që më ndihmoi mua dhe të tjerët t'u japin kuptim jetëve të tyre në një mënyrë fuqizuese, e cila është e vërtetë sipas shkrimeve.

⁵² Filipianëve 3:12-14

⁵³ Luka 24:13-35

Është e rëndësishme të qartësohet se çfarë është e çfarë nuk është një trajner. Ka një arsye se pse përdora fjalën “shoqërues” e jo “guidë turistike” për ta përshkruar këtë rol. Ashtu siç e sqaron trajneri Dejell Stoll (Dale Stoll), një trajner i vërtetë nuk shton asnjë gjë në ty, e cila nuk ishte atje më përpara; përkundrazi, roli i një trajneri është të ndihmojë që të nxjerrë prej teje atë që Perëndia e ka vendosur brenda (dhe ndonjëherë është e fshehur aq mirë, sa që as ju vetë nuk e dinit se ajo ekzistonte).⁵⁴ Kjo do të thotë se trajneri dhe i trajnuari janë të barabartë; në fakt rolet shpesh ndërrojnë vendet në pika të ndryshme gjatë udhëtimit.⁵⁵

Mendoni për vetë udhëtimin tim. Siç ju tregova më përpara te ky libër, kishte çaste gjatë udhëtimit në të cilat ndjeva aq shumë dhimbje, sa që ishte e vështirë ta bëja edhe një hap të vetëm përpara. Por ndërkohë që dezertorët koreanoveriorë bashkohen me mua në shtegun e udhëtimit të heroit, unë zbulova se historitë e tyre përfshinin shumë më tepër dhimbje nga sa kisha përjetuar unë. Në disa raste, historitë e tyre përfshinin shumë më tepër dhimbje nga sa mund të arrija të kuptoja! Po të isha përpjekur të sillesha si një “guidë turistike” për ta, duke u shtirur se mund t’u jepja atyre diçka për dhimbjen, që ata nuk e dinin, kishte shumë të ngjarë (dhe me të drejtë) që ata nuk do të ma kishin vënë veshin. Dhe mua do të më duhej t’i ekzagjeroja aspektet e viktimës brenda historisë sime, me qëllim që t’i bindja ata se “unë e ndiej dhimbjen tuaj.” Përkundrazi, si një “trajner shoqërues” unë mund t’u them atyre: Dhimbja ime nuk krahasohet dot në asnjë mënyrë me dhimbjen tuaj. Por një gjë që e kam parë në jetën time është se dhimbjet më të mëdha që përjetova, në fakt u shndërruan në kapitujt e një historie edhe më të madhe, që po e tregonte Perëndia dhe të cilën unë nuk mund ta shihja dot. Ajo historia më e madhe ishte një histori hero

⁵⁴ Tony Stoltzfus, *Leadership Coaching: The Disciplines, Skills and Heart of a Christian Coach* (Virginia Beach, VA: Tony Stoltzfus, 2005), 7.

⁵⁵ Lester J. Foltos, *Peer Coaching: Unlocking the Power of Collaboration* (Thousand Oaks, CA: Corwin, 2013).

dhe jo një tregim viktime. A do të donit të shihnit, se mos ndoshta e njëjta gjë është e vërtetë edhe me dhimbjet tuaja më të mëdha?”

Me të vërtetë ishte një partneritet i barabartë. Teksa ata nisën t'i tregonin historitë e tyre sipas kornizës së udhëtimit të heroit, kjo gjë më bëri ta shihja vetë udhëtimin tim në një mënyrë të re dhe më të thellë. Duke i trajnuar ata, e kuptova se ende ka dhimbje të mëdha në jetën time, që unë pëpiqem t'i le jashtë historisë së udhëtimit tim të heroit, për shkak se ato janë akoma të dhimbshme për mua për t'i kujtuar. Por teksa të dhjetë dezertorët në këtë libër ndanë me mua kujtime të dhimbshme njëri pas tjetrit, duke i treguar ato sërish në kornizën e udhëtimit të heroit, mora guxim më të madh për ta ndarë udhëtimin tim të heroit të plotë me ju dhe të tjerët. Shpresoj se leximi i të gjitha historive së bashku në këtë libër do të ketë të njëjtin efekt te ju.

Partneriteti i barabartë është thelbi i trajnimit. Në fakt, Federata Ndërkombëtare e Trajnimit e përkufizon trajnimin si “partneritet me klientët në një mënyrë që provokon mendime dhe një proces krijues, i cili i frymëzon ata të maksimalizojnë potencialin e tyre personal dhe profesional.”⁵⁶ Kjo është shumë më ndryshe nga përvoja që shumë prej nesh patëm me profesionet ndihmuese, si këshillimi. Atje ne varemi nga përvoja profesionale e këshilluesit, që të na sigurojë neve diçka që na mungon. Për kontrast, në trajnim ne e fillojmë me idenë se ajo që kemi (përfshirë edhe dhimbjen tonë) është mjaft e dobishme dhe e mjaftueshme; gjithçka që na nevojitet është pak drejtim. Kemi nevojë për një kornizë, si ajo e udhëtimit të heroit për të na ndihmuar që ta dimë sesi ta kuptojmë dhe përdorim atë për lavdinë e Perëndisë.⁵⁷

Meqenëse unë vij nga një kulturë shumë hierarkike në Kore, jam skeptike në thelb për pretendime të tilla si ai që trajnimi

⁵⁶ International Coaching Federation, “FAQs,” ICF, March 12, 2014, lexuar më 12 mars, 2014, <http://www.coachfederation.org/about-icf/overview/>.

⁵⁷ Tina D. Connan, “What’s the Difference Between Counseling and Coaching?” Tina D. Connan, NCC, LMHC, March 12, 2014, lexuar më 12 mars 2014, <http://www.bocawomencare.com/WhatstheDifferenceBetweenCoachingCounseling.en.html>.

kërkon që trajnuesi dhe klienti ta trajtojnë secilin si të barabartë. Jam rritur të mendoj se ndërkohë që miqësia, dashuria, dhe përkujdesi janë në dispozicion prej bashkëmoshatarëve tanë, ne duhet t'u drejtohem njerëzve që janë përmbi ne, për të marrë gjërat që mund të sjellin ndryshim në jetët tona, qoftë para, pushtet, urtësi, mprehtësi ose shëndet. Po të flas me ndershmëri, unë u rrita të mendoj në atë mënyrë për Perëndinë. Por Jezusi, Perëndia i bërë mish, na tregon një rrugë të ndryshme. Ai udhëton bashkë me ne. Fjalët e Tij të fundit, të shënuara më sipër, janë ato ku thotë se ai do të vazhdojë të udhëtojë me ne, deri në fund të epokës. Nëse Perëndia zgjodhi të jetë shoqëruesi ynë e jo guida jonë turistike, atëherë a nuk duhet edhe ne të jemi kështu për njëri-tjetrin?

Kështu që, teksa ndërmerrni përsipër ta shkruani udhëtimin tuaj të heroit, unë ju inkurajoj që të takoni trajnerë, të cilët mund të jenë shoqëruesit tuaj gjatë udhëtimit, të cilët mund t'ju japin tre premtime, për të cilat Thorn, Goldsmith dhe Mekllaud (McLeod) thonë se janë thelbësore për trajnimin:

- Unë premtoj të jem partneri yt për mendimin.
- Unë premtoj të jem mbështetësi yt objektiv.
- Unë premtoj të të ndihmoj që të jesh i përgjegjshëm.⁵⁸

Vini re, se bërja dhe mbajtja e këtyre tre premtimeve, nuk kërkon asnjë trajnim të avancuar profesional ose certifikim; ti dhe një lexues tjetër mund ta trajnoni njëri-tjetrin përmes procesit të udhëtimit të heroit të përvijuar në këtë libër, thjesht duke i bërë këto premtime dhe duke u përkushtuar t'i ndani së bashku udhëtimet tuaja. Në fakt, disa studime të fundit tregojnë se ky lloj i trajnimit mes kolegësh mundet

⁵⁸ Andrew Thorn, Marilyn McLeod, and Marshall Goldsmith, "Peer coaching overview," Marshall Goldsmith Library, 2007, lexuar më 12 mars 2014 from <http://www.marshallgoldsmithlibrary.com/docs/articles/Peer-Coaching-Overview.pdf>.

në fakt të bëjë dallimin mes dështimit e suksesit.^{59, 60} Natyrisht, Bibla na e ka thënë këtë shumë kohë më parë: Autori i Fjalëve të Urta thotë: “Planet dështojnë nga mungesa e dëshmitarëve, por atje ku ka shumë këshillues, ato dalin me sukses.”⁶¹

Vetë ky libër është produkt i trajnimit mes kolegësh. Fillimisht, unë e regjistrova me video udhëtimin tim të heroit bashkë me udhëzimet dhe me gjithë fletën e punës së udhëtimit të heroit, që e kisha hartuar, e ua dhashë ato të dhjetë dezertorëve, historitë e të cilëve janë përfshirë në këtë libër. U kërkova atyre t’i përdornin këto materiale për t’i hartuar e për të shkruar historitë e tyre. Qëllimi im ishte të zhvilloja një burim për studim vetiak. Por përmes trajnimit të tyre unë arrita të kuptoj se udhëtimi i heroit nuk është kurrë një aventurë individuale! Natyrisht ata kishin nevojë të flisnin me njëri-tjetrin dhe me mua për të pyetur sesi i kuptonim ne pjesët e ndryshme të udhëtimit dhe sesi i kishim përjetuar ato.

Rezultati përfundimtar ishte se ky projekt u transformua në mënyrë thelbësore në tre mënyra: Së pari, unë arrita ta shoh rëndësinë e sigurimit të lexuesve me shumë histori, jo vetëm me timen, si një ndihmë trajnimi. Edhe pa qenë fizikisht të pranishëm, secili prej dhjetë heronjve në këtë libër ndihmon për t’ju aftësuar që ta kuptoni konceptin e udhëtimit të heroit dhe ta zbatoni atë në jetën tuaj. Së dyti, e shtova këtë kapitull të fundit si një pikë kulmore në mbështetje të rekomandimit që të punoni përmes këtij libri me ndihmën e trajnuesve në nivel kolegu ose edhe me një trajnues

⁵⁹ Paul Bray, Doyle M. Cummings, Susan Morrissey, Debra Thompson, Don Holbert, Kyle Wilson, Eric Lukosius, and Robert Tanenberg, “Improved Outcomes in Diabetes Care for Rural African Americans,” *Annals of Family Medicine* 11, no. 2 (March/April 2013): 145-150.

⁶⁰ David H. Thom, Amireh Ghorob, Danielle Hessler, Diana De Vore, Ellen Chen, and Thomas A. Bodenheimer, “Impact of Peer Health Coaching on Glycemic Control in Low-Income Patients With Diabetes: A Randomized Controlled Trial,” *Annals of Family Medicine* 11, no. 2 (March/April 2013): 137-144.

⁶¹ Fjalët e Urta 15:22.

profesional. Ashtu siç u thotë Vudi (Woody) shokëve e shoqeve të tij lodra tek filmi i Disney *Toy Story*: “Një shok për kokë, që të nxit. Nëse nuk e ke një të tillë, gjeje!”⁶² Përndryshe, edhe lexuesi më i zellshëm mund të humbasë ose të ngecet teksa përpiket të lundrojë përmes udhëtimit të heroit si një udhëtar i vetëm fare.

Vini re se e përmenda idenë e një trajnuesi profesional në paragrafin e mëparshëm. Tani ju mund të bindeni për vlerën e një trajnuesi mes kolegësh për t’ju shoqëruar në udhëtimin tuaj, por mund të pyesni veten se çfarë ndihme shtesë mund të sigurojë një trajnues profesional. Shkencëtari i sporteve pioniere Tim Noks (Tim Noakes) tregon historinë e Xhon Landi-t (John Landy), burrit të dytë që vrapon 1.61 kilometra në më pak se katër minuta. Noks tregon se Landi kishte të ngjarë të ishte atlet më i mirë sesa Roxher Banister-i (Roger Banister), burri i parë që e theu pengesën katër minutëshe. Në fakt, Landi kishte arritur ta mbyllte distancën prej 1.61 kilometra për katër minuta e dy sekonda *shtatë herë*, përpara sesa Banisteri më në fund ta thyente kufirin katërminutësh. Por disa ditë përpara se Banisteri ta arrinte përfundimisht këtë vendosje rekordi, Landi e përshkruante detyrën si të “ishe duke u përpjekur të depërtoje përmes një muri me tulla.” Në 6 maj 1954, ditën kur Banisteri depërtoi përmes atij muri, ai në fillim i tha trajnerit të tij se nuk donte të merrte pjesë në garë për shkak të motit të keq; megjithatë, trajneri i Banisterit i tha atij se ai mund ta kapte kohën 3:56 për 1.61 kilometra, nëse do të përkushtohej të vraponte atë ditë. Banisteri ra dakord të vraponte dhe ajo pengesa e pamundshme ra. Pas vetëm 46 ditësh, Landi do ta thyente rekordin e Banisterit. Noks shpjegon se, arsyeja pse Banisteri e vendosi rekordin e jo Landi, ishte se Banisteri kishte një trajner, që e bindi atë se përbrenda tij kishte më tepër potencial, nga sa ai vetë besonte se e kishte atë. “Ajo gjë që ne

⁶² John Lasseter, Pete Docter, Andrew Stanton, and Joe Ranft, “Toy Story,” DailyScript.com, March 13, 2014, lexuar më 13 mars 2014, http://www.dailyscript.com/scripts/toy_story.html.

vërtet na duhet në jetë, - thotë Noks, - është një trajner që do të na japë vetëbesimin për të bërë atë që është e jashtëzakonshme.”⁶³

E pashë këtë dukuri në punë, teksa trajnoja dezertorët koreanoveriorë, historitë e të cilëve shfaqen në këtë libër. Së pari, ata folën mes tyre, dhe kishin dyshime serioze, nëse dhimbja dhe pengesat e tyre mund të ishin pjesë e udhëtimit të një heroit. Ashtu si trajneri i Roxher Banisterit, roli im si trajner profesional ishte t’u jepja atyre vetëbesimin për të bërë diçka të jashtëzakonshme. Dhe pikërisht si Roxher Banisteri, që të dhjetë ata depërtuan përmes mureve me tulla në jetët e tyre çuditërisht shpejt.

Kjo është vlera e një trajneri profesional. Ndonjëherë që të gjithë trajnerët mes kolegësh në jetën tuaj mund të të thonë se nuk mundesh dot ta përfundosh udhëtimin e heroit. Kurse një trajner profesional, që shërben si një partner i mendimit krijues, mund të të japë mbështetje objektive dhe të të mbajë përgjegjës, bazuar mbi përvojën e gjerë dhe përfshirjet e suksesshme në trajnime në të kaluarën. Rezultati është se ti mund të nisësh të besosh tek e jashtëzakonshmja.

I jam falënderuese Zotit, që Ai më aftësoi për të besuar në gjërat e jashtëzakonshme për secilin nga njerëzit në këtë libër. Nga ana ime kjo ishte më tepër sesa një mendim i dëshiruar. Ishte e vërtetë objektive, e nxjerrë nga fjala e Perëndisë, e kombinuar me përvojën time të kaluar mbi trajnimet dhe ishte dhuntia e vetëbesimit, të cilën ma dha Zoti vonë, në udhëtimin tim të heroit. Kjo gjë më aftësoi për të parë se secili prej këtyre dezertorëve gjithashtu ishte në një udhëtim heroit, edhe pse asnjëri prej tyre nuk e besonte atë, kur filluam të punonim së bashku në këtë projekt. Tani ata kanë depërtuar nëpër muret e tyre prej tulle, dhe më kanë lejuar mua që t’i përfshij historitë e tyre këtu, bashkë me historinë time, që së bashku të mund ta rritim edhe vetëbesimin tuaj.

Gjithçka që ju duhet të bëni është të përkushtoheni për të vrapuar sot. Zoti do të kujdeset për pjesën tjetër të gjërave, ndoshta duke përdorur në jetën tuaj trajnerë prej kolegëve ose profesionistëve.

⁶³ Tim Noakes, “The Mindset to Succeed” (video), June 16, 2012, lexuar më 13 mars 2014, <http://www.youtube.com/watch?v=dYWLfPmnJSI>.

Bibliografia

Bickford, Jim. American Comeback. Las Vegas, NV: American Comeback-Publishing, 2013.

Bray, Paul, Cummings, Doyle M., Morrissey, Susan, Thompson, Debra, Holbert, Don, Wilson, Kyle, Lukosius, Eric, and Tanenberg, Robert. "Improved Outcomes in Diabetes Care for Rural African Americans." *Annals of Family Medicine* 11, no. 2 (March/April 2013): 145-150.

Campbell, Joseph. *The Hero with a Thousand Faces* (The Collected Works of Joseph Campbell), 3d ed. Novato, CA: New World Library, 2008.

Central Intelligence Agency. *The World Factbook: Korea, North*. <https://www.cia.gov/the-world-factbook/countries/korea-north/>. (accessed Oct 15, 2021).

Chisolm, Linda A. *Charting a Hero's Journey*. New York, NY: The International Partnership for Service Learning, 2000.

Choi Song Min. "Re-defections chalked up by Musan NSA," *Daily NK*, November 13, 2012. <http://www.dailynk.com/english/read.php?cataId=nk01500&num=10028> (accessed November 23, 2012).

Connan, Tina D. "What's the Difference Between Counseling and Coaching?" Tina D. Connan, NCC, LMHC, March 12, 2014. <http://www.bocawomencare.com/WhatstheDifferenceBetweenCoachingCounseling.en.html> (accessed March 12, 2014).

Demick, Barbara. *Nothing to Envy: Ordinary Lives in North Korea*. New York, NY: Spiegel & Grau, 2009.

Disraeli, Benjamin. *Coningsby: Or the New Generation*. Boston, MA: Adamant Media, 2000.

Fuqua, Jacques L., Jr. *Korean Unification: Inevitable Challenges*. Dulles, VA: Potomac Books, 2011.

George, Linda. *Fill-in-the-Blank Plotting: A Guide to Outlining a Novel Using the Hero's Journey & Three-Act Structure*. Milwaukee, WI: Crickhollow Books, 2009.

Hunter, Helen-Louise. *Kim Il-song's North Korea*. Westport, CT: Praeger, 1999.

International Coaching Federation. "FAQs." ICF, March 12, 2014. <http://www.coachfederation.org/about-icf/overview/> (accessed March 12, 2014).

International Crisis Group "Strangers at Home: North Koreans in the South." Crisis Group Asia Report No. 208, 14 July 2011.

Jae, Mok Yong. "80% of Defectors Struggle to Hold Down Positions." *Daily NK*, February 14, 2011. <http://www.dailynk.com/english/read.php?cataId=nk00100&num=7357> (accessed March 11, 2014).

Jeon, WooTaek, Hong ChangHyung, Lee ChangHo, Kim, Dong Kee, Han, Mooyoung, and Min, SungKil. "Correlation between Traumatic Events and Posttraumatic Stress Disorder Among North Korean Defectors in South Korea." *Journal of Traumatic Stress* 18, no. 2 (April 2005): 147-54.

Kim, Hyung-chan and Kim, Dong-kyu. *Human Remolding in North Korea: A Social History of Education*. Lanham, MD: University Press of North America, 2005.

Kim Joon-Ho. "Pyongyang Moves to Identify Defectors." *Radio Free Asia*, March 12, 2012. <http://www.rfa.org/english/news/korea/defectors-03122012163808.html> (accessed March 11, 2014).

Kwon, Heonik and Chung, Byong-Ho. *North Korea: Beyond Charismatic Politics*. Lanham, MD: Rowman & Littlefield, 2012.

Lamond, Bill. *Born to Lead*. New York NY: Penguin Books, 2006.

Lasseter, John, Docter, Pete, Stanton, Andrew, and Ranft, Joe.

"Toy Story." *DailyScript.com*, March 13, 2014.

http://www.dailyscript.com/scripts/toy_story.html (accessed March 13, 2014).

McGregor. "Margaret Thatcher, In Her Own Words." *The Washington Post*, April 8, 2013.

http://www.washingtonpost.com/business/on-leadership/margaret-thatchers-best-quotes/2013/04/08/97abce78-a07d-11e2-82bc-511538ae90a4_story.html (accessed March 11, 2014).

Ministry of Unification, Policy on North Korean Defectors. Policy on North Korean defectors<Data & Statistics<South-North Relations<통일부_영문. Retrieved September 30, 2021 from https://www.unikorea.go.kr/eng_unikorea/relations/statistic/defectors/.

Minow, Martha. "Surviving victim talk." *UCLA L. Rev.* 40 (1992): 1411.

Noakes, Tim. "The Mindset to Succeed" (video). June 16, 2012. <http://www.youtube.com/watch?v=dYWLfPmnJSI> (accessed March 13, 2014).

O'Dwyer, Cait. *Imagining One's Future: A Projective Approach to Christian Maturity*. Rome, Italy: Editrice Pontificia Università Gregoriana, 2000.

Pennebaker, James W. "Telling Stories: The Health Benefits of Narrative." *Literature and Medicine* 19:1 (2000): 3-18.

Ravi, Hema. "Ode to Mother." *Poem Hunter*, August 13, 2009. <http://www.poemhunter.com/poem/ode-to-mother-2/> (accessed March 11, 2014).

Sande, Ken. "Church Discipline: God's Tool to Heal and Restore Marriages." In *Pastoral Leadership for Manhood and Womanhood*. Ed. Wayne Grudem and Dennis Rainey. Wheaton, IL: Crossway Publishing, 2003.

Sohn, Ho-Min. *The Korean Language*. New York, NY: Cambridge University Press, 1999.

"Sparky Anderson Quotations." *Memorable Quotations*. <http://www.memorablequotations.com/anderson3.htm> (accessed March 10, 2014).

Special Reporting Team. "DPR Korea: Defector Among Us— What Does She Look Like." Reliefweb, October 19, 2010. <http://reliefweb.int/report/democratic-peoples-republic-korea/dpr-korea-defector-among-us-what-does-she-look> (accessed March 11, 2014).

Stoltzfus, Tony. *Leadership Coaching: The Disciplines, Skills and Heart of a Christian Coach*. Virginia Beach, VA: Tony Stoltzfus, 2005.

"The Chinese Farmer." Inspire21. <http://www.inspire21.com/stories/lifestories/TheChineseFarmer> (accessed March 10, 2014).

Thom, David H., Ghorob, Amireh, Hessler, Danielle, De Vore, Diana, Chen, Ellen, and Bodenheimer, Thomas A. "Impact of Peer Health Coaching on Glycemic Control in Low- Income Patients With Diabetes: A Randomized Controlled Trial." *Annals of Family Medicine* 11, no. 2 (March/April 2013): 137-144.

Thorn, Andrew, McLeod, Marilyn, and Goldsmith. "Peer coaching overview." Marshall Goldsmith Library, 2007. <http://www.marshallgoldsmithlibrary.com/docs/articles/Peer-Coaching-Overview.pdf> (accessed March 12, 2014).

Tolkein, J.R.R. *The Return of the King: Being the Third Part of the Lord of the Rings*. Boston, MA: Houghton Mifflin Harcourt, 2012.

Vogler, Christopher. *The Writer's Journey: Mythic Structures for Writers*, 3d ed. Studio City, CA: Michael Wiese Productions, 2007.

Yang, Jongsung. *Cultural Protection Policy in Korea: Intangible Cultural Properties and Living National Treasures*. Seoul, Korea: Jimoodang International, 2003.

Për Autoren

E Përndershëmja Dr. Hjun Suk Folei është bashkë-themeluese dhe Presidente e “Zëri i Martirëve” në Kore, që kërkon ta mbajë të gjallë shpirtin e martirëve në Kishën Koreane. Ajo është një shërbëtoresh aktive në fushën e përndjekjes globale ndaj të krishterëve dhe gjithashtu një studiuese, që përpiket të bëjë kërkime e t’i zgjidhë problemet për praktikantët dhe grupet e politikave. E Përndershëmja Dr. Folei është një zë mbarëbotëror edhe në komunitetin e krishterë të Koresë së Veriut, edhe në atë të grave të përndjekura, dhe ka folur edhe në kuvende kombëtare, edhe në ato globale në Sri Lanka, Finlandë, Poloni, Belgjikë, Australi, Holandë dhe në Mbretërinë e Bashkuar (MB). Ajo krijon rrjete me drejtueset e shërbësve në Amerikën e Veriut, Evropë dhe Azi, sidomos në fushat e drejtimit të shërbësve, dishepullimit dhe krishterimit koreanoverior. Ajo gjithashtu shërben si anëtare e bordit të statutit për Këshillin e Krishterë për Transparencën Financiare në Kore. Ajo mori doktoraturën në Drejtimi Strategjik nga Universiteti Regent dhe u shugurua nga KAICAM. Ajo është përkthyes e një numri librash të krishterë dhe burimesh, duke përfshirë materialet për të ndihmuar me këshillimin për veten, librin *Paqebërësi* nga Shërbesat Paqebërësi dhe *Këta janë brezat*, i cili detajon historinë e të krishterëve të fshehtë në brezin e tretë në Korenë e Veriut.

Çfarë është “Zëri i Martirëve”?

Te Luka 9:23, Zoti Jezus thotë: “Kushdo, që do të jetë dishepull i imi, duhet ta mohojë vetveten dhe ta marrë kryqin e vet përditë e të më ndjekë.” Kjo mund të tingëllojë shumë e trishtë dhe shqetësuese për të krishterët, që ndjekin shtegun e botës për lumturi. Të krishterë të tillë shpesh ndihen keq për ata persona, të cilëve iu duhet të vuajnë sepse janë të krishterë. Ata shpresojnë për një jetë begatie pa vuajtje, për veten e për të tjerët.

Por është një “Re e Madhe e Dëshmitarëve” (Hebrenjve 12:1), e cila njih një shteg më të mirë. Këta janë burra e gra përreth botës dhe në vendin tonë, edhe në të shkuarën, edhe në kohën tonë, të cilët i dorëzuan jetët e tyre për Zotin në një çast, ose që e jetojnë dashurinë e tij sakrifikuese për shumë vjet. Ata na mësojnë se marrja dhe ndarja e dashurisë së Perëndisë është e denjë për cilëndo sasi të vuajtjes njerëzore dhe se një dashuri e tillë nuk mund të ndalet prej asnjë pushteti në tokë, përfshirë edhe vdekjen. Mënyra e tyre është i vetmi shteg për një gëzim të thellë dhe të përgjeshëm. Është jeta e krishterë normale.

“Zëri i Martirëve” në Kore është përkushtuar për t’i aftësuar të krishterët e sotëm koreanë, edhe nga Jugu, edhe nga Veriu, si edhe vëllezërit e motrat e krishterë nga e gjithë bota me lidhje të veçanta me Korenë, që ta kujtojnë këtë shteg dhe të mësojnë së bashku sesi të ecin mirë përgjatë atij. Ne e bëjmë këtë duke dëgjuar nga afër zërin e Jezusit, dhe të atyre martirëve të krishterë koreanë, të hershëm, si dhe të të krishterëve të përndjekur anembanë botës sot, të cilët e ndjekin atë pavarësisht gjithçkaje, sidomos në Korenë e Veriut. Ne kemi partneritet dhe përbashkësi me ata që vuajnë

për Krishtin, jo me keqardhje ose trishtim, ose një dëshirë për t'i shpëtuar ata, por me bindjen se dashuria sakrifikuese e Krishtit është thesari më i madh që njerëzit mund ta marrin prej Perëndisë dhe që mund ta shprehin në jetët e tyre.

“Zëri i Martirëve” u themelua në vitin 1967 prej Të Përndershmit Riçard Vurmbrand (Richard Wurmbrand), një pastor nga Rumania, i cili u burgos dhe u rrah për besimin e tij për më shumë se 13 vjet prej autoriteteve komuniste. Sot, punën e Të Përndershmit Vurmbrand e vazhdojnë organizatat e pavarura “Zëri i Martirëve” në më tepër se 20 vende, në partneritet me besimtarët e përndjekur në më tepër se 70 kombe.

I Përndershmi Erik Folei dhe E Përndershmi Hjun Suk Folei e themeluan “Zërin e Martirëve” në Kore në vitin 2003.

Për më tepër informacion mbi “Zërin e Martirëve” në Kore dhe për burime të tjera për ecjen me Krishtin bashkë me martirët, për të krishterët e hershëm koreanë, dhe për besimtarët e sotëm që përndiqen kudo nëpër botë, vizitoni <http://www.vomkorea.com>, na merrni në telefon te ky numër: 02-2065-0703, ose na dërgoni email te kjo adresë: info@vomkorea.com.

Prezantimi i UF / TF

ZIM Koreja drejton dy shkolla për dezertorët koreanoveriorë: Teknologjia e Fshehtë (TF) dhe Universiteti i Fshehtë (UF). Teknologjia e Fshehtë i dishepullizon dezertorët nga Koreja e Veriut për bazat e besimit të krishterë, kurse Universiteti i Fshehtë jo vetëm që i mëson dezertorët koreanoveriorë si të kryejnë shërbesë në Korenë e Veriut, por është një shkollë, përmes së cilës ata kryejnë shërbesë në Korenë e Veriut. Në vend që të presin për ribashkimin, studentët e UF ndërmarrin hapa drejt ribashkimit duke iu shërbyer njerëzve të tyre në Korenë e Jugut (aktualisht në Korenë e Jugut ka 34,000 koreanoveriorë) dhe në vijat e frontit – për ata koreanoveriorë që kanë dezertuar, janë trafikuar për seks, dhe të cilët janë të izoluar, të sëmurë, ose që janë dërguar për të fituar para për regjimin e Koresë së Veriut anembanë nëpër vendet e botës.

UDHËTIMI I HEROIT

MËSONI PREJ TË KRISHTERËVE KOREANOVERIORË HISTORINË JETË-SHPËTUESE, QË PERËNDIA TREGON ... PËR JU!

Teksa koreanoveriorët rriten, atyre iu duhet të mësojnë përmendsh më tepër se njëqind histori për jetën e Kim Il Sung-ut. Kim Il Sung-u është heroi i pothuajse çdo historie në Korenë e Veriut. Por, kur koreanoveriorët arratisen prej vendit të tyre, ata mësojnë se Kim Il Sung-u nuk ishte hero. Ata vuajnë teksa përpiqen t'i japin kuptim jetës. Ata i pranojnë shpejt historitë që u tregojnë të tjerët atyre: Se ata janë viktimat, ose madje edhe tradhtarët. Rezultatet janë fatale: dezertorët koreanoveriorë kanë përqindjen më të madhe të vdekjeve për shkak të vetvrasjes nga të gjitha grupet në botë.

Kjo është arsyeja se përse u përfshiva me trajnimin e dezertorëve koreanoveriorë lidhur me ritregimin e historive të tyre duke përdorur kornizën e “udhëtimit të heroit”. Unë u tregoj atyre se Perëndia synon që ne të triumfojmë mbi armiqtë tanë me anë të gjakut të Birit të Tij, Jezusit, dhe me anë të fjalës së dëshmisë sonë. Kjo ju përfshin edhe juve. Secili prej nesh duhet të mësojë sesi t'i tregojë historitë e veta në atë mënyrë që i tregon ato Perëndia. Po të mos veprojmë kështu, historitë tona gjithmonë do të kenë fund jo të lumtur. Në këtë libër do të lexoni “udhëtimet e mrekullueshme të heroit” për dhjetë të krishterë nga Koreja e Veriut. Unë do t'ju tregoj sesi mësova ta braktisja “historinë time të viktimitës”, me qëllim që të bëhesha fitimtare në Krishtin — dhe do t'ju tregoj sesi edhe juve mund të bëni kështu.



E Përndershëmja Dr. Hjun Suk Folei (Dr. Hyun Sook Foley) është Bashkë-Themeluese dhe Presidente e Zërit të Martirëve në Kore. Për më shumë se 15 vjet ajo ka qenë pioniere dhe drejtuese për punën me Korenë e Veriut, duke përfshirë punën me besimtarët e fshehtë në Korenë e Veriut, dy shkolla trajnimi për dezertorët nga Koreja e Veriut (Universiteti i Fshtëtë dhe Teknologjia e Fshtëtë) në Korenë e Jugut, transmetimet në radio dhe dërgimin e balonave për në Korenë e Veriut, përkthimin dhe shtypjen e Biblave dhe materialeve dishepullizuese në dialektin e Koresë së Veriut.